



SKENDER DRINI

**NJEREZIT
DHE DETI**

roman

81H-31

876

SKËNDER DRINI

NJERËZIT DHE DETI



roman

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

I

Shefi i kuadrit i numëroi profesionet që kishte ndërruar dhe ndërmarrjet ku nuk kishte zënë vend. Diç kërkonte me ngulm me librezën e punës, duke e vërtitur nëpër duar dhe duke ngritur sytë nga Deni, sa për ta ndezur më shumë. E tërhoi! Vështrimi i tij shprehte dyshim dhe mosbesim. Qe korrekt, po i ftoh-të. Ishte një burrë i dobët dhe i bardhë në fytyrë. Edhe duart i kishte të bardha. Ishte përjashtimi i vetëm i atij vendi me diell dhe me det.

Deni e shkarkoi me humor gjithë zemërimin mbi kravatën e hollë të shefit të kuadrit. Në peshkim atë e quanin «Kravata e ngushtë».

— Pastaj ke këtë ndërprerjen...

— Pse duhet gjithë kjo biografi? — nuk iu durua më Denit.

— Pesë profesione dhe asnjë profesion! — tha shefi i kuadrit sikur të kishte zbuluar ndonjë komplot.

Nuk e priste këtë. Kishtë ndërruar punë dhe ndërmarrje, po kudo diçka kishte mësuar. Madje diku kishte kërkuar dhe rrugë të reja. E mbanin për të shkaktët dhe këtë duhet ta dinte edhe shefi i kuadrit. Ata njiheshin.

— Kush thotë që nuk kam asnjë profesion? — e ngriti zërin Deni.

— Kjo! Kjo është gjithçka! Këtu janë rregulli, shkenca, disiplina, organizimi, shteti... — gati sa nuk i ngriti një himn librezës së punës shefi i kuadrit.

Deni zgjati dorën si i hutuar, po tjetri e mbuloi me pëllëmbë librezën. Ai jetonte tani çastin e madh të marrjes së njerëzve në punë. Përpara tij shpalosej jeta e njerëzve, ku ai hynte me përgjegjësi të madhe, vetëm me ligje dhe rregullore. E zgjaste sa mundte takimin e parë me njerëzit dhe donte që ata të bindeshin patjetër se puna fillonte nga ajo zyrë. Nuk mund të kishte punë pa atë zyrë! Ajo ishte hallka kryesore në ingranazhet e mëdha të shtetit.

Deni psherëtiu. Iu duk se ai tjetri ia kishte bërë librezën e punës më të shenjtë se nënën e tij! Iu kujtua doktor Marku dhe formoi një përshtypje të shtrembër për shefin e kuadrit. «Shefat e kuadrit janë ziliqarë...» — i kishte thënë ai. «Ndonjëri nga shefat...» — ishte përgjigjur Deni. «E di pse janë ziliqarë ata? Se përmes duarve të tyre përshkohen dekorimet, rruget për jashtë shtetit, ngritjet në përgjegjësi», — kishte vazhduar mjeku.

Ai që kishte përpara nuk ishte ziliqar, po diçka tjetër që nuk po arrinte ta merrte vesh.

— Pse u ktheve sërish në det? — ndërroi tonin shefi i kuadrit.

T'i thoshte që i ishte zgjuar malli i detit si një vegim krejt i papritur dhe që e kishte bekuar atë thirrjen që kishte bërë peshkimi për specialistë?

— Iu përgjigja thirrjes suaj! — tha shkurt Deni.

— Vendet për saldator dhe motorist u zunë nga ak-

5
sionistët që erdhën përpara teje. Mbetet të punosh vetëm si peshkatar, po me gjithë ato profesione që ke ti...

— O Zenel! Ne njihemi! — e theu me të ashpër etiketën zyrtare Deni.

— Duhet biseduar me nëndrejtorin... — shefi u ngrit pa mbaruar fjalën. Deni i preu rrugën.

— Do të flas me nëndrejtorin, pra...

Deni e pa me sy të keq. Kishte vendosur të punonte në det dhe do të punonte në det!

— Quaje të mbaruar këtë punë! Eja nesër...

Deni zbriti shkallët e ndërmarrjes duke mbajtur nëpër gojë «Krvatën e ngushtë» i hutuar pas atij mëngjesi të gjallë me rrëmujën e gëzuar të shkarkimit të peshkut. Përpara magazinave thërrisnin, shkonin e vinin me arkat në duar, binin boritë e makinave si në ditët e një gjahu të madh. Në të vërtetë vendi përpara magazinave ishte epiqendra e zhurmës së qytezës dhe nuk kishte të bënte shumë me gjahun e madh dhe gjahun e vogël.

— Asgjë! Anijet erdhën pothuaj bosh... — i tha një nga shoferët.

Dikush e tërhoqi nga fundi i xhaketës.

— Riqo... — pëshpëriti Deni me një ndjenjë kënaqësie të thellë. Me të parë djalin, ai e hodhi pas shpine shefin e kuadrit. I përkëdheli flokët e shpeshtë dhe të ngatërruar që kishin shkëlqimin e mermerit të zi. E kapi për flokësh dhe ia ktheu fytyrën nga vetja.

— Çkemi? Ishe te nëna?

— Plasi më rrjetat... — tha Riqoja si ndonjë i rritur. E kishte për të ëmën që punonte aty. Vetëm atë kishte. I ati i kishte vdekur nga një tumor.

— Nuk të shoh të gëzuar...

— E pat! Ajo ta hodhi me një tjetër! — tha Riqoja duke i nxjerrë fjalët me zor ngaqë Deni ia kishte shtrembëruar kokën,

— Ku e pe? — u bë serioz Deni.

— Qeshin dhe lëpijnë akulloret! Ajo duhet vrarë...

— tha Riqoja duke fryrë gjoksin si një kreshnik i dalë nga moda.

— Shkojmë! — tha Deni. Ai i futi krahun djalit për t'i dhënë ngjyrën e shakasë zemërimit që po i ndizej.

I gjetën të dy mes njerëzve që shtyheshin për të marrë akullore. Rasha ishte mbështetur pas murit, e kishte thyer njëren këmbë dhe taka e hollë e këpucës së saj gërvishte me njëfarë spitullimi murin e dyqanit të stofrave.

«Ç'zakoni poshtë! Lëpihet dhe rri me një këmbë si lejlek!» — mendoi Deni dhe i ra lehtë në shpinë atij djalit.

— Urdhëro? — u kthye tjetri me njerëzi.

— Avullohu! — i pëshpëriti Deni.

— Nuk marr vesh...

— Avullohu! Mbathja!

Tjetri e pa me hutim Rashën. Ajo e përplasi fundin e akullores me zemërim dhe bëri nga Deni, po Riqoja i preu rrugën.

— Mbathja! Mbathja! — i tha ai me zemërim.

— Me ç'të drejtë? Kush ju pyet ju? — e humbi Rasha, që nuk dalloi asnjë ndryshim mes Riqo jevgut dhe Denit. Ajo i rrotulloi sytë nga ata që ishin aty dhe iu morën mendtë nga turpi.

— Ç'doni? Kush jeni ju? — pyeti ai që shoqërohej me Rashën. As ai nuk dalloi asnjë ndryshim mes Denit dhe Riqos.

— Mbathja! — u kreshpërua Riqoja.

Tjetri kërkoi një shpjegim nga turma, po nuk gjeti mbështetje. I thanë më mirë të largohej. A nuk e shihte Denin? Të hante të gjallë...

— More... Edhe sikur të jetë vetë djalli, nuk lëviz!
— tha ai që shoqërohej me Rashën duke kërkuar me sy ndonjë polic.

Rasha e shtyu lehtë.

— Të lutem ik! Është i dehur... — i tha për ta zburur. Pastaj iu kthye Denit, nuk do t'ia harronte kurrë atë që i kishte bërë.

Deni tani kishte tjetër punë. Po blinte akulloren e Riços.

— Mbathja në shkollë! Këtej e tutje nuk dua të di më nga lëpihet Rasha... — i tha duke i zgjatur akulloren.

Përreth qeshën. E dinin që Deni vdiste për Riçon. E panë të përkëdhelte djalin dhe me kaq ia harruan harbutërinë.

Rasha me atë tjetrin u ndanë.

— Ai është njëfarë fodulli dhe asgjë tjetër... — i tha ajo duke i dhënë dorën. Foli me zë të lartë për ta dëgjuar Deni.

Deni nuk e kishte mendjen tek ajo. Përkëdhelte Riçon.

— Vagabondazh... — hodhi një fjalë njëri nga turma.

— Asgjë! Vetëm një shaka... — e mbytën zërin e tij.

Rasha kishte qëndruar pak përtej. I mbante lotët me zor. Deni bisedonte tani sikur të mos kishte ndodhur asgjë me njërin nga shoferët e urbanit. «Është harbut... Është plot me vetveten...» — mendoi me dhimbje Rasha. Asaj iu kujtua i ati. Do ta merrte vesh dhe do të përmbyste shtëpia. Ishte e dyta herë që Deni bënte po këtë skenë. Në të dy rastet e kishte turpëruar me shokët që kishte pasur në fakultet. U kishte dhënë shkas të mendonin se ajo kishte mbetur një malësore e nënshtruar. Po të mos ishte i ati, ajo do ta përmbyste dheun aty tek akullorja. I ati nuk e donte Denin. Sipas tij ai nuk kishte bërë prokopi askund. «Ai që nuk zë vend në një punë, nuk zë vend as me një grua...» — i kishte thënë njëherë si në kalim Rashës.

Deni përshkoi restorantin dhe doli në verandën që shihte nga deti. Në një tryezë andej nga fundi rrinte doktor Marku.

— Ti je kaluar! Kur s'të pëlqen më një punë, të servirin tjetrën! — i tha mjeku me të qeshur. Nuk ishte në humor të mirë.

— Lëre, se na plasi shpirtin «Kravata e ngushtë»,
— tha Deni. Ai i tregoi me pak fjalë takimin me shefin e kuadrit.

— Zeneli nuk është nga ata që të kam folur unë. Është tjetërsoj! Nuk e di as unë si është... Ç'do të pish?

Deni nuk donte gjë. Marku tha diçka për sezonin e varfër që po fillonte. Plazhi ishte pothuaj i shkretët.

— Nuk ka ardhur as plaka e detit, as profesori... — buzëqeshi Deni.

— As ajo me kostum të bardhë... — e ndoqi po ashtu mjeku.

Deni i bëri me dorë të heshtte.

— Pra, ti po kthehesh prapë në det?

Tani sytë e mjekut ishin më të kaltër se zakonisht dhe flokët e verdhë e kishin marrë ngjyrën e okrës. Ky ndryshim ishte një skerc i dobët i diellit në perëndim, që mund të luante me ngjyrën, po nuk mund ta prishte butësinë e fytyrës së mjekut.

Çfarë t'i thoshte? Puna në det i shkante natyrës së tij të trazuar dhe të shkathët. Pastaj rrëmbimin e kishte të përbashkët me detin, qetësinë e kishte të përbashkët me detin...

— Që kur kam ikur më rri mendja vetëm aty. Nuk i shoh dot peshkatarët, kur kthehen në mëngjes, nuk i shoh dot anijet... Jam bërë ziliqar!

— Prapë ke për të ikur! Ti nuk zë vend! — foli me bindje mjeku.

Tjetri u inatos dhe ndezi cigaren.

— Ke dëgjuar? Na erdhi mallkimi i ri i papës... — ndërroi bisedë mjeku. Ai e kishte fjalën për figurinat e shenjtorëve dhe kryqet prej materiali plastik që kishte nxjerrë deti.

— Kush çan kokën për papën! — nuk i dha rëndësi Deni.

— Mos e merr kaq lehtë... Të kam gjetur «Thundrën e hekurt» dhe një libër të Tagorës. I kam në ambulancë. Shpejt duhet të të gjej edhe një manual të

ndihmës së shpejtë, se nuk dua të më shtohet edhe një pacient tjetër me të vjella dhe të marrura mendsh nga deti!

— Do të shqyhem zorrësh dhe nuk do të më shohë askush! — tha Deni me gjithë mend. Ai u nda nga mjeku. Rrugës iu kujtua Rasha dhe shefi i kuadrit. Ishte një trazim që i ngjante zënies së detit. Ndoshta edhe më keq, se nuk e vllte dot...

II

Motobarkat dhe anijet e tjera të peshkimit rrinin puq me njëra-tjetrën, si sardelet në një kuti konserve. Kjo binte më shumë në sy, kur shkëputeshin anijet nga moloja. Pas anijeve vinin sandallat, që ishin lidhur varg dhe tërboheshin duke u shkëputur në bashin dhe barqet e anijeve të tjera. Sandallat 'ishin shpëtimi, po ishin dhe barra e keqe e detit!

Nuk mendoi të kishte aq miq në molo. I fishkëllyen, i thirrën nga maja e direkëve, e gjuajtën me sardelet e mbetura në kuvertë. Aq shumë u prek nga kjo pritje, sa mendoi që edhe sirena e asaj anijes që po ikte bin-te për të.

— Ej, Den! A të flaku toka?

— Ej, Den! U ktheve të nxjerrësh zorrët prapë?

Në këto të thirrura miqësore kishte gëzim dhe habi. Rrallë dhe krejt rrallë ndodhte të ktheheshin prapë

ata që kishin ikur një herë nga peshkimi. Puna ishte e lodhshme dhe sundonte nata. Nata ishte e detit! Kush hynte në peshkim duhet të zgjidhte mes ditës dhe natës...

I thirrën se e donin edhe për atë nam prej kokëkrisururi që nuk e dinte as vetë si i kishte dalë. Gjëja më e krisur që kishte bërë ai nuk e kalonte atë marrëzinë me Rashën. Megjithatë ai kishte namin e kokëkrisurit...

«Pulëbardha» rrinte mes anijeve të tjera dhe nuk iu duk aq e vjetër dhe e rrënuar sa thoshin. Në këtë molo ajo ishte dëshmia e fundit e drurit në det. Ishte dëshmi e asaj lashtësie kur njeriu i qe futur detit me butësinë e drurit dhe nuk e kishte gërvishtur me hekur. Hekuri ishte i plotfuqishëm, druri ishte fisnik! Kjo kuptohej menjëherë kur lemeriseshin nga përplasjet anijet metalike dhe puqej butë në molo «Pulëbardha». Ai e kishte parë gjithnjë me njëfarë romantike këtë anije të vjetër, po nuk kishte punuar me të.

E pritën ftohtë. Vetëm Taushi e shtrydhi fort me 140 kilogramët e trupit të tij dhe u përmallua. Kapiteni i zgjati dorën pa fjalë, motoristi vetëm ngriti sytë dhe as Pali me Ndoc Markun që i njihte prej kohësh nuk treguan ndonjë interes.

Deni i tha kapitenit që e kishin sjellë të punonte si peshkatar i thjeshtë, po vërejtë reagim të keq të motoristi. «Ka frikë se mos i zë vendin», — tha me vete.

Kapiteni dhe motoristi ishin nga një fshat. Kjo iu kujtua menjëherë, «nga fshati i nëndrejtorit...» — mendoi me njëfarë mërzie.

Taushi i preku muskujt e krahut.

— Mirë je... — i tha ai me kënaqësi, e kishte seriozisht.

«Mirë je për të tërhequr rrjetat...» — mendoi Deni që e mori vesh se «Pulëbardha» nuk kishte limbjotë.

Deni rrudhi buzët. Taushi ishte miti i forcës! Ky mit kishte jetuar në det derisa u dukën limbjotat e para dhe tani ishte në të perënduar. Megjithatë Taushi

ishite një mit, po kishte edhe nga ata që nuk e merrnin kështu. «Tausi e ka trupin të fortë dhe shpirtin të ligshët!» — thoshin për të.

Në palmetë ishte errët. Baxhën e kishin zënë arkat që i kishin hedhur pa rregull.

— Ngadalë... — dëgjoi zërin 'e Karakollit dhe u gëzua, po tjetri nuk tregoi interes.

«Ehu! Edhe unë di të mos çaj kokën!» — mendoi duke lënë trastën mbi tryezë dhe deshi t'i kthente shtëpinë Karakollit.

— Nuk lihet çanta aty... — dëgjoi. Karakolli ndezi dritën dhe Deni u zu ngushtë nga hordhia e furrtareve të zeza që i ishin turrur trastës së tij.

— Çështë kjo hata? — pyeti duke përplasur trastën andej-këtej.

— Na u ngjitën këto ditë! Bela e madhe! — tha Karakolli.

Deni rrotulloi sytë nëpër palmetë. Furrtaret e zeza vraponin gjithandej nëpër tavanin e palmetës dhe binin poshtë.

— A ke një shkrepëse? — pyeti Deni.

— Kot e ke! Nuk i vret as flaka, as helmi! — tha Karakolli. Ai ishte shtrirë dhe pinte duhan. Dikush thoshte që ishte tetëdhjetë vjeç, dikush më pak... Me letërnjoftim i duheshin edhe nëntë muaj për të dalë në pension. Këtë dinte Deni. Ishte i dobët, si një relief kockash që nuk e fshihte dot as lëkura e nxirë nga dielli, po ishte i fortë. Kishte një djalë ushtar dhe farefis të largët. Shoqërohej me pak njerëz. Më të shumtën e kohës rrinte me profesorin, Pashk Lulin.

Karakolli i zgjati shkrepësen, po pastaj i tërhoqi dorën.

— Prit... A e pate shpirtin të pastër kur hipe këtu?

«Dëgjo edhe punë shpirtrash tani...» — tha Deni me vete. Atij i hipi një mërzi e papritur, sa pothuaj u pendua që kishte pranuar të punonte te «Pulëbardha».

— Nuk dilet në det me shpirt të pistë... — vazhdoi Karakolli.

Deni mendoi se nuk kishte hipur me shpirt të pastër në anije. Ishte i bindur që ai Zeneli e kishte degdisur për inat në këtë anije ku sundonin ata përbindëshat e zinj. Ia tha këtë Karakollit.

— A nuk ia mbath më mirë? Deti nuk është për salltanete!

— A nuk të ka lodhur deti, Karakoll? — gaboi Deni.

— Kush më përmend pensionin, më përmend varrin! Rri në punën tënde! — u zemërua Karakolli. Ai nuk deshi të dinte më për Denin.

Deni u pre. E shpëtoi nga ajo gjëndje rregëtima e motorit që posa e nderzën. Po nuk shkoi shumë dhe krismat e rregullta u ngatërruan, u shndërruan në gërvishtje të zhurmshme metalike, që i ngjasonin tërheqjes së zinxhirëve të spirancës. Motori pushoi.

— I përsheshi cilindrat... — pëshpëriti Deni që nuk pati më asnjë dyshim për qëllimet e mbrapshta të shefit të kuadrit.

Mori shkrepësen dhe futi një furrta të madhe brenda.

— Po tani? — pyeti Deni.

Karakolli i ktheu shpinën pa i dhënë përgjigje.

Deni rrudhi buzët. Mendoi që kishte ardhur në një motobarkë që nuk e donin. Ndoshta duhet të largohej pa filluar...

Në kuvertë e ndjeu veten edhe më keq. Kapitani bërtiste me të madhe dhe motoristi ishte mbledhur sa një grusht, megjithëse nuk kishte faj. Ishte motoristi më i zoti i ndërmarjes.

Deni kafshoi buzët. Anijet e tjera po e linin molon një nga një dhe kjo iu duk e rëndë, gati çnjerëzore. Ato as që çanin kokën që «Pulëbardha» do të rrinte pas molos, si një qenie e plagosur për vdekje. Ato po iknin pa i shtrirë dorën! Ky na qenkësh ligji i detit... Ligji i xhunglës!

Buzëqeshi. Të gjitha këto i mendoj nga inati që nuk do të dilte dot në det.

— Mekanikët nuk bëjnë një lek! Janë larukët e nëndrejtorit, he i fshiftë rriqna! — shau motoristi. Ai e hodhi përdhe bluzën e ndyrë dhe u fut te motori.

Deni u habit. Motoristin e dinte mik të ngushtë të nëndrejtorit.

— A ka ndonjë shpresë? — pyeti si budalla Deni kur e dinte që nuk kishte asnjë shpresë për t'u ndrequr motori.

— Paske pasur mik të fortë për patentën e motoristit... — iu përgjigj kapiteni.

«O të kacafytem me këta, o të ndërroj anije...» — tha Deni me vete.

Tani anijet ishin shtyrë thellë në det, po ai nuk deshë t'i shihte.

Kërceu nga anija pa i folur njeriu. Moloja ishte si e shurdhër, si e humbur. Ajo varfërohej përnjëherësh me të ikur anijet, mbetej një rrypinë e vjetër betoni, e kafshuar në dyzet anët nga deti.

Erdhi me një frymë deri në qendër të qytezës. Një rëzit me të cilët do të punonte e kishin pritur ftohtë, po as ai nuk kishte ndryshuar nga ata. Kështu kishte menduar rrugës, ndaj nuk kishte pse të ikte nga «Pulëbardha».

Hyri në farmaci. Kishte njerëz dhe Rasha mbësh-tillte tableta.

Deni i ra xhami.

— Një minutë... — tha Rasha pa e ngritur kokën.

Deni i ra edhe më fort.

— Prit, mor shok... — u nxeh farmacistja, po mbeti keq kur ngriti kokën.

— Më jep diçka kundër bumellave... — tha si me mospërfillje.

— Nuk di ç'janë bumbelat! — e deformoi fjalën farmacistja. Ajo nuk ia kishte harruar Denit atë që kishte bërë.

— Nuk e di? Shife, atëherë! — thirri Deni dhe ia hodhi kutinë e shkrepëses mbi banak.

Pas kësaj ilariteti i Rashës dhe një emër latin që e shqiptoi një zë i njohur. *Bllata orientalis...*

— Pashk Luli... — pëshpëriti Deni, që u kthye ngadalë, sikur të druhej se mos prishte një ëndërr.

Pashk Luli ishte zgjatur mbi xhamat dhe ndiqte martirizimin e furrtares së zezë, që i dredhonte farmacistes.

— Ti je i marrë! I marrë! — thërriste Rasha, ndër-sa mendohej të shkelte me këmbë insektin e zi.

— Shpëtoi! — rrahu shuplakat Pashk Luli.

Rasha u lëshua e këputur në karrige dhe sytë i mbetën nga Deni.

— Ose të mbushesh edhe ti, ose të na pastrosh anijen!

— Do ta pësosh një ditë! Në marrshin e fundit po hallakatesh! — iu përgjigj Rasha.

Deni qeshi. E ngacmoi për të atin, pastaj i tha të mendonte për atë ilaçin. U kthye nga Pashk Luli. Sytë e tij lëviznin në një orbitë të valëzuar. I dridhej lehtë koka.

— Vonë erdhe, profesor...

— Kur ka diell, nuk është vonë...

Deni i futi krahun dhe u bind që ai e kishte harruar. Po do të kujtohej. E pyeti ku kishte zënë vend.

— Në kolibe! — tha pa të keq Pashk Luli.

Deni qeshi. Tjetri vinte në prill dhe ikte në tetor. Në fillim i lëshonin dhomën më të mirë, pastaj e shtynin pak nga pak, sipas trysnisë që pësonte plazhi, gjersa përfundonte në një kabinë dërrase.

E përcolli profesorin gjer te kabina duke dëgjuar me durim një leksion të ngatërruar për ruajtjen e ekuilibrit në natyrë. Pse donte ta shfaroste *Bllatën Orientalis*? Po të ishte për t'u shfarosur, e shfaroste natyra!

— Natën e mirë, profesor!

— Të paça! Të pastë natyra!

III

Pati frikë se mos dëgjonte sërish atë lebetitjen e zinxhirëve të rëndë, po motori vazhdoi të punonte me një frymë dhe anija u nis. A do të mbahej në det? Muajt që kishte punuar në peshkim nuk ishin asnjë lloj garancie! Më mirë të mos e mbante mendjen te të vjellat dhe te përkundja e dallgëve! Më mirë të mendonte për natën e parë të ngulimit të vërtetë në jetë! Gjer atëherë kishte kalëruar nëpër karuselin e një cirku kurioz, ishte hedhur sa mbi një objekt, mbi një tjetër. Cirku nuk kishte det, prandaj kishte ardhur këtu, të gjente detin...

Ishte një ndër netët e mrekullueshme ku fantazia brendh pa kufi. Frynte një erë e lehtë dhe ajo sillte aromën e leshterikëve, aromën e jodit të plazhit përzier me dihatjen e sherbelës që kundërmonte mali, pasi zbërthëhej pak nga pak nga zagushia e ditës. Kjo

ishte djersa e malit dhe ajo kundërmonthe erë sherbe-
le...

Pyeti për Karakollin.

— Do të shkojmë ta marrim! — nuk i kushtoi vë-
mendje kapiteni.

Ku do ta merrnin? Përpara ishte vetëm deti dhe
qielli! Nuk pyeti, se kureshtja dhe naiviteti paguheshin
shtrenjtë në det, ishin objekte talljesh dhe zbavitjesh!
Kishin dashur t'ia hidhnin edhe atij një herë, kur i
kishin thënë të sillte spirancën për ta grasatuar!

Kapiteni ia la timonin motoristit dhe iu afrua De-
nit. I kërkoi nga ai ilaçi me të cilin kishte zhdukur
furrtalet e zeza. I ishin ngjitur në shtëpi.

— Pomeks? Të gjej sa të duash!

— Të pashë të menduar...

— Po mendoja të të zë vendin! — bëri shaka Deni,
po iu kujtua Marku. «Mbase më pëlqen të jem kapiten
anijeje!» — i kishte thënë mjekut. «Ti nuk ke hall të
komandosoh të tjerët! Ke hall të bësh pas kokës sate!» —
i qe përgjigjur Marku.

— Të gjithë duan të na zënë vendin! Edhe ai atje!
— kapiteni tregoi me kokë motoristin.

Deni seç tha për fëmijërinë e tij. Nuk kishte ën-
dërruar gjë tjetër veç kapitenit të anijes!

— Më gjithë mend që ai do të ma zërë vendin... —
vazhdoi kapiteni për motoristin.

«Nuk shkuakan dhe aq mirë këta këtu...» — mendoi
Deni. Nuk deshë ta ushqente këtë bisedë dhe zuri të
vështronte bregun. Pse po udhëtonin paralel me të?
Anijet e sardeles nuk ndiqnin këtë kurs! Pastaj u çudit
kur motoristi i la timonin dhe shkoi të shuante motorin.
Ç'do të bënin përballë atij projektorit të kufirit, që po-
sa ishte ndezur?

— Do të gjuajmë me projektor! — deshë ta fuste
në kurthin e zbavitjeve kapiteni.

— Me projektor nuk është gjë! Unë kam gjuajtur
me elektrik dore! — i bëri ballë Deni.

— E sheh Karakollin? — pyeti kapiteni me dorën
në drejtim të malit.

SHKURTOR
GJINDOR
50908 17

Deshi t'i kthente shpinën. Nuk mund të talleshin me të!

— E ke poshtë projektorit...

U trondit. Një hije e turbullt zgjatej majë shkëmbit dhe ajo përfaqësonte Karakollin. Iu duk si hija e një shpirti të truar të lemerisur pas natës e pas detit! Aty për aty e mori vesh pse i thërrisnin Karakoll! Ai ishte karakolli i dallgëve, i natës, i tufës së gjallë që lëvizte nën det dhe duhej gjetur nga lëvizte!

— Ai po thërret! E ka gjetur peshkun! — kapiteni zuri të lëvdonte Karakollin! Ç'ishin busulla dhe holloti përpara tij?

Deni ishte i tronditur. Ishte i tëri nën pushtetin e Karakollit. Duke e vëzhguar, ndjeu njeriun mbi natyrën. Nuk kishte asgjë vulgare, nuk kishte asgjë poshtëruese tek ajo hija majë shkëmbit, megjithatë Deni sesi e ndjeu natyrën nën këmbën e njeriut... Edhe i erdhi mirë, edhe ndjeu njëfarë shqetësimi... Pashk Luli i kishte thënë një herë që për njeriun duhet të kishte një kufi dhe se këtë kufi e vinte vetë natyra...

— Për njeriun nuk duhet të ketë asnjë kufi në natyrë! — e mblodhi veten Deni.

— Ç'thua? Pa kufi shkon atje ku nuk duhet... — e pa me hutim kapiteni.

— Asgjë! Seç po mendoja... — Deni u skuq.

Pali me Ndoc Markun kishin lëshuar sandallin. Do të merrnin Karakollin.

— Duan një orë të kthehen. Zbresim në palmetë! — e ftoi kapiteni.

Ai kishte kabinë të veçantë, po ajo nuk e kalonte gjatësinë e një shtrati fushimi. Deni mendoi që njeriu duhet të kalonte patjetër «shkollë» e detit për të kuptuar privilegjet që kishte në tokë...

I bëri përshtypje shtrati me libra.

— Janë të Palit. I lë këtu se kabinën e kam me çelës...

Kapiteni kishte një fytyrë të njomë prej djali të ri dhe flokë të thinjur. Duhet të ishte diçka më i madh se

Deni, po nuk dallohej. Flokët e thinjur i dukeshin si ndonjë parukë e vënë për t'u burrëruar.

Ai nxori çarçafë për Denin dhe i tregoi ku do të flinte. Shtratin e kishte pas derës. Sipër Palin dhe te këmbët motoristin...

Deni u hodhi një sy shtretërve dhe u zhyt në një botë përrallore. Cilët ishin ata xhuxhë që do të pushonin ndër ta? Ja, atje në fund të palmetës gërhinte ciklopi i xhuxhëve, Taushi! Ai ishte shtrirë në shpinë dhe kishte mbledhur këmbët. Deni e kishte parë që kudo që shkonte, ai i mblidhte këmbët pa turp dhe këtë e kishte nga ndrydhja e atij shtrati.

U hodhi një sy çarçafëve të Palit. Ishin të bardhë borë. Në krye kishin një «N» të stampuar dhe në fund një «S».

«Nord, Sud...» — sesi tha me vete Deni dhe iu afërua së vërtetës. Pali nuk donte ta ngatërronte pozicionin e çarçafit as mbasi të lahej... Një tekë e tij!

U shtri.

Motobarka lëkundej lehtë dhe ndillte gjumë. Ai do të kishte fjetur, po të mos kishte ardhur motoristi. Ai i hodhi çizmet pa asnjë kujdes dhe u përplas në shtrat.

Deni i hapi sytë. Seç vinte një erë e keqe. U ngrit ndenjor dhe sytë i shkuan te çizmet e motoristit. Kuterbonin si ato fuçitë e plehrave. Deshi t'i fliste për çizmet, pastaj e la. U ngrit, veshi xhaketën dhe doli në kuvertë.

— Natën e parë nuk ka gjumë... — tha kapiteni pa u kthyer nga ai. Ai rrinte dhe vështronte bregun nga duhej të vinte sandalli.

«Natën e parë ka erë çizmesh», — tha me vete Deni.

— Duhet ta lësh veten në dorën e detit... Ta braktisësh, si i thonë, ndryshe nuk ke gjumë!

Deni u zemërua. Iu duk se ai tjetri po i thoshte të pajtohej edhe me erën e çizmeve.

— Po vijnë! — tha kapiteni.

Deni nuk pa asgjë.

— Rrahin lopatat...

Pas pak u afrua sandalli dhe Deni mendoi që ishte futur në një botë të errët dhe ai ishte krejt qorr. I duhej të gjente sy të rinj për të mos u turpëruar.

Karakolli u ngjiti i pari dhe pas tij dy të tjerët. Kapiteni i thirri motoristit, pastaj i zgjati një cigare Karakollit. Deni priti të flisnin për peshkun, po ata seç thoshin për një lloj rose, që gjuhej në gusht. Siguria dhe qetësia e Karakollit e tronditën. Duhet ta kishin pisk anijet e tjera që nuk kishin Karakoll.

Tërhoqën spirancën.

— Nga Leshnaja!... — foli Karakolli.

Kapiteni shkoi te timoni.

Derisa mbërritën te Leshnaja, Deni u përpëliti në një mori hamendjesh. Si mund të kishte asnjë ndryshim në rrafshin e dallgëve? Ai mendoi që ky ishte misteri i këtyre njerëzve dhe ai kishte të bënte me horizontin, me yjet, me hënën dhe me çdo element tjetër të natyrës që shërbente si kufi!

E kishin shuar motorin e madh. Punonte vetëm ai i dritave. Pali me Ndoc Markun përgatisnin elektrolinjën. E ngarkuan në sandall së bashku me fenerin e madh.

Drita afroi çdo gjë, njerëzit, sandallin, e afroi edhe detin në atë lakuriqësinë e tij të murrme dhe pa asnjë bukuri. Dallgët i ngjanin një relievi prej bronzi të derdhur ashpër. Çdo gjë rreth e rrotull që nën pushtetin e dritave dhe të hijeve. Elektrolinja përshkohej si një gjarpër me sy të zjarrtë duke përhapur pesë rrathë të mëdhenj drite. Kreu i saj dukej se arrinte horizontin dhe kjo nuk ishte tjetër veç iluzionit të hapësirës pa dritë.

Zbritën të hanin. Që të tre e kishin mbështjellë bukën me letër të trashë.

— Pashë hollotin. Na prure në pus të sardeles!
— tha kapiteni. Ai e ndau në tri pjesë një qepë të madhe dhe njërën ia dha Denit. Pastaj i zgjati edhe

një shojzë të fërguar, po Deni nuk e kishte mendjen aty. Pastaj as nuk i hahej. Vështronte Karakollin dhe ndiente njëfarë inati për pushtetin që kishte ai njeri mbi njerëzit.

— E di si është lëkura e detit? Diku trashon, diku hollon! Diku nxin, diku murrmon... Diku fle, diku çon tallaz... — tha i menduar Karakolli. Tani edhe ai nuk ia ndante sytë Denit.

— Në lëmë të sardeles na solle... — vazhdoi të flite kapiteni me gojën plot.

— Mos na i merr mendtë, — iu përgjigj tjetri thjesht. Dukej që nuk i hynin në sy lëvdatat.

— Holloti tregonte 70 metra ujë! — të tijën se të tijën kapiteni.

— A nuk e ndez më mirë atë valixhen? — ia preu edhe një herë Karakolli duke treguar televizorin, pastaj u kthye nga Deni dhe i tha që, sa të ndizej televizori, do të fillonte të gërhinte ai «derr jevgu» që ishte shtrirë atje.

Deni e ndezi televizorin. Taushi zuri të gërhinte vërtet.

— Shuaje!

Deni u turbullua. Me ta shuar, Taushi kishte heshur si me buton.

— Ndize prapë!

Deni u ul në vend dhe mblodhi shuk me nervozizëm gazetat dhe mbeturinat e tjera të bukës pa i vështruar në sy. Pati frikë se mos ia kishin punuar. Ndoshta Taushi nuk flinte dhe i përshtatej lojës së tyre...

U ngjiti në kuvertë dhe i hodhi mbeturinat në det. Më mirë të mos e dridhnin fort me të...

Pali e pruri me sandall Ndoc Markun. Tani në kuvertë ishte ngjitur edhe kapiteni. Ai e preku Denin në sup.

— Diçka ka atje te llamba e fundit... — tha ai.

Llamba e fundit ulej dhe ngrihej me ritmin e valëve dhe pas saj përplasej dhe shtyhej një masë e rru-

mbullakët në gjasim të një balloni, apo të një fuçie.

— A nuk duket si një minë deti? — pyeti kapiteni. Ai i foli Taushit të shihte ç'kishte atje te llamba e fundit.

— Unë? Mua më ha nata, kapidan! — u spraps Taushi duke fërkuar sytë.

Deni nuk priti. U hodh në sandall mbas Palit. Sa u vonuan ata për t'u kthyer, kapiteni iu shkreh Taushit sa mundi.

— Kapidan, askush nuk ka vdekur prej frikës! Të gjithë kanë vdekur prej trimërisë! — tha me butësi Taushi. Kapiteni deshi t'i përvishej prapë, po ai e ngatërroi më tej. — Kapidan! Unë nuk kam frikë prej vdekjes, po kam frikë prej frikës!

U kthyen ata të dy që ishin larguar me sandall.

— Ç'kishte? — pyeti kapiteni gjithë kureshtje.

— Gazetat e darkës! Të gjitha gazetat që hodhëm në det me mbeturinat e darkës ishin fryrë si balon! — qeshi Deni.

Kapiteni u var në anë të motobarkës me buzën në gaz. Një mizëri qeniesh lëviznin nën ujë poshtë llambës dhe kjo ishte një botë e turbullt dhe memece që e ndriçonte dielli ditën dhe njeriu natën.

— I shikon pinat?

Pinat ishin fluskat e ajrit që ngjiteshin e shpërthenin lart.

Deni u drodh. Pinat ishin mesazhi i jetës, ishin një dëshmi tronditëse që ia kalonte çdo prove tjetër për thellësinë e jetës.

— Shko të flesh! — i tha kapiteni.

Zbriti dhe u shtri. U rrotullua sa në një krah, në një tjetër. Tek merrte frymë iu bë se nxirrte edhe ai pina nga mushkëritë... Nxirrte pina dhe dëgjonte një zë të thellë që i thoshte se ishte në një gjiri me banorët e thellësive...

Motobarka dridhej nga shungullimi i motorit të madh. Të gjithë ishin mbi kuvertë. Vetëm Karakolli vinte rrotull rrjetës në sandall. Tërhiqnin rrjetën! Kjo e tërhequr e kishte shtyrë Denin të mërzitej nga deti dhe të ikte. Të ikte, megjithëse e donte detin! Kishte ikur në fund të vjeshtës, pas një nate të ftohtë dhe ishte dridhur si në ethe. Rrjeta e lagur peshonte si plumbi dhe duart avullonin në takimin me të. Kishte qenë akull për një kohë të gjatë, pastaj duart dhe rrjeta u bënë një dhe ai nuk kishte qenë në gjendje të dallonte duart. Më tej nuk e kishte ndier as fytyrën, ku binin dhe ngrinin cirkat e ujit. Kishte menduar që pas asaj vjeshte vinte acari i dimrit dhe sado i butë që të ishte do t'ia kalonte fundit të vjeshtës. Deti ishte lëmi i madh i erës, ku ajo harbohej pa kufi. Era në det ishte pështjellimi i madh i natyrës në virgjërinë e saj të frikshme. Njeriu ende nuk kishte arritur t'i vinte fre erës në det, ende nuk kishte arritur të mbillte pyje në det...

Duke tërhequr rrjetën, ai mendoi se ishte kthyer për të matur veten. E donte detin, po kishte edhe inat me veten që ishte thyer një herë. Tani do të pëlciste aty gjersa t'ia dilte mbanë!

I kishte rrjepur duart prapë si atëherë, po nuk kishte të ftohtë. Nuk kishte mësuar ende të tërhiqte rrjetën. I fërkonte duart pas saj, ndërsa të tjerët e kapnin atë me shpejtësi sikur të kapnin një pre!

U përpoq të mos rrinte pas Taushit, që hidhte aq rrjetë në kuvertë sa hidhnin të gjithë të tjerët. Ç'do të bënte ai kur të montonin limbjotën? Limbjota do ta nxirrte nokaut dhe miti i tij do të merrte fund.

— Kur të vijë ajo makaraja e ndyrë, unë do të zbres në molo të shkarkoj qymyr! — tha Taushi.

— Ku ka si teknika... — e ngacmoi Deni.

— Jepi, xhan, se të zuri gjumi! — ia ktheu Taushi me të butë.

Deni i vari krahët poshtë, i shkundi, i hapi dhe i mbylli duart, po ato i ishin rënduar dhe nuk i ndiente.

Taushi buzëqeshi. E largoi Denin dhe përfshiu mes krahëve të tij të fuqishëm edhe pjesën e Denit.

Rrjeta sa vinte dhe afrohej. Karakolli i binte përçark duke e ngushtuar me kujdes të madh rrethin e saj.

— Si të duket? — i thirri Deni.

— Karakollit i flet? Qenke lafshë gjeli! — ia preu Taushi.

— Kështu nuk më flet njeri mua! — i kërceu gjaku Denit.

— Shpirti i Xhikes. Nuk e pata me të keq! — u tërhoq tjetri përnjëherësh. Ai e la rrjetën dhe u fsheh pas arkave të peshkut.

Denit i ra inati. Madje i erdhi keq kur të tjerët nisën të qeshnin me Taushin. Atë që kishte frikë ai e vinte përpara, po bëhej qull kur i turrej një fëmijë.

Deni pyeti pse nuk duhej trazuar Karakolli.

— Tani ai merret vesh me peshkun! — iu përgjigj Pali me seriozitet.

— Si merret vesh?

— Vetëm ai e di...

Nuk e mori vesh as Palin, as Karakollin, që ishte ngritur në këmbë në mes të sandallit dhe shtynte rrjetën poshtë me kokën e lopatës.

— Ai po e lëshon peshkun... — u çudit Deni.

— Po e lëshon! — e ndoqi Pali pa e prishur gjakun.

Deni vështroi të tjerët. As ata nuk po e prishnin gjakun.

— Veçse po e tepron... — tha Pali.

A mos ishte kjo bestytنيا e vjetër e detit për të cilën kishte dëgjuar? A mos po ia kthente Karakolli detit prapë pjesën e vet?

— Po i ikën edhe sardelja e madhe, he e rroftë dreqi! — thirri Pali me fytyrë nga kapiteni.

Karakolli e largoi lopatën. Rrjeta u ngjit në sipërfaqe dhe sardelja mbeti brenda.

— Asgjë nuk marr vesh... — pëshpëriti Deni.

— Ai e lëshoi sardelen e vogël! E vogla për dy muaj bëhet e madhe! — i tha Pali.

— Anijet e tjera e marrin mbarë...

— Mbarë e merr edhe ndërmarrja, po Karakolli nuk e merr mbarë! — ia ktheu Pali. Me sa duket edhe ai ishte me Karakollin.

Karakolli qeshte dhe Denit i shkoi mendja prapë tek ajo bestytنيا e vjetër. Iu duk se plaku ishte marrë vesh me detin. «Kaq të mora, kaq të lashë.»

— I lëshoi nja tre kuintalë, he i krypshta, trutë! — u ankua Taushi.

— A t'ia them Karakollit? — e trembi Pali.

— Mos, se më ban xhan-xhin! — u lemeris tjetri.

Deni pyeti nëse e dinte ndërmarrja këtë që bënte Karakolli.

— Ndërmarrja do planin! Ne e kemi plotësuar atë me sardele të madhe, ndërsa mjaft nga anijet e tjera nuk e kanë plotësuar as me të madhe, as me të vogël, — iu përgjigj Pali.

Pali i pëlqente. Nëse Karakollit nuk i dukej shpirti, Pali ishte i përshkueshëm si një kristal i pastër.

— Janë afro 200 arka! — fërkoj duart me kënaqësi kapiteni.

Deni e la arkën me peshk. Pak përtej rrinte Karakolli. Ai u kishte kthyer shpinën dhe nuk donte të dinte ç'bëhej më tej.

Deni pyeti ç'bënte Karakolli atje.

— Tani ai mendon... — tha Pali duke rrëmbyer arkat.

Deni deshi të dinte më tej.

— Mendon për të birin që e ka ushtar, për detin dhe për Pashk Lulin! E njeh Pashk Lulin? Vetëm për ata të tre mendon dhe thotë se i vjen keq për të tre... Pastaj ai gjithnjë na sjell shpinën në këtë çast. Nuk e duron dot si pëlçet peshku në kuvertë!

Deni u përmbajt. Nuk mund ta zbulonte me një natë Karakollin. Atij i tërhoqi vëmendjen motoristi që hidhej përpjetë nga kënaqësia. Ajo natë u kishte dhënë 400 lekë fitim. Motoristi kishte ca sy të vegjël lak-

mitarë që bëheshin si të gjelbër nën efektin e parasë. Deni i ktheu shpinën.

Taushi thirri dhe u rrëzua në grumbullin e arkave. Ndër këmbët e tij hidhej dhe përdridhej peshkaqeni i vogël që ia kishin sjellë për ta trembur. Ishte një mrekulli e thellësive me atë shpinën e kaltër në të blertë dhe me atë trupin e hollë dhe elegant.

— O momja Xhike! O momja Xhike! — thërriste Taushi, që kishte mbetur në shpinë ashtu siç ishte rrëzuar. Motoristi ia kishte afruar peshkaqenin te hundët. Ishte njëlloj sikur të trembej elefanti nga miza, po megjithatë tmerri i Taushit ishte i vërtetë.

Motoristi e qelbi. I rراسi bishtin e peshkaqenit në gojë dhe Taushi zuri të qante. Ai ishte ngritur në këmbë dhe i ngjante një statuje të gurtë, të lagur në shi...

Motoristi nuk e dëgjoi kapitenin dhe vazhdoi ta ngacmonte. Kishte diçka të keqe dhe përcmuese në lodrën e tij.

Deni i ra supit.

— Po e ngacmove më, të theva turinjtë! — i tha Deni, megjithëse u përpoq të mos ishte i ashpër.

— Ehu! — u fry motoristi dhe ata sytë e vegjël i morën një ngjyrë të gjelbër. Vuri duart në bel dhe e ktheu pak trupin praptazi. E njihte Denin, po nuk kishte si i lëshonte udhë. Përgjithësisht atij i largoheshin. I shkante fjala në peshkim dhe thoshin se e kishte mik nëndrejtorin. Zhdukej ndonjëherë nga puna dhe, kur e pyesnin ku kishte qenë, përgjigjej «se kishte kryer disa detyra speciale». Po ta pyesnin më tej, do të thoshte se kjo ishte sekret shtetëror.

— Nuk është mirë... — ia bëri Deni me ton tjetër, po asnjëri nuk e mori vesh se nuk po përpiqej të zbuste motoristin, po veten. Nxehej përnjëherësh dhe më vonë e vuante së tepërmi këtë gjendje. I vinte turp.

Motoristi i ktheu shpinën dhe e gjitha kjo kaloi pa u vënë re. Të gjithë e kishin mendjen te peshku që kishin zënë. Madje edhe Taushi e kishte harruar peshkaqenin dhe sikur nuk po e vlerësonte Denin që e përkrahu.

Po i afroheshin portit. Qyteza ishte përfshirë në një mjegull të hollë, të bardhë në të kaltër. Kjo ishte një napë gjysmë e tejdukshme pas së cilës rrinin si të varura në ajër gjysmat e apartamenteve dhe të kabinave të plazhit. Tutje nëpër rrugë nxitonin në një mënyrë qesharake njerëzit e vonuar për punë. Duke i parë nga deti, ata ishin të zhveshur nga çdo lloj personaliteti. Plazhi nuk ishte kështu. Ai kishte «personalitetin» e tij të pandryshuar, hapësirën e murrme të rërës, dritat neon që kishin harruar t'i fiknin, kabinat e kaltra përpara të cilave rrinin karriget e përmbysura. Dielli ishte ende pas malit, po plazhi dukej se kishte nisur të avullonte.

Deni rrinte mbi një arkë. Nuk i ndiente krahët. Lërret dhe duart i dukej se ishin të huaja. Kështu do të shkonte nja një javë, gjersa puna dhe mundimi të vinin çdo gjë në vendin e vet.

- Duhet limbjota... — i tha kapitenit.
- Anija është e vjetër. Nuk na e japin!
- A ka në depo?
- Ka, po thonë që presin anijet e reja...
- Mos i ruajnë për Xhafë Kalisin?

Tjetri e pa me vëmendje. Shumë shpejt u kishte hyrë të fshehtave të ndërmarrjes ky djalë! Xhafë Kalisi ishte një ndër kapitenët që priste anije të re. Ndërkohë bënte një punë dosido, ose më saktë nuk bënte asnjë punë në peshkim. E dinin të gjithë që ai ishte mik për shpirt me nëndrejtorin.

— Si të prunë te ne? Nuk vjen dokushdo te ne... Këtu vihet me mik! — i shkeli syrin kapiteni.

Deni mbeti një çast. Me mik? Cilët kishte miq ai në peshkim? Përkundrazi, kishte menduar se e kishin emëruar për keq në këtë anije... Por ajo na qenkësh një minierë ari!

- Gjithnjë zini kaq peshk? — ndërroi bisedë Deni.
- Si të jetë Karakolli...
- Po ju të tjerët ç'jeni?
- Ne vijmë mbas tij!

Deni nuk e zgjati. Kishte filluar të ndiente njëfarë turbullire sa herë përmendej emri i Karakollit. Kishte dëgjuar edhe më përpara për të, po ose i kishte marrë për ekzagjerime, ose si spekulime të injorantëve që përpiqeshin të sfidonin shkencën dhe teknikën.

— Do ta dorëzosh ti peshkun sot! Magazinierin e ke të njohur, po kjo nuk vlen një dysh, se ai do të përpiqet të ta hedhë me kualitetin. I gjithë peshku është i cilësisë së parë...

Magazinier ishte i ati i Rashës që nuk donte ta shihte Denin me sy.

Kapiteni iku menjëherë dhe nuk i la kohë të kundërshtonte. Ishin pranë molos dhe aty duhej mjeshtëri e madhe për të gjetur vend në mes të mjeteve të tjera. Në këtë çast moloja ishte plot spektatorë, që prisnin të gajaseshin me përplasjet e anijeve dhe vallet e çmendura të sandallave. Kapiteni e afroi butë anijen në molo. Ajo nuk u mbështet në gomat e vendosura në anët e saj, po qëndroi paralel me bankinën prej betoni. Pali me Ndoc Markun hodhën cimat dhe «Pulëbardha» qëndroi. Nisën të shkarkonin peshkun në sytë e kuresharëve dhe të peshkatarëve të anijeve të tjera që nuk kishin marrë as gjysmën e prodhimit të «Pulëbardhës».

— Sa? 210 arka? Nuk është e mundur! Ne nuk kemi as 60! — u dëgjua një zë!

— Karakolli është magjistar! Neve na rrofshin aparatet! — e pasoi një tjetër nga një anije metalike.

Ankime për rrymat e ujërave, për rrjetat që u ishin shpuar papritur, për hollotët që nuk punonin si duhet, për peshkun që ishte pakësuar... «Tërbuni» kishte ardhur bosh dhe «Kastrioti» që ishte një ndër anijet më të reja dhe të pajisura më mirë ishte ndarë me 50 arka. Peshkatarët ankoheshin se kishte qenë një natë e keqe, kur kishte qenë një natë jashtëzakonisht e favorshme për të peshkuar. Po kështu e kishin peshkatarët!

Deni e pa Karakollin që po mbështillte ca sarde-

le në një letër. Ai i kishte rreshtuar si fishekët dhe po i numëronte. Dhjetë sardele! I numëroi edhe një herë! Dhjetë sardele! Atëherë mbeti i kënaqur dhe i mbështolli. Ai vuri buzën në gaz përpara hutimit të Denit.

— Sardelet e profesorit... Të njëmbëdhjetën nuk e merr. Vetëm dhjetë copë! — foli si me vete Karakolli.

E kishte parë prej vitesh Karakollin me Pashk Lulin. Thoshin që ata shëtisnin bregut gjithë paraditen, flisnin një fjalë kur takoheshin, një në mes të shëtitjes dhe një kur ndaheshin, po askush nuk e dinte përse flisnin.

Kapiteni i thirri edhe një herë të kishte kujdes atje në magazinë. Deni po vinte këmbën në makinën që kishte ngarkuar peshkun kur i thirri kapiteni. Për pak sa nuk zbriti. Si mund të kishte kujdes me të atin e Rashës?

U bë akull. Syri i djathtë i Gjon Kabashit i rrinte mbi kokë, i majti në mes të gjoksit. Kur nxehej, strabizmi i magazinierit kalonte çdo orbitë.

Ai ngriti dy gishtërinj lart, sikur të shpaloste një vendim historik dhe kjo do të thoshte që peshku ishte i cilësisë së dytë.

— Ngadalë... — iu mor fryma Denit. Ai do ta kishte lënë të gjithë prodhimin të cilësisë së fundit, për të shpëtuar nga ai njeri, po i vinte turp nga shokët.

— Shkarkoni arkat! — nuk i vuri vesh magazinieri.

Deni i doli përpara. Ngriti një gisht dhe e tundti ashtu siç kishte bërë tjetri.

— Jo, pa u përmbysur bota! — tha Gjon Kabashi.

— Atëherë po presim tërmetin! — foli Deni dhe u ul në një arkë.

— Liro vendin për të tjerët! — urdhëroi magazinieri. Ai u hodhi një sy punëtorëve të magazinës, po ata nuk luajtën.

— Ndoshta mund të bëjmë një lëshim... 150 ar-

ka me të parën, 50 me të dytën... — psherëtiu magazinieri.

Deni tundi kokën.

— O djalë! Ti je truderr, po unë jam truhi! — thirri Gjon Kabashi. Ai ishte ndezur dhe shkante e vinte nëpër magazinë me ata hapat e mëdhenj të mallësorit që nuk do të mësohet në qytet. Ishte zverdhur, se diçka i thoshte përbrenda që do të detyrohej të lëshonte udhë, të dorëzohej para atij djaloshi kryeneç.

Deni mori cigaren me një gjest të qetë. Nuk donte ta zemëronte. Në të vërtetë i vinte keq për atë njeri, si për një të sëmurë pa shpresë. Thoshin se ai vuante kur të tjerët merrnin shumë para, sëmurej. «Ai vuan vetëm për shtetin! I dhimbset shteti! Ka frikë se mos dobësohet shteti!» — kishte thënë për të doktor Marku. I shkruante vit për vit ministrisë për «shkeljen e parimeve socialiste në peshkim lidhur me shpërblimin e peshkatarëve». E kishin sqaruar, i kishin tërhequr vërejtjen kaq herë, po ai vazhdonte të shkruante.

— O të dytë, o hiç!

— Rri të rrimë, atëherë! — tha Deni që u ul në cepin e peshores së madhe.

Magazinieri ishte mbushur në djersë. Si mund të rrihej? Përpara magazinës ishin grumbulluar kamionët me peshk. Shoferët u binin borive, shanin dhe kërkonin të shpejtonte.

— Të merremi vesh! Kështu e varfërojmë shtetin... — e uli zërin Gjon Kabashi.

— Shteti kërkon drejtësi për ligjet që ka vendosur vetë! — tha Deni.

— Shteti jemi ne! Ne e kemi në dorë... Prandaj...

Heshti... Magazina ishte mbushur me shoferë dhe peshkatarë që shoqëronin mallin. Gjon Kabashi e pa vetën në mes të gazit dhe të zemërimit të tyre. Gazi dhe zemërimi i tyre e hidhte sa në një anë në tjetrën...

Ai ishte ndezur me të gjithë dhe ata tani po i jepnin të shtyrën!

— Nuk hoqe që nuk hoqe dorë, o Gjon Kabashi! Na fute veremin! Shteti, shteti! Mos u plevitos për shtetin, se ka ma shumë mend se ti! — u hodh një nga shoferët.

Gjon Kabashi ngriti dy gishtërinj lart, të verdhë, të hollë dhe të deformuar! Ato kishin zënë vendin e fjalës që nuk e nxirrte dot nga zemërimi.

— Rri të rrimë! — përsëriti Deni.

— Si t'ia bëjmë? — rrotulloi sytë për ndihmë magazinieri. Ai kishte mbetur vetëm përpara gjithë atyre njerëzve. U lëkund për një çast, por, me të menduar që të gjithë ata përpiqeshin për të zhvatur shtetin, erdhi në gjendjen e parë. Ç'i donin tërë ato para? Ai për vete kishte jetuar me një rrogë magazinieri... Nuk e mori vesh as vetë si e rrëmbeu atë lopatën e akullit. Ata që ishin te dera e shtynë jashtë. Gjon Kabashi kishte bërë luftën, pastaj kishte ndjekur edhe bandat. «Po të vrau njeri, ai të vret! A nuk e shihni si fshin njëherë tokën me sy përpara se të ngrëjë kokën?» — thoshin për të. Strabizmin ia kishin marrë për dhelpëri...

— Ti, Gjon Kabashi, je kundër shtetit... — tha Deni me ngadalë.

Të gjithë mbajtën vesh. Tani mosmarrëveshja mes tij dhe Gjon Kabashit po hynte në një rrugë më të errët.

— Kur kam qenë unë për këtë shtet, mor këlysh...

Heshti. E vrau e mburrura. Ai kishte bërë luftën dhe e kishte bërë me sakrifica të mëdha, po askush nuk e kishte dëgjuar gjëmimin e saj prej tij mbas Çlirimit.

— Më rri larg... — i tha Gjon Kabashi krejt i zverdhur.

Denit iu kujtua Rasha. «Rri larg Rashës, sa rrin dielli me tokën!» — e kishte kërcënuar. «Sa të më rrijë larg Rasha, do të rri edhe unë», — i ishte përgji-

gjur Deni. «Mirë, mirë, po ti më njeh...» — kishte vazhduar Gjon Kabashi. «Të njoh dhe kam për të të harruar!» — e kishte mbyllur grindjen Deni.

Magazinieri e hodhi lopatën. I zgjati faturën Denit, i cili tashmë nuk ishte në gjendje të hidhte firmën. Ndiante njëfarë mëshire për atë njeri, kur duhet ta dënonte.

— Harram e paç... — tha me zë të ulët magazinieri, po megjithatë e dëgjuan.

Deni nuk tha gjë. Ai ndiante njëfarë rrënimi në shpirt. Diçka po i shkërmoqej përbrenda, siç shkatërrrohet një suva e vjetër. Ai mendoi që Gjon Kabashi diku kishte ecur përpara, diku kishte mbetur një piring i vjetër nga binte herë pas here suvaja. «Kush merr Rashën, do të ketë vjehërr një piring të vjetër», — tha me vete Deni.

U kthye të ikte dhe mbeti. Nëndrejtori vështronte me krahët e kryqëzuar në gjoks. Duhet të kishte kohë aty...

— Hiqe përparësen! — i tha ai Gjon Kabashit.

— Pse ta heq? — çapëleu sytë tjetri.

— Je i pezulluar!

— Ç'do të thuash? — u bë dyllë i verdhë magazinieri.

— Do të thotë të shkosh në shtëpi! — tha nëndrejtori prerë.

Gjon Kabashit iu rrotullua vendi. E pa së prapthi nëndrejtorin dhe iu duk si diçka që duhej peshuar. Duhet ta kalonte kuintalin! Kishte mjaft në peshkim që e kalonin kuintalin... Sa për cilësinë... Për nëndrejtorin ai do të ngrinte tre gishta...

E hoqi përparësen pa thënë gjë. Vetëm kur iu afërua Denit pëshpëriti: «E kam pritur të keqen prej teje!» Iku dhe la një heshtje të rëndë pas vetes.

— Ç'keni! Tunduni! Gjon Kabashi e ka mbushur dhjetë herë kupën! — tha me zemërim nëndrejtori.

Asnjeri nuk foli. Sa ishte aty Gjon Kabashi nuk e

domin, tani që kishte ikur, sikur e ndienin që ai vend nuk bënte pa të.

— Thuajini Lizës të vijë për të peshuar...

Dikush u turr andej nga punishtja e rrjetave, pastaj erdhi e tha që Liza nuk kishte dalë në punë.

Nëndrejtori hoqi xhaketën.

— Sillni arkat! Do të peshoj unë! — tha.

Kryeinxhinieri se me kë bisedonte në oborr. E pa Denin dhe i bëri me dorë të afrohej.

— Hë, si e kalove në det? — e pyeti duke i shtrënguar dorën.

— Më vrave... — dhe i tregoi dorën gjithë flluska.

— Aha! Të paska lënduar shala! E njeh shokun Sami? — pyeti tjetri duke i treguar atë burrin e shkurtër me të cilin bisedonte.

— Nga rrjetat? — pyeti sekretari i Partisë.

Deni pohoi me kokë.

— Shoku Sami posa ka ardhur dhe do t'i dijë të gjitha hallet e peshkimit. Të gjitha nuk i di as unë që e kalova vitin këtu! — tha kryeinxhinieri.

— Një vit nuk është shumë, po nuk është as pak! — foli sekretari. Ai dukej njeri i përmbajtur dhe disi babaxhan. Të kundronte një herë në sy, pastaj fliste. Kishte ardhur kohët e fundit në ndërmarrje.

— Shokut Sami i duket se e kemi fetishizuar Karakollin! Po a nuk është bërë legjendë? Një herë i hedh sytë detit dhe e sjell anijen plot. Ne e mendojmë për zot të detit, po ai është armiku ynë! Ai po na i largon njerëzit nga shkenca, nga teknika!

— Njeriun me mend nuk mund ta largosh nga shkenca dhe teknika! — vërejtë sekretari i Partisë pas asaj pauzës së tij të zakonshme.

— Nuk e largon? E di ç'ndodhi dje me një nga kapitenët? E di si m'u përgjigj? «Nuk dua rrjeta moderne!

Asgjë nuk dua! Më jep Karakollin dhe të shohësh ku e çoj planin!»

— Pse je kaq i nxehur me Karakollin? — pyeti Samiu dhe i buzëqeshi Denit.

Deni sikur erdhi në vete. Ai rrinte me ta dhe mendjen e kishte te Gjon Kabashi. Ndihej i vrarë dhe me një makt përbrenda. Nuk i kishte ndodhur të bëhej shkak për të keqen e tjetrit. Ç'do të bëhej me Gjon Kabashin?

— Nuk kam gjë me Karakollin! Ai mund të jetë një përjashtim, mund të jetë mbreti i përvojës, po nuk mund të jetë gjithçka. Ose do t'i përvishemi seriozisht shkencës, ose do të gjunjëzohemi pas intuitës dhe përvojës së tij!

— Përvoja e tij duhet përhapur...

— Nuk kam kundërshtim, po përvoja dhe intuita të çojnë gjer në një pikë, shkenca është ajo që nuk të lë në rrugë! Po këtu te ne... Kam punuar në ndërmarrje të tjera, po një ngadalësi dhe ngathtësi si në peshkim nuk kam parë askund!

— Duket se deti është konservator... — deshi të bënte shaka Samiu.

— Kryesorja është drejtimi...

— Mos po merr hak? — buzëqeshi sekretari.

Denit nuk i pëlqente ky njeri. Iu duk se çdo gjë po e merrte me shaka. Po mendonte si të ndahej me ta. E kishte mendjen te Gjon Kabashi. Ai duhet të kishte arritur në shtëpi. Do ta merrte vesh Rasha... Turp i madh!

— Ju tani keni ardhur, shoku Sami, po unë kam një duf këtu përbrenda se nuk po çaj dot! Gjithë sa fola i kam shtruar në organizatë! Sa për atë karakteristikën... Mbase edhe jam ferra e ndonjërit këtu, po nuk ka rëndësi...

Sekretari buzëqeshi. E kishte dëgjuar disa herë të thoshte «mirë, nuk ka rëndësi». E kishte lexuar atë karakteristikën, që Komiteti e kishte quajtur subjektive. Kishte qenë një mendim për ta ngritur në përgje-

gjësi kryeinxhinierin, po, me atë karakteristikë ...Ai padashur po e verifikonte në vend atë karakteristikë...

— Do të punojmë në formë artizanale, apo do t'i hyjmë shkencës? E dini si e zënë tonin japonezët? J vënë njërit një radio në bisht dhe ai pastaj tregon ku është gjithë tufa...

Deni tha se i duhej të shkonte. Nuk e duronte më kryeinxhinierin. Në djall të venin japonezët me gjithë radiot e tyre.

— Prit! Kam punë me ty! — nuk e la të largohej tjetri.

Sekretari rrudhi buzët. Në karakteristikë thuhej se kryeinxhinieri më shumë fantazonte, sesa punonte!

— Përpara se të shkojmë tek ajo radioja këtu duhen parë gjëra më të ngutshme... — buzëqeshi Samiu.

— E dini? Kam menduar për atë rrjetën 1500-metërshe për tonin...

Sekretarit iu kujtua karakteristika. Aty shkruhej se kryeinxhinieri kishte marrë disa vendime që e kishin dëmtuar materialisht ndërmarrjen. Me sa dukej edhe kjo po vërtetohej. Ndërsa për ato që shkruheshin më tej... Ato ishin shpifje!

— A na mbajnë shpatullat për një rrjetë të tillë tani që i kemi me pakicë edhe rrjetat e zakonshme? — pyeti Samiu.

Tjetrit i ra entuziazmi. I rrudhi krahët.

Sekretari i ra miqësisht shpinës dhe u largua.

Deni vari hundët. Sekretari nuk ishte marrë fare me të.

— Mos e qelba? — e mbajti kryeinxhinieri.

— E qelbe sa i shkoi era në Karaburun! — tha Deni.

— Mirë! Nuk ka rëndësi, po unë kam projekte plot! Do t'i dëgjosh?

— Muã më gjete? Unë sa kam vënë këmbën këtu!

— Prit, pra...

Deni tundi kokën. Nuk kishte nge të dëgjonte ndonjë gjë si ajo puna e radios së japonezëve. E njihte

kryeinxhinierin. Ai ishte i apasionuar pas punës, po rrëmbehej lehtë pas çdo gjëje të re që lexonte.

— Mirë! Nuk ka rëndësi! Shko...

— Mos më thuaj mua shko! — Deni nuk e pranonte as me të qeshur atë fjalë.

— Mirë! Nuk ka rëndësi... — u skuq kryeinxhinieri.

Deni deshi t'i shmangej shefit të kuadrit, po ai i preu rrugën.

— Prit! Kur do ta lagim? — i buzëqeshi ai.

— Kur të duash! — u përgjigj Deni me sytë të kollarja e shefit të kuadrit.

«Pulëbardhën» e ke nga nëndrejtori! Nuk shkohet kollaj aty! Dhe... Dhe llotosisin se vendet e zgjedhura i ruan për miqtë! Ti as që e ke njohur nëndrejtorin!»

Deni u rrudh pa ditur ç'të thoshte.

— Kështu! Ta dish... Nuk hipet kollaj te «Pulëbardha»...

Deni nisi të nxehej. Mos po i bënte presion ai tjetri? Mos kërkonte t'ia dinte për nder? Mos donte t'ia shpërblente?

Shefin e kuadrit e thirrën nga zyrat dhe Deni shpëtoi pa e nxjerrë gjithë handrakun që i ishte mbledhur përnjëherësh përbrenda. I nxehur siç qe, nuk e vuri re triçiklin që u fut në oborrin e ndërmarrjes. Shau dhe i lëshoi rrugë. Thoshin që triçikli vinte gjithnjë kur ktheheshin pellagjikët nga deti. Deni e ndoqi triçiklin me sy të keq gjersa qëndroi përpara magazinave, pastaj u largua.

IV

E diela gjallërohej në fillim të verës dhe nuk dukej si një ditë pushimi. Megjithatë Gjon Kabashi nuk dinte ç'të bënte të dielën. Hardhitë i kishte shtrirë aq bukur nëpër ata telat e ndehur, sa mund të haheshin me një simetri bletësh. Ligustrat rreth oborrit i kishin prerë «karre» dhe asnjë gjethë nuk dilte jashtë kufirit të caktuar, portaren e kishte lyer, ndërsa rruginën gjer te shkallët e kishte shtruar me një çakëll të imët që zhurmonte ëmbël nën këmbë. Sillej nëpër oborr dhe vështronte mos gjente punë. Asgjë për të bërë! Duke u vërtitur, ai mendonte shpesh që vetëm tokës nuk i mbarohej kurrë puna dhe ndiente një të therur që ishte ndarë nga toka. I hidhnin gazetën dhe ai qetësohej, ose siç thoshte e bija, «shpirtin e punës» e zinte «shpirti i politikës». Zinte një qoshe dhe nuk ndihej

gjersa të hidhnin topin fëmijët që luanin përtej, apo gjersa të gjente diçka për t'i treguar Rashës.

— Rashë! Prapë shpërthim bërthamor në Semitalapinsk...

— Në Semipalatinsk! — e korrigjonte Rasha.

— Njëlloj! Shpërthimi është aq i madh, sa më ngatërrohen germat, — thoshte ai.

Gjon Kabashi u ul në shkallë. Kjo ishte një e diel tjetër! Ishte e diela e pezulluar! Gjithçka kishte qenë e pezulluar pasi kishte lënë peshoren e madhe!

Ishte një mëngjes i qetë dhe rrugës nuk kishte njeri. Rasha kishte përveshur mëngët dhe po ndente rrobat që kishte larë.

— Nuk ndehen ashtu... — tha i ati. Ai i hoqi çarçafët dhe i vari ndryshe. Nuk i kishte thënë gjë Rashës për atë pezullimin. Vlonte përbrenda, ndërsa së jashtmi sillej si të dielat e tjera. Ajo mund ta kishte marrë vesh, po jo nga goja e tij...

Rasha u ul te shkallët. I ati nuk kënaqej kurrë me punën e tjetrit, po nuk mund t'i shkonte kundër. Ai bënte punë të përkryer.

— Kështu thahen shpejt... — tha pasi i nderi të tëra.

Rasha psherëtiu. Dikur, vitet e para pasi i vdiq e shoqja, ai i varte rrobat shpejt e shpejt dhe turrej brenda krejt i kuq në fytyrë. Fshehtas fshinte, gatuate dhe arnonte.

I ishte dashur të ishte edhe burrë edhe grua. Ajo gjente andej-këtej nëpër shtëpi trikot që kishte thurur ai dhe i vinte të qante. Arnat e tij të para dhe trikot kishin qenë të rënda, të trasha dhe gati primitive. Kishin mbetur si një dëshmi e vjetër e martirizimit të tij. Ato ishin malli dhe trishtimi i vjetër i shtëpisë! Rasha i vinte sa në një vend në një tjetër, po nuk i hidhte dot! Më vonë ai mësoi të arnonte në mënyrë të përsosur dhe të thurte në mënyrë të përsosur. Ajo ishte punë dhe Gjon Kabashi nuk mund ta merrte me mend si mund të mos ishte e përsosur! Thoshin që ai

sëmurej nga puna e dobët. Ishte një shembull hiperbolizimi për të tjerët, po në këtë rast ishte brenda natyrës së vet. Në këtë pikë natyra e tij dhe bota shkonin krah për krah. Pse nuk vështronte njeriu natyrën e gjallë? A kishte ndonjë gjë të papërsosur në natyrën e gjallë? Kështu pyeste, kur zemërohej për një punë të dobët. Kur nxirrte hojet e bletëve, ai mahnitej dhe nganjëherë e vinte njeriun pas bletëve...

Rasha buzëqeshi hidhur. E kishte rrahur një herë vëllai i madh pse kishte thirrur: «Tata është grua!» I ati e kishte marrë me të mirë. «Kush nuk do të koritet duhet të jetë edhe burrë edhe grua!» — i kishte thënë ai pa e lënë trikon nga duart.

«Çudi! Ai nuk më ka rrahur kurrë...» — tha me vete Rasha. Edhe me vëllanë e madh vetëm me atë shpullë ishte ndarë. Ai ishte oficer në Mirditë, ndër-sa i vogli në Shkollën e Bashkuar. Sikur të kishte qenë Rasha djalë, edhe atë do ta kishte drejtuar nga ushtria... Nuk e kishte dobësinë e uniformës, kishte dobësinë e rregullit. Ai kishte shkuar ushtar drejt e nga mali dhe i kishte lënë mbresa të pashlyeshme rregulli i ushtrisë. Kur ishte kthyer, ai kishte besuar që ushtria ishte shteti! Për shumë kohë ai nuk ishte pajtuar dot me jetën civile. Akoma tani nuk ishte pajtuar plotësisht... Dikur ai thoshte që fuqia e shtetit ishte tek ushtria dhe nuk pranonte asnjë diskutim. Më vonë e dëgjonte me durim Rashën kur thoshte që fuqia e vendit ishte te gruri, te minerali, te klasa punëtore... Më tej ai kishte hedhur një hap të papritur kur kishte thënë që fuqia e shtetit ishte te shkolla... Ky ishte një kapitull i ri në jetën e Gjon Kabashit, një kapitull sa i dhimbshëm aq dhe i ndritur! Ai kishte ndjekur fëmijët e tij për të arritur te ky përfundim. Shkolla e tyre kishte qenë edhe shkolla e tij, pas atyre pak klasëve që kishte bërë natën. Kishte mësuar nga fëmija i parë dhe ishte bërë mësuesi i fëmijës së dytë! Kishte mësuar nga i dyti dhe ishte perfeksionuar si mësues i të tretit! Kujtesa e tij e mrekullueshme e kishte

vënë në vështirësi me ato programet që ndërronin çdo vit. Si mund të ndërronin programet kur dija dhe shkenca ishin po ato? Si mund të mos përfshihej në program një mësim që ishte përfshirë tre vjet përpara? Ku mbetej ajo pjesë historie, ku lihej ai kapitull gjeografie? A nuk ishte njëloj sikur të punoje tokën dhe të lije një ngastër djerr në mes të saj? Megjithatë ai shpeshherë bënte pyetje të çuditshme që tregonin themelet e dobëta të kulturës së tij. Rasha qeshte dhe ai dilte nga dhoma duke varur buzët.

Ai nuk e kishte rrahur kurrë, po ajo ende e kishte shumë frikë. E kishte frikë se ai qe munduar shumë për t'i rritur. Më përpara kishte qenë i prerë, tani sikur ishte zbutur. Fliste gjatë me të dhe Rashës i duhej të dëgjonte ato biseda që ai dikur i bënte vetëm me burrat. Rasha dëgjonte e dëgjonte me vetëmohim, se, kur niste ai, nuk kishte të mbaruar. Fliste dhe kundërshtonte! Ky ishte një dialog përpara të cilit Rasha ishte një arbitër pa asnjë të drejtë. E drejta e saj qe të dëgjonte, t'i bënte shoqëri dialogut. Shpesh gjente një shkak për të dalë jashtë, po Gjon Kabashi e ndiqte pas pa e shkëputur dialogun. Pastaj vinin djemtë dhe gjithçka ndërpritej. Sa rrinin ata gjithçka ndryshonte. Gjon Kabashi kujtohej që mund të rrinte në vatër si një patriark i madh dhe të fliste për çështje me rëndësi jetike me të bijtë. Ai nuk mund të rrinte si patriark i madh kur ishte vetëm me Rashën, nuk kishte kuptim... Ndër ato ditë Rasha mendonte që i ati kishte mbetur po ai malësor, që kishte zbritur dyzet vjet përpara në këtë qytezë dhe qytetërimi i tij nuk shkonte përtej gazetës që e lexonte me zë të lartë në oborr... Kështu mendonte ajo gjersa ikinin djemtë, po pastaj ata mbeteshin vetëm të dy dhe ajo harronte që ai e kishte fyer. Po Rasha e harronte shpejt. Fyerja nuk ishte asgjë përpara heroizmit të tij për të mbajtur familjen.

«Ai ka vuajtur si gruri nën mokër...» — tha me vete Rasha. I erdhi keq për të atin. Ai nuk ishte ankuar kurrë, prandaj i vinte edhe më keq. Kur i vinte duart

në fytyrë, Rasha e dinte që ishte sëmurë, ose ishte në prag të sëmurdjes. Nuk e pyeste. Ishte e kotë, se ai asnjëherë nuk përgjigjej. Ikte dhe zinte një qoshe dhe nuk ndihej gjersa t'i largohej e keqja. «Kur të hahet, ha! Kur të lënë fuqitë, shtrihu! Kur je sëmurë, zër një qoshe dhe kollitu!» — thoshte ai duke i zgjidhur kësh-tu nevojat e njeriut sipas ligjeve më të thjeshta të natyrës. Kur ishte fjala për vetë, nuk ua varte mjekëve, ose më saktë ua varte më pak se të tjerët. Ai arrinte gjer në njëfarë paradoksi me ato pyetjet për mjekët. «E ç'janë mjekët? Njerëz si ne janë!» — thoshte në një mënyrë të tillë, sikur të kërkonte që ata që ushtro-nin mjekësinë të ishin diçka mbi njeriun, përtej njeri-ut... Si mund t'i besonte ai doktor Markut, që ishte rri-tur dy kulme përtej shtëpisë së tij? Ai kishte rrudhur buzët për të drejtën e studimit të së bijës. «Farmaci! Hapa! Aspirina! Tregti me pakicë! Kinkalери» — ki-shte thënë. Megjithatë nuk e kishte penguar të bijën të shkante në fakultet. Mendimi i tij nuk kishte ndryshu-ar shumë as tani, kur e ngrinte Rashën për urgjen-cat. «Përse? Për aspirina?» — bënte shaka Rasha du-ke fërkuar sytë. Ai mbliidhej në vetvete dhe thoshte: «Kjo është brenda rregullave të shtetit!» Gjoni ishte një lëmsh i ngatërruar, po prapëseprapë nismën dhe fundin i kishte të drejta. Mjaftonte ta dëgjoje një he-rë... Dobësia e tij ishte politika, ku ai si zakonisht shkak-tonte valë të ngatërruara që i paqonte në fund me një qartësi për t'u habitur. Disa herë kishte shkaktuar ilari-tet në lektorët që punonin tema në peshkim. Në ndonjë rast edhe ia kishin marrë ters...

— Nuk na erdhi as inxhinieri...

Rasha nuk e ngriti kokën. Ajo e ndiente që ai mundohej t'i fshihte atë, pezullimin.

— Nuk na erdhi inxhinieri, të thashë...

— Kushedi...

— Thuaj që e kemi mërzhitur! — tha ai dhe va-zhdoi të sillej nëpër oborr, me mendjen te pezullimi dhe tek inxhinieri. Inxhinieri ishte i sëmurë dhe ai i lëshonte një dhomë për plazh. Vinte vit për vit dhe

nuk mērzitej nga ligjēratat e Gjon Kabashit. Gjon Kabashi nuk ia donte tē shoqen, qē nuk kishte punē tjetër veç «*laj e shpēlaj*»! Ia zinte pērditē pamjen e rruqēs me ndērrerat dhe ai nuk ishte nē gjendje tē pērfshinte gjithē rrugēn nga shkallēt siç ishte mēsuar. Ua ndērroi vendin rrobave, ia vari afēr ligustrave. Humbēn ca rroba dhe e shoqja e inxhinierit e humbi durimin...

— Tate! Shko diku! Merre dhe stērkate zagarin...

— tha Rasha duke pērdorur pēr qenin atē shprehje qē pērdorej pēr kuajt. Kētē e kishte nga i ati.

Gjon Kabashi ktheu kokēn nga kasollja e qenit. Zagari ishte rrasur brenda. Edhe ai ishte pezulluar dhe kishte turp tē dilte jashtë!

U ul dhe mori gazetēn, po u bē pērnjēherēsh nervoz. Si nuk po dilte askush t'ia numēronte nē ballē atij Pinoçetit nē Kili?

Ligustrat u drodhēn. Rasha kērcēu nē kēmbē.

— Riqo! Spiun i fēllicur! — thirri ajo.

Ligustrat u shpupurishēn sikur tē kishte shpērthyer pērmes tyre një shqarth i trembur dhe Riqoja u zhduk pas apartamenteve.

Gjon Kabashi e la gazetēn. Mendjen e kishte te pezullimi dhe tek inxhinieri. Sikur ta kishte aty, do tē ndihej mē lehtë. Nuk do ta kishte gjithē atē mllef nē zemēr qē nuk i tha asnjē fjalē nēndrejtorit kur e pezulloi. Nuk mund tē fliste nē sy tē tē tjerēve...

— Unē jam pronar... — tha ai papritur.

Rasha e pa me frikē. Ku donte tē dilte? Pse nuk shkonte mē mirē tē zgjidhte qēshtjen e punēs?

— Sepse dhe shtëpia ēshtë pronē dhe unē jam sjeļļē si pronar me inxhinierin! Jo mos i varni rrobat aty, jo mos e ngrini zērin e radios! — parodjzoi vetveten Gjon Kabashi.

— Ne e mbanim lugēn nē grusht kur erdhi kētu nē fillim inxhinieri... — sesi i shkoi pas avazit edhe Rasha duke kujtuar qysh i kishte mēsuar e shoqja e tij si tē silleshin, si tē gatuanin, si tē qepnin dhe tē qēndisnin...

— Do t'i bēj telegram... — tha Gjon Kabashi.

Rasha u gëzua kur pa Salkën të portarja. Salka e mërziste, ishte «emisioni pa ndërprerje», po u gëzua se nuk donte ta zgjaste me të atin.

— Han m'u bë shtëpia, mor zotni! Parmbrëmë pata doktorët e spitalit të ushtrisë, mbrëmë kryetarin e bashkimeve profesionale me të shoqen, sot në drekë atë aktorin e Peshkopisë, për darkë pres Kostaqin me Madalenën! Madalenën, moj Rashë, të bijën e Jorgjisë së Mihal Banushit, që u rrëzua me makinë në Llogora... — numëroi Salka pa ndërprerje. Ajo kishte ndehur llërët mbi portare dhe fliste me nge.

— Epo... Ti je shtëpi e madhe Salkë... — nuk iu durua Rashës. Ajo tani ia kthente Salkës. Mjaft e kishin duruar gjithë ato vite. Salka ishte nga Durrësi dhe ky ishte avantazhi i saj ndaj banorëve të tjerë të vendit që ishin përgjithësisht malësorë.

— Nga e hëna më vërshon Jovani me të mbesat dhe i nipi i Filipit, mor zotni!... — vazhdoi Salka. Ajo përmendte emra dhe emra pa fund sikur të tjerët t'i dinin se cilët ishin.

— Je derë e madhe, Salkë... — tha me tonin e mëparshëm Rasha. Salka nga nëna binte fis me Bushatlinjtë e Karamahmutit, nga i ati me Ali pashë Tepeleenën! Kur e kishin pyetur si kishte qenë e mundur të bashkoheshin kështu në një derë Shkodra me Janinën, ajo u qe përveshur keq. I kishte quajtur malokë truthtarë që nuk merrnin erë nga historia! A nuk i dinin ata lidhjet e Karamahmutit me pashanë e Janinës? «Mirë, Salkë, po gjashtë breza ta mbajnë mend gjirinë e tët shoqi në Mertur të Hasit...» — e ngacmonin. «O të humbur e të përhumbur! Unë nuk flas për sot e për dje, po për shekuj!» — thërriste dhe donte me çdo kusht të ishte më e privilegjuara në këtë qytezë. Sipas saj në këtë qytezë kishin ardhur ca të humbur, ca të harruar nga zoti që nuk kishin bërë prokopi askund. «Po oficerët, Salkë?» Salka tërhoqej menjëherë kur i përmendnin oficerët. Thoshte se ata i kishte sjellë detyra, ashtu siç e kishte sjellë edhe atë. Punën e kame-

rieres në mensën e peshkimit e quante detyrë, siç e quante eveniment faktin që ajo kishte shërbyer gjithnjë duke pasur të varur në krahun e kthyer një peçetë të gjatë që nuk ishte parë ndonjëherë në këtë vend.

— Ai sekretari i Partisë ishte një rondokop që nuk i qeshte nuri... — tha Salka.

— Shoku Sami nuk është rondokop, po sekretar partie! — ndërhyri Gjon Kabashi.

— Pëshpëritet se ia kishin ngopur kryeinxhinierit me atë karakteristikën...

— Kur e thua ti, ka vdekur! — u tall Rasha.

— Si e morët prapë në peshkim atë harrakatin? Nuk u dogjët një herë? Apo ia ka ngrohur gurmazin ndonjërit? — tha Salka që nuk e donte Denin.

— Salkë! Ti e përzien keq llafin... — u vrenjt Gjon Kabashi.

— A nuk ta hodhi baglën me të ardhur në magazinë? — vazhdoi Salka që nuk mund t'ia falte Denit që i afrohej dhe i thërriste pas shpine: «Si i ke llambat, o emisioni pa ndërprerje?»

— Të thashë! E përzien keq e më keq llafin! — e trembi me zemërimin e tij Gjon Kabashi.

— Ika! M'u dogj pilafi! — u bë erë Salka.

Gjon Kabashi seç tha nëpër dhëmbë dhe deshi të hynte brenda. Emri i Denit e kishte ngritur peshë. Po pse nuk thoshte asgjë ajo Rasha?

— Nuk je murgeshë që ma ke përmbysur kokën!

Rasha e vështroi me sy të lodhur, po atij iu duk se ajo vuante.

«Ai ma ka turbulluar këtë bijë...» — tha me vete Gjon Kabashi dhe ndjeu vërshimin e gjakut në kokë. Ndjeu që diçka do të ndodhte dhe pas kësaj do të shkonin kot të gjitha sa kishte bërë gjer tani... Do të shkonte kot ndershmëria e tij, puna e mundimshme, do të shkonte kot kujdesi i dhimbshëm që kishte treguar për fëmijët dhe sakrificat që kishte bërë. Të gjitha do të avullonin, si vesa pas diellit për një hiç, për njëfarë njeriu, për një zuzar! Ai shkoi aq larg, sa për një

çast mendoi që Deni përpiqej ta prishte me shtetin, me Partinë! A nuk ishte dëshmi pezullimi? Do ta detyronte të bënte ndonjë marrëzi dhe... Kuptohej pastaj... Ai qe i bindur që Deni tallej me të bijën. Po ta donte për fat, do të sillej ndryshe. E, po të sillej ndryshe?

Këtu u zu ngushtë. Sido që të sillej, nuk e donte për dhëndër!

Ngjiti një shkallë, por Rasha e shtrëngoi fort për krahu. Ai u kthye me fytyrë nga rruga. Pas dërrasave të portares dukej silueta e kërrusur e një plake. Plaka u drejtua pak nga pak, shtriu krahët dhe u kap pas qemerit të sipërm të portares me krahët hapur. Kështu ajo ishte një bina e madhe që sundonte në gjithë oborrin.

— E zuri gjithë dritën... — u drodh Rasha. Për një çast mendoi që ajo plakë i kishte ngujuar të dy aty brenda dhe nuk do t'i linte të dilnin që aty. «Vjen vit për vit sa të na e përsërisë mallkimin te dera», — u drodh Rasha.

Të dyve iu duk se plaka qeshte. Ndoshta edhe qeshte, po kjo ishte edhe më keq. Nuk i bënin dot ballë shprehjes së fytyrës së saj. Ajo qe si e ndarë më dysh: gjysma në dritë dhe gjysma në terr!

— Marë! Pash tokën e qiellin ec brenda! — iu lut Gjon Kabashi.

«Nuk do të hyjë! Do të pështyjë dhe do të ikë! Tre vjet ka që pështyn dhe ikën!» — tha Rasha me vete.

Plaka u zgjat edhe më tej. Sikur vuante torturën e rrotës së mesjetës me ata krahët e zgjatur: Rasha për pak sa nuk thirrë. Qe bërë terr dhe qielli sikur ishte puqur pas asaj tendës së rrushit, Rasha mezi merrte frymë. Pastaj i pa shpinën plakës dhe iu duk se qielli zuri vend në kufirin e vet.

«Kësaj here ajo nuk pështyu», — tha Rasha pa ndër ndonjë gëzim të veçantë. Ishte aq e tronditur, sa kishte nevojë që dikush ta fyente për të ardhur në vete. Ajo besoi që kësaj radhe plaka e kishte mbajtur helmin përbrenda dhe nuk e kishte derdhur mbi ta. Helmi do

ta plaste shpejt... As kjo nuk ishte e mundur. Ajo e kishte mbajtur gati gjysmë shekulli helmin në gjoks dhe nuk kishte plasur...

— M'u prish kjo verë! — tha Gjon Kabashi dhe hyri brenda duke përplasur derën.

Mbi gjethet e hardhisë u ndien pika e rralla të shiut, pastaj ia nisi rrebeshi.

V

E ndiente Riqon pas shpinës, po bënte sikur nuk e kishte parë. Rrinte mbi një gur përtej molos me shpinën kthyer nga zyrat e ndërmarrjes. Deti ishte mbuluar me mjegull dhe atje pas farit po kthehej një motobarkë e vonuar. Kjo ishte një pamje e zbehtë, që u përgjigjej atyre projeksioneve të filmave të vjetruar dhe nuk ishte imazhi i vërtetë i portit. Gjallëria e përhershme e tij ishte gjallëria e njerëzve, po ajo binte ndonjëherë pa kuptuar, pasi shkarkoheshin anijet dhe niseshin peshkatarët në shtëpi. Ishin në det dhe mendonin shtëpinë, niseshin për shtëpi dhe e mbanin kokën nga deti! Si thoshin peshkatarët? «Rrimë gjashtë muaj në det dhe na duket se trualli ynë është deti! Rrimë gjashtë muaj në tokë dhe na duket se trualli ynë është toka!»

Kishte qenë një natë e mbarë, megjithëse Kara-

kolli nuk ishte ngjitur atje në majë të shkëmbit për të hetuar peshkun.

Deni nuk kishte pranuar ta shoqëronte sardelen në magazinë. Kishte radhën, po nuk kishte pranuar. A nuk pëshpërisnin se Gjon Kabashi e kishte pësuar nga këmbëngulja e tij? Pati një pakënaqësi tjetër, ndërsa po largohej. Motoristi me Taushin i kishin mbushur çantat e mëdha me sardele dhe po i hidhnin në shpinë. «Shpirti i Xhikes! Gjithë lagjja mjaullin për një bisht sardele...» — i kishte thënë Taushi si i zënë në faj. Motoristi as që e kishte parë të udhës të thoshte gjë. «Sikur po e teprojnë me peshkun...» — kishte vërejtur Deni. «Shpirti i Xhikes! Zbute zemrën... Si do t'ia bëj unë nesër-pasnesër me dasmën e Hatës?» — kishte hapur sytë Taushi. Motoristi e kishte parë me përbuzje. «Tri herë po të martohet Hata, kunata, po mos u tremb për peshkun! Nuk mbarohet deti!» — kishte thënë motoristi duke i hedhur një vështrim mos-përfillës Denit.

Këtij i kishte hipur inati ndërsa largohej motoristi me çantën në krah dhe kishte dashur ta mbante, po kishte ndërhyrë Karakolli. «Deti na ka dhënë, ne u kemi dhënë të tjerëve... A e njeh kapitenin e «Maliqit»? Nuk i lë të marrin një bisht sardeleje, po cila barkë është për faqe të zezë me planin? «Maliqi!» — kishte thënë Karakolli.

— Ç'ke që më ngjitesh? — pyeti Deni pa u kthyer.

— Kush të ngjitet? Ne ecim dhe takohemi... — tha djali i lënduar.

— As Rashës mos iu ngjit më! — mezi e mbajti gazin Deni.

— Nuk më merr malli për framacisten!

— Farmacisten! — e korrigjoi Deni.

— Framacisten! — rrahu këmbën Riqoja me inat.

— A mos doli nga drejtoria motoristi, Zeqiri? — e zbuti zërin Deni. E kishte ngacmuar për shaka, po e kishte tepruar.

— E ç'më duhet mua? — tha djali i zemëruar dhe ia mbathi.

Ishin të tre në zyrë dhe ai deshi të ikte... Deshi të ikte se kishte vetëm dy javë në peshkim dhe kishte ardhur të ankohej dhe të kërkonte... Ata të tre e mbërthyen me sytë e tyre në mes të derës dhe nuk iku dot. Sytë e nëndrejtorit ishin të bezdisur, të motoristit akull, ndërsa shefi i kuadrit luhatej mes kureshtjes dhe gудisë...

I kishin thënë që nëndrejtori nuk linte njeri të flisre. I kishin thënë që ai monologonte në dialog, i kishin thënë që nuk duhet ta ndërprisje...

— Nuk ke më shumë se dy javë këtul! Nuk gabohem! Të njoh kështu... (nëndrejtori ngriti dorën e hapur përpjetë, e shkundi dhe Denit iu duk se e njihte si copë letre që e merrte era). Nuk të njoh nga të tjerët! Të tjerëve vizë! (nëndrejtori e uli dorën nga lart-poshtë sipër kokës së Denit dhe atij iu duk se e ndau në dy pjesë). Kushdo mund të vijë tek unë... Jam mikpritës, po nuk jam shumë bujar! Nuk mund të heq njeri nga dezurni! Nuk e kam të lehtë të jap lejë për shkollën e natës se natën e kemi punën! Nuk mund t'jua ndërroj cimat dhe fenerët para afatit, se nuk kam ku i marr! Nuk mund t'jua ndërroj rrjetat kur i ngatërroni me paudhësitë tuaja, se nuk kam ku i marr, — tha ai dhe i përzjeu shuplakat me energji sikur të ngatërroheshin rrjetat.

Nëndrejtori heshti dhe e vështroi në sy. Si ishte e mundur që nuk e kishte ndërprerë? Kështu vepronin vetëm nëpunësit e vjetër që ia dinin huqet.

Nëndrejtori u ul rëndë dhe e mbështeti qafën e trashë pas poltronës së vjetër. Ai ishte njeri i fortë, po nuk bënte asnjë përpjekje të të impononte personalitetin e tij. Megjithatë kjo sesi vinte vetvetiu... «Do të shpëtosh nga frika e tij? Bëji një vizitë në shtëpi! Ecën në majë të gishtërinjve nga frika e së shoqes! E ka xhadë! Xhadë!» — thoshte Salka për të.

E kishte njohur nëpër qytet këtë njeri, po nuk e kishte njohur në punë. Nëpër qytezë kishte diçka prej Taushit, në punë kishte diçka prej furtunës... Me për-

jashtëm të shefit të kuadrit «që mbështillej pas frymës së vet për të mos u rrëzuar» dhe kryeinxhinierit që nuk vinte mish kurrë, nëpunësit e tjerë të ndërmarrjes ishin shulakë dhe të shëndoshë. Nëndrejtori hante pak dhe Salka e tepronte kur e fuste në një kallëp me nëpunësit e tjerë. «Ata janë tmerri i detit! Nuk kanë lënë karavidhe në këmbë! Nuk kanë lënë karkalec e kallamar! Nuk kanë lënë oktapod pa shqyer!» — thoshte Salka nga inati pse nuk ia kishin marrë djalin në punë.

Nëndrejtori ishte qetësuar. Shefi i kuadrit kishte një fytyrë pa shprehje, ndërsa motoristi që merrte herë pas here diçka nga tryeza e nëndrejtorit përpiqej të tregonte që ishte si në shtëpinë e vet.

— Kam ardhur për limbjotën! — tha Deni, që u çudit si e nxori atë që përpiqej ta kapërdinte.

Karrigia kërciti kur nëndrejtori u kthye me vrull nga dy të tjerët.

— Dëgjuat? Ka ardhur për limbjotën! — tha me nervozitet.

— Unë kam ardhur te ju! — tha Deni me qëllim.

— Nuk më kishte shkuar ndër mend për këtë... — tha nëndrejtori si i këputur.

Denit iu duk se ai u lëshua ashtu nga inati që nuk e gjeti vetë pse kishte ardhur Deni.

— Nuk më kishte shkuar ndër mend... — foli sikur të ankohej nëndrejtori. U mërzi. I kishte rënë barra e drejtimit pa qenë drejtor. Drejtori ishte sëmure prej një viti dhe nuk dihej puna e tij. Herë flitej se do të dilte në punë, herë thuhej që do të sillnin drejtor të ri. Nëndrejtori nuk kishte lakmuar asnjëherë t'ia zinte vendin. Aq më shumë nuk donte tani. Kishte shkuar disa herë në komitet për të parë ç'do të bëhej për drejtuesin e ndërmarrjes. Gjersa kishte qenë drejtor, ai përgjigjej vetëm për prodhimin dhe nuk kishte të bënte as me njerëzit, as me dikasterin. Ankesat dhe kërkesat i zgjidhte dhe i shtronte drejtori. Ai i rrinte disi larg dikasterit. Kërkonte gjërat më të nevojshme,

ato që ishin si buka e përditshme dhe merrte ato që i jepnin. Vetëm se nuk i falte kurrë ata që i premtinin e tërhiqeshin. Për një premtim të tillë ai kishte vajtur dhe i kishte marrë gati me zor rrjetat në Sarandë. «Ehu! Ai e ka punën me gjak të nxehtë dhe kokëfortësi!» — thoshin në dikaster për të. Vetë e mbante fjalën dhe kërkonte që ta mbanin edhe të tjerët. «Do t'i marr rrjetat që na keni premtuar dhe planifikuar, — u kishte thënë atyre të dikasterit, — se me fjalën tuaj u kam premtuar edhe unë peshkatarëve!» Ishte punëtor, po thoshin, që punën e konceptonte pas mendjes së vet dhe nuk pranonte mënjanimë dhe shmangie ndaj asaj që kishte bërë ai. Tani e kishte lënë, po dikur thoshte: «Ke gjoks? Futju punës! Po nuk pate gjoks, kot e ke!» Nuk e kishin dëgjuar asnjëherë të thoshte: «Ke mend? Futju punës...» Edhe ai vetë punonte me gjoks. Ishte natë e ditë në këmbë. Sa tek anijet, sa në kantieret e riparimit, sa në ndërmarrjet e rretheve të tjera. Qe i prerë për t'i zgjidhur punët aty për aty dhe e kishte pisk me punët që planifikoheshin për afate të gjata. Thyhej motori i një anijeje, ai i hipte «Gazit» dhe kërkonte uzinat e gjithë vendit. Ishte e pamundur që të vinte bosh. Thoshin se «Gazit» të tij i vinte era peshk... Ai nuk e quante për ndonjë gjë të madhe kur anijet që niseshin për riparim në Durrës të merrnin ndonjë arkë me peshk për mekanikët.

«Ne ende nuk jemi 100% me planin, po që kur e ka në dorë drejtimin e ndërmarrjes Murat Nallbani, po i afrohem realizimit të tij! — i kishte thënë Denit kapiteni. Thonë që ai e ka mbushur peshkimin me njerëzit e tij...» — nuk kishte ndenjtur rehat Deni. «Ehu! Me këto llogari unë dal fis me gjysmën e Shqipërisë!» — i ishte përgjigjur kapiteni. «Detin nuk e ka me libër, po me përvojën e të vjetërve dhe me ç'i thotë mendja! Kështu kam dëgjuar...» — kishte vazhduar Deni. «Pse? A mos e ka keq? Si të duket Karakolli?» — i ishte përgjigjur tjetri.

— Këta kanë një jetë me atë barkë dhe nuk më

kanë kërkuar limbjotë! — tha më në fund nëndrejtori duke treguar Zeqirin me gisht.

Motoristi u kollit. Deni priti të kollitej edhe shefi i kuadrit. Priti të kollitej edhe vetë nëndrejtori... Ata ishin tre, po ai shihte vetëm një njeri dhe atë e kishte kundër! E ndjeu që nuk mund t'i bënte ballë atij njeriu, se ishte thyer vetë përbrenda. Kishte ndër marrë një hap gjithë madhësi, pa i thënë njeriu, pa u këshilluar me askënd! Si ishte e mundur që ata shokët e tij të punës që kishin kaq kohë në atë anije të mos ishin interesuar për limbjotë? Kushedi sa do të tallëshin me të të nesërmen! Kishte vajtur te nëndrejtori të ndërhynte në favor të tyre, të shkencës, të përparimit teknik! Kështu mendoi ai, pastaj shkoi edhe më tej në analogjinë me Don Kishotin, Heronjtë kryesorë të letërsisë botërore ai i kishte kufizuar në mes Don Kishotit dhe Shvejikut, sepse «e gjithë zgjuarsia e botës rrinte mes Shvejikut dhe Don Kishotit».

— Shoku Murat...

— Me sa shoh unë, nuk ke gjoks! — e ndërpreu tjetri.

— Nuk ma ke parë gjoksin... — u nxeh Deni.

— Nuk mund të shpenzojmë për një barkë druri që është kandidate për t'u prehur në fund të detit!

— E kuptoj... — tha Deni, pa qenë i bindur aspak që ishte ashtu siç thoshte ai tjetri. Ai ishte i bindur që njëri nga limbjotat nëndrejtori e ruante për Xhafë Kalisin.

U mat të dilte. Ndiante një boshllëk përbrenda, një mërzi që e shtynte të ikte sa më larg nga ajo zyrë. Nuk ishte i nxehur, ishte akull, ishte si i mpi-rë. Iu desh t'i lëshonte udhë sekretarit të Partisë, që posa hyri. Ardhja e tij sikur e ndërroi menjëherë klimën e zyrës. Motoristi i mblodhi këmbët nën karrige dhe e humbi sjelljen familjare, ndërsa shefi i kuadrit mori dosjen që ishte mbi tryezë dhe deshi të dilte. Sa-

miu e mbajti me një gjest, pastaj i buzëqeshi Denit sikur ta kishte të njohur të vjetër.

— Nuk ka as dy javë te ne dhe na kërkon limbjotë... — foli sa për të prishur heshtjen nëndrejtori.

— Po a kemi limbjotë? — pyeti Samiu.

Nëndrejtori nuk pati kohë të përgjigjej, se u hap dera me rrëmbim dhe brenda hyri Liza, ajo që kishte zëvendësuar Gjon Kabashin.

— Nuk mundem më! — tha me një frymë.

— Mundesh që ç'ke me të! — e kundërshtoi nëndrejtori me atë maninë e tij për t'i vënë të tjerët përpara.

— Ai rri aty dhe nuk luan nga vendi...

— Kush rri aty? Sqarona, se na plase! — e humbi durimin nëndrejtori.

— Gjon Kabashi! Rri në një qoshe dhe nuk m'i ndan sytë! Apo nuk i ka ata sytë... Më dridhet kandari! Nuk mundem! Ka tri ditë që rri po në atë vend! Gjej një tjetër, shoku Murat! — foli Liza shpejt e shpejt.

— Të flet? Të pengon? — pyeti nëndrejtori dhe u ngrit i shqetësuar.

— Nuk flet, rri si gur, po ata sytë... Gjithë sardelen do ta kaloj të dytë dhe të tretë nga ai!

— Nuk duhet të rrijë aty... — tha si nëpër dhëmbë nëndrejtori.

— Gjeni një tjetër, shoku Murat...

Murat Nallbani e përcolli magazinieren dhe mbylli derën.

— Ai duhet të vinte për sqarime... Duhet të ankohej... — tha ai.

— Askund nuk ka për të shkuar! — ndërhyri shefi i kuadrit.

Deni u tërhoq dhe doli pa e vënë re. Nëndrejtori shkante dhe vinte nëpër zyrë. Ai qëndroi përpara Samiut.

— I duhej dhënë një mësim Gjon Kabashit! Si thua, shoku Sami?

— Nuk e di! Nuk jam thelluar...

— Po është e thjeshtë, shoku Sami!

— Unë po vij nga Komiteti i Partisë! — i preu fjalën tjetri. Ai mori një pamje të zymtë dhe vetullat e trasha iu bashkuan në mes të ballit. Kështu u bë i rëndë dhe i paafrueshëm.

— Të paskan ngarkuar mirë e mirë! — u hodh nëndrejtori.

— Sa na takon të mbajmë! Jo më shumë!

— Për sa ke punuar këtu, asgjë nuk të takon të mbash, shoku sekretar... — sikur e mori me të mirë Zeneli.

Tjetri rrudhi vetullat edhe më shumë. Ato i jepnin një përfytyrim krejt tjetër kujt do që nuk e njihte. Ai ishte njeri i matur dhe i butë. Ai fliste ngadalë, aq ngadalë, sa ndonjëherë bëhej i mërzitshëm.

— Plani keq... Sardelet e javës tjetër u prishën dhe shkuan për derra! Motobarkat nisen dhe kthehen pa dalë mirë nga porti për një cilindër dhe për një piston! Ku jemi me revolucionin tekniko-shkencor? Në ndër-marrje mungon fryma e kritikës dhe sundon njëfarë akraBallëku! Ka edhe të tjera dhe... Kapakun ia vë ajo karakteristika për kryeinxhinierin! Për këto duhet të mendojë grupi i punës për mbledhjen e ardhshme të organizatës, — tha Samiu duke vështruar shefin e kuadrit.

Zenelit iu tha buza. Nuk kishte asgjë personale me kryeinxhinierin! E kishte nxirë atë karakteristike vetëm se nuk kishte besim tek aftësitë e tij! Kishte pasur frikë mos ngrinin në përgjegjësi një njeri për të cilin nuk kishte besim!

Nëndrejtori e hodhi lapsin mbi tyrezë.

— Për të ngritur probleme, është lehtë, për të ndihmuar, është vështirë! U prish frigoriferi i madh, u prishën edhe sardelet! Me se t'i nis kur nuk më mjaftojnë mjetet? Ç'faj kam unë se gripojnë menjëherë ato pjesët e këmbimit? Ku duhet material importi, duhet material importi dhe pikë! Ose t'i dalin zot dhe

të mos rrahin gjoksin kot! Më hëngrën shpirtin me akraballëkun dhe tarafllëkun! Po kush të vinte në peshkim gjer pak përpara? Ca të humbur... Kështu që jam detyruar të tërheq të njohurit...

— Tani nuk ngurrojnë më të punojnë këtu... — vërejtji sekretari. Ai ende nuk dinte si të sillej me nëndrejtorin. Ç'peshonin më shumë tek ai njeri, të metat apo meritat?

— Nga katër muaj që ke në peshkim, tre i ke kaluar në ushtri... — tha me nëntekst Murat Nallbani. Ai e shtypi fort cigaren në tavëll. Të gjitha i kishte shuar përgjysmë.

— Në këta tre muaj ke marrë dhjetë bashkëfshatarë dhe një djall e di si kanë hyrë!

Nëndrejtori u kthye nga Zeneli. Dhjetë veta? E pamundur!

— Urdhëro? — belbëzoi shefi i kuadrit.

— Asgjë... — tha tjetri. Ishte nga një vend me Zenelin dhe ai ia mbushte mendjen për të marrë bashkëfshatarët në punë. «Si të mos e marrim djalin e Zef Kaçulit? Apo nuk janë besnikë Kaçulët? Si të mos e marrim Pjetër Gomilën, kur morëm një bataçqi si Marko Marken e Pashkut?» Shefi i kuadrit edhe propozonte edhe bënte presion.

— Asgjë... — përsëriti nëndrejtori, që po tërbohej duke parë sa qetë rrinte shefi i kuadrit. Nesër-pasnesër ai do të ndërhynte prapë për të marrë ndonjë të afërm në punë! «Yti mishin ta ha, po koçkën ta ruan!» — e kishte zakon të thoshte shefi i kuadrit.

— Këto do t'i bisedojmë në Parti! — tha Samiu.

Nëndrejtori nuk arriti të përgjigjej, nuk gjeti një fjalë dhe të gjithë e kishte nga ajo qetësia e shefit të kuadrit. Më në fund i nxori çelësat dhe i hodhi mbi tryezë.

— Këto më kanë mbetur në derë! Kurrë nuk i kam dashur dhe nuk dua t'i kem! Nuk e kam çuar dëtin në shtëpi! Kam punuar si ma ka prerë mendja!

— Nuk duhet t'i mbahemi vetëm kokës sonë...

— Je i ri këtu! Do të mësohesh!

— Nuk besoj të mësohem... — buzëqeshi tjetri.

— Shumë i prerë qenke sot, shoku sekretar! Kush tha të mësohesh me të keqen? Po gjithsesi ti e ke më kollaj, se ti, si të thuash, kritikohesh teorikisht, kur-se mua më mbërthejnë për fyti për planin! — u nxeh nëndrejtori. Më tej ai shtoi se nuk e kishte shkelur kolegjalitetin dhe se nuk mund ta mbushte detin me peshk dhe t'i bënte debilët të zgjuar! Ai që zemëruar që sekretari ishte hedhur menjëherë në sulm dhe as që kishte pyetur në ishin gjallë a vdekur!

Sekretari e ndjeu prapë atë strehën e errët sipër syve. Kur i hipte mërzia, ajo ndehej pa dëshirën e tij dhe ai nuk kishte si e pengonte. Nëndrejtorin nuk kishte pse ta pyeste për shëndetin, se ai i ngjante një kaldaje në shpërthim nga të ngjallurit. E kishte njohur disa vjet përpara dhe ai kishte qenë kockë e lëkurë. «Moshë dhe rakia, mezet e peshkut dhe ajri i detit», — tha me vete. Dilte gota e rakisë dhe do të dilte nga fundi i detit edhe peshku! Një bisht peshku thoshin pa e përcaktuar në ishte një bisht sardeleje, apo bisht lojbe!

— Kemi përpara festivalin folkloristik dhe duhet të përsërisim suksesin që keni pasur disa vjet përpara, — tha me ton më të shtruar sekretari i Partisë.

«Te festivali më rreh mua!» — mendoi nëndrejtori.

— Ah, harrova... Na lavdëruan për brezin e mbrojtjes...

Nëndrejtori u kthye nga ai. Vetëm për një muaj kishte punuar me të, po kishte vënë re që sekretari numëronte në fillim gjithë të këqijat dhe vetëm nga fundi thoshte diçka të mirë. Asnjëri nga kuadrot që kishte njohur nuk vepronte kështu.

— Po të doni, ju jap nga një kafe...

— E pimë, madje pa sheqer! — tha nëndrejtori që ishte gjer në fyt me të.

— Nuk ke pse zemërohesh! Për punën e kisha! —
tha me qetësi sekretari.

— Të gjithë për punën e kemi, po nuk po na e
shohin punën! — e mori disi veten nëndrejtori.

— Po tani? — pyeti nëndrejtori me të dalë sekre-
tari i Partisë.

— Hiç... Si gjithnjë!

«Si gjithnjë... Si kollarja e ngushtë! Si të fryrat
që më bën në vesh...» — tha me vete me mërzi nën-
drejtori.

— Ç'do të thotë «si gjithnjë»? — iu kthye shefit
të kuadrit:

— Hiç... Pse e merr kaq ters?

— Do të na djegin! — tha Murat Nallbani me zë
të rëndë dhe tjetrit iu duk sikur tha që e meritonin
të digjeshin!

— Nuk je bërë për t'u djegur!

Nëndrejtori buzëqeshi. «Të djegurit» mbeti në një-
jës, si kishte mbetur atëherë me atë çështjen e kar-
burantit nga e cila ai tjetri kishte dalë i larë. «Nuk do
të të dëgjoj më, moj kravata e ngushtë!» Nëndrejtori
sollti ndër mend pëshpëritjet se shefi i kuadrit e ki-
shte zënë pisk nëndrejtorin dhe e kishte në dorë...

— Duhet biseduar me shokët! Nuk duhet të të
vërë përpara ai sekretari... — tha Zeneli. Ai po veço-
hej gjithnjë e më shumë.

— Mos guxo të thuash një fjalë!

— Të sqarohen shokët... — u përpëliti tjetri.

— Hesht! Nuk jam nga ata që i bëj krahmarrje
organizatës!

— Pse nxelesh? Dhashë një mendim! Gabova?
Më thuaj që gabova!

Nëndrejtori e pa me vëmendje. Me të dalë në
rrugë ai do të zinte njërin e tjetrin për të shkarkuar
veten nga ato që mund të dilnin në organizatë. Pas-
taj, kur të sigurohej për vete, mund të përpiqej ta
mbronte dhe atë.

— Ku do ta nisim sardelen? Në konservim, apo në kombinat?

Mbase ai pyeti kot, po tjetrit i dogji, se kishte të bënte me metodën e tij të punës. Nëndrejtori lëvizte mjaft herë me kontratat sipas leverdisë së ndërmarrjes dhe nuk pyeste ku shkonte prodhimi. Përpisqej të hiqte sa më parë peshkun.

— Do të respektojmë grafikun!

— Triçikli! — tha me zë të ulët shefi i kuadrit duke u zgjatur te dritarja.

— E pastaj?

— Ta nisim bosh?

Si po përmbahej ashtu? Të gjithë i kishte dëgjuar me një qëndrim shembullor, që nga Deni gjer te shefi i kuadrit, që e ngacmonte në plagë. Kishte dëshirë ta niste bosh triçiklin dhe këtë e kishte vendosur prej ditësh, po ai tjetri do t'ia merrte për frikë. Shkelje kishte, vjedhje nuk kishte! I hiqej një pjesë e peshkut dyqanit dhe u shkonte miqve të tij! Kaq!

— Triçikli të marrë sa të pëlcase me gjithë goma! — tha gati solemnisht nëndrejtori, po pas kësaj u ul i këputur. U zhyt në poltronë dhe përnjëherësh pati përshtypjen se u fundos më thellë. me atë triçikël... Ishte i mërziur, i shqetësuar dhe bënte gjumë të keq. Në gjumë thërriste për të dalë nga pellgjet ku fundosej... Zgjohej dhe, gjersa zbardhte, mendonte se duhej të zbrazej diku, të fliste me ndershmëri, të bënte autokritikë... Dilte në punë dhe puna e mbështilte në vorbullën e vet, në përplasjet e veta, në lëshimet prej të cilave nuk dinte si të shpëtonte. E dinte që do të dilte një ditë përballë të tjerëve... Kot sa e shtynte! Ai mund ta kishte bërë me kohë, po trembej për atë që do të vinte pas. Trembej se nuk e mbante dot fjalën! Druhej se nuk do të dinte të punonte ndryshe, të drejtonte ndryshe... Trembej, se ishte të mësuar ta mbante fjalën!

— Ishte edhe para dhjetë ditësh... — tha Zeneli për triçiklin.

Tani nëndrejtori kishte harruar gjithë prapësitë e ditës, tani në kulmin e tyre kishte zënë vend Gjon Kabashi. Si nuk e kishte marrë të pinin një kafe dhe t'i shpjegonte politikën ekonomike të shtetit? I kishte dhënë vetëm urdhra, këshilla zyrtare dhe vërejtje!

U kthye me rrëmbim nga shefi i kuadrit.

— Hapi veshët mirë! Dy shefat, i planit, i flotës, kryeinxhinieri, ti dhe unë në det! Sonte në det! — tha me një frymë nëndrejtori.

— Unë në det? Jam me shiatik, me raport...

— Në det! Po nuk dole, dorëzo zyrën!

Shefi i kuadrit u spraps. Tjetri i kishte ardhur në turinj dhe i tundte gishtin! «Oburra, se e zuri tërbimi i punës!» — tha me vete Zeneli. I dinte shpërthimet e nëndrejtorit. Ishin rrufetë e ditës me diell, ishin ana-kronizmi i klimës... Kur i shkrepse një ide, shndërrohej përnjëherë në një lëmsh nervash dhe përplasjes, që paqoheshin vetëm kur kishte përfunduar gjithçka.

— Dëgjove? Në det! — përsëriti nëndrejtori pa u kujtuar që ai tjetri kishte ikur.

VI

Deni e mori për bujë... Ç'do të dilte nga kjo? Administrata në det i ngjante një fanfare të mjerë. Instrumentet e saj stononin, lëkundeshin dhe prishnin radhën nën mëshirën e dallgëve...

Deni buzëqeshi duke parë si i mbante lart pantallonat e dokut shefi i kuadrit për të shpëtuar nga ndryshku i cimave dhe grasoja. Ai ishte një ekuilibrist i mrekullueshëm në tokë dhe një ekuilibrist për t'u vajtuar në det. Të kujtonte komikët e parë të filmave pa zë ndërsa epej sa në një krah në një tjetër me t'u nisur «Maliqi». Edhe nëndrejtori kishte groteskun e tij teksa kapërcente parmakët e motobarkës, po, me të rënë në kuvertë, peshonte në vend të vet. Nuk e qeshën. As ata që nuk e donin nuk e qeshën. U kishte ngrënë shpirtin me punë dhe me atë lehtësinë për t'u kthyer nga drejtues në punëtor moloje. Sfida e madhe e tij

nuk ishte në zyrë, po aty në molo kur mbartte me ndonjë rast peshën e rëndë për të turpëruar dembelët, Ai kishte thënë që aty ishte sfida e vërtetë, ajo e muskujve! Nga zyra nuk mund të kishte sfidë! Nga zyra të mundte pozita... «Ka njëfarë virusi të pashërueshëm... Duhet të çlirojë energji dhe zyra nuk i mjafton për këtë», — kishte thënë një herë doktor Marku duke parë si ishte kthyer nga rruga nëndrejtori për të mbartur një sandall të rëndë që nuk e ngrinin dot të tjerët. Nëndrejtori nuk e donte zyrën. Ndodhej në ndonjë anije në molo dhe lajmëronte administratën të vinte aty për mbledhje. Kjo u kishte pëlqyer peshkatarëve.

Deni nuk dinte ç'të bënte me të nëpër këmbë. Iu duk se ai më shumë kishte ardhur për t'i ngatërruar. Ai fuste hundët kudo dhe filloi ta mërziste me të drejtë dhe pa të drejtë ekuipazhin. Vetëm Karakolli nuk e kishte mendjen tek ai. Rrinte në bash me mjekrën në dorë dhe bërrylin mbështetur në parmak. Dukej se ishte një pjesë e drurit të anijes, dukej sikur ishte gdhendur në bash, ashtu siç gdhendnin dhe përjetonin grekët, fenikaset dhe gjithë popujt e lash-të të detit në skafin e anijeve zotërit, mitologjinë dhe eufemizmin.

Nëndrejtori nuk zinte vend. Ai i tha kapitenit që verigat e barkës pneumatike të shpëtimit ishin ndryshkur dhe në rast rreziku do ta kishin keq. Ai shau kur pa elektrolinjën të mbledhur lëmsh në qiç, bërtiti për shporetin që nuk kishte përposh mbrojtëse llamarine kundër zjarrit, u kanos se nuk do t'i linte të dilnin në det pa pasur aq goma shpëtimi sa ishte personeli, pastaj zbriti në palmetë dhe ngriti çarçafët. Me përjashtim të atyre të motoristit të tjerat ishin tepër të pastra.

— Vetëm derri mund të flejë këtu! Jo, jo! As derri... — foli ai pa ditur i kujt qe shtrati.

Ai do të ishte zgjatur më tej sikur të mos i tërhiqte vëmendjen Karakolli, që iu afrua shtratit të tij dhe u shtri me shpinën nga ata që ishin në palmetë.

— Nga do të fryjë era, Karakoll? — pyeti si me shaka nëndrejtori.

Tjetri nuk u tund, vetëm sa ktheu fare pak kokën. Dukej vetëm hija e fytyrës së tij se dritën e priste shtrati i sipërm.

— Ke marrë letër? — nëndrejtori e kishte fjalën për të birin që e kishte ushtar në Sazan.

Karakolli tundi kokën dhe përgjigjja e tij u mor vesh nga shtrati që kërciti. Nuk kishte marrë letër!

— Të nis unë nesër për Sazan!

Karakolli u përpëliti pa thënë gjë.

— Ç'thashë? Nuk mundem nesër! Jemi në fushatë! Pas dhjetë ditësh...

— Ti vetë jep, vetë merr... — pëshpëriti Karakolli.

— Ç'thua për sonte? Nga t'ia mbajmë?

Tjetri nuk u përgjigj.

E la. E dinte që nuk i nxirrej gjë me të shtyrë Karakollit. U mor me kapitenin dhe bisedoi për lëvizjet e sardeles në ditët e fundit.

— Them t'ia mbajmë nga Marqela... — tha nëndrejtori.

— Nga Marqela! — i thirri kapiteni Palit në timoneri.

Nëndrejtori pa sahatin. Donte edhe dy minuta të shkonte tetë. Ky ishte orari i ndërlihdhjes me radio. E ngriti edhe dy herë të tjera mëngën e xhaketes për të parë orën dhe kjo donte të thoshte që kishte nisur të merrte zjarr. Ky ishte ai tërbimi i punës, që thoshin të tjerët, ai ankthi që e mbërthente atë vetë dhe këthehej pastaj në një darë të fortë për të gjithë të tjerët. Ai u ngrit me vrull dhe hapi radion, po nga nxitimi shtypi butonat që nuk duheshin. U rropat për njëfarë kohe për ta vënë radion në punë dhe kjo në njëfarë mase ishte një dëshmi, që «tërbimi» i punës nuk i kishte prirë gjithnjë për mirë. Më në fund u dëgjua zëri i dispeçerit që kërkonte anijet nëpër det. Ish-

te një zë i shqyer dhe gati ankues. Ishte një zë naiv pa tonin profesional të dispeçerit të detit.

Dispeçeri i kërkoi me radhë anijet. «Pulëbardhën» e la në fund. Nëndrejtori dëgjoi qyfyret e dynjasë në radio dhe këto ishin pyetjet dhe përgjigjet e atyre që flisnin nga deti. Njëri nga ata të «Dukagjinit» i tha dispeçerit se kishte nisur të binte borë...

— Borë? Borë, the? Përsërite! — u dëgjua dispeçeri.

Në palmetë shpërtheu gazi.

— Radioja i duket një mjet i përkryer që nuk mund të bëjë shaka! Harron ata bashibozukët që janë pas radios, — tha nëndrejtori.

— Mos e ngatërro borën me mjegullën... — erdhi zëri i dispeçerit.

— Ta tregoj nesër mjegullën dhe borën, mor gdhe! — u zemërua nëndrejtori. Edhe i vinte të qeshte, edhe kishte dëshirë ta kishte aty dispeçerin dhe ta mbërthente për fyti.

— «Pulëbardha»! «Pulëbardha!» . Si më dëgjon? Marrje... — erdhi rishtazi zëri i shqyer i dispeçerit.

Nëndrejtori u zemërua me të vërtetë. E kishte dëgjuar kaq herë dispeçerin, po kurrë nuk i kishte shkuar ndër mend që atë farë zëri e dëgjonin edhe radio të tjera jashtë peshkimit. Mjaftonte që të hynin në të njëjtën valë...

— Mbylle! Na bëre me turp! — i thirri me të madhe nëndrejtori. E kishin kritikuar që nuk fliste me shumë edukatë me personelin. Ai i kishte habitur kur u kishte thënë si me shaka se «në det nuk kanë qejf t'u flasësh me edukatë...».

— Sikur të pashë pardje në Tiranë? — u kthye nëndrejtori nga Deni. Deri atëherë as që e kishte shikuar në sy. E zuri krejt të papërgatitur Denin.

— Isha vetëm një paradreke! Në darkë arrita të dal në det! Bëra një rrugë pothuaj kot së koti... — tha Deni dhe u skuq lehtë. Ai nuk do t'i tregonte as atij, as njeriu tjetër përse kishte qenë në Tiranë. Kishte shkuar në Institutin Bujqësor. Kur qe në SMT

qe regjistruar në Fakultetin e Veterinarisë, po për dy vjet nuk kishte dhënë asnjë provim dhe pothuaj e kishte harruar atë punë gjersa e ngjalli doktor Marku. Nuk e kishin përjashtuar, i kishin marrë parasysh dy vitet e ushtrisë. «Më duket se bëhet edhe ihtiologji, si shtesë lënde, apo si degë më vete, nuk e di... Pse nuk e mbledh mendjen? Gjersa thua që do të ngulesh në det? Ke një barrë tru që po të rrjedhin kot!» — i kishte thënë doktor Marku. Ai e kishte vështruar si gjithnjë me sy të pastër, të butë. Ai e përkëdhelte Denin. Doktorin ishte dobësia e Denit, kështu thoshte ai, ndërsa mjeku thoshte që mburrej me Denin, po askush nuk e kishte marrë vesh pse mund të mburrej me të

— Hajt! Gjytyryma! Elektrolinjen! — thirri nëndrejtori me entuziazëm! Ai nisi t'u përzihej prapë të tjerëve, po tani nuk e kishin aq rëndë, se ishte i gëzuar dhe ndillte njëfarë besimi në mes të të gjithëve.

Taushi ishte fshehur pas arkave.

— E kape miun? — qeshi Deni.

— Hesht, se ai më merr në sandall! Për shpirt të Xhikes nuk rri pa u nisur mbas elektrolinjës ai shoku Murat!

Nëndrejtori nuk u kujtua për të. I bëri një shenjë energjike me dorë Palit dhe të dy kërcyen në sandall. Denit i erdhi mirë, nuk kishte asgjë të shtirur në vepri-met e tij. Ndoshta kishte edhe diçka për të ardhur keq tek e shihte si harbohej për të mos mbetur prapa të rinjve. «Trupin tonë nuk e ka, shpirtin tonë e kalon...» — sesi tha me vete Deni. Dinte diçka nga jeta e tij. Kishte qenë shumë i ri në luftë bashkë me të atin e Rashës. Nuk fliste për atë kohë. Vetëm një herë e kishin dëgjuar t'i shkruhej Gjonit në magazinë: «A të ka lënë shpirti, Gjon Kabashi? Ke qenë petrit me fletë!»

— Qyqja! Me të hy mneri! — u lebetit Taushi duke parë si humbi sandalli në terrin e natës. Ai ishte zgjatur mbi arkat boshe. I rrokullisi ato, u pengua andej-këndej, por nuk u rrëzua. Zbriti në palmetë të bënte një sy gjumë. Shkoi edhe Deni pas tij. Deshi të

shtrihej, po i tërhoqi vëmendjen një si dispensë e daktilografuar keq mbi shtratin e Palit. Ishte një material mbi metodat moderne të gjetisë së sardeles. Nën titullin shkruhej që ishte përkthyer dhe daktilografuar nga kryeinxhinieri. Deni buzëqeshi. Përkthyesi vihej në çdo vepër, për daktilografistin nuk kishte dëgjuar... E la dispensën dhe u shtri.

Taushi rrotullohej sa në një krah në tjetrin. E kishte lënë trupin të lirë dhe ai lëkundej nën pushtetin e motobarkës. Nuk kishte qetësi dhe shqetësimet e tij nuk mund t'i mbante kurrë për vete pa i bërë shqetësime të gjithë globit.

— Ç'djallin ke? — u bë nervoz Deni.

— Po më zë deti... Xhaja m'i ka fajet! Ai iku me të shumtët dhe më bëri të vij në këtë kasaba çapaçule, ku nuk kishte punë tjetër veç deti...

— Ç'hyn xhaja? — pyeti Deni dhe u pendua, se tjetri mund të niste një ligjëratë pa fund.

— E varrosëm xhajën me efendi Sabriun, pas të cilit luante mendsh im atë. Isha dhjetë vjeç dhe më rridhnin qurrat nga frika e efendiut që këndonte qitapin dhe nga varri i xhajës. Dikur efendi u mbylli qitapin dhe tha: «Tashti m'u përgjigj!» «Kush u përgjigj? pyeta unë.» «Xhaja yt!» «Rren me gjithë mjekër», sesi ia shkrepë unë, po, me të mbaruar fjalët, ia dhashë të qarit se e dija ç'do të më gjente. Im atë më rrahu tri ditë rresht. Të katërtën ika dhe erdha këtu. Kam pasur një teze, motrën e Xhikes, këtu e mbeta...

Deni i ktheu shpinën. Nuk qe e mundur të gjente as ai qetësi. «Det i vdekur...» — tha me vete dhe mendoi që kjo natë kështu do të shkonte me det të vdekur, me psherëtimat e Taushit dhe trazimet që do të shkaktonte kthimi pa sukses i nëndrejtorit.

— Pse e ke kaq frikë nëndrejtorin? — pyeti Deni.

Tjetri iu përgjigj me një gërhimë të zgjatur. Deni u vesh dhe u ngjiti lart. Karakolli ishte ngjitur sërish

pas bashit. Deni nuk po e kuptonte indiferencën e tij. Mos nuk donte të ishte pas nëndrejtorit?

Dëgjoi llapashitjen e lopatave dhe u gëzua. Tani e ndiente po aq larg sa të tjerët afrimin e sandallit nëpër natë. Ai i zgjati dorën nëndrejtorit, po tjetri ia largoi. Deshi të ngjitej pa ndihmën e të tjerëve. Kërceu në kuvertë, sikur të hipte mbi një podium fitimtari. Megjithatë Deni nuk guxoi ta pyeste. Pyeti Palin.

— Kasaphanë do të bëhet! — u përgjigj Pali. Ai vuri gishtin në buzë dhe tregoi nëndrejtorin që vërtitej në kuvertë me dorën në mjekër sikur do të merrte një vendim jetik.

— Shoku Murat! Kemi çaj të nxehtë në termos... — i tha kapiteni.

— Çaj? E kush çan kokën për çaj? — pyeti nëndrejtori gati me të keq. Pas kësaj ai u turr nga radioja dhe zuri të shtypte butonat me nervozizëm.

— «Dukagjini»? Njofto pozicionin! Pesëmbëdhjetë milje nga Marqela? Ngrije menjëherë elektrolinjën dhe eja kënde! Si? Nuk ke mundësi? Ku ka fjalë, mor teveqel! Është urdhër! Kupton? Urdhër! — tha nëndrejtori që u kthye nga kapiteni dhe zuri të shante atë të «Dukagjinit» që kishte ngurruar të ngrinte elektrolinjën.

— Mbase ka parë peshk...

— Peshku është këtu, poshtë nesh! — tha nëndrejtori duke e rrahur kuvertën fort me çizme.

Kapiteni i «Pulëbardhës» deshi t'i jepte një cigare. Tjetri ia shtyu dorën gati me të keq.

— «Riviera»? Këtu «Pulëbardha»! Flet Murat Nallbani! Si më dëgjoni? Shumë mirë që më dëgjoni! Sa larg jeni nga zona e Marqelës? Dhjetë milje nuk janë asgjë! Për një orë e gjysmë të jeni këtu! Si? Mblidhni lekat se më xhindosët.

Nëndrejtorin e kishin mbuluar djersët. Ai po drejtonte një betejë, kishte marrë plagë, po në vend të gjakut i rridhte djersë... Denit iu duk diçka si i tru-

llosur, si i ngatërruar brenda vetes, po nuk ishte kësh-tu. Ai ishte në mes të gëzimit dhe shqetësimit, pran-daj dukej ashtu.

— Ke parë ti? Asnjëri nuk të bindet pa të kundërshtuar një herë mirë e mirë dhe pa të nxjerrë 100 bishta! Është zakon këtu me këta derrat e derrave! Edhe t'u japësh mish të pjekur, do të kundërshtojnë një herë derrat e derrave, — përsëriti nëndrejtori du-ke e trajtuar me njëfarë përkëdhelie fjalën «derr». Në fund të fundit ata ishin njerëzit e tij!

Ai u step një çast dhe sikur e humbi. Kishte për-para Denin, kur kishte kujtuar se fliste me kapitenin e «Pulëbardhës».

— Nuk ke punë ti? — iu kthye Denit.

— Nuk kam as punë, as gjumë! — u përgjigj po me të njëjtin ton Deni.

Nëndrejtori vazhdoi të thërriste anijet e tjera një-rën pas tjetrës. Zemërohej, qeshte, fshinte djersët, lu-tej aty-këtu me të butë dhe përplaste dorën e lirë pas tryezës.

«Po të dështojë... Është bërë për të ardhur keq! Kot ruan një lëkurë drejtori të gjithëpushtetshëm! Po të dështojë... Do të jetë fundi i tij! Kurrë nuk do ta marrë veten!» — mendoi Deni dhe bëri mënjanë.

Nëndrejtori e la mikrofonin dhe iu shkreh Denit.

— Kush të tha të ikësh? Do të bëhet një panair va-porësh këndeje pas nja dy orësh që nuk është parë në histori! — tha ai dhe i futi krahun Denit që nuk dinte si të sillej pas këtij ndryshimi të befasishëm. Ai e tërhoqi kështu Denin gjer në palmetë. Edhe nëpër gry-kën e shkallëve kështu deshi të futej.

— Sikur dëgjova për një çaj... — tha ai. — Për një çaj të ngrohtë...

Kapiteni i afroi termosin.

— Ju jeni të organizuar mirë! — tha nëndrejtori du-ke mbushur gotën.

— Mbahemi... — buzëqeshi kapiteni.

Taushi zuri të gërhiste.

— Kështu pëllet gjithnjë? — qeshi nëndrejtori.
— Kur ndizet televizori dhe kur ka zhurmë... —
tha kapiteni.

— Qenka naziq... — tha ai duke pirë një gllënjëkë
çaj. Ai i kishte vënë dorën në shpatull kapitenit dhe
bënte shaka.

— Mos më shihni mua! Kush e ka orarin le të
shtrihet!

Deni u shtri. Ai kishte vënë re që shtrati nuk py-
este në det për asnjë lloj etikete dhe për asnjë lloj
protokolli. Ai pa të zgjaten poshtë shkallëve këmbët e
Karakollit. Edhe ai u shtri pa u hedhur sytë atyre të
tjerëve, madje sikur u ktheu shpinën si me inat. Edhe
ai kishte rënë dhe ishte ngritur disa herë. Kjo kishte
qenë një natë e shqetësuar.

— Ikim një herë atje lart? — tha nëndrejtori që e
tërhoqi kapitenin për krahu.

Denit i shkuan sytë te gota e çajit. Sa e kishte vë-
në në buzë.

«Ky qenka i marrë! Qenka i tërbuar...» — mendoi
Deni dhe mbylli sytë. Për disa çaste u bë qetësi, pas-
taj mbi kuvertë, tamam mbi kokë të tij nisi të shkon-
te e të vinte dikush me të njëjtin ritëm. Ishte e pa-
mundur të flinte. Po ç'bënte Karakolli?

— Pse je i mërzitur, Karakoll? — pyeti Deni.

Karakolli nuk i dha përgjigje. Deni u kthye prapë
në krah të mëngjër. Dëgjoi që erdhi motoristi. Ai flis-
te me dikë, apo me vete:

— Na i mblodhi gjithë qentë këtu! Na e hoqi koc-
kën nga goja! — fliste me vete motoristi që nuk donte
të grumbulloheshin të gjitha anijet në zonën e Marqe-
lës. Ai heshti dhe hoqi çizmet. I përplasi si zakonisht
dhe u hodh në shtrat. Deni e duroi gjer këtu. E duroi
duke shtrënguar anët e shtratit. Pastaj nanurisja e de-
tit dhe qetësi e thellë. Ndofta do të kishte fjetur, si-
kur të mos e kishte mbushur pak nga pak gjithë pal-
metën një erë e ndotur. U ngrit ndenjtur. Edhe Kara-
kolli që ngritur. Sytë e tyre u kryqëzuan. Karakolli

zgjati dorën poshtë dhe përkuli pak gishtin me atë gjestin tragjik të Cezarëve romakë që u jepnin fund gladiatorëve të mundur. Vdekje për çizmet e motoristit!

— Ej! Nxirri jashtë çizmet dhe pastroji! — i tha Deni me të mirë motoristit.

— Si the? — erdhi zëri i tij nën batanije.

— Nxirri jashtë çizmet se mbajnë erë! — e ngriti tonin Deni.

— E ke prej ciklonit! Tash po të kalon! — u skërmit motoristi.

— Nuk do të ngrihesh?

— Ehu! Te Tafa se te Tafa!

Deni nuk tha gjë. U ngrit, u vesh me ngadalë dhe mori çizmet duke vështruar nga Karakolli.

— Ej! Ku po i çon çizmet? — u ngrit ndenjtur motoristi.

— Ec e shihi! — tha Deni qetë-qetë. Ai u ngjit nëpër shkallë me mendjen te Karakolli. E kishte parë duke vënë buzën në gaz. Ishte hera e parë që e shihte duke vënë buzën në gaz.

Motoristi erdhi pas tij gjysmë i zhveshur duke sharë dhe duke thirrur. Nëndrejtori me kapitenin u kthyen nga ata. Deni nuk u la kohë të ndërhynte, se i hodhi çizmet në det. Pas kësaj pati njëfarë zbatice, një heshtje të thellë dhe hañi. Motoristi nuk u besonte syve dhe kishte mbetur si guhak, ndërsa kapiteni me nëndrejtorin nuk merrnin vesh ç'po ndodhte.

— Do ta paguash me gjak! Armiqësi!... Sabotim! — u ngatërrua motoristi duke drejtuar sytë për ndihmë nga nëndrejtori.

Deni u çudit me Karakollin. Kur arriti të ngjitej në kuvertë?

— Drejt e ke! Nuk duhet t'i hidhte në det! E qelbi detin! — iu drejtua motoristit Karakolli.

— Si mund të heshtni, shoku Murat? — pyeti gjithë vrer motoristi.

— Nuk ke si flet pas asaj që tha Karakolli! — deshi ta mbyllte zënkën nëndrejtori.

— Këtu do të rridhte gjaku, po të mos ishit ju! —
kërceu motoristi. Deni mendoi që një njeri si moto-
risti mund të të bënte hatanë vetëm pas shpine. Tek
hidhte çizmet, sesi i shkoi mëndja te Rasha. «Të
dhanë këmbët? Nga asnjë ndërmarrje nuk ke ikur vetë,
po të kanë zbuar!» — do t'i thoshte ajo me të padrej-
të që në takimin e parë. Po pse e kishin këtë mendim
shumë veta për të? «Se e kam thënë gjithnjë fjalën e
fundit në fillim...» — vazhdoi të thoshte ai me vete.
Po... a mund ta pushonin për një gjest të tillë? Duke
i hedhur çizmet, kishte menduar që edhe mund ta ki-
shte pisk, po nuk e kishte prapsuar dorën.

— Nesër do të shkoj zbathur gjer te sekretari i
Partisë! Gjer në rreth do të shkoj! — thirri motoris-
ti dhe i ktheu shpinën nëndrejtorit.

— Kështu i zgjidh ti punët gjithnjë? Me kobure? —
iu drejtua nëndrejtori Denit.

— Kur më hipën gjaku... — u zu ngushtë Deni që
ende nuk po merrte vesh nga anonte nëndrejtori.

— Nuk duroheshin ato çizme... — ndërhyri kapiteni.
— Po mund të gjendej edhe rrugë tjetër...

— E dini atë me cjamin dhe qelbanikun? Dhjetë
veta vunë bast se do ta duronin erën e cjamin dhe e
humbën bastin. Hyri qelbaniku. Bastin e humbi cjamin...
— ia dha gazit nëndrejtori.

Deni nuk po u besonte veshëve. Si ishte e mundur?
A nuk e kishte mik motoristin Murat Nallbani?

— Këta të dy nuk do të rrinë urtë tek unë... —
tha kapiteni.

— Ruaj këtë, se Zeqiri ka vetëm pallavra! Ti më
mirë mbaj mend të më zgjosh në pesë...

Ai u largua, po, tek zbriste në palmetë, u kthye.

— Në tre të më zgjosh! Jo në pesë!

Kapiteni i vari buzët. Kështu edhe atij i duhej të
zgjohej në tre!

Tërhiqnin rrjetën, tërhiqnin detin... Të gjithë detin me fshehtësinë dhe heshtjen e madhërishtme! Të gjithë detin gjer te horizonti me mjegull. Jo vetëm detin, po edhe atë mëngjes të hirtë, edhe thirrjet e pulëbardhave edhe siluetat e ngrira të maleve që ngjanin me ciklopë të fjetur... Deti afrohej me një farë përtacie, si një derdimen i ngathët, po nuk dukej se kundërshtonte. Edhe për pak ata do të tërhiqnin të gjitha anijet që kishte mbledhur me radio aty rrotull nëndrejtori dhe që rrinin si të përvuajtur rreth «Pulëbardhës», megjithëse ishin më të mëdha se ajo.

— E mbushëm rrjetën me bagla... — i përshpëriti motoristi Palit.

— Qepe! — i tha Pali.

— Bagla dhe çfarë baglash!

— Thuaja nëndrejtorit! — ia ktheu shpinën tjetri.

— Ku ishte nëndrejtori? Aty nuk kishte asnjë nëndrejtor! Kishte një njeri të shëndoshë, një peshkatar të rëndomtë, të harruar pas punës së tij që nuk po kujtohej që ishte lagur dhe bërë qull nga rrjeta. Ai ndryshonte nga të tjerët, se i lëshonte krahët poshtë herë pas here dhe i shkundte për t'i çlodhur.

— Jepi! Jepi! — e shtynte përpara kapiteni duke harruar cilin kishte në krah. Ky ishte një ligj i punës që i rrëzonte poshtë të gjitha autoritetet e botës.

Nëndrejtori i vari krahët. Deni ishte në të mëngjër të tij dhe e kishte vërejtur tërë kohën sforcimin e tij për të mos mbetur prapa. Deni e shtrinte krahun më larg për t'i pakësuar rrezën e veprimtimit nëndrejtorit. Ai njeri po i hynte në shpirt.

— Duhet limbjota... — pëshpëriti Deni.

— Ta merr mendja që duhet! — u përgjigj Murat Nallbani duke vazhduar të tërhiqte rrjetën.

«Më në fund ia gjeta thembrën!» — mendoi Deni i kënaqur.

Nëndrejtori i foli Karakollit. E pyeti nëse kishte peshk.

— Hana pesëmbëdhjetë! — u përgjigj tjetri nga sandalli, pa ndonjë kënaqësi të dukshme. Thoshin që, kur

zinin sasira të jashtëzakonshme peshku, ai nuk ishte në vete. A nuk e kishte lënë ai atë fjalën «Mjaft e përditë, sesa plot e një herë në mot»?

— Mjaft! Të marrim sardelen! — urdhëroi kapiteni duke e lënë rrjetën.

Tani ishte çasti më delikat, se peshku duhej marrë sa më shpejt nga fundi i rrjetës.

— Ma zgjat atë garuzhden... — i tha Deni Palit për mjetin që merrnin peshkun nga rrjeta. Kështu e quanin me shaka në mes tyre.

Në kuvertë nisi ecejaku i atyre që nxirrnin sardelen dhe e zbraznin nëpër arka. Ndesheshin me njëri-tjetrin, rrezonin peshkun mbi kuvertën e ngushtë, bërtisnin dhe thoshin qyfyre, të cilat i harronin pasi të ishte sistemuar peshku. Sardelja hidhej, përplasej dhe shpërndahej për një çast në të katër anët, po arkat mbyllnin njëra-tjetrën dhe sardelja mbetej brenda. [Pas një gjysmë ore nuk kishte më asnjë arkë bosh.

— Ndajeni kuvertën më dysh! — tha aty për aty kapiteni.

Më dysh! Ky është operativiteti! — rrahu shuplakat nëndrejtori. Ai nuk dinte si ta shprehte gëzimin. Posa e kishte lënë radion. Të gjitha amijet nuk dinin ku ta futnin peshkun! «Në xhepa! Në këmishë! Në brekë! — u kishte thënë ai me humor. — Dëgjuat? Vetëm silleni në molo...»

E ndanë kuvertën më dysh me arkat e mbushura dhe zunë ta hidhnin aty peshkun. Nëndrejtori ishte mbështetur pas direktut dhe bënte llogari me vete. Edhe dy net të tilla dhe ikte gjithë plani i vitit!

Edhe motoristi ishte në ankth. E pyeti Palin sa mund t'u takonin, dymijëshe, apo trimijëshe? Ai e kishte harruar krejt atë punën e çizmeve dhe e kishte mendjen te paratë.

— Tri bagla! — ia ktheu Pali që nuk e kishte harruar atë që i kishte thënë motoristi.

— Edhe më shumë do ta kishim zënë, sikur të mos

na ishin afruar ato lëvozhgat e arrave! — tha motoristi duke parë me inat nga anijet e tjera.

— E ke shpirtin si vaji i motorit! — i tha Pali.

— Gjon Kabashit do t'i bjerë hemorragji kur të shohë gjithë këtë hata...

— Ta kishe ti shpirtin e tij, do të ishte ndryshe!
— ia ktheu Pali.

Dëgjuan nëndrejtorin që i thirri me të fortë Karakollit.

Karakolli nuk e ngriti as kokën, as lopatën me të cilën ulte rrjetën.

— Të urdhëroj të heqësh lopatën! — thirri nëndrejtori duke u varur mbi parmakun e anijes.

— Sot është një gisht sardele, mbas një muaji bëhet një pëllëmbë... — u lut Karakolli.

— Ose lër lopatën, ose lër punën! — u zemërua nëndrejtori.

— E lashë! Haje të gjithë detin! Haje! Përpije! — iu shkreh Karakolli. Ai e lëshoi lopatën në sandall dhe u ktheu shpinën atyre që ishin në motobarkë. Ndenji ashtu në mes të sandallit, sikur të mos kishte të bënte më me asnjërin.

— Çfarë kaptine... — tha nëndrejtori pa të keq për Karakollin, pastaj u kthye nga të tjerët dhe i porositi që të ndanin peshën e motobarkës njëjloj në të dy anët.

Kjo nuk i pëlqente asnjërit. Ata donin të hynin në port me barkën të anuar në një krah nga pesha. Po të kishte mundësi, edhe të ciknin ujin parmakët e sipërm... Kjo do të ishte një lavdi e paharruar...

— Nuk patëm kohë as t'i lagnim arkat... — i pëshpëriti motoristi Palit.

— As tash nuk je ngopur? — i shfryu tjetri. Pali ia kishte hequr disa herë nga duart zorrën e ujit, kur donte t'i lagte arkat që të peshonin më shumë.

Nëndrejtori kishte hipur në kabinën e komandimit. Donte të shihte nëse e kishin marrë peshkun anijet e tjera.

— Po t'i vësh një pece të zezë në njërin sy, ai nuk i lë gjë mangut Nelsonit! — u skërmit motoristi që mban-te mend një film me admiralin anglez. Tani e kishte më keq me nëndrejtorin, sesa me Denin. Nuk mund t'ia harronte që nuk e kishte përkrahur.

— Hesht, se nesër do të lëpihesh pas tij! — i tha pas shpine Pali, po zërin e tij e mbuloi urdhri i kapitenit për t'u nisur.

Nëndrejtori kishte zbritur dhe rrinte mbështetur pas kapitanerisë. E kishte humbur gjallërinë përnjëherësh. Kishte nxjerrë shaminë dhe nuk pushonte së fshiri ballin ku nuk kishte aspak djersë.

— Do t'i zërë fytin sardelja! Ku do ta mbajë? Me se do të transportojë? — nuk pushonte së dërdëllituri motoristi atje pas arkash.

Nëndrejtori hapi radion dhe u lidh me dispeçerin. E urdhëroi të ishin gati në molo dy zetoret me rimorkio dhe autofrigoriferi. I tha të lidhej me ata të portit në emrin e tij që të mos u jepnin kripë makinave që vinin nga rrethet e tjera.

— Të mos u japin kripë? Po ç'tu japin? — u çudit dispeçeri.

— Sardele! — tha nëndrejtori dhe u gjallërua përnjëherësh. Ai u ngjit në kabinë dhe i lëshoi gazin në maksimum. U dëgjua motori të gumëzhinte dhe nga oxhaku u dendësua tymi. Motoristi nxori kokën nga baxha dhe deshi të thoshte diçka të keqe, po e mbylli gojën kur pa nëndrejtorin në kabinë.

— Si nuk më dhe një cigare, kapiten? — tha me gjallëri nëndrejtori.

— Disa herë ta kam zgjatur... — u përgjigj kapiteni.

— Disa herë? Kujt ia hedh këto? — zuri të qeshte nëndrejtori.

— Ai po qesh! I dha rrugë sardeles dhe po qesh! — i pëshpëriti Pali Denit.

— Si ia dha rrugën?

Me radio!

Deni ngriti supet. I kishte vlejtur ajo natë. Kishte

qenë një mësim i madh për të. Kishte qenë një natë punë ku ai kishte përmbysur shumë mendime që kishte formuar për njerëzit jashtë punës. Për nëndrejtorin të parin...

Hodhën cimat pa fjalë dhe po kështu nisën të shkar-konin peshkun. Kjo nuk ishte parë ndonjëherë. Shkar-kimi i peshkut zakonisht bëhej me bujë dhe rrëmujë, po tani nuk kishte kohë askush të fliste.

Nëndrejtori kaloi përpara Denit dhe zbriti në molo, Deni vrapoi pas tij.

— Kur të vijmë për limbjotën, shoku Murat? — i foli pas shpine Deni.

Nëndrejtori e mbajti hapin dhe u kthye me vështirësi nga ai.

— Më premtove për limbjotën... — përsëriti Deni.

— E gjete kohën! Ferrë paske qenë! Po kush të premtoi për limbjotën? Unë të thashë vetëm që limbjota duhet! Dëgjon? Du-he-t — i ndau rrokjet nëndrejtori dhe e la Denin në mes të molos.

— Duhet... — përsëriti Deni si ndonjë fëmijë që i kanë mbushur mendjen me zor. Ai pështyu përdhe me inat. Ashtu i kishte thënë, duhet! Kjo qe e vërtetë!

I thirrën nga anija. Ç'rrinte si hu në mes të molos? Apo kishte pak peshk për të shkarkuar?

Autofrigoriferi u mbush plot dhe u nis. Afër «Pulëbardhës» erdhi një nga zëtorët me gjithë rimorkio. Mbas një gjysmë ore i kishin ngarkuar gjithë arkat. Kishte mbetur sardelja që e kishin rrethuar në mes të kuvertës.

— Duhet arka! Nuk ka arka! — tha Ndoc Marku. Ai ishte një djalë tepër i heshtur dhe i qetë. Kur fliste ai, dihej se duhet të kishte ndodhur diçka e jashtëzakonshme.

Arka nuk kishte, anijet e tjera po afroreshin në molo. Kjo e rëndonte gjendjen se të gjithë e dinin që në peshkim kishte pak arka rezervë.

Denit nuk iu besua kur hyri në molo një «Zis» i

ushtrisë i ngarkuar plot e përplot me arka boshe nga ato të zarzavateve dhe të dyqaneve të tregtisë. Nga kabina zbriti nëndrejtori dhe bëri me shenjë të merrnin arkat. Mbi kamion u turrën të gjithë ata që ndodheshin në molo, madje edhe marinarët e «Tërbunit» që kishte ardhur nga Durrësi për të ngarkuar bimë mjekësore.

Kur vështroi për të dytën herë «Zisin», Deni e pa karrocerinë e tij bosh. Nëndrejtori u fut në kabinë, tërhoqi portën dhe i ra me bërryl ushtarit të nisëj.

— E ka thyer në rrugë! Shih kur të kthejë edhe të tjerë! Me atë kokë që ka edhe autoambulancën e ngarkon me peshk! — tha kapiteni.

Kështu ndodhi. Brenda një ore nëndrejtori erdhi edhe dy herë të tjera me arka boshe. Radhën e parë me një «Skodë» të Pukës, radhën e dytë me makinën mësimore të shoferëve të rinj.

— Po pse vjen vetë?... — tha Deni si i habitur. E kishte harruar limbjotën. T'i thoshte tani dikush se duhet të vdiste për nëndrejtorin, do të vdiste!

— Ku pyesin shoferët për të tjerët? Vetëm atë njohin...

Në port hyri autofrigoriferi duke i rënë fort borisë. Në një anë të derës së makinës ishte kapur kryeinxhinieri, në anën tjetër shefi i planit. Ata u hodhën përdhe me atë shqetësimin e zjarrfikësve, pastaj nga kabina doli dhe sekretari i Partisë.

— Erdhi gjithë shtabi... — tha kapiteni i «Pulëbardhës». Ai ishte gjithë luspa sardeleje në fytyrë. Edhe të tjerët ishin kështu. Rrezet e diellit thyheshin pas luspave dhe sajonin shkëlqimin e argjendit mbi fytyrat e peshkatarëve.

— Nuk ka frigorifer dhe magazinë që e mban gjithë këtë peshk! — tha Deni duke mbushur arkën e fundit.

— Kush tha që do të hyjë në magazinë? Nuk e dëgjove nëndrejtorin që i tha dispeçerit të lidhet me ata të portit? Ata i kanë në dorë shoferët! U thonë që nuk ka ngarkesë dhe ata janë të detyruar të marrin sardelen...

— Rifuxhio?

— Rifuxhio! Me arka! Me thasë... Ndërsa ne flasim, sardelja po ikën për Pukë e për Tiranë! — tha duke qeshur kapiteni.

— Marrin sardelen dhe mbeten pa kripë!

— Kripa nuk prishet, sardelja prishet!

— Nuk do t'ia dalë me gjithë këtë peshk! — vërejti Deni.

— Nuk e njeh atë... Gjer tani duhet të ketë bërë një njëzet telefonata me qytetet e ndërmarrje të ndryshme! E di ç'thonë në komitet? Më përpara plotësojnë kërkesat e tij për të telefonuar, se kërkesat e komitetit! Ca makina i nis me marrëveshje, ca të tjera ua lë në dorë! Mjerë shoferët që u duhet të rropaten për t'u mbushur mendjen të marrin peshkun! — i shkeli syrin kapiteni. Ai i zgjati një cigare, po Deni nuk e mori.

— Jemi qelbur! Duhet shtatë okë sapun! — tha Deni që zuri të shkundte luspat e peshkut nga trupi dhe nga fytyra. Befas pa Karakollin. Si që e mundur që ishte krejt i pastër. Karakolli seç po mbështillte në një letër. «Dhjetë sardelet e Pashk Lulit» — tha me vete Deni. Tute motoristi me Taushin po mbushnin si zakonisht trastat.

— Sot edhe nga një thes të marrin, nuk u thotë njeri gjë! — buzëqeshi kapiteni.

Motoristi ishte zbathur. I kishte përveshur pantallonat gjer sipër gjunjëve dhe këmbët i kishte të përgjakura nga sardelet që kishte shkelur gjatë punës.

— Mos e zgjat me të... — iu lut kapiteni.

— Jo! Jo... — ia ktheu Deni.

Ndoc Marku zuri të lante motobarkën me zorrën e ujit. Ai kishte shërbimin. Vetëm ai njeri i heshtur mund ta duronte shërbimin pas një gjuetie të tillë. Pas një gjuetie të tillë, kërcisnin gotat në ndonjë qoshe të klubit dhe peshkatarët ishin zotërit e botës...

Kapiteni kërcëu në molo. E ndoqi Karakolli me Palin. Motoristi erdhi gjer te parmaku i anijes dhe aty mbeti. Lëshoi trastën në kuvertë, pastaj u kthye prapas

dhe i ktheu shpinën molos. Sytë i kishin humbur thellë, megjithatë lëshonin një dritë të idhët. Priti se mos e përhapnin historinë e çizmeve ata që ikën. Askush nuk mund të ruante një sekret të tillë që do ta mbushte gjithë verën me romuze dhe shaka. Peshkatarët vuanin për të trilluar gjëra shumë më të thjeshta se kjo dhe me to kalonin një sezon gjuetie. Tani e kishin të gatshëm gazin për gjithë vitin... Motoristi priti të merrte dhenë historia e çizmeve dhe të mbledhej përpara tij gjithë moloja... Ç'do të ndodhte kur t'i fishkëllenin dhe t'i thërrisnin të tregonte me këmbët e zbathura? U kthye me ngadalë dhe pa me bisht të syrit nga ata që po iknin. Ata të tre e kaluan postblokun pa folur me asnjëri. Psherëtiu, ndjeu lotët, po arriti t'i mbante. Do të qante me gjithë qejf, sikur të mos ishte aty ai që e kishte shkaktuar gjithë këtë histori. Deni lahej nën zorrën e Ndoc Markut që e lëvizte nga donte ai me durim. Deni iu shmang vështrimit të motoristit. Nuk e duroi dot. U turbullua dhe mbeti keq. Harroi zorrën dhe uji i hyri nën këmbë, po megjithatë gjoksi iu ndez flakë nga një pështjellim i papritur. Pastaj të nxehtët i ra përnjëherësh, ndjeu zbrazëtirë dhe një inat të madh ndaj vetes. Iu bë sikur kishte grabitur një njeri në mes të rrugës dhe i kishte zhveshur çizmet. U ul dhe i hoqi të tijat. Ia hodhi motoristit.

— Ik te Riqoja! Thuaji të më sjellë këpucët! — i tha pa e vështruar.

VII

Mbledhja sapo kishte mbaruar dhe të gjithë po dilnin një nga një. Shefi i kuadrit i erdhi pranë nëndrejtorit me një buzëqeshje triumfi.

— I kim? — e pyeti.

Nëndrejtori i ktheu fytyrën. Ajo shëmbëllente me ditët e rutinës, kur ndihej i ngathët dhe nuk i ecte puna.

— Në vend që të gëzohesh.... — shefi i kuadrit nuk kuptoi ç'kishte ngjarë me të.

Nëndrejtori i hoqi sytë nga ai dhe tjetri e mori vesh që duhet të ikte.

Nuk po i gjente dot cigaret. Në fund e pa që paketën e kishte mbi tryezë. Kot i kishte kthyer gjithë xhepat. Mendoi që ishte vetëm në atë dhomë dhe ia këputi një të sharë.

— Punë dreqi! Punë dreqi! — përsëriti.

Sekretari i Partisë u kollit.

— Siç e sheh jam edhe unë këtu! — i tha ai.

Tjetri futi paketën në xhep dhe u ngrit përnjëherë.

— Shkojmë bashkë! — e ftoi Samiu.

Nëndrejtori e prit.

— Po të mos kollitesha, ti mund të rrëfesheshe në atë dhomë.

Tjetri nuk i dha përgjigje.

— Mos je zemëruar?

— Ndoshta! Nuk e di mirë... Nuk di ç'të them...

— Pas një mbledhjeje të tillë një tjetër në vendin tënd mund të dilte ngadhënjyes...

— Shoku Sami!

Si të duket organizata jonë? — e pyeti menjëherë Samiu.

— Mendim për organizatën mund të shpreh vetëm në organizatë! — u përgjigj gati zyrtarisht nëndrejtori.

— Mund ta shprehësh edhe këtu... Nejshe! Organizata është mjaft e formuar, po ti je beniamini i saj...

Nëndrejtori e mbajti hapin. Nuk e dinte atë fjalë. Do të hapte fjalorin... Po ç'ti përgjigjej atij tjetrit? Ai kishte qenë mësues, pastaj ishte marrë me administratën. Edhe shefi i planit me kryeinxhinierin kishin punuar për ca kohë në arsim. «Kush nuk bën për mësues e bien në peshkim....» — tha me vete si për hakmarrje nëndrejtori. Donte patjetër të gjente diçka kundër sekretarit. E kishte plasur me atë ngadalësinë e tij, me ato pauzat e gjata në të folur... Nëndrejtori për pak sa nuk kishte thirrur, kur kishte nxjerrë ai tjetri shaminë nga xhepi.... «Nxirre! Nxirre, më, se na vdiqe!» — kishte dashur të thërriste.

— Ç'do të thotë «beniamini»? — pyeti me njëfarë vrazhdësie.

— I përkëdheluri, si të thuash... — tha avash-avash ai tjetri.

— Pse je kaq i ngadalshëm? Më grive mushkëritë!

— Ç'të bësh? Natyra...

— Me sa nuhas, e ke me të keq me mua...

— Më lër mua! Si e ke ti me vetveten?

Murat Nallbani u zu ngushtë. Tjetri nuk mbrohej, po hidhej në sulm. Kurrë nuk kishte parë të kishte këtë efekt një sulm kaq i ngadalshëm...

— Pas mbledhjes, kur mendoje se ishe vetëm në zyrë, ti e kishe me të keq me vetveten....

«Mirë po e di... Me vetveten e kisha!» — mendoi nëndrejtori.

— Po të të hyja më mirë në shpirt edhe gjatë mbledhjes, me vetveten e kishe...

«Me vetveten e kisha...» — aprovoi në heshtje nëndrejtori.

— Kur e ke me vetveten, e ke mirë...

— Supozime! Sa për atë që thashë më përpara... Ti nuk e ke me të keq me mua! Të ishte ndryshe, nuk do ta bëje mbledhjen e organizatës fill pas suksesit që pata në det! Do ta anulroje me ndonjë shkak...

Kishte raste që nëndrejtori e hutonte me personalitetin e tij, e bënte ta ndiqte me admirim. Kishte raste që e bënte të harronte që duhet të mbante qëndrimin e vet dhe shkonte pas tij gjersa kujtohej që nuk e kishte mirë. Tani po ndodhte e kundërta.

— Unë mendoj që kam të bëj me një organizatë të pjekur, që i vë sukseset më një anë dhe të metat në anën tjetër... — tha Samiu.

— Po ç'ndodhi në të vërtetë? Sipas teje, kuptohet... Sukseset errësuan të metat dhe beniaminit të organizatës nuk i hyri ferrë në këmbë! A gjykoj sipas teje? — tha nëndrejtori me njëfarë triumfi.

— Duhet të të kisha lënë të rrëfesheshe aty pas mbledhjes ...Aty nuk do të luhateshe mes sedrës dhe së vërtetës, siç po luhatesh tani... Mua mund të më thuash çfarë të duash! Po vetes? Do ta kesh pisk! Ndonjëherë ti shkundesh i turbulluar, po gjithsesi u shkon përsipër të metave në punë me atë energjinë tënde me të cilën i vë përpara edhe të tjerët... Unë... Lëre! Do ta vazhdojmë ndryshe këtë bisedë!

— Ndryshe e vazhdojmë, po ti nuk e njeh as detin,

as ndërmarrjen! Isha kështu si ti, kur erdha në fillim, as qimen nuk e lija të binte përdhe! «Prit, më thoshin, do të të bëjë deti për vete!» Kjo ishte e njëjlojtë me atë fjalën tjetër «të bën toka për vete!» E mban mend si kishte erë rrushi amerikan në fillim? Tani e ndryshoi toka...

«Mirë që e ndryshoi...» — tha sekretari me vete.

— Kështu, nuk e njeh detin...

— Mos i bjer në qafë as detit, as tokës! Bjeri njeriut!

— Kryeinxhinierin e kam fantazist më tepër se ç'duhet, sekretarin e Partisë e kam realist më tepër se ç'duhet... — vuri buzën në gaz nëndrejtori.

Tjetrin e vrau përsëritja e fjalës «e kam», «e kam»! Peshkimi nuk ishte domeni i Murat Nallbanit! Ai sikur po i largohej me qëllim, kur mund t'i afrohej me një fjalë, sikur po i ikte në të errët dhe nuk e ndiqte dot. Ai ishte i fortë dhe duhet të mbaheshe diku që të mos të të merrte me vete... Ishte njeriu i çastit të madh, fenomen i çastit të madh dhe këtë e kishte treguar atë mëngjes...

— Pse nuk i lëmë hamendjet dhe ta marrim shtruar? — pyeti nëndrejtori.

Tjetri tundi kokën. Ta merrje shtruar, do të thoshte të përsëritje një për një ato që ishin thënë në organizatë.

— Një herë tjetër! — tha.

— A mos kujton se ndryshon nga unë? Si unë je, babaxhan! Unë e kam me alarm, ti e ke me avashllëk...

Sekretari e pa me shqetësim. Mos ishte ngutur duke e shtruar çështjen në organizatë? Murat Nallbani ishte njeri i punës! Puna mund ta nxirrte vetë në udhë... Në mbledhje ishte diskutuar stili i drejtimit, perspektiva, interesi i pamjaftueshëm i nëndrejtorit për të rejat e shkencës dhe teknikës, akrobllëku në ndërmarrje... «A nuk është kryesorja realizimi i planit?» — kishte pyetur nëndrejtori fill pas raportit. Një pyetje naive dhe e dëshpëruar... «Planin do ta realizosh pas dy-tri aksionesh si ai i mbrëmshmi!» — nuk i ishte duruar Samiut. «Do ta realizoj!» — i kishte rënë tryezës Murat Nallbani.

«Mund ta realizosh, po kjo nuk është e gjitha...» — kishte vazhduar sekretari. «Kishin diskutuar të tjerët. E kishin kritikuar, po me dhimbje. Në mëngjes edhe ai ishte tronditur. Nëndrejtori e kishte trullësuar, e kishte befasuar me atë sulmin e furishëm në det. Sekretari mendoj që secili nga ata që kishin diskutuar të linte të mendoje që në fund të fundit po kritikoj një njeri që e bënte punën burrërisht dhe me hije... «Punon spontanisht! Kjo është sentimentalizëm!» — kishte thënë sekretari, megjithëse e ndiente edhe vetë që ai e bënte punën burrërisht dhe me hije... «Edhe sentimentalizëm mund të ketë për një trim si Murat Nallbani! Ai është...» «Mjaft! Mos e dridh llafin më për mua!» — ishte ngritur nëndrejtori. «Pse? Kam mendimin tim...» — që përpëlitur shefi i kuadrit. Nëndrejtori kishte ngritur dorën të heshte dhe Samiu nuk kishte ndërhyrë dot. Nëndrejtori po e merrte me vete, po e tërhiqte gati me zor... Kështu gjer nga fundi i autokritikës së tij. Nga fundi Samiu ishte kujtuar që nëndrejtori nuk ishte i qetë, sa kohë u shkonte përsipër pa vëmendje të metave të tij. Pastaj i qe dukur sikur ishte një njeri i dubluar, sikur kundërshtonte me shpirt atë që thoshte me fjalë... Më tej kishte menduar që ajo nuk ishte një autokritikë e plotë dhe, kur bëri konkluzionet, kishte thënë «me sa duket Murat Nallbani ia lë kohës autokritikën e vërtetë». Kishte folur për personalitetin e drejtuesit, për atë që nuk duhet t'u imponohej të tjerëve, kishte folur për të metat në rrugën e ngjitjes... Ato nuk i takonin vetëm nëndrejtorit! Mos ishte organizata anemike dhe nuk e përballonte dot Murat Nallbanin? Mos ishte me tarafe? Jo! Kështu mund të ishte vetëm ndonjëri... Pas këtyre fjalëve Samiu ishte kthyer nga shefi i kuadrit. Ky kishte folur për të metat në punë, po nuk kishte harruar të thoshte se për çdo gjë kishte vënë në dijeni nëndrejtorin... Kishte thënë që peshkimi nuk ishte si ndërmarrjet e tjera që kishin lëndën e parë dhe makinerinë! Atyre u duhej kërkuar plani gjer në një dhe jo ndërmarrjes së tyre që i kishin anijet mbi ujë dhe peshkun nën ujë!

Samiu e kishte dënuar këtë mendim që mbështetej në rastësi! Një mendim i tillë mund të lindte vetëm aty ku nuk bëhej shkencë...

Nëndrejtori po largohej. Tek ikte ai, sekretari mendoi që nuk kishte vepruar aq mirë duke i lidhur të metat e ndërmarrjes kryesisht me të. Përgjegjësi duhet të mbanin edhe të tjerët.

Deshi të kthehej në klub. Rrinte ndonjëherë me peshkatarët, po ata e vinin në pozitë të vështirë, se nuk e linin të paguante. «Sekretar! Do të paguash kur të plakesh...» — i thoshin. Shefi i kuadrit nuk e kishte pëlqyer afrimin e tij me peshkatarët. Si mund të kishte autoritet kur qeshte dhe tregonte anekdota në kafene? Apo nuk kishin një gjuhë ata të detit? Gjuhë hambarësh e palmetash...

«Raporti duhet të ishte më i pjekur dhe përgjegjësia më e përcaktuar...» — mendoi rishtazi sekretari i Partisë. Iu prish qejfi dhe nuk deshë të kthehej në klub. Iu kujtua kryeinxhinieri. I kishte hyrë në mëngjes në zyrë. E kishte bosh. «Të gjitha materialet i kam në shtëpi...» — i ishte përgjigjur duke kërkuar një dokument që i duhej për nëndrejtorin. E kishte bërë rrëmuje tryezën. Nuk ishte i rregullt me shkresat, po ec e dila përpara Murat Nallbanit! E ngrinte peshë ndërmarrjen!

«Nuk më kanë bërë vend në peshkim...» — i kishte thënë pasi e kishte gjetur më në fund shkresën.

«As ti nuk ia ke bërë vendin vetes sa duhet!» — kishte menduar Samiu.

Kryeinxhinieri i hapi derën. Ai kishte një dhomë në katin e dytë mbi dyqanin e kinkalerisë. Doli në kanotiere dhe pantallona të shkurtra.

Samiu buzëqeshi. Kishte dëgjuar qyfyre për ato pantallona që kryeinxhinieri i përdorte në plazh. Ato ishin alergjia e nëndrejtorit dhe kishin rolin e vet në karakteristikën e zezë që kishte përgatitur shefi i kuadrit.

Kryeinxhinieri mbeti si i shastisur aty në prag. As që e ftoi të hynte brenda... U skuq duke kujtuar himnet që i kishte thurur në mëngjes nëndrejtorit teksa përpi-

qej t'i jepte rrugë peshkut. «Është ujk! Është furtunë! Është zot! Ne jemi një hiç përpara tij!» Pas këtij ditirambi titanik kishte ardhur nëndrejtori dhe e kishte bërë për dy lekë në sytë e Samiut për atë shkresën që nuk gjendej...

Sekretari u prek. Ky djalosh kishte pasur të bënte me ujq të rregjur të detit, që të përpijnë gjallë, po të panë të druajtur dhe timid. Po gjithsesi ai ishte mbajtur. Qe një djalë i gjatë, i dobët, me flokë të verdhë dhe sy të kaltër në gri.

— A mund të hyj?

Kryeinxhinieri u bë flakë dhe nuk diti ku ta vinte. Në pështjellimin e tij hynte droja dhe respekti përpara eprorëve.

— Këtu ka rrëmujë... — tha kryeinxhinieri duke larguar tufën e dosjeve dhe të dispensave. E tha me aq butësi dhe turp atë fjalë, sa që u duk sikur tha që aty kishte rregull. Brenda këtij «rregulli» hynin pjatat e përmbysura mbi tryezë, shtrati lëmsh, pantallonat e hedhura përdhe dhe një llambë elektriku e thyer në dritare. Pastaj muret... Muret i kishte të mbushura me harta të bëra me dorë dhe ato i jepnin dhomës pamjen epike të një shtabi ushtarak.

— Pse je bartur kështu me të gjitha? — pyeti Samiu.

— E kush m'i duron atje? Kjo është harta e pengesave të nënujshme që kam bërë për dhjetë milje nga bregu. Kryqet e zeza janë pengesat... E hodhe rrjetën aty, e le milionin e lekëve në fund të detit! Na kanë mbetur kështu... E kam shumëfishuar hartën, po binden peshkatarët? «Ne t'i kemi treguar pengesat! Nuk na duhet harta», thonë. Është e vërtetë, po unë kam bërë sondazhe në shumë breza peshkatarësh...

— Interesant... — tha Samiu. Po megjithatë sesi i erdhi kur mendoi që puna e parë e kryeinxhinierit kishte qenë mbetja e rrjetave. A nuk shkonte kjo pas karakterit të tij pak romantik?

Harta tjetër kishte kuadrate pa asnjë shenjë konven-

cionale. Ajo priste të mbushej. Ishte harta e zonave të peshkimit.

— Nganjëherë më duket punë serioze, nganjëherë marrëzi! Ku zihet peshku një natë, nuk zihet tjetrën...

— Një përpikëri absolute nuk mund të ketë! Nuk duhet kërkuar hartë për një milje e për dy milje, po për zona më të thella... Peshku lëviz... A mund të zënë vend diku lëvizjet e sardeles? — pyeti sekretari me sytë nga harta.

Kryeinxhinieri i tregoi hartën afër derës.

— Edhe ajo relative dhe e paplotësuar... Kam nxjerrë një mesatare në mes tregimeve të përafërta të peshkatarëve...

— Cili është sekreti i Karakollit? Përvoja? — pyeti befas Samiu.

— Përvoja dhe rikonjocioni që i bën detit, dihen, po me duket ka edhe diçka tjetër... Futa kokën një herë në vendin ku fle. Gjithë kompensatën që mbyll anën e mëngjër të shtratit e kishte të gërvishtur me thikë. Tre rreshta me të gërvishtura që përfaqësonin tre vjet! Pastaj viti që i ndarë në muaj dhe në ditë. Ditët me gjueti të mbarë ishin në rreth dhe kishin edhe vendin ku ishte zënë peshku...

— Shih shih... — tha sekretari me interes.

— Hyra sot në drekë në anije. Karakolli e kishte gërvishtur edhe ditën e mbrëmshme. Ishin tre rathë dhe germa «M» poshtë tyre! Marqelë! Erdha dhe nxora ditarin e bordit të «Pulëbardhës». Aty shkruhej se vjet në të njëjtën datë ishin zënë në zonën e Marqelës 31 kuintalë sardele! Atëherë mblodha ditarët e anijeve të tjera se mos arrij një përfundim krahasues, po ata nuk janë mbajtur në rregull...

Ditarët zinin gati çerekun e dyshemesë dhe nga pamja e jashtme përbënin një arkiv për t'u vajtuar. Ishin të grisur, të ndyrë, të lidhur me fill cimash dhe shumica pa kopertinë.

— Vetëm do t'ia dalësh gjithë kësaj pune? Do të merrësh në qafë! Kësaj nuk ia del dot vetëm as kapaciteti

më i fortë shkencor! Ja pse «nuk të kanë bërë vend» në peshkim, siç m'u ankove në mëngjes! Duke lënë më një anë subjektivizmin, them që ata që të kanë kundërshtuar kanë pasur njëfarë të drejte. Duke u marrë me shumë punë përnjëherësh, nuk je marrë me asnjë punë seriozisht! Puna duhet shpërndarë!

— Jam munduar, po nuk më kanë dëgjuar! E di si janë peshkatarët kur zbresin në tokë? Si ujçit!

— E para peshkatarët nuk janë ujç, po, edhe sikur të jenë kështu, këta «ujç» duhet të kategorizohen! Çfarë lënde duhet të përvetësojnë ata? Rutinën e vjetër të peshkimit, apo të rejat e shkencës?

— E drejtë, po puna që kam ndërmarrë unë do kualifikim të lartë...

— Sa peshkatarë ke me të mesmen?

— Ka, po sa janë... — u zu ngushtë kryeinxhinieri.

— Shumë keq! Më fal, por...

E ndjeu alarmin e zemërimit dhe u mundua ta përmbante. Te një njeri i avashtë si ai alarmi i zemërimit rrinte mbi ato vetullat e trasha që iu kreshpëruan. Iu shtrënguan dhe i dhembën, sikur t'i kishte sinuset plot. I ktheu shpinën kryeinxhinierit dhe iu afrua dritares. Natën qyteza e vogël nuk ishte asgjë. Ishte vetëm disa pika dritash neon që kufizonin një rrugë. I erdhi keq për kryeinxhinierin. Ai ishte një djalosh i ndershëm, i patëkeq, që kishte aftësi, po nuk kishte metodë pune. Në fund të fundit atë nuk e kishin ndihmuar. Kërkesat që kishte ai nxirrnin telashe. Duheshin mënyra të tjera pune, drejtimi dhe administrimi.

— Ato gërvishtjet e Karakollit mund të jenë një zbulim i madh! Po si të shkoj mendja?

— Si të them... — u skuq kryeinxhinieri.

— Kam filluar të dal në det... Një natë, dy net në secilën anije. Dua të njihem me peshkatarët dhe me punën. Pasi të kem kaluar në të gjitha anijet, do të bisedojmë se si mund ta shpërndajmë punën. Kam dëgjuar edhe për gjuetinë me elektrolinjë vertikale...

— Ja, këtu e kam! Këtë dosjen e dytë e kam me të

dhëna për anët ekologjike. Nafta që derdhet në det nga anijet po na bën dëm...

Samiu qeshi. Entuziazmi i kryeinxhinierit ishte prekës. Ai nuk dinte ç'punë të fillonte më përpara.

— Gjuetinë me elektrolinjë vertikale do të ishte mirë ta eksperimentonim një herë me një anije të vetme.

— Me «Pulëbardhën»! Kam Palin atje! — u hodh si fëmijë kryeinxhinieri.

— Ke Palin, po ke edhe Karakollin! A nuk do të jenë dy ekstremë?

— Karakolli është njeriu më i çuditshëm që kam njohur, po edhe më i ndershmi!

— Nuk kam kundërshtim, po një gjë më çudit... Pse nuk ua thotë të tjerëve ato që di për detin? Ato gërvishtjet me thikë?

— E di si më tha Ndoc Marku?... Kishte shërbimin kur u afrova te shtrati i Karakollit. «Ti po e vjedh Karakollin! Kush vjedh atë, nuk i prin e mbara!» Kështu më tha. Karakolli i ka të lidhura punët e detit me «mbarësi» dhe me «prapësi»! Një lloj bëstytnie...

— Ai më kanë thënë që nuk beson, sado që është plak, po kjo nuk do të thotë që ai nuk është bestyt... Bestytنيا është thjesht njëfarë frike dhe ajo e ka burimin në injorancë.

— Nganjëherë edhe unë e kam frikë atë. Më duket sikur merret vesh me detin, me thellësitë...

— Patjetër që merret vesh! Me çdo gjë që e njeh mirë mund të merret vesh! — tha sekretari i Partisë filozofikisht.

— E di që e ke mirë, shoku Sami? — Tjetrit iu bë qejfi që e vuri Karakollin në baza materialiste.

— Ta lëmë punën, po a ke qenë në shtëpi? Kryeinxhinieri ishte nga Elbasani. Shkonte një herë në muaj, një herë në tri javë në shtëpi. «Ka një të mirë ai Landi, se nuk na çan veshët një e dy për të vajtur në shtëpi si ata jabanxhinjtë e tjerë që kemi pasur në peshkim!» — thoshte për të nëndrejtori.

— Tani shpejt nuk kam qenë, po mirë janë... E di,

shoku Sami? Kam dëshirë që atë tratën e re t'ia japim «Pulëbardhës»...

Sekretari vuri buzën në gaz. Ishte e çuditshme si ishte lidhur aq shumë pas detit ky elbasanas. Kishte me mijëra njerëz që e kishin detin nën hundë dhe nuk i kthenin një herë sytë andej...

— Ç'është kjo tratë?

— I kam shtuar nja njëzet metra një trate të zakonshme, tridhjetë metra, që të jem i saktë! Nuk e di a më lejon nëndrejtori për «Pulëbardhën»... Kam një mendim që tratat që përdorim tani për sardelen duhen bërë më të mëdha...

— Për «Pulëbardhën», po për Palin? — e ngacmoi sekretari i Partisë.

— Anijet janë dru, janë hekur... Njerëzit e bëjnë anijen ... — u skuq lehtë kryeinxhinieri.

Tjetri u mundua të sillte ndër mend atë Palin. Nuk i kujtohej.

— Mos është një zeshkan me buzë të trasha ky Pali?

— Jo! Ai është Vata, feneristi i «Korabit»...

— Kur bëhet gati trata?

— Për dy-tri ditë!

— E provojmë bashkë! — tha sekretari i Partisë. Ai u ngrit. Tjetrit iu bë qejfi, po, kur dolën jashtë, u kujtua që nuk i kishte ofruar kurrëgjë Samiut dhe e humbi qetësinë.

— Sonte deti është bosh... — tha Samiu duke vështruar hënën që e kishte përmbytur vendin me një dritë të bardhë.

I lëshuan udhën autofrigoriferit që u ngjit lart drejt peshkimit.

— E pe? E po kush ishte në kabinë? — tha si i hutuar kryeinxhinieri.

Tjetri tundi kokën. Operativiteti i nëndrejtorit e dërrmonte, e bënte nganjëherë të luhatej... Ku drejtin kishte qenë natën Murat Nallbani?

— Na doli në udhë si xhind! — tha kryeinxhinieri.

— Edhe xhind mund të jetë... — qeshi Samiu. Ai e py-

eti kryeinxhinierin pse nuk vepronin kapitenët ashtu siç kishte bërë Murat Nallbani? Pse nuk e mbledhnin flotën kur nuhatnin peshkun?

— Ajo punë do mend, do edhe guxim! Po sikur të gabohen? Fëlliqen për gjithë jetën!

— Mos është edhe ndonjë hall tjetër? Xhepi? — buzëqeshi sekretari.

Tjetri ngriti supet. Samiu u nda i kënaqur. Do të hante bukë dhe do të shkonte të luante shah. Taushi nuk kishte dalë në det. Ai ishte një derr hileqari, po edhe hilet e tij kishin bukurinë e vet...

VIII

Rrinin në kuvertë dhe luanin domino. Taushi u kishte kthyer shpinën me përbuzje. «Me domino merren laperët». — kishte thënë. — Agallëkun e njeriut e tregon shahu...» — kishte thënë Taushi. Samiu qeshte, luanë me ngadalë dhe e ngacmonte për dasmën. Hata martohej të dielën dhe merrte burrin e tretë...

— Hata po merr mëz të pashiluem... — tha Samiu si pa të keq.

— Mos fut hundët! Shif pelën tënde që e ka frikë vorri! — u fry Taushi.

— Sekretarit të Partisë i flet kështu? — i pëshpëriti Deni me shaka.

— Pse, ç'thashë? — u bë qull Taushi.

— A e merrni burrë, apo bir në shpirt atë dhëndrin? — u hodh motoristi. Ai e dinte që dhëndri ishte gati fëmijë përpara Hatës.

— Xhani i Taushit! Hesht, të kam rixha! Kështu jemi ne jevgjiti! — u zbut Taushi.

Deni i la gurët. Ishte futur kot. Nuk e dinte dominonë. Pastaj ai Samiu... Më përpara i dilte shpirti, se guri! Ishte një provë për nervat... Po si nuk e kishte zënë deti?

U ngrit dhe iu afrua Karakollit. «Pulëbardha» hepohej ngadalë në një det që kishte nisur të trazohej.

— A nuk më thua pse ka qenë deti i përbashkët qysh se është krijuar bota dhe toka copa-copa? Deti ka qenë i gjithkujt dhe i askujt! Toka ka qenë pronë! — tha papritur Karakolli.

Deni u gjallërua. Ku i shkonte mendja atij njeriu?

— Detin nuk mund ta rrethonin me gardh... — u mundua të bënte shaka Deni. Qe i gëzuar që po hapej Karakolli.

Tjetri seç kundërshtoi, po përtej nisën të thirrurur e motoristit që ishte ngritur në këmbë dhe i kishte hedhur gurët. Ai nuk bënte hile, po ishte grindavec në lojë. Po ai Samiu? Si nuk i luajti një qepallë? Po sikur ishte zverdhur...

Samion e kishte zënë deti. U ngrit dhe nxori ato që kishte ngrënë dhe nuk diti ç'të nxirrte më duke ndenjtur tash e parë me kokën jashtë anijes. Kthehej dhe hallakatej nëpër kuvertë, siç hallakateshin të brendshmet e tij dhe askush nuk kishte ç't'i bënte.

— Nuk e paske shaluar kurrë detin, shpirti i Xhikes! — e kishte hutuar Taushi. Samiu nuk kishte shaluar as kalin e butë dhe jo një mustang të egër, siç ishte deti...

I dhanë kos. «Kot, sa për të freskuar se nuk të bën gjë», — i thanë, po Samiu ia la kosit qetësinë që ndjeu.

— U qetësove, se u qetësua ai atje! — i tha Karakolli duke i treguar detin pa asnjë valë.

— Ta mblodhi turrën? — i thirri Taushi Samiut me shaka.

— Heshtni! Kemi anije përpara! — u dëgjua Pali nga timoneria.

Në mes të muzgut dukeshin konturet e një motoskafi të madh. Ishte rreth gjysmë milje larg dhe ecte pothuaj me shpejtësinë e tyre.

— Anije e huaj, po sa larg jemi nga toka? — pyeti Samiu.

— Tridhjetë, tridhjetë e pesë milje! — u përgjigj kapiteni.

— Xhan-xhin nuk paska brenda ai motoskafi! — tha Taushi.

— Mos gri sallatë! — iu hodh kapiteni. Ai i tha Palit të ulte shpejtësinë.

«Pulëbardha» sikur mbeti në vend. Nuk ecte as me gjysmë milje në orë. Motoskafi i madh kaloi përtej, pastaj panë që po e arrinin. Kishte ndalur.

— Me ne e paska... — pëshpëriti Samiu me njëfarë shqetësimi.

Shqetësimi i tij iu ngjit edhe të tjerëve. Ishte një lloj mërzie që nuk mund ta shpjegonte asnjëri. Nuk donin ta kishin pranë atë motoskaf dhe kaq!

— Shpejtësinë në maksimum! — urdhëroi kapiteni.

«Pulëbardha» u shkund dhe bëri përpara. U shkund dhe bëri përpara edhe motoskafi i madh. Kërcimi i tij qe i shpejtë dhe i beftë si i panterës.

— Mbaje gazin... — urdhëroi kapiteni.

«Pulëbardha» qëndroi. Edhe motoskafi qëndroi. Me sa dukej edhe tek ai dikush duhet të kishte urdhëruar të mbahej gazi...

— Duhet lajmëruar tanët! Na është ngjitur! — tha sekretari i Partisë.

— Është në ujërat ndërkombëtare... — vërejti kapiteni.

— Gjithsesi! — tha tjetri duke u drejtuar nga radioja.

— Sikur po ndërron kurs... — pëshpëriti Deni.

Motoskafi i madh bëri një kthesë të ngathët, si të atyre govatave prej plastilke me të cilat argëtohen fëmijët në plazh, dhe i ktheu pjesën e prapme të tij «Pulë-

bardhës». U soll nga jugperëndimi, pastaj u dëgjua një uturimë motorësh dhe e përfshiu errësira.

— Bre, bre! Lugati... — kishte mbetur si i shastisur Taushi nga shpejtësia e madhe e motoskafit.

Deni mendoi se tani ishte më keq, tani që e kishin humbur nga sytë. Ai mund të ishte diku në mes të errësirës dhe rrinte me motorët shuar. Përgjonte dhe priste. Ai do të kthehej prapë! Kështu i ishte mbushur mendja Denit.

— Mund të jetë nga ata të kontrabandës së Mesdheut! Vetëm ata kanë një shpejtësi të tillë. I kemi ndershur edhe herë të tjera, — tha kapiteni.

— Bëj be që e pashë, bëj be që s'e pashë... — pëshpëriti Taushi.

Deni iu afrua Karakollit. Plaku nuk ishte trazuar fare. Deni i tha me shaka se, po të kishte deti gardh, nuk do t'i kishte shqetësuar ai motoskafi...

Kapiteni mori regjistrin e bordit. Shënoi ditën dhe orën. «Një motoskaft i huaj i pidentifikuar u soll përreth 20 minutash në mënyrë provokuese ndaj nesh. Nuk pati asnjë incident», — shkroi ai. Pastaj u tha shokëve se ishte koha të hidhnin elektrolinjën.

Karakolli u kthye gjithë nerva nga të tjerët. Tha që ishte ngatërruar koshiloku.

— Nga e more vesh? Nuk ka as dhjetë minuta që e hodhëm! — foli Deni.

Karakolli zgjati dorën. A nuk i shihte tapat? Gjysmat ishin mbi ujë, gjysmat nuk ishin!

E tërhoqën koshilokun me nervozitet. Dikush përmendi motoskafin, po nuk ia varën. Kishin punë për të tërhequr rrjetën.

— Karakoll! Je ndezur shumë! — i tha Deni me të butë duke dashur t'i thoshte që po lodhej shumë.

Tjetri e pa me vëmendje dhe pak nga pak fytyra e tij u ashpërsua.

— Gjithçka bëj e bëj për këtë! — tha Karakolli duke i rënë fort me pëllëmbë drekut të anijes.

— Nuk thashë gjë, Karakoll... — u shqetësua Deni.

— Për nderin e kësaj... — vazhdoi plaku duke rrethuar me një gjest të gjithë motobarkën.

Denit iu duk sikur tha «për nderin e shtëpisë, të kullës, të trojeve!» Dhe nuk e pati keq. Nuk e pati keq, kur mendoi që Karakolli e vinte një për një nderin e punës me nderin e kullës dhe të trojeve!

— Rëndon... — tha Taushi duke tërhequr.

— Të rëndon barku! — u tall motoristi.

— Pse guditesh? A nuk zëmë një herë pa e mbyllur koshilokun? — tha Pali. Nuk u mor vesh nëse fliste seriozisht.

Kapiteni u thirri të shpejtonin. Nuk do të vononte të zbardhte dhe kështu nuk e hidhnin dot rrjetën më. Dielli duhet të ishte diku në limitet e horizontit, po këtë vetëm detarët e regjur mund ta kuptonin.

— Ej! Kapiteni! — thirri Taushi. Ai ishte varur jashtë anijes.

U kthyen nga ai. Taushi lëvizte dorën me energji dhe i ftonte të afroreshin.

Në fund të koshilokut kishin mbetur dy pako të mëdha, të mbështjella me një mbulesë të trashë najloni. Pakot kishin në fund një si balon ajri. Njëri ishte i fryrë, tjetri i shpuar.

— Të punoftë bafti! Cigare! — tha Taushi duke fërkuar duart.

— Thashë unë që ishte nga ata të kontrabandës së Mesdheut! — foli kapiteni. Edhe ai ishte i bindur që kishin kapur cigare. U kishte ndodhur edhe herë të tjera kështu.

— Me këto balonat përposh kemi gjetur pako të kontrabandës së kafesë! Nuk kemi gjetur cigare me balona... — vërejti motoristi.

Menduan për shumë mrekulli të detit dhe të qiellit,

po as njërit nuk i shkoi ndër mend që kishin peshkuar ungjij! Ungjij të freskët në shqip, të posadalë nga shtypshkronjat e Propaganda Fides! Portrete të freskëta shenjtorësh! Portrete të papës!

Deni kaloi përnjëherësh një tronditje të fortë. Mendoi që e kishin detin kundër, armik... Ja çfarë nxirrte ai! Pastaj iu kujtua Karakolli. Ai kishte thënë që deti ishte i të gjithëve dhe i askujt... Ato dhurata ishin mallkimi i papës. Ditë përpara ai ishte gjunjëzuar diku në një breg deti me fytyrën nga Adriatiku...

Pakot e çara i kishin përmbysur në mes të anijes dhe nga ato ishin shkapërdërdhur ungjijtë dhe portretet e shenjtorëve që i kishte dëmtuar thika e Taushit. Gjer në fund ai kishte shpresuar për cigare... Zotërit e atyre dhuratave do të ishin mërzitur fort, po të gjendeshin aty. Do të besonin se kishin të bënë me indigjenë, se ishin në hapat e parë të krishtërimit dhe se veprimi i tyre misionar kishte kaluar anash këtij bregdeti pa e prekur! E pra ata e kishin mbuluar hartën e botës për gati 20 shekuj me kryqe dhe paskëshin harruar të ngulnin një të tillë në këtë breg! Po ata e dinin që nuk ishte kështu. Një kryq kishte kaluar edhe Adriatikon, por nuk kishte zënë vend si duhet... Megjithatë zotërit e këtyre dhuratave do të besonin se kishin të bënë me indigjenë, aq të topitur dhe të vrarë rrinin njerëzit përpara ungjijve dhe shenjtorëve.

— Zoti na qenka në qiell... Qenka në det! — tha Taushi dhe shkaktoi një drithmë. E lëshoi kot së koti, se atë nuk e dinin as për besimtar, as për ateist.

I thanë të heshtte.

— Deti qenka më i thellë se qielli! — nuk pushoi ai.

Dikush duhet të thoshte diçka për të qenë, të bënte diçka. Deni vështroi sekretarin e Partisë.

— Nuk guditëm, — tha ai.

Deni u bë nervoz. Iu duk se ai tjetri po e merrte tepër shtruar atë punë.

— Po mendoja... E keqja e madhe shpesh na ka ardhur nga deti... Edhe e keqja e fundit na erdhi nga deti!

Kjo është luftë dhe ajo nuk ka për të pushuar! — Samiu merrte frymë thellë, mundahej ta mbante veten, po edhe ai ishte i tronditur.

— Flakini në det! — tha Pali.

— Nga deti dolën... — u përgjigj Deni.

— Dolën nga motoskafi i madh! — tha kapiteni. Ishte ngritur me atë shënimin në regjistrin e bordit. Atë e kishte shkruar natën, po të vërtetat e mëdha duheshin parë ditën...

Karakolli rrinte mënjanë. Zakonisht ai nuk interesohej për ato që nxirrte deti. Madje kishte edhe njëfarë frike nga ato shishet e mbushura përgjysmë me pije, që nuk duronte pa i provuar Taushi. Ia kishte hequr kaq herë nga buzët...

— Deni i tregoi një nga ungjitë.

— As ata të parët nuk paskan rënë nga qielli... — tha Karakolli si me mërzi. Ai me njëfarë mënyre përsëriti Taushin.

— Nuk të bën përshtypje?

— Punë e vjetër... Në jemi natyrë! Kështu thotë Pashk Luli! Asgjë tjetër vetëm natyrë... Na sollën të mbrapshtën! Tash e kishim nxjerrë koshilokun me peshk...

I grumbulluan të gjitha ato që gjetën në një thes dhe nuk e panë motoristin që e fshehu një ungjill në ato dy arkat me sardele që kishin mbetur kot në rrjetën e pambyllur. Motoristi ishte kuqeshtar. Nuk kishte pasur kurrë një ungjill në dorë.

— Nuk do ta hedhim koshilokun? — pyeti Taushi. Ai ishte më i vrarë nga të gjithë. Ishte përfur për cigare të huaja.

— Me sa duket ai motoskafi u zbraz më përpara se duhej! — tha kapiteni pa ia varur Taushit.

Samiu pyeti nëse kishte mundësi të dilnin në bregun tonë materialet që u gjetën.

— Pse, a pak kanë dalë? Si të jenë ujërat... — u përgjigj Karakolli. Ai i hodhi një vështrim të thellë Denit. Denit iu duk se ai në çast ishte gati ta rrethonte detin me gardh....

— Hidhni koshilokun se na iku sardelja... — thirri kapiteni.

Në magazinë erdhën dy arkat me sardele, po nuk kishte ardhur ende historia e ungjijve. Gjon Kabashi rrinte në një qoshe dhe shihte Lizën në sy... Gjithë ato ditë këtë punë kishte bërë dhe nuk kishte burrë ta nxirrte nga magazina. «Ik, ankohu te sekretari... Shko në komitet...» — kishte guxuar një herë Liza. «Mbylle! Unë nuk jam nga ata që ankohen!» — i ishte përgjigjur ai. «Sa do të durosh kështu?» — kishte vazhduar Liza. «Gjer-sa të ngordh...» — ishte hakërryer ai.

Liza trazoi me dorë njëren nga arkat që kishte sjellë Taushi në shpinë. E tërhoqi menjëherë. Kishte takuar në diçka të fortë. E përmbysi arkën në çimento me frikë. Ungjilli që nuk kishte mundur të merrte motoristi u hap dykapakësh dhe doli Krishti i kryqëzuar. Ai që pak i ndragur dhe i përlyer, po luspat e sardeles kishin krijuar një aureolë gati fosforeshente.

Gjon Kabashi ngriti sytë nga Salka që po i lutej prej kohësh Lizës për pak akull, pastaj vështroi Taushin. Salka ishte shprishur në çast, ishte shndërruar në tmerr dhe habi. Gjon Kabashit iu duk se sytë e saj rrotulloheshin pa fund dhe se po vononin të ktheheshin në orbitën e vet. Sytë e Salkës e morën me vete Gjon Kabashin, e kthyen nga deshën me kokën poshtë dhe këmbët në tavan. Kur e mori veten, pa Taushin të gogësinte dhe atëherë zuri të përpëlitej mes çudisë, frikës dhe turpit. Çfarë ishte kjo? Një lodër me zarar për ta dëmtuar, megjithëse ishte i pezulluar, apo një shaka për ta bërë me turp, siç ishin munduar edhe ndonjëherë tjetër? E mori për vete. Kjo nuk kishte të bënte me Lizën! E dinin që rrinte aty dhe ia bënë këtë... Ai rrëmbeu lopatën me të cilën derdhnin akullin dhe nuk e diti pse e rrëmbeu. Në fund e përplasi fort pas grumbullit të akullit.

— Mos rri si rosak! Doli nga deti... — tha Taushi ftohtë.

— Nga deti? — u lebetit Salka.

— Pse, a mos e polla unë? — tha Taushi duke fryrë barkun e tij të përbindshëm.

— Nga deti! Nga deti! — përsëriti Salka dhe iku me të shpejtë.

Gjon Kabashi rrinte si pa frymë. Donte të dinte dhe nuk donte të pyeste. Nuk mund të pyeste njëfarë Taushi që ishte aq larg tij në punët e qiellit, tokës dhe detit... Harroi që ishte i pezulluar. U ngrit mekanikisht dhe plotësoi faturën. Gaboi për të parën herë në jetën e tij. Sipas asaj fature «Pulëbardha» kishte dorëzuar 20 arka me sardele të cilësisë së parë...

— Tundu! Hiqe që aty... — i tha Lizës.

Liza kishte mbetur pa gojë. Kështu kishte qenë edhe kur i mori faturën nga dora.

Gjon Kabashi nuk deshë ta prekte ungjillin. E mori me lopatë dhe e la pas derës së magazinës.

IX

Hata rrinte buzvarur dhe i binte me bërryl të shoqit: «Ha» — i thoshte. Pastaj rrotullonte, sytë me mërzy nga ata që kërcenin dhe i binte prapë me bërryl të shoqit. «Pi!» — i thoshte. Ai ishte një zeshkan i pashëm, me flokë të dendur që i vareshin mbi ballë dhe sy të thellë që kundronin Hatën. Ajo ishte shëmtirë në krahasim me të. Hata rrinte aty, po ajo nuk duhet të ishte dasma e saj, po e administratës së ndërmarrjes, e ekuipazhit të «Pulëbardhës» dhe e miqve të Taushit. Ata sikur kishin gjetur një pretext për të dëfryer: dasmën e Hatës!

Ishin mbledhur në oborrin e Taushit. Prapa kishin malin, përpara apartamentet dhe detin. E gjithë qyteza ishte një rresht shtëpish njëkatëshe dhe një rresht apartamentesh që shtriheshin disa kilometra. Qyteza ishte një rrëpirë e ngushtë mes detit dhe malit.

Dasmorët ishin brenda kangjellave, kureshtarët pas tyre. Të parët dëfrenin, të dytët bërtisnin dhe bënin zhurmë me njëfarë zilie.

— Plasja u raftë! — bërtiti Taushi. E kishte me qentë, që lehnin dhe u ngatërroheshin dasmorëve nëpër këmbë, të joshur nga kockat që hidhte pas shpine motoristi i «Pulëbardhës». Ai dhe nëndrejtori rrinin në krye të vendit. Andej turreshin mezet më të mira dhe birra e ftohtë.

Deni ishte zënë ngushtë. Në të mëngjër e shtrëngonte shefi i kuadrit, që rrinte si një monument, në të djathtë e ngacmonte doktor Marku. Përpara nuk guxonte të ngrinte sytë. Përpara kishte Gjon Kabashin me të bijën... Deni mbështetej pas kangjellave për të mos i pasur përballë ata. Pas kangjellave e pickonin në qafë. «Den! Unë jam këtu!» — i thoshte Riqoja. Ai i fishkëllente fort pothuaj te veshi me atë gëzhhojën e fishekut, që nxirrte një klithmë përmbi gjithë orkestrën.

— Den! Unë jam këtu! — tha Riqoja.

Deni mori një kofshë pule dhe ia zgjati me dorën prapa. Kur u kthye, ndeshi vështrimin e ftohtë të shefit të kuadrit. Të ftohtë, disi të mërzhitur dhe pa interes. Mos ndodhte kështu se dasmën e udhëhiqte nëndrejtori dhe atij nuk po ia varnin sa duhej. Thoshin që ai vinte si me zor nëpër dasma. Ishte i pamartuar. Thoshin që kjo ishte arsyeja që ai «ishte ashtu si ishte»! Kishte një motor të mbetur në shtëpi, kishte dashur ta nxirrte atë përpara... Me fjalë të tjera ishte sakrifikuar dhe po sakrifikohej për të.

As Deni nuk ishte në atë harenë e të tjerëve. Kishte Gjon Kabashin përpara dhe Rashën! Po ç'bënte Rasha? Si nuk e pa një herë në sy? Gjon Kabashi nuk i ngrinte sytë nga tryeza, Rasha qeshte me kryeinxhinierin...

Deni u kthye nga shefi i kuadrit. Zeneli e uli gotën pothuaj pa e çikur në buzë.

— Kjo është dasmë dhe këtu vihet për të pirë dhe për të kënduar! — i tha Deni.

— Për të pirë dhe për të kënduar, po jo për t'u hardallosur! — tha shefi i kuadrit duke drejtuar edhe më shumë trupin.

Nuk po hardallosej askush. Vetëm motoristi e tepronte duke hedhur kockat pas shpine me kapadailëk dhe duke ngacmuar dhëndrin. Ai bënte shaka të trasha dhe pa lezet, po nëndrejtori shkrihej gazit. Kishte pirë shpejt e shpejt gotat e para. Ai u ngrit dhe i ftoi të gjithë për të pirë për çiftin. Pastaj i ftoi të pinin të gjithë për Karakollin. Karakolli kishte një shishe raki përpara dhe dy peshq. Nuk kishte pranuar gjë tjetër. Pashk Luli nuk kishte asgjë përpara. Megjithatë ai sikur ishte dehur nga të pirët e të tjerëve. Ngrinte duart dhe rrihte shuplakat kot së koti.

— Të falem, nëndrejtor! — tha Karakolli thjesht. Pas kësaj ai u mor me Pashk Lulin.

Murat Nallbani ngriti edhe dolli të tjera, po shefin e kuadrit nuk e përmendi. Gjon Kabashi dhe shefi i kuadrit nuk iu përgjigjën dollive të tij.

— Mbaje mend po nuk kërciti sherri... — i pëshpëriti doktor Marku Denit.

Nëndrejtori u kërkoi atyre të orkestrës të merrnin «Napolonin», po Gjon Kabashi i pengoi.

— Jo! Pezullohet! Pezullohet kënga! Merrjani asaj të krushqve! — thirri sa kishte fuqi dhe i ra tryezës me grusht.

— A nuk të thashë? — i pëshpëriti mjeku Denit.

Deni nuk desh të turpërohej Gjon Kabashi. Nuk desh për Rashën. U kthye nga Samiu që rrinte përbri mjekut, po ai nuk e kishte mendjen. Qe kthyer dhe se me kë fliste dhe qeshte me zë të lartë pas kangjellave. Pa Rashën që desh të mbante të atin, po ai e shtyu, e uli në vend.

— Pezullohet! — përsëriti Gjon Kabashi me forcë. Ai ngriti këmbën të kapërcente tryezën dhe ashtu mbeti. Karakolli e gozhdoi në vend me qetësinë e sy-

ve të tij. Pastaj ai rrudhi buzët. Edhe Gjon Kabashi rrudhi buzët. Karakolli uli kokën. Edhe Gjon Kabashi uli kokën. Ndenji në karrige.

Ata të orkestrës deshën të merrnin këngën e Murat Nallbanit.

— As njerën, as tjetrën! — tha rëndë Karakolli.

— Mirë! As njërën, as tjetrën! — përsëriti nëndrejtori sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

— Dasma qenka shamatë... — i pëshpëriti Pashk Luli Karakollit me çudi. Ai mund të kishte më shumë se gjysmë shekulli që nuk kishte qenë në një dasmë.

— Vallëzim! Tani do të ta marrin Rashën! — i pëshpëriti mjeku Denit.

Rashën shkoi ta merrte motoristi i «Pulëbardhës».

— Jo! — tha Gjon Kabashi.

— Or Gjon... Unë...

— Jo! Pezullohet! — tha Gjon Kabashi.

— I kanë hyrë në hak Gjon Kabashit me atë pezullimin... Po e marrin në qafë! — tha mjeku.

— Ai vetë nuk shkon të merret vesh... — u përgjigj Deni, që tani ishte penduar që kishte ardhur aty.

Gjon Kabashi i ra me bërryl kryeinxhinierit.

— Ngrehu merr Rashën! — i tha për habinë e të gjithëve.

— Shoku Gjon, unë...

— Ngrehu!

Tjetri u ngrit nga frika mos pëlciste sherri prapë. E tërhoqi Rashën në mesin e tryezave. Ajo e shtrëngoi veten dhe u mbajt. Gjithsesi donte të fitonte diçka për të atin, ta nxirrte nga turpi.

— Cili është njeriu më i lumtur këtu? — pyeti mjeku.

— Deni mendoi për dhëndrin. Ai po e përlante me sy Hatën. As pinte, as hante. Hata i binte me bërryl.. «Ha» — i thoshte.

— Taushi! — tha mjeku.

Taushi duhet të ishte. Rrezatonte një qetësi, një

kënaqësi... Dukej si një fëmijë i madh i mbajtur mirë dhe i përkëdhelur. Ai vetëm hante. Bota e tij ishte normale përpara copës së mishit dhe anormale kur i dilte kockë. Pse ziheshin ata përpara tij kur e kishin aq lehtë të mbanin mishin dhe të hidhnin kockën?

Dukej se tani edhe ata më zemërakët e kishin flakur kockën dhe dasma po shtyhej e gëzuar.

— A nuk të duket se po ngjishet pak si tepër Rasha? — e ngacmoi mjeku Denin.

Deni nuk arriti të buzëqeshte. Nuk e dinte as vetë se ç'kishte. Ai u qetësua kur u ulën ata të dy në vend. Rashën e ftoi dikush tjetër, po Gjon Kabashi nuk e la. E ngriti prapë kryeinxhinierin.

— Ç'i ka hipur kështu? — pyeti mjeku.

Deni u mundua. E mori për një sfidë kundër tij. A mos i thoshte Gjon Kabashi se Rasha meritonte një kryeinxhinier? «Ai është i dehur! Nuk mund të mendojë të tilla gjëra», — e ngushëlloi veten Deni. Megjithatë zuri të lëvizte në karrige e shqetësuar. Shefi i kuadrit seç foli për sjelljen e pakulturuar, po ai nuk e mori vesh. Nuk ndihej i qetë kur ata të dy shtrëngoheshin dhe kërcenin. A mos e kishte edhe Rasha për inat të tij? I thirri Riqos. Mbështolli një kockë në një copë letër dhe ia dha Riqos.

— Shpjerja kryeinxhinierit! — i tha Riqos.

— Do të bësh skandal? — u shqetësua mjeku.

Riqoja nuk priti që ata të dy të uleshin. Ia dha tek kërcenin.

— E ke nga Deni! — i tha kryeinxhinierit.

Landi e hapi letrën. Kocka e pulës ra përdhe.

— Ka humor... — pëshpëriti kryeinxhinieri me buzën në gaz.

«Humor? Ti je leshko!» — tha Rasha me vete.

Tjetri e ngriti dorën nga Deni, sikur ta përshëndeste nga «Pulëbardha». E tërhoqi Rashën me gëzim dhe vazhdoi të kërcente pa marrë vesh gjë. Po letrën e dytë e mori vesh. Ajo kishte brenda gëzhojën e plumbit me të cilën fishkëllonte Riqoja.

— Ai është xheloz... — tha krejt i zverdhur dhe e hoqi dorën nga Rasha.

— Le të bëhet xheloz për Hatën! — tha Rasha me zemërim. Ajo u kthye nga Deni, po Deni vështronte qiellin pa të keq...

— Shpëtove! U ul në vend... — i pëshpëriti mjeku Denit.

Dasma ishte nga fundi dhe ishte bërë më e gëzuar. Qe bërë një shesh i hapur nga kangjellat e rrëzuara, përmes të cilave qarkullonin të ftuarit dhe të paftuarit, fëmijët dhe qentë... Këta të fundit mbetën në mes të saj kur u larguan çiftet dhe zunë të përfyteshin mes tyre.

— Plasja u raftë... — thirri edhe një herë Taushi, po tanimë ai kishte mbetur pa zë.

Qentë u përfytën edhe pak rreth një gjëje të zezë që kalonte gojë në gojë. Më në fund dikush i trembi dhe ata u shpërndanë duke e lënë përdhe prenë e tyre.

— Den! Ai është një kryq plastik... — pëshpëriti me njëfarë ankthi mjeku.

— Na e hodhën, apo e sollën qentë? — u vrenjt Deni.

— Qentë! Qentë! Janë tërbuar me të gjithë pasditen në plazh dhe e kishin nëpër gojë kur filloi dasma, — tha Rigoja.

Tani të gjithë e kishin parë kryqin dhe heshtnin. Motoristi i «Pulëbardhës» tentoi të ndryshonte gjendjen me një shaka, po nuk i ndezi. Ai e pyeti shefin e kuadrut nëse ishte e vërtetë që u hidhte miqve kripë në këpuce. Kripa në këpuce tregonte që nuk duhet t'i shkelnin më në shtëpi...

— Pse mërziteni? — pyeti papritmas nëndrejtori. Ai largoi tryezën dhe doli në mes të gjindjes. E ngriti kryqin, e pa me vëmendje, pastaj e mbajti nën çakmak gjersa u shkrumua nga flakët.

— Fund! — tha i kënaqur dhe fshiu duart me njëra-tjetrën në mënyrë teatrale.

— Bravo! Fund! — i mbajti anën motoristi.

Sekretari i Partisë sëç i foli mjekut, po Deni e kishte larg.

— Ç'tha? — pyeti Deni.

— Nëndrejtori ishte në karakterin e tij kur e dogji kryqin! Shpejt dhe në mënyrë të vendosur! Pas kësaj për të mori fund çdo gjë dhe u zgjidh çdo gjë! — përsëriti mjeku fjalët e sekretarit.

— A do të ikim tani? — pyeti Deni me mërzi.

— Me sa duket nuk do të ikim... — u përgjigj tjetri duke bërë me kokë nga nusja.

Hata ishte ngritur në këmbë dhe tërhiqte të shoqin, po ai kishte varur kokën dhe nuk ishte më për asgjë. Atëherë ajo u hodh të kërcente vetë. Ajo ngriti në këmbë një valle të lashtë, të harruar, që mund të ishte mëma dhe ati i gjithë të tjerave që sollën kohët më vonë. Ajo duhet të kishte lindur përpara se të ngulej kryqi në këto troje e megjithatë të gjithëve u dukej sikur të kishte lindur ato ditë. Ajo ishte egërsi dhe sfidë, besim dhe dashuri... Hata kërcente vallen e urrejtjes në dasmën e saj dhe nuk ishte më ajo shëmtira që rrinte në tryezë. Kërcente vallen e urrejtjes në dasmën e saj dhe të gjithë ishin të gëzuar dhe të mahnitur.

— Ajo ka shkëlqimin e mermerit të zi... — pëshpëriti Deni.

— Ajo e fitoi dasmën e saj! E fshiu atë që ngjau... — foli mjeku.

«E fshiu kryqin!» — plotësoi Deni me vetë.

X

Hëna dilte nga retë dhe futej prapë në re. Llambat e elektrolinjës feksnin, si shpirtra të mekura, të pafuqishme dhe mezi shquheshin në detin e turbulluar nga valët. Det i vdekur, i lëshuar i tëri në pushtetin e qetë të natës, i braktisur në vetmi dhe në heshtje! Vala e dobët pluskonte e shuhej pa zë pas faqeve të anijes dhe nuk ishte në gjendje të shprishte atë ndjenjë mërzie e gjumi që i kishte pllakosur të gjithë. Qielli ishte i ngatërruar, i kapërthyer mes reve dhe hënës, që dukej sikur shkonte me galop përmes tyre pikërisht atëherë kur besonin se do të mbetej në të errët. Nga qielli nuk kishte asnjë ndihmë! Duhej një re mitike për ta mbajtur zap hënën aq kohë se nevojitej për t'u grumbulluar peshku poshtë elektrolinjës.

— Prandaj duhet elektrolinja vertikale! Hëna depërton në det 15-20 metra, ndërsa elektrolinja vertikale edhe 40 metra! Prandaj...

— Ehu... — bëri motoristi dhe i preu fjalën kryeinxhinierit.

Rrinin të gjithë në kuvertë, të mbështetur pas anës së anijes. Me sa duket as këtë natë nuk do të kishte peshk dhe kjo ishte nata e katërt. Dy net kishin qenë me hënë, e treta terr, po terr kishte qenë edhe Karakolli që ishte munduar dhe nuk kishte rënë në peshk. Para tri netësh ai kishte zbritur posa ishte ngjitur në anije. Po niseshin pa dëshirë, vetëm se kështu ishte urdhri. Kur kishte hënë, asnjëri nuk donte të dilte në det. «Si dreqin nuk na u nda hëna?» — kishte thënë me mërzi Deni duke kërcyer në anije! «Hesht! — i kishte vënë gishtin në buzë Pali. — Mos truaj!» Deni kishte ndeshur sytë e Karakollit që e kishte fiksuar për njëfarë kohe, pastaj ai kishte rrëmbyer trastën dhe ishte hedhur në molo. Ishte larguar pa kthyer kokën. «Lëre! Kur truan ndokush në det, ai nuk kthehet më!» — kishte shpjeguar Pali. Të nesërmen ai nuk e kishte vështruar Denin dhe as që ia kishte kthyer përshëndetjen. Natën tjetër i kishte kaluar përbri dhe i kishte thënë me një fill zëri: «A truhet buka? Nuk truhet!...»

— Na u gjetën dhe këta të dy... — turfulloi motoristi për sekretarin e Partisë dhe për kryeinxhinierin. Kishte folur për ta që në molo, tek bëheshin gati të niseshin. «Ata të dy po vijnë vërdallë... Plaça, po nuk na u ngjiten! Trata e re do edhe autoritet prapa!»

Feneristi fishkëlleu atje tej. Nuk dukej asnjë bisht sardeleje.

— Ja, e zbatuam urdhrin, shoku Sami, dolëm në det dhe harxhuam gjithë atë karburant! Ku është peshku? Ai mezi zihet në terr e jo më në dritë të hënës! — tha kapiteni. Ai e tërhoqi sekretarin gjer te kabina. Holloti nuk jepte asnjë shenjë.

— Më lidh me anijet e tjera! — i tha sekretari duke i treguar radion. Ai dha e mori për njëfarë kohe me pesë a gjashtë anije, pastaj e fiku radion me mërzi.

— Megjithatë duhet të ketë një ilaç edhe për hënë... — psherëtiu ai.

— Të porosisim një filtër si të atyre projektorëve të teatrit që i përdorin për të ndërruar ngjyrat. Unë do t'i vija një filtër sterrë të zi! — tha Deni.

— Ilaži është elektrolinja vertikale...

Motoristi u kollit dhe i preu fjalën për të dytën herë kryeinxhinierit.

— Kur flasim të tjerët, mbaje kollën me dorë! — i kthye me ton sekretari i Partisë.

— Vetëm ajo mund të rivalizojë me hënën... — e vazhdoi mendimin kryeinxhinieri sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

— Elektrolinja jote na shkuaka dyzet metra, po sardelja e dimë që nuk shkon dyzet metra! — vazhdoi motoristi, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Sekretari i Partisë rrudhi buzët. Nuk i pëlqeu as të përmbajturit e kryeinxhinierit, as paturpësia e motoristit. A kishte nerva ai Landi? U kthye nga motoristi.

— A e keni provuar elektrolinjën vertikale?

— Jo!

— Provojeni dhe pastaj flisni! Dhjetë herë, njëqind herë provojeni, pastaj flisni! — u nxeh Samiu.

— Një fjalë goje, po ec e gjeje! Cila llambë u duron atyre presioneve, — tha gati me triumf motoristi.

— Po, si është kjo metodë, atëherë? — u gjet disi ngushtë sekretari i Partisë.

— Përdoren llamba speciale, që i durojnë trysnitë e mëdha, — shpjegoi kryeinxhinieri.

— Nuk kemi nga këto llamba? Në asnjë vend nuk ka te ne?

— Me sa duket nuk ka... — u përgjigj si i kapitur kryeinxhinieri.

«E atëherë ç'na përrallis për metoda të reja?» — për pak sa nuk iu përvesh sekretari, po e mbajti veten.

Samiu u kthye nga Karakolli. Ai ishte ulur mbi një arkë dhe pinte duhan me sytë përdhe. Dukej sikur nuk kishte të bënte me asnjërin dhe nuk kishte dëgjuar asgjë nga ato që u thanë aty.

— Unë e kam zënë peshkun me pishë... — tha Ka-

rakolli për habinë e të gjithëve. Ai as nuk e kishte parë sekretarin që ishte drejtuar nga ai.

— Me pishë? — e nxiti ta zgjaste bisedën Samiu.

— Aty në ato hekurat ku vëmë fenerin kam ndezur pishën! Pisha më ka regjur në të zi si jam e peshku as më ka parë, as më ka dëgjuar! Çoji një herë me sandall këta bandillat deri te feneri, edhe të vdekurin e ngrënë prej varrit me ato lopatat! Unë dikur jam nisur nga bregu dhe kam mbajtur vesh lopatat e mia. Kur ua kam dëgjuar zhurmën, e kam parë se nuk më bëjnë krahët dhe jam kthyer në breg. Kurse këta... Zhurmë lopatat! Zhurmë helika! Zhurmë motori i madh dhe ai i dritave! Kur dëgjon zhurmën e makinës, a rri në rrugë, apo ikën, sekretar?

— Iki... — vuri buzën në gaz Samiu.

— Kur trembesh ti, peshku trembet edhe ma shumë!

— A mos duhet të përdorim velat?

— Nuk do të ishte keq... Duhet ndrequr gabime të tjera...

— Cilat gabime? — nguli këmbë sekretari.

— Pashë tratën e re... Shtojcën e kanë bërë dyfish! Rrjetë e dobët, më thanë, prandaj e kanë dyfish! Po sa zvogëlohen vrimat kështu? Rrjeta ka për të mbledhur pa dallim sardelen që është sa një thua bashkë me të madhen! E korrëm detin pa kujdes! — tha Karakolli me inat.

— Pa kujdes? — e nxiti edhe më shumë sekretari.

— A është e ndaluar gjuetia e karkalecit në pesëdhjetë metra ujë? Është e ndaluar! Po të gjitha anijet sjellin karkalec kur dihet që nuk gjendet në thellësi më të mëdha në këto anë! Ku e kanë zënë? Aty ku është e ndaluar e megjithatë drejtorja mbyll sytë dhe paguan paratë kur duhet të vinte gjoba!

— Karakoll! Ti e ke drejt! — tha sekretari i Partisë.

— Ehu, sa të drejta kam...

Filloi të frynte jugu dhe hënës iu turrën retë.

— Po e hanë... — tha motoristi duke parë si po i vër-suleshin retë hënës.

Deti u errësua zonë pas zone ashtu siç erret një skenë kur tërhiqet sipari.

— Tashti mund të shpresojmë! — tha kapiteni duke fërkuar duart.

Sekretari e kishte mendjen te Karakolli. U mundua ta bënte të fliste prapë, po ai nxori vetëm pak fjalë dhe pastaj nuk e hapi më gojën me gjithë përpjekjet e Samiut.

— Deti punohet, mbillet dhe korret! Deti është si toka! — tha pas njëfarë kohe Karakolli.

Sekretari i Partisë nuk e mori vesh pse u trondit aq shumë pas atyre fjalëve. Tjetri kishte folur kur nuk e priste.

— Karakoll! Të marr vesh dhe nuk të marr vesh... — i tha i turbulluar.

Plaku nuk u përgjigj.

— Mos do të thuash që ne vetëm e kemi korrur detin?

Karakolli u mbështoll edhe më shumë në atë hesh-tjen e tij.

— Shoku Karakoll...

— Nuk do të nxirrte gjë më nga plaku. U kthye nga kryeinxhinieri.

— Kemi hedhur pak rasat në det... — u ankua ai.

— E pastaj? — e kishte fjalën nëse e kishin ndjekur zhvillimin e rasateve.

— Pak na kanë dhënë dhe, për t'i ndjekur... duhen mjete. — u përtyp kryeinxhinieri.

— E hëngrën! E shqyen! — thirri motoristi duke parë gjithnjë nga retë që i ishin sulur hënës. Ishte bërë errësirë e plotë dhe elektrolinja punonte si duhej.

— A i mbarte materialet në zyrë? — pyeti sekretari. Ai e kishte fjalën për hartat dhe punimet e tjera që mbante në shtëpi.

Tjetri pohoi me një të luajtur të dobët të kokës. I kishte futur si vjedhurazi ato në zyrë. E kishte mbyllur derën përbrenda dhe pastaj i kishte fiksuar nëpër mure. Kishte pasur shumë frikë se do të hynte nëndrejtori dhe

do të tallej. Këtë punë ai e kishte filluar në zyrë, në drejtori ishte turrur një ditë aty dhe i kishte thënë me zemërim që «ishte më mirë të nisej në det, sesa të merrej me vizatim teknik!», «Nuk është vizatim teknik, po rilevimi i bregdetit dhe...» «A nuk më thua në çfarë kuadrati ndodhet Taushi tani?» — ishte tallur në drejtori duke vënë dorën në hartë.

— Duhet vënë shkenca në ballë... — belbëzoi sekretari i Partisë.

— Urdhëro...

— Dëgjo, Landi! Do të punosh disa ditë dhe do të më sjellësh mendimin tënd se ç'duhet bërë në ndërmarrjen tonë për të ecur me kërkesat e kohës! Bisedo me shkollën, pyet, kërko! Po deshe, ik ndonjë ditë në peshkimin e Durrësit.

— Mund të ta them që tani ç'duhet bërë, shoku Sami...

— Jo tani, jo! Ato që do të më sjellësh ti i dua për vete, për të krijuar një ide, pastaj mund t'i rrahim dhe t'i shoshisim në drejtori...

— Ia hodhëm hënës, me sa duket, shoku Sami! — u afrua motoristi. Ai foli sikur të kishte ndonjë meritë për këtë.

— Retë mund të shpërndahen...

— Do të dendësohen, do të bëhen sterrë! Fryn ju ga, shoku Sami!

— E paskemi shpresën ndër re... — u përgjigj tjetri me mërzë. Ai iu afrua Denit që ishte varur jashtë dhe vështronte llambën e elektrolinjës që ishte zhytur në anë të anijes.

Deni përplasi duart me gëzim. Një skumërr i ishte sulur një sepieve të vogël dhe ajo ia kishte zbratur nën hundë gjithë ngjyrën e zezë. Kur u qartësua uji, sepia ishte zhdukur, ndërsa skumërrin sillej si i trullësuar në një rreth të ngushtë.

— Luftë... — pëshpëriti Samiu. Ai i hoqi sytë nga uji dhe ndezi cigaren.

— Sepia ishte më e përgatitur se skumrri dhe fitoi!
— tha Deni.

— Më e sofistikuuar... — buzëqeshi Samiu.

— Fundi i detit duhet të jetë një tmerr i përgjakur...
— tha Deni i menduar.

Tjetri e vështroi me vëmendje. Ky djalosh i fortë kishte nisur t'i pëlqente. I kishin treguar atë historinë e çizmeve dhe ndonjë gjë tjetër për të, po ende nuk kishte vendosur si të merrej me Denin. Për një gjë ishte i bindur, se ai ishte njeri i ndershëm, po nga ata njerëz që i zbatojnë dhe i ekzekutojnë ligjet vetë!

— Si të duket deti pas atyre profesioneve që ke provuar?

— Qenke në dijeni? Asgjë nuk mbetet e fshehtë këtu! Deti është i vështirë, po është ashtu siç e dua unë. Deti nuk është kurrë njëlloj dhe unë nuk e dua atë punë që është njëlloj... Nuk do të iki nga deti, shoku sekretar...
— buzëqeshi Deni.

Edhe tjetri buzëqeshi.

— Nuk do të iki, se nuk më lëshon.

«Në fund të fundit kjo është puna e vërtetë, ajo që nuk të lëshon», — tha me vete sekretari i Partisë.

— Koshilokun! Koshilokun! — u dëgjua zëri i kryeinxhinierit.

— Kush do të jetë me petromaksin?

— Dëgjova kapitenin t'i thotë Karakollit...

Samiu buzëqeshi. Kishte dëgjuar të thoshin që Karakollit i mblidhej peshku edhe pa fener...

Filluan të lëshojnë koshilokun e ri. Kryeinxhinieri shkante sa në një krah në një tjetër dhe ishte gjithë kujdes mos ngatërrohej e mos grisej rrjeta. Me përjashtim të motoristit të gjithë kishin njëfarë tendosjeje.

— Namin do të bëjmë me këtë koshilok! — u tall motoristi.

Përkrah kishte Ndoc Markun, po ai ishte një njeri pa gojë.

— Me një koshilok të tillë kanë zënë balena... — e ngriti zërin motoristi.

Krejt papritmas pushoi motori i dritave dhe gjithë elektrolinja u fik.

— E mori dreqi tani! — thirri kapiteni duke vështuar motoristin.

Ai pa një herë si i hutuar, pastaj kërcëu në këmbë si ndonjë shqarsh, u kacavar nëpër baxhën që ishte mbi motor dhe humbi poshtë. Të gjitha lëvizjet e tij ishin shumë të shpejta dhe të programuara si të një kompjuteri.

Nuk shkuan as tridhjetë sekonda dhe motori filloi të punonte. U ndezën dritat e elektrolinjës dhe të gjithëve u erdhi fryma në vend.

— Nuk kam njohur njeri më të shkatërruar dhe njëkohësisht më të aftë për motorët... — tha Deni.

— Megjithatë ia hodhe çizmet në det... — i shpëtoi sekretarit të Partisë.

Deni ngriti supet. U skuq.

Tjetri i rrahu shpatullat dhe i qeshi me mirësi. U fikën edhe një herë llambat, po u ndezën sakaq. Kujtuan se mos motoristi e kishte lënë motorin, po ai ishte poshtë.

— E di, shoku Sami? Llambat ndizen të gjitha përnjëherësh, po, duke i parë ato, Pali betohet që është në gjendje të dallojë njëren llambë nga tjetra kur ndizet... — tha Deni.

— Ka iluzion! Korrenti përshkohet me atë shpejtësi që nuk e kuptojmë dot... — u përgjigj tjetri.

Në anije u ngjit Pali. Kishte qenë gjer në atë kohë me fenerin, pastaj ia kishte lënë Karakollit. Pali nuk ishte mirë atë natë.

— Si duket? — pyeti sekretari.

— Nuk është pa gjë... — u përgjigj Pali i lodhur. Ai e kishte ndarë punën me Karakollin, se nuk kishte dashur ta linte plakun gjithë kohën me petromaks.

— Ik dhe vizitohu në mëngjes...

— Ehu... — bëri Pali. Ai kishte një ulçer të vjetër dhe nuk i binte prapa. Iku pas kabinës dhe u mbloodh kruspull me duart e kryqëzuara mbi bark.

— A nuk keni pak çaj të ngrohtë? — pyeti sekretari, duke ndjekur me sy Palin.

— Po zbres të shoh... — tha Deni.

— Zgjoje dhe atë hipopotamin, se do të vdesë në gjumë! — bëri shaka Samiu për Taushin.

Pas pak poshtë u dëgjuan të thirrura, zhurma e sendeve që rrëzoheshin, zhurma e digkaje të qelqtë që u thye dhe nëpër shkallën e ngushtë që të nxirrte në kuvertë u duk më në fund koka e zezë e Taushit.

— Më tërboi! Më zgërlaqi, pasha shpirtin e Xhikes! Më hodhi poshtë me gjithë dyshek! U mbyll në kabinë, se do ta përtypsha si sardele! — turfulloi Taushi duke fërkuar sytë pareshtur. Ishte ende në gjumë.

Tjetri zuri të qeshte me lot duke parë si hallakatej Taushi. Ai i ngjante një demi të trullosur, që s'dihej si ishte futur në një sallon me pasqyra... E vrau fort bërrylin pas krahut të vinçit, u këput si ndonjë lëndë e madhe që e kanë lëshuar rrënjët dhe u plandos përtokë duke qarë.

— Oj Xhike, krahu! Oj Xhike, krahu...

— Hesht! Nuk të vjen turp?

— Shoku Sami? — e harroi përnjëherësh dhimbjen tjetri dhe u ngrit në këmbë duke fshirë lotët me fundin e kanotieres që e ngjiti me mundim gjer te sytë.

— Nuk je fëmijë! Je burrë!

— Nuk qava unë, pasha Xhiken! Qau krahu... — tha me naivitet Taushi.

Thërriste Karakolli atje përtej, po nuk merrej vesh se ç'kishte.

— Kanë filluar ujërat... — u trondit Taushi.

— Ujërat? Po, pse a pak ujëra ka deti?

— Rrymat... — e gjeti më në fund Taushi.

— E pastaj?

— Ehu! Ti nuk paske haber! Ujërat e marrin para koshilokun e veç kur ta shohim mën barkë! Ti nuk paske haber, pasha Xhi... — u kujtua se me kë fliste dhe u bë dyllë i verdhë. Aq i verdhë, sa mund të shquhej në gjysmerrësirën që zotëronte aty. Ai u tërhoq praptas, u

pengua, u mbajt disi, pastaj humbi pas stivës së arkave.
Karakolli thërriste. Të gjithë ishin mbi kuvertë. Thërriste dhe kapiteni.

Pali me Denin kërcyen në sandallin tjetër.

— Kot... — pëshpëriti Ndoc Marku.

Samiu deshi të dinte më tej, po Ndoc Marku u largua.

Deni me Palin e kishin arritur fenerin.

— Po ikën! Nuk ka burrë që e mban! — thirri Pali duke vënë duart si hinkë në gojë.

— Vinçin se na iku! — thirri kapiteni duke kërkuar me sy motoristin.

Zunë të tërhiqnin rrjetën përmes vingit. Koha nuk priste për ta tërhequr me dorë. Tani asnjëri nuk e kishte mendjen të peshku, po të koshiloku që duhej shpëtuar. Ndihej gërvishtja e kavove që fërkoreshin pas mbështjellësit. Ishte si një vajtim i lehtë dhe i pandërprerë.

— Nuk kam fat... — tha me një zë të shuar kryeinxhinieri.

— Lëre fatin! — nuk iu durua Samiu.

Kavot kërcitën, u epën. U ndje tendosja e tyre si tendosja e fundit e muskujve të njeriut pas një mundimi sfillitës.

— Stop! Stoop! — thirri me sa kishte fuqi kapiteni.

— E pat! Është mbështjellë pas helikës apo pas fundit të anijes... — tha kryeinxhinieri. Ai kaloi në anën tjetër të anijes dhe u var jashtë. U afrua dhe Samiu dhe vështroi poshtë. Asgjë nuk dukej.

— Ja! Ajo është! Ajo napa e bardhë që vezullon! — tha me dhimbje kryeinxhinieri. Ai u kthye dhe u lëshua mbi kuvertë të dërrmuar.

Sekretari i Partisë i shqeu sytë dhe nuk pa gjë. Më tutje iu duk se e pa koshilokun të lëkundej nën ujë si një vello të tejdukshme.

— Mbetëm! As bëjmë përpara, as prapa! Mbetëm! — vazhdoi me një zë të ngashëryer kryeinxhinieri.

Samiu e dinte që, po të mbështillej rrjeta pas helikës, vetëm palombarët mund ta zgjidhnin atë punë

pa e dëmtuar shumë koshilokun. Po gjithsesi rrjeta duhej prerë aty ku ishte mbështjellë.

Ishin mbledhur të gjithë mbi kuvertë. Sandallat përplaseshin pas barkut të anijes dhe, kur nuk kishte dallgë, kjo tregonte që kishte rryma të forta nën ujë.

Kapiteni u lidh me dispeçerin. Nuk dëgjohej mirë dhe zuri të bërtiste. Dispeçeri e pyeste për peshkun, kapiteni i fliste për rrjetën që ishte bllokuar nën anije.

— Rri të rrimë gjersa të na vijë... — foli ai me mërzi.

Të tjerët ulën kokat. Kjo mund të shkonte edhe dy ditë...

— Dikur unë kridhesha nën fundin e kësaj... — tha Karakolli me zë të ulët dhe i ra kuvertës me këmbë.

— Ku ka mbetur koshiloku, Karakoll? — pyeti Deni me interes.

— Mbështillet si oktapod pas helikës e duhet prerë rreth saj!

— A bëhet kjo punë?

— Do zemër...

Karakolli ndjeu dorën e sekretarit të Partisë në sup. Ai e pyeti si kishte ndodhur kjo.

— Ujërat...

— Mos u mërzit! Ç'faj ke ti? — e mori me të mirë Samiu duke parë sytë e lodhur të plakut.

— Ujërat dhe... Pleqëria! — shfreu Karakolli.

— Rrymat janë rryma! Nuk ke ç'u bën... — vazhdoi me të njëjtin ton sekretari i Partisë.

— Një kohë unë i nuhatja ujërat me milje larg...

Nuk gjeti dot një fjalë për ta ngushëlluar plakun. Edhe të tjerëve u duhej thënë diçka se kishin mbetur si të mpirë. Vetëm Deni nuk zinte vend. Tani ishte në krye të anijes, tani në fund...

— Na i more mendtë... Nuk je në bulevard! — i tha kapiteni, po ai nuk i ktheu përgjigje.

Deni qëndroi përpara Palit. Me sa duket atij i kishte

filluar prapë stomaku, se ishte bërë dysh aty pas direktut. «Ky nuk është për në fund të detit», — tha me vete Deni. As motoristi nuk ishte për atë punë. Denit i mbetën sytë te qimet e rralla të mjekrës së tij. Të gjata e të rralla, si ato të litografive të Azisë Juglindore. Nganjëherë ai rrinte edhe më shumë se dy javë pa u rruar. «Ky ka mushkëri për në fund të detit, po nuk ka zemër!» — mendoi Deni për Tanushin. Në fund ai u afrua te Ndoc Marku. Ndoci rrinte këmbëkryq andej nga fundi i motobarkës dhe kishte hapur në prehër bukën e mëngjesit. Ai hante sikur të mos kishte ndodhur asgjë!

Denit i shkuan sytë te thika e vogël me të cilën ndante djathin në rriska të holla dhe e fuste në gojë bashkë me të. E zemëroi qetësia e tij. Ai merrej edhe me gatimin. Kështu i plaste edhe kur gatuante.

— Ku e ke thikën e madhe? — e pyeti Deni.

Tjetri ktheu përmbys gishtin e madh të dorës së mëngjër, ndërsa me tjetrën vazhdoi të hante. Bëri me shenjë nga vendi ku kishin shporetin.

— Kot e ke gjuhën! Jepja ndonjë memeci! Bëji nder! — u zemërua Deni! Ai zbriti poshtë të kërkonte thikën. Gjer në atë çast vetëm një gjë kishte ndër mend: koshilokun! Koshiloku kishte mbështjellë helikën dhe duhej prerë! Kaq! Se duhej zhytur, se duhej qëndruar nën ujë... Nuk e kishte llogaritur këtë. E preku thikën fare lehtë me gisht. Shau nëpër dhëmbë duke parë gjakun. Ndoc Marku ishte thikëmprehësi i gjithë peshkimit! I kishte xhepat mbushur me gur smerili dhe lloj-lloj gurësh të tjerë më të butë. Deni u ngjit në kuvertë. Po lindte. Po lindte një ditë bosh. Ajo shihej në fytyrat e të gjithëve dhe ai nuk mund ta linte kështu. Shkoi në fund të anijes duke marrë frymë thellë pareshtur. Kështu bënte sa herë ishte vënë në garë me shokët për rezistencën në ujë. Në rrethin e tij ia kalonte vetëm doktor Marku. Heshti, ishte ende herët. Rrezet e diellit përplaseshin pas malit

të sherbelës dhe vetëm jehona e tyre binte mbi det, si një avull i ndritshëm dhe i ngrohtë.

Iu afrua Karakolli. E pa drejt në sy për një copë herë. Ky ishte njëfarë hetimi dhe Deni e ndjeu veten të zbuluar përpara tij.

— Qysh se kam lindur, kam pasur diçka mangut... — belbëzoi Karakolli. Ai e goditi kokën lehtë me grusht.

«Edhe do që të zhytem, edhe ke frikë...» — tha me vete Deni. Kështu i kuptoi ai fjalët e plakut.

— Edhe ti ke diçka mangut... — tundi kokën Karakolli. Atij tani iu kthye gjallëria e disa ditëve përpara, kur kishte pasur sukses në det. Ai ishte zemëruar pak kur ishin nisur nga moloja dhe Samiu e kishte pyetur për ato të gërvishturat anës shtratit. Pika, shigjeta, germa të shtrembra dhe vija të shkurtra në gjasim të hartave astronomike të qiellit... Aty anës shtratit ishte qielli i Karakollit, por atmosfera e tij ishte e mbushur plot ujë... Ai nuk kishte dashur të fliste. «Pse nuk flet, Karakoll? Kujt do t'ia lësh mendjen tënde?» — ishte zemëruar Samiu. «Aty nuk ka shkollë! Ka vetëm hamendje dhe vrojtime...» — kishte kundërshtuar plaku. Megjithatë të kanë dalë një për një!» — kishte vazhduar sekretari i Partisë. «Kanë dalë...» — ishte tërhequr plaku. «E atëherë?» — kishte shpresuar sekretari. «Atëherë? Këtu jemi...» — e kishte mbyllur atë bisedë.

Karakolli u largua duke vështruar detin e mbushur me dritë. Deni u zhvesh. U var pas anës së anijes dhe u zhyt lehtë në ujë. Nuk donte që ta shihnin të tjerët. Ndjeu ujin e ftohtë dhe mendoi që kjo ishte një marrëzi. Mendoi që nuk do t'ia dilte dot. Megjithatë u zhyt poshtë duke u orientuar pas anës së anijes. Ishte errët si në mes të natës pa hënë. Iu desh njëfarë kohe për të kuptuar që ishte zhytur në atë anë ku vetë anija bëhej pengesë për rrezet e diellit. Doli në krahun tjetër, po nuk mund të rrinte më gjatë nën ujë. U ngjiti. Dikush nga

anija hodhi lëvozhga vezësh dhe ato i ranë në kokë. Askush nuk e kishte marrë vesh ç'po bënte ai. «Vetëm plaku e ka kuptuar...» — mendoi ai dhe u zhyt rishtas. E arriti helikën me dy-tri pashë. Ajo i ngjante një koke të madhe qepe të bardhë nga rrjeta që e kishte mbështjellë në të gjitha anët. U mundua ta shprishte atë lëmsht të ngatërruar, po shpejt e pa që nuk mund të bënte gjë. I ra atëherë me thikë dhe pa që një pjesë e rrjetës u liria dhe u hap tutje andej nga ishte ana e errët pas anijes. U ngjit. Se sa kushton një thërrime ajri, vetëm mushkëritë e munduara e dinë!

Dikush pështyu në det ndërsa ai pushonte. Iu duk se e pështynë se ishte zhytur fshehtas. Kjo ishte një vepër prej kokëkrisuri dhe asgjë tjetër! Kur doli nga uji, radhën e tretë pa Karakollin që po e kërkonte me sy gjithë ankth. «Pse nuk ua the të tjerëve kur je kaq i shqetësuar?» — sesi i erdhi të bërtiste Denit. Pastaj për një çast iu duk se Karakolli e kishte me të keq me të. «Deshe të luftosh vetëm? Lufto vetëm! Deshe të vdesësh vetëm? Vdis vetëm!» Doli edhe disa herë të tjera mbi ujë dhe Karakolli nuk kishte luajtur nga vendi. Atij po i çaheshin mushkëritë, por i dukej se dhembja më e madhe i vinte nga Karakolli. Plaku ishte zbutur, ishte qullur nga frika dhe Denit në atë marramendjen e zhytjeve iu duk si një molusk që e ka flakur deti në breg të shkretë... Doli edhe një herë mbi ujë përmes një rruge që kishte menduar se nuk do të mbaronte kurrë. Jashtë kishte diell, po bota kishte mbetur pa ajër! Ku ishte ajri? Diçka thithte me të gjitha mushkëritë, diçka pa vlerë dhe që nuk e ushqente dot... Ai e hapi gojën sa mundi dhe iu duk se thithi diell... Ai ishte i vakët, i ngrohtë, i gjithëpushtetshëm, megjithatë nuk ishte ajër! Sa kushtonte një thërrime ajri? Sesi i erdhi ndër mend që nierëzimi u kishte kënduar me shekuj diellit dhe yjeve dhe nuk i kishte kushtuar një sonetë të vetme ajrit! Iu kujtua se thoshin që mendime të tilla të çuditshme u vijnë vetëm atyre që janë duke u mbytur... Po ai ishte mbi ujë! Ai po mbytej për ajër! Prapë thithi diell! E thithi dhe e

nxori ashtu të vakët si e kishte kapërdirë. E nxori të kuq dhe ai u hap nëpër ujë...

Karakolli ia dha britmës me sa fuqi pati. U grumbulloan të gjithë dhe e nxorën nga uji.

— E preva! Lashë vetëm një fill për të mos humbur! Tërhiqeni... — belbëzoi Deni.

Dikush e zuri nga krahët dhe deshi t'i bënte frymëmarrje artificiale.

— Ai nuk ka pirë ujë... — tha kapiteni.

— S'ka gjë! Vazhdo, Pal! — tha sekretari i Partisë me shqetësim të madh. Më shumë e kishte trembur Tausi që kishte vënë kujën pas shpinës së tij. U kthye t'i jepte një dush, po u pre kur e pa gjithë atë burrë që rrinte në gjuhë dhe fërkonte këmbët e Denit ngaqë nuk dinte ç'të bënte tjetër.

Deni vulli dhe me sa duket kjo e liroi. Ai mori frymë thellë dhe mushkëritë e tij u ngjitën shumë lart. Mbetën për një kohë ashtu, sa të gjithëve iu duk se nuk do të uleshin më, pastaj u ulën dhe u ngritën ritmiksht. Deni buzëqeshi.

— Kjo është aventurë e rrezikshme! — tha Samiu.

Deni u ngrit në bërryla. Ndenji pak ashtu, pastaj u shtri. Zuri të dridhej.

— Duhet ndërruar! Zbriteni në palmetë! — urdhëroi kapiteni.

Nuk pranoi ta zbrisnin në palmetë. Ndoc Marku solli një turrë batanijesh dhe ia hodhën sipër. Samiu ia hoqi rrobat nën batanije. Në fillim pantallonat që nuk i kishte hequr kur ishte zhytur, pastaj edhe të mbathurat. Ia veshën këmbishën dhe ia rrasën pas trupit sa mundën batanijet. Pali i rrëkëlleu në grykë shishen e fërnëtit që e mbante për stomakun dhe pas kësaj Deni u ndie më mirë.

Sekretari i Partisë psherëtiu dhe u ngrit. E kishte pësuar pas shpine gjithë kohën kryeinxhinierin, po ai e kishte humbur fillin.

— Dekompresion! Dekompresion... — pëshpëriste ai.

— Tani nuk ka më nevojë as për kompresion, as për

delkompresion! — iu përgjigj thatë sekretari i Partisë.

— Kaloi! — buzëqeshi Deni si i zënë në faj. Ai vë-shtroi rrobat e tij që i kishin nderë për t'u tharë dhe i erdhi turp. A nuk do të thoshte kjo që ai ende ishte shumë larg detit?

— Koshiloku! — thirri motoristi nga krahu tjetër i anijes.

U sulën të gjithë andej. Koshiloku kishte dalë mbi ujë dhe tapat e tij shkëlqenin. Dukej sikur posa e kishin hedhur për të bërë rrethimin dhe ai rrinte mbi ujë i qetë dhe i pafaj.

— Kapeni me parangall! — urdhëroi kapiteni.

Hodhën një parangall dhe e ngjitën lart një cep të rrjetës, pastaj zunë ta tërhiqnin.

Karakolli u ul te koka e Denit.

— Sherri më shihet... — belbëzoi.

Deni buzëqeshi. I erdhi të shtrinte krahët dhe ta përqafonte.

— Të lashë vetëm se burrin duhet ta lësh në kokë të vet — vazhdoi. Ai tani dukej prapë i sertë dhe i ashpër.

Deni mendoi që, po të shtrinte krahët, ai nuk do ta linte që ta përqafonte. Asnjëri nuk do të kishte lënë. «Mbase as të shoqen...» — mendoi një budallallëk Deni.

— I shkreti ti! Nuk ke për të ikur kurrë nga deti! — tha me zë të butë Karakolli.

Tjetri nuk e mori vesh nëse i vinte mirë apo keq Karakollit që ai nuk do të ikte nga deti, sado që kishte përdorur atë shprehjen «i shkreti ti»!

Rrjeta kishte mbetur, nuk vinte më tej. U përpoqën me të gjitha fuqitë të këpusnin fillin që kishte lënë Deni, po nuk qe e mundur.

— Ta lidhim shkurt me vingjin... — tha motoristi.

— Jo! Shqyhet! Ka shpëtuar mirë gjer këtu! — tha kryeinxhinieri. Ai zuri të zhvishej.

— Ej! Kur të të vijmë në varrim? — bëri shaka të keqe motoristi.

Kapiteni e shtyu tutje dhe ai heshti.

— Nuk është punë për ty, shoku kryeinxhinier... —
tha kapiteni duke i hedhur një sy trupit të dobët të tje-
trit.

Tutje u dëgjua një trup që u hodh në ujë. Sa ishin
aty panë njëri-tjetrin për të marrë vesh se kush u hodh.
Mungonte Ndoc Marku.

Sekretari i Partisë tërhoqi mënjanë kapitenin.

— Kjo anije mund të ketë heronj, po disiplinë nuk
ka! — i tha me njëfarë ngashërimi.

— Epo, kështu jemi... — u përgjigj kapiteni, sikur ta
kishte lëvduar ai tjetri!

Ndoc Marku doli mbi ujë dhe e tërhoqën menjëherë.

— E preve? — pyeti në një mënyrë krejt të zakon-
shme kryeinxhinieri. Deni i kishte hequr misterin fun-
dit të anijes. Ç'vinte pas tij do të ishte krejt e rëndom-
të....

Ndoc Marku fshiu hundët pa dhënë përgjigje dhe zu-
ri të fërkohej fort gjersa e skuqi trupin me peshqirin
që i hodhi Pali.

— Foll! A e preve? — përsëriti kryeinxhinieri.

— Fësht! — ia bëri Ndoc Marku.

— Ç'prisni? Tërhiqeni, atëherë! — ushtoi zëri i kapi-
tenit.

Sekretari iu afrua Denit. I erdhi të qeshte duke parë
si e mbante kokën e tij në prehër Taushi. «Ngjet diçka
dhe të shtron... Të shtron sëmundja, dhimbja dhe kuj-
desi i të tjerëve...» — mendoi për Denin sekretari i Par-
tisë.

— S'kam gjë! — tha Deni dhe kërkoi ndërresa. Të
dijat nuk ishin tharë ende.

— Rri se të hoqa tabanijet! — e kërcënoi Taushi.

Deni qeshi. Tjetri u thoshte gjithnjë batanijeve «ta-
banije».

U afrua kryeinxhinieri. Ishin dëmtuar rreth 20 me-
tra nga koshiloku.

— Asgjë! Unë mendova se do të ishte bërë hataja!
Është merita e shokut Den, se, po të kishte ndenjur
edhe një gjysmë dite nën ujë, koshiloku do të kishte

mbaruar i tëri! — tha kryeinxhinieri. Ai tani e kishte marrë veten.

— Ç'presim? Të ikim! — tha Samiu.

Kapiteni tundi kokën.

— E kemi tërhequr fort në fillim koshilokun me vinq dhe mund të jetë mënjeluar boshti i helikës. Po të jetë kështu, shkatërrohet kur të ndizet motori! — tha ai.

— U dashka të na rimorkiojnë, atëherë... — vërejti Pali.

— «Lura» nuk është më larg se një milje... — u hodh kryeinxhinieri.

— Kanë për t'u tallur e kanë për të bërë qejf me ne! — tha Pali.

— Hesht!

— Heshta, kapiten...

«Lura» vinte drejt tyre, po të gjithë sikur donin ta vononin sa më shumë afrimin e saj. Përveç kapitenit asnjëri nuk i kishte sytë nga ajo anije pellagjike që e kishte bashin të ulët e të gjerë si një govatë trashanike.

Kapiteni hodhi një raketë në drejtim të anijes që e kishte shmangur kursin dhe «Lura» ndërroi rrugë dhe bëri drejt tyre. Peshkatarët e saj ishin të gjithë mbi kuvertë dhe vërenin me kureshtje ç'kishte ndodhur me «Pulëbardhën».

— Si e keni hallin? — thirrën nga «Lura».

— Defekt motori! Na rimorkioni! — u përgjigj kapiteni pas një ngurrimi të vogël.

«Lura» doli përpara. I hodhën një cimë të trashë, pastaj tërhoqën spirancën. Anija u lëkund dhe shkoi pas «Lurës» si një qenie e bindur dhe fatkeqe.

Gjer në molo ata të «Lurës» nuk e morën vesh të vërtetën. Në molo Denit i shpërtheu një gulsh gjaku dhe u bë alarm. Ai e kishte marrë veten dhe kishte menduar që çdo gjë kishte kaluar, kur i shpërtheu gjaku. E fshehu në pëllëmbë, po pëllëmbët nuk janë krijuar për të mbajtur gjakun... U bë një rrëmujë! Një batërdi me të thirrura dhe të pyetura... Një pyetje sundonte mbi

të gjitha dhe kjo kishte të bënte me sedrën e detit: Kush ishte te feneri kur nisën ujërat?

— Isha unë! — tha Pali.

— Shko se të merr me të mirë Gjelina! — u tallën me të.

— Mos ma përmendni gruan! — bëri sikur u zemërua Pali.

— Shkruhu polic! Je vigjilent! — iu hodh një tjetër Palit, po ai nuk i vuri vesh. I kishte futur kra-hun Denit dhe po e ndihmonte të hipte në autofrigorifer. U rrasën të tre brenda, ai, Deni dhe Samiu.

— Në spital! — tha Samiu.

— Jo! Jo! Në ambulancë! Duhet të jetë Marku aty... — tha Deni. Atij mezi ia kishin mbushur mendjen të hipte në makinë.

Salka kishte arritur para tyre në ambulancë. Ajo kishte hequr shaminë nga koka (me siguri ajo do t'i kishte rënë nga të rendurit për t'u gjendur sa më parë në vendin e ngjarjes) dhe merrte e jepte me ata që ishin grumbulluar aty.

— E ç'pret prej tij, mor zotni? Kërcehet nga maja e direktut në det për një bast? — po thoshte Salka duke u munduar të lidhte shaminë.

— Nga maja e direktut, Salkë?

— Edhe nga maja e dregit hidhet ai! — tha Salka, po, me të parë makinën që u ndal, u hoq mënjanë.

— Kot! Nuk kam asgjë... — tha Deni edhe një herë duke hyrë në ambulancë. Atij tani i vinte turp. Kush e duronte Markun, pa lëri të tjerët!

Mjeku nuk u tall me të. E shtriu në shtrat, e ktheu andej-këndej duke e dëgjuar me stetoskop për një kohë të gjatë, pastaj i tha infermieres të merrte një koagolant.

— Sill një klauden, megjithëse nuk është gjë! — tha ai i qetësuar.

Deni u kthye. Ndjeu një dorë të lehtë mbi ballë. Ajo i kishte zënë ballin dhe gjysmën e syve.

— Riqo... — pëshpëriti Deni.

Djali u kap pas dorës së tij, pastaj i mbështeti kokën në gjoks.

— Ja një tjetër ku mund të mbështetesh... Ku mund të mbështetemi! — tha sekretari i Partisë, po kryeinxhinieri nuk e kishte mendjen aty. Për të Deni kishte marrë fund. Kryeinxhinieri e kishte humbur. Ishte mbështetur te dritarja dhe shtyhej pas saj sikur të donte të dilte prej aty.

— Ka plot si ky, po duhen aktivizuar... — vazhdoi Samiu.

— Pse, do të ngrihet ky? — tha ai si i hutuar.

Tjetri pohoi me kokë. Kryeinxhinieri ngriti dorën me gëzim dhe e rrëzoi kaktusin që ishte në dritare. Ambulanca u mbush me dhe.

— Asgjë! Fat... — pëshpëriti mjeku.

Erdhi Rasha. Kot mendohej të dukej e çinteresuar.

— Mos lësho receta për brufen! Ka mbaruar! — tha Rasha dhe pa Denin me bisht të syrit.

— Unë ika! Thuaji Gjon Kabashit se unë ika në atë botë ... — tha një budallallëk Deni.

— A nuk dilni të gjithë jashtë? Cirku mbaroi dhe ky akrobati nuk ka asgjë! — tha mjeku me zemërim. I ra me shkelm dheut të vazos që kishte mbetur në mes të dhomës, iu shkreh kot së koti infermieres, pastaj mbylli derën nga kishin dalë të tjerët dhe u mbështet pas saj me sytë nga Deni.

— Si të dukem? — mori pozë ky.

— Si një hajvan që nuk e ke shokun! Asgjë tjetër!

— Pse more zjarr kështu, o koka e shkencës? — pyeti Deni me shaka.

— Si të erdhi të përmendësh Gjon Kabashin? Të jem si ajo, marr Budën e shëmtuar për burrë dhe nuk t'i shtie sytë kurrë ty.

— Pse, keq do ta kishte ajo të martohej me perënditë?

Mjekut iu desh t'i lëshonte udhë nënës së Denit. Ajo merrte frymë rëndë dhe shtrëngonte në dorë shaminë e flokëve.

— Ububu! Në det do ta hante kokën! Në det... — fliste ajo me vete.

— Mos kështu! Nuk ka gjë... — e mori me të mirë Marku.

Ajo e largoi nga dera. Priste të gjente një kufomë dhe gjeti Denin ndenjtur mbi shtratin e vizitave...

Thirri dhe deshi ta puthte, po grushtet e saj të dobëta u mblodhën, u bënë kërcu dhe ranë si breshëri mbi supet e Denit.

— Më fike! Ik nga deti! Haram gjiri! — i tha ajo pa i ndërprerë ato grushtet e dobëta. Kështu gjersa u lodh dhe u shkreh në vaj.

— Mirë, mjaft tani, — i tha Deni. Ai ia mori shaminë dhe ia lidhi me kujdes në kokë.

— Është mirë të rrish ndonjë ditë në spital për një vëzhgim të mëtejshëm... — tha mjeku.

— Nuk e paskam të gjatë! — u tall Deni. Ai tani merrej me të ëmën, i fërkonte ballin, sytë i shtrinte ato vetullat e thinjura... Ajo deshi të bashkohej me mjekun, po Deni i zuri gojën me dorë.

— Qepe! — i tha me të butë. Ai u hodh përdhe.

— Ku shkon, o i marrë? — pyeti mjeku, të cilit i mbeti në dorë shiringa ku kishte klaudenin.

Tjetri doli pa i dhënë përgjigje. Me njëren dorë tërhiqte nënën, me tjetrën Riqon.

Plazhi i pasdrekës ishte i atyre që ishin në punë. Ata «vjedhin me ngut një copë diell...», kishte thënë Pashk Luli.

Iu afrua Rashës. Ajo kishte mbyllur sytë dhe nuk i hapi as kur i çiku flokët me këmbë.

— Pse më bën me turp? — pyeti ajo pa i hapur sytë.

— Edhe hapin ma njeh... — pëshpëriti ai.

— Kot! Krejt kot... — tha ajo.

— Shiko, Rashë...
— Ik dhe mos më bjer në qafë!
— Prit një herë!
— E di si je ti? Si anije pa spirancë! — tha ajo.
— Ku të ngul? — deshi të bënte shaka ai.
— Në Sahara! Në shkretëtirë! — tha ajo me zemërim.

— Unë po të dua...

Ajo u kthye me rrëmbim dhe e pa drejt në sy. Bërrylat i kishte të fundosur në rërë dhe kokën e kishte në mes të duarve.

— Unë kurrë nuk do të të lutem ty! — i tha ajo.

Ai e ndjeu veten keq dhe nuk diti si t'i përgjigjej. Fryhej dhe kreshpërohej si ndonjë budalla përpara Rashës. «Pse? Pse?» — tha me vete dhe u largua me shpirt të rëndë. Një herë nuk deshi të shkonte andej nga ish-in shtirë mjeku me Pashk Lulin. Marku do të fillonte nga këshillat mjekësore, ndërsa profesori nga fantazitë... Megjithatë shkoi drejt tyre.

— Sëmundjet nuk janë për buajt... — tha mjeku me ta parë.

— Ç' thua doktor? Ka kaq buaj të sëmurë! — nuk e kapi ironinë Pashk Luli.

— E kam për këtë buallin këtu...

— Djali! Ku e kalove të keqen? — pyeti Pashk Luli.

— Në det! — tha Deni dhe u shtri.

— Ku ka më mirë se në det, djali...

— Profesor! Bashkë po flisnim për gjëra me rëndësi, po na erdhi ky injoranti...

— Posi, posi! — u gjallërua Pashk Luli. Ai kërkoi djathtas e majtas dhe e gjeti më në fund gazetën.

Deni u prek. Sa afër syve e mbante gazetën! Nuk përdorte syze. Atyre që e kishin pyetur Pashk Luli u ishte përgjigjur me një paradoks: «Nga të gjitha qeniet e natyrës vetëm njeriu mban syze! Si bënin qeniet e tjerë të natyrës? Si ia dilnin të jetonin dhe të gjallonin brez pas brezi pa syze? «Unë jam munduar të mësoj prej tyre!»

Deni buzëqeshi. Kur nuk i ndodhej letër me vete, Pashk Luli, për të mos harruar, shkruante me ngut në anët bosh të gazetës. Ngranjëherë përdorte stenografinë. Gazetën e merrte përditë. «E lexon, s'e lexon, gazeta duhet marrë përditë! Si mund të jesh qytetar pa marrë gazetën?» — thoshte ai.

— Si nisa të them, e kam gjetur pse është mbushur plot me hudhra ky vend! Edhe në saksii i mbjellin...

Deni me mjekun shkëmbyen një vështrim plot gaz. Vërtet, gjithandej mbillnin hudhra...

— Vend deti! Peshku shkon me hudhrën... — buzëqeshi mjeku.

— Ndryshe thotë legjenda, djali! Këtë vend e kishin në dorë perritë. Treqind ishin të reja dhe visheshin me tyl të bardhë, po kaq ishin të vjetra dhe visheshin me tyl të zi! Bënin ligjin në këto anë dhe askush nuk mund të kalonte nëse nuk kishte ngrënë hudhra. Vetëm era e hudhrave i largonte perritë... — tha Pashk Luli duke lexuar ato që kishte shkruar në anë të gazetës.

E njihnin këtë legjendë, po nuk ia prishën dhe e dëgjuan gjer në fund.

— Sikur po flisnim për partinë, profesor...

— Partinë? Janë autoktonë në këto anë! Me ato që janë zbuluar dhe me ato që kam gjetur unë...

Verë pas vere ai e mbushte kabinën me terrakota dhe fragmente enësh dhe metalesh të zbuluara andej-këndej. Kushdo që gjente diçka nisej tek ai, pastaj shkonte në muze. Një pjesë e pasurisë së muzeut vinte nga duart e Pashk Lulit, po plot materiale të tjera ai i kishte dërguar në Tiranë. Ata të arkeologjisë nuk e kishin trajtuar kurrë seriozisht. Kishin mbiçmuar naivitetin e tij dhe kishin nënvleftësuar seriozitetin e tij! Dhe në njëfarë mënyre nuk kishin faj! Nuk kishin arritur ta merrnin vesh që te ky njeri serioziteti dhe naiviteti rronin krah për krah! Mjaftonte të përmendte atë punën e hudhrave që të mos i vinte vesh asnjëri... Ai nuk i shante ata të arkeologjisë, se ai nuk dinte të shante.

Nuk mbante mëri, se nuk dinte të mbante mëri. «Pashk Luli është një institucion shpirtmërisë!» — thoshte doktor Marku për të. Po vjet kishte ikur në shtator dhe ishte kthyer pas dy ditësh. Kishte harruar një pjesë të terrakotave në kabinë. Pas kësaj qyteza kishte fituar një nam të pakundërshtueshëm. Kur ndonjëri sillte ndonjë fakt të papëlqyer, Pashk Luli hidhej përpjetë: «Mua ma kallëzon atë qytet? Ku ka një vend në botë ku nuk të prekin terrakotat?» Në rini ai kishte qenë fetar dhe kjo i dilte nganjëherë si një bri i deformuar i një kafshe parahistorike kur bënte ndonjë interpretim të shtrembër për fenomenet që diskutoheshin. E kishin pyetur nëse besonte. «Nuk jam lodhur për të dalë nga feja! Unë vetëm se e kam harruar atë. Më ka ikur nga mendja!» — ishte përgjigjur. Ai ishte i pastër si alabastrin për të gjithë. Për motoristin e «Pulëbardhës» ishte i dyshimtë. Atë e shqetësonin ato hieroglifet stenografike në anë të gazetës që nuk kishte mundur t'i deshifronte kurrë. E kishte thënë ku duhej shqetësimin e tij dhe kishte marrë një përgjigje të vrazhdë.

— Erdhi ariu... — pëshpëriti mjeku.

Tutje po vinte Taushi. Në njerën dorë kishte çadrën e diellit që e mbante si një shkop të lehtë, në tjetrën kutinë e shahut. Ecte duke u anuar, sa në një krah, në një tjetër. Këmba i ngulej në rërë dhe dukej se nuk do të mundte ta nxirrte më. Të gjithë hapnin gropë për të ngulur çadrën, ndërsa ai e raste shkopin e saj duke i mëshuar sa mundej me bark. Çadrën e merrte kot. Nuk rrinte kurrë në hije. E merrnin të tjerët, e merrte dhe ai si një shenjë dinjiteti.

— Plaça po s'qe duke e kërkuar sekretari... — tha mjeku.

Taushi kishte ndenjtur në gjuhë dhe të dy duart i kishte mbështetur në rërë. Kishte diçka prej ankthit

të bishës... Përpara shtrihej shkretëtira me rërë nëpër të cilën ai kërkonte partnerin e shahut...

— Erdhe? Lëkura jote sot nuk do të vlejë një grosh! — tha me kënaqësi Taushi. Ai i bëri vend Samiut.

Tjetri u ul po me atë gëzim përballë tij, pa pyetur për ata që ishin rrotull, po pyetur për shefin e kuadrit. «Si mund të luajë shah një sekretar partie i shtrirë si lopët në mes të plazhit? Ku ma ka dinjitetin?» — kishte thënë shefi i kuadrit. Më tej ai kishte shtuar që vetëm kategoria e Taushit mund të grindej ashtu në mes të kallaballëkut... «Grindje» ishin diskutimet rreth lojës dhe protestat e Samiut për hilet e Taushit. Kali i tij në çaste tragjike bënte çdo lloj lëvizjeje duke përfshirë këtu edhe kërcimet e gjirafës... Pastaj nuk kishte rast që nuk e kthente lëvizjen. Kur kthente lëvizjet, thoshte se e kishte ngritur figurën për të fshirë katroren që e kishte mbuluar rëra.. Meqë rërë kishte gjithnjë, kishte edhe lëvizje të kthyerat gjithnjë!

— Po e fshij! Ç'ke ti! — gati ulëriu Taushi.

— Fshiji gënjeshttrat më mirë! Hilet! — u përgjigj i zemëruar Samiu. Ai e shtyu shahun dhe figurat u përmbyshën. I ktheu shpinën partnerit të tij dhe u bashkua me Denin me shokë.

— Hile? E fshiu? — pyeti mjeku.

— E fshiu! Nuk luaj me të! — tha buzëvarur Samiu.

— Prapë ke për të luajtur nesër! — tha mjeku.

Samiu ia dha gazit me të madhe. E dinte që kish-te për të luajtur prapë të nesërmen. U kthye dhe i ra shpatullave miqësisht Taushit. Nuk i mbante mëri, po nuk donte të luante më shah.

— Kaloi? — i tha Denit duke pasur parasysh atë që i ndodhi në mëngjes.

Deni tundi kokën.

— A mos duhet të pushojë ndonjë ditë, doktor?

— Mirë do të ishte...

— Nuk kam për të pushuar! — tha Deni prerë.

— Ndërmarrja ka një propozim për ju të «Pulëbar-

dhës». Duam t'ju bëjmë anije eksperimentale, anije shembull... — tha sekretari i Partisë kur pa që Deni as që donte të bisedonte më për ngjarjen e mëngjesit.

— Shembull është! — tha Deni duke pasur mendjen te Karakolli.

— Duam tjetër shembull! Atë që kërkon koha dhe zhvillimi i vërtetë i revolucionit tekniko-shkencor...

— Keni zgjedhur një anije druri... — vërejti Deni.

— Kemi zgjedhur njerëzit...

— Anije druri? Mrekulli! — doli me vonesë nga hesh-tja e tij Pashk Luli. Ai e donte «Pulëbardhën» se aty ishte Karakolli.

— Kur do ta gjejmë atë nimfën, profesor? — pyeti mjeku. Pashk Luli kishte një ide fikse. Kishte lexuar ndër autorët antikë se ndër këto brigje ngriheshin statu-ja të nimfave detare. I kishte kërkuar ato dhe kishte biseduar me mjekun që ishte një skulptor amator.

— Do ta gjejmë, djali...

— Kemi biseduar gjatë sot në ndërmarrje me të gjithë... — e rifilloi bisedën e ndërprerë Samiu.

— Mos është fjala për elektrolinjën vertikale? — pyeti Deni.

— Për atë edhe plot të tjera!

— Unë punë dua... — tha Deni.

— Do të shihemi! — tha sekretari i Partisë dhe iku duke i përshëndetur të tjerët me dorë.

— Ai do të të bëjë gjëmën! Bëji hile ti! Fshiji katrorët e shahut me fshesat e komunales dhe ktheji figurat... — i futi dreqin mjeku Taushit që kishte mbetur si ndo-një trung i shkretë pas tyre.

— Jo, shpirti i Xhikes, jo! — u shqetësua Taushi.

— Lëre Xhiken, gjëmën do të të bëjë...

— Mos u tall, se i bie infarkt... — ndërhyri Deni.

U ngrit edhe Pashk Luli. Ai kishte parë Karakollin atje tutje.

— Ajo paska ardhur... — tha papritur Deni duke treguar një plakë të ulur më gjunjë tej në breg të detit.

- E kam parë!
 — A mos është një çikë e marrë? — pyeti Deni.
 — Jo! Është shumë e vuajtur...
 — Nuk i biem një herë plazhit gjer poshtë? — tha Deni.
 — Kostumi i bardhë nuk ka ardhur dhe as ka për të ardhur! — tha si me mërzi mjeku.
 — Nuk i dihet... — u përgjigj Deni i menduar.

Samiu hyri në klub të merrte një paketë cigare. Pa nëndrejtorin që rrinte vetëm në një cep të sallës së mbushur me njerëz. E pa me njëfarë çudie se ai nuk rrinte kurrë vetëm. Kur nuk kishte njeri, ngrihej dhe ikte. Ai e thirri me dorë dhe Samiu u afrua. E ndjeu menjëherë që kishte pirë, megjithëse mbi tryezë kishte vetëm tre-katër filxhanë kafeje. Filxhanët ishin të bardhë përbrenda dhe sekretari e mori vesh se kësh-tu bënin ndonjëherë banakierët, shtinin raki apo konjak në filxhanët e kafesë, «për të mos komprometuar klientët e rëndësishëm».

Nëndrejtori ngriti sytë që i kishin marrë një të kuq të lehtë. U panë për një çast me njëri-tjetrin dhe Samiu u ul si padashur. Në mëngjes, pasi ishin kthyer të gjitha anijet nga deti dhe ishte mbyllur ajo puna e Denit, nëndrejtori i kishte mbledhur në zyrën e tij specialistët, disa kapitenë anijesh, Karakollin dhe shefin e planit. Ai e kishte çuditur Samiun kur kishte thënë: «Tani hapeni gojën dhe na thoni ku na dhëmb, se nuk jemi pa plagë!» «Nuk është fjala vetëm për të shëruar plagët, por për të bërë përpara!» — kishte vërejtur Samiu që ishte çuditur nga kjo mbledhje e papritur. Me gjithë vullnetin e mirë që kishte pasur nëndrejtori, siç doli më vonë, ai prapë e kishte provokuar këtë mbledhje pa ndonjë parapërgatitje, sipas stilit të tij të punëve rrufe. Ai kishte dëgjuar gjithë kohën

dhe i kishte nxitur njerëzit të flisnin. Kishte ndenjur me kokë ulur. E kishte tundur disa herë atë kur thuhej ndonjë gjë me mend dhe sekretari i Partisë e kishte ndier veten kudo me të. Kishte qenë një mbledhje për përmirësimin e mëtejshëm të punës në peshkim dhe kundër punës me hope. «Vetë provokimi i kësaj mbledhjeje që një punë me hope...» — i kishte thënë nëndrejtori Samiut kur kishin mbaruar dhe këtij i ishte dukur disi i vrarë dhe i lënduar. «Po pse kështu?» — e kishte pyetur Samiu, megjithëse që i bindur që në mbledhje ishin rrahur mendime me vlerë. «Stili... Koka ime...» — ishte përgjigjur tjetri dhe ishte larguar. Mos kishte filluar të reflektonte nëndrejtori?

— Dëgjo, shoku Sami! Kurrë nuk më është dukur vetja nëndrejtor dhe as drejtor! E kam quajtur të përkohshme këtë detyrë dhe nuk ia kam bërë hyzmetin... — tha Murat Nallbani.

«Kjo është e vërtetë! Nuk e ke lakmuar pozitën!» — mendoi Samiu. Ai vështroi rreth e rrotull. Nuk donte të niste një bisedë të tillë në atë çast.

— Pse je vetëm?

— Më erdhën nja dy dhe i zbova! Ta kisha llafin...

— A nuk e vazhdojmë nesër këtë bisedë?

— I re hilesë, filxhanët e kafes kanë pasur konjak, po unë nuk jam i dehur! Gjithçka mund të jem, po nuk jam i dehur.

«Nuk je...» — tha mekanikisht me vete Samiu. I kishte dëgjuar peshkatarët të thoshin që «kur ishte i dehur, Murat Nallbani mund ta fillonte pijen esëll!» Elipse të ngatërruara peshkatarësh... Megjithatë nuk e mbante mend të dehur Murat Nallbamin.

— E di që unë jam fajtor për Denin dhe për gjithë ç'ngjau në mëngjes me ju atje në «Pulëbardhë»? A nuk do të ishte më mirë të vinte dikush tjetër në vendin tim?

Tjetri e pa me vëmendje. Në mëngjes ai kishte qenë i gjallë dhe aktiv, ndërsa tani ishte i lëshuar.

— A nuk e lëmë për nesër? — e mori me të mirë Samiu.

— Nesër më kërcen një mendje tjetër dhe i fsheh zorrët! — tha nëndrejtori duke i bërë shenjë kamerierit të vinte.

— Unë nuk do të marr gjë dhe ti do të ngrihesh! — tha gjallërisht sekretari i Partisë.

— Mos mendon që po mbys mërzinë me konjak? Aspak! Dua të bëhem në qejf, po qejfi nuk më vjen! Ke parë kështu? — buzëqeshi ai.

Samiu nuk diti ç'të thoshte.

— Bëj ta kap qejfin, them se e zura dhe ai më ikën me të mbaruar filxhani me konjak! A nuk të duket e çuditshme, shoku Sami? Sikur të kishit limbjotë ju sot në mëngjes, do ta kishit tërhequr rrjetën shpejt dhe nuk do të kishin ndodhur ato që ndodhën! Limbjotën ma kanë kërkuar ata të «Pulëbardhës» dhe nuk ua kam dhënë. Kam dy në depo... «Ja pse nuk e kap dot qejfin...» — mendoi tjetri. Kështu i tha edhe Murat Nallbanit.

— Ti nuk ishe kështu në mëngjes... — vazhdoi Samiu.

— E di si ndodh? Je në krye të një pune dhe mendon që ata që janë poshtë teje gjithsesi do ta kryejnë detyrën, ua jep, apo nuk ua jep limbjotën! Ua jep, apo nuk ua jep elektrolinjen e re... — iu shmang përgjigjes që priste Samiu. Vërtet, në mëngjes ai nuk e kishte ndier edhe aq atë që kishte ndodhur, po shqetësimi kishte ardhur duke u rritur. Pasi kishte lënë, punën ai ishte drejtuar nga Deni, i ishte afruar banesës së tij, po pastaj nuk kishte hyrë brenda. Ai madje e kishte ndërtuar në kokë bisedën që do të bënte me të, megjithatë nuk kishte hyrë. «Unë i dua trimat...» — kishte dashur t'i thoshte.

— Më duket se bëmë një punë të mirë në mëngjes! — tha Samiu.

— Nuk ta paskam ditur vlerën, po edhe nuk kemi ndenjtur shumë bashkë. Kam menduar që vetëm di të

gjesh të meta... — i iku prapë nëndrejtori fillit të bisedës së Samiut.

Tjetri u skuq. Në këto raste thuhet: «Çflet kështu? Kam edhe unë të metat e mia!» Ai nuk tha gjë, vetëm se rrotulloi sytë pa kuptim nëpër lokal për t'i ikur vështrimit të tij.

— Si nuk më the një fjalë për Gjon Kabashin? Kam bërë mirë, kam bërë keq... Si t'ia bëj?

— E pse duhet të flas unë? Është mirë të arrish vetë një përfundim!

Tjetri e pa me vëmendje. Sekretari ishte i ngadalshëm, po nuk qe i plogët. Tani ishte mësuar me të. U ngrit, kur Samiu mendonte që nuk do të shkulej pa u mbyllur lokali.

— Takohemi nesër! — i tha pa i thënë që të dilnin bashkë.

— Mirë, po mos të të kërcejë mendje tjetër dhe m'i fshih zorrët... — bëri shaka Samiu me fjalët e tij.

XI

Ecte nëpër kallamishte dhe nuk e merrte vesh si e kishin tërhequr me vete. «Do të vish! Bëje haram këtë mëngjes! A nuk sheh që po tërbohemi gjersa të hapet sezoni?» — i kishte thënë nëndrejtori. Ai i kishte treguar zagarët që rendnin përpara atyre dhe i kishte futur krahun. I kishte takuar poshtë qytezës, te kënetat e tharë, përtej së cilës fillonte rezervati i fazanëve. Deni ende kundërshtonte me vete, po ishte vonë. Nëndrejtori nuk ia lëshonte krahun, madje ia shtrengonte edhe më shumë, si për të treguar një dhimbje, apo një miqësi. Ai i kishte lënë të iknin përpara motoristin e «Pulëbardhës» dhe Zenelin.

— Dolëm një herë, se na u ndryshkën zagarët... Po, edhe më dilej, edhe nuk më dilej... Ke provuar të rrish me dikë një vit a pesë vjet dhe pastaj të të

mbarohen llafet? — pyeti nëndrejtori dhe tregoi ata të dy që ishin përpara.

Motoristi i fryu hundët me të parë Denin, ndërsa shefi i kuadrit nuk tregoi ndonjë interes.

— Unë dal vazhdimisht me ata dhe na janë mbaruar llafet ... Më shumë na bashkon zakoni! Dhe ta dish, unë jam më i mërzitshmi nga të tre! Unë nuk durohem! E di edhe vetë...

«E ç'më duhen mua këto?» tha Deni me vete.

— Nga paske qenë mbrëmë?

— Në Mallakat, te një mik! — u përgjigj Deni.

— Po ç'kemi? S'ikur na ke ndenjur me hundë... Nuk të blemë sa duhej kur erdhe te ne, apo jo? Paske qenë më i shtrenjtë! Shumë më i shtrenjtë! — tha Murat Nallbani me kënaqësi. Ai ia shtrëngoi edhe më fort krahun.

Denit i erdhí të ikte, t'ia jepte vrapit dhe të ikte! As ai nuk e merrte vesh pse ndihej aq bosh përpara atij njeriu që po e lëvdonte me gjithë zemër. Ai arriti gjer atje sa të mendonte që aio ditë kishte nisur ters dhe ndoshta ashtu do të mbaronte... Përpara tyre ishte ndeshur me Gjon Kabashin. Kishin dalë të dy papritmas prej kallamishës dhe kishin mbetur ballë për ballë në atë stom të ngushtë në mes të ujit. Me sa dukej edhe Gjon Kabashit i ishte ndryshkur zagari dhe kishte nxjerrë fa shpinte. Ai kishte ciftin në krah, po aio ishte vetëm koloriti i giuetisë se nuk mund të shtinte pa u hapur sezoni... Deni e kishte parë grykën e saj dhe sesi kishte menduar që mund të shtinte edhe pa u hapur sezoni... Gjon Kabashi ishte anuar dhe i kishte hapur vend. Edhe Deni ishte anuar. Pastaj giokset e tyre ishin cikur dhe ishin ndarë... Aq i kishte mjaftuar Denit për të ndërer që ai e urrente.

Zagari i nëndrejtorit u kthye, u ledhatua duke u shtrirë barkas, bëri përpara me hapin e një zbuluesi

të regjur dhe iu hodh të zotit në gjoks me një kërcim të rrufeshëm.

Murat Nallbani e përfshiu me të dy duart dhe e mbajti ashtu duke përzier frymën e tij me frymën e qenit. Ishte një setër i shkëlqyer, i pastër dhe sqimatar, një nga ato kafshët e racës që takohen rrallë dhe janë frut i një seleksionimi të gjatë. Pëshpëritej që Murat Nallbani e kishte lënë të shopen pa makinë qepëse për atë zagari, ishte nisur të blinte makinën dhe kishte përfunduar të zagari! Mund të ishin edhe fjalë, po kështu thuhej...

— Nuk e kam mirë zagarin... — tha papritur nëndrejtori.

Denit iu duk sikur tha «nuk e kam mirë djalin».

— Hiç mirë nuk është... — vazhdoi i tronditur.

Deni e pa se mos tallej. Zagari harbohej tërë gjallëri në gjoksin e Murat Nallbanit.

— Është egërsuar! Nuk e kam pasur kështu! Kështu ndodh kur e mbaj mbyllur, po ku të lë sardelja? — u ankua nëndrejtori. Ai e lëshoi qenin dhe zagari u zhduk nëpër kallamishte duke lehur pa ndërprerje.

E arritën shefin e kuadrit.

— Ç'u bë Zeqiri? — pyeti Murat Nallbani.

— Iku pas zagarit...

— Mos na bëjë ndonjë budallallëk andej nga rezervati... Po e bëri ta mbajë në shpinë! Është mësuar keq ai! — tha nëndrejtori me njëfarë zemërimi.

Shefi i kuadrit rrudhi buzët. Ai nuk i kishte aprovuar kurrë shkeljet që bënte motoristi, po nuk donte që Murat Nallbani të fliste kështu në sy të Denit.

— Kot të morëm! Ti nuk paske gojë! — i tha Denit Murat Nallbani me mërzë.

«Vërtet, kot më morët!» — aprovoi Deni me vete.

— Si nuk paske çifte ti? Kush ka mbetur pa çifte

te ne? — tha nëndrejtori që përpiquej të ndizte një bisedë.

Deni e dinte që një pjesë e madhe e peshkatarëve kishin armë gjahu. Veç pasionit, çiftja ishte një shenjë dinjiteti në peshkim.

— As mos e blej! Është mikrob! Nuk ka antibiotik që e lufton! Një mikrob i bukur që të vret! I vetmi mikrob që është i bukur dhe të vret... — u ndez nëndrejtori.

Shefi i kuadrit u rruadh prapë. Me sa duket nuk ishte në një mendje me nëndrejtorin. Po të ishte gjuetia mikrob, shteti do ta linte të lirë! Tha që nuk ishte asnjëfarë mikrobi.

— A të merr gjumi kur pret të dalësh për gjueti?

— Gjumë topash! — u përgjigj Zeneli.

— A të hahet buka?

— Sa për tre veta!

Nuk ke mikrob! Ke për të jetuar gjatë! Shite çiften! — i tha me njëfarë ironie nëndrejtori.

Tutje u shpupurishën kallamishte dhe nga ato u ngritën një tufë shapcash. Nëndrejtori e hoqi çiften në mënyrë të rrufeshme dhe ua drejtoi atyre. Deni priti krismën, po në vend të saj pa grykën e çiftes poshtë...

— E sheh çfarë mikrobi? Për pak sa nuk shtiva! — tha nëndrejtori dhe buzëqeshi hidhur. Ai tani dukej me të vërtetë i mërzhitur.

— As shapka nuk lejohet? — pyeti Deni.

— Sivjet as shapka! Këtu më mirë të mos vish... Të ngrihen mushkëritë! E di sa larg janë fazanët që këtu? As dhjetë minuta! — tha Murat Nallbani.

— U zhduk Zeqiri... — tha shefi i kuadrit duke vështruar rreth e rrotull.

As dukej motoristi, as ndiheshin qentë. Kallamishtja ishte një botë e fshehtë dhe me të papritura. Nuk shihej asgjë, kur befasi të vinte nën hundë një

lopë që kishte humbur udhën, apo një kalë, që ishte shtyrë andej nga nuk duhej.

U dëgjua një e shtënë jo fort e largët. Nëndrejtori dhe shefi i kuadrit panë njëri-tjetrin.

— A nuk të thashë? Na turpëroi! — pëshpëriti Murat Nallbani.

— Te fazanët? — pyeti Deni.

— Te fazanët! Ai është i tërbuar! Kur e ngre një herë grykën, nuk e ul më! Dhe këtu gryka të ngrihet vetë...

— Mos u ngut... — tha shefi i kuadrit.

Tjetri nuk tha gjë, po u turr përpara me zemërim. Deni me shefin e kuadrit mezi e ndoqën. Nëndrejtori hapte kallamishtet me duar dhe shtyhej thellë e më thellë. Papritmas ai qëndroi. Deni mbeti si i shushatur pas shpinës së tij. Në atë rreth kallamishtesh të shkelura pa Gjon Kabashin me çiftin në gjunjë. Përpara tij shtriheshin të mbytur në gjak dy zagarë, i veti dhe i nëndrejtorit.

— A ka se si? — u kthye si i trullusur nëndrejtori nga Deni. Ai që kishte vështrimin të shterur, pa jetë.

— A ka se si? — pëshpëriti ai duke bërë nga qeni i tij. As që i hodhi sytë Gjon Kabashit. E ktheu setrin në shpinë, aty u duk një plagë e madhe, e thellë, që kullonte ende gjak.

I solli krahët qenit dhe Gjon Kabashit që nuk kishte luajtur nga vendi. E kishte humbur.

— O Murat! Kujtohu... — i foli shefi i kuadrit,

— Ty nuk të kanë vdekur fëmijë e mos të vdekshin... — pëshpëriti nëndrejtori.

«Ditë e keqe» ... — tha me vete Deni.

— Pse ma vrare zagarin, o Gjon Kabashi? — pyeti nëndrejtori pa u kthyer nga ai.

— Më shqeu zagarin tim! Nuk e dija se i kujt ishte! — tha ngadalë Gjon Kabashi.

— E ke ditur! Ke marr hak për tjetër gjë! —

u dëgjua zëri i motoristit. Asnjëri nuk e kishin parë kur kishte ardhur ai.

— Unë haqun nuk e marr ndër qen, e marr ndër njerëz! — tha Gjon Kabashi.

— Nuk e paske ditur... — turfulloi motoristi.

— Nuk e kam ditur i kujt ishte, nuk e njoha në fillim, po edhe ta njihja, kësisoj kishte për të ndodhur! — tha Gjon Kabashi.

«Gjithsesi ai është burrë...» — tha Deni me vete. I erdhi keq për Gjon Kabashin, i erdhi keq për nëndrejtorin...

Nëndrejtori u kthye andej me ngadalë. Aq ngadalë, sa Deni gati mbeti pa frymë duke pritur ç'do të ndodhte. Nuk po shkulej dot nga vendi t'u hynte në mes. I ishin këputur këmbët nga ankthi.

— E di unë ç'do ti... — vazhdoi me të njëjtin ton motoristi.

Deni u çudit me shefin e kuadrit. Ku e gjeti atë forcë ta shkundte ashtu për xhakete?

— Ku je? A po i fryn sherrit me bulçi? — thirri shefi i kuadrit. Motoristi u tërhoq duke kapsallitur sytë e vegjël, ku patjetër kishin mbetur të fiksuara ato ngjyrat paradisiake të fazanëve. Zemërimi i tij ishte tërbimi prej fazanëve...

Murat Nallbani bëri një hap përpara. Ai qe i ngadalshëm dhe vendimtar. Ç'do të ndodhte tani? Sikur e kishte përfshirë muzgu atë fushë kallamishtesh dhe i kishte ndarë nga pjesa tjetër e botës. Të gjithë ishin aty me ankthin e tyre. Besonin se mund të ndodhte diçka e rëndë.

«Ç'ditë e prapë», — tha Deni me vete.

— Nesër paraqitu në detyrë, Gjon Kabashi! — tha nëndrejtori. Ai i ktheu Denit fytyrën e tij të trazuar, të luhatur mes dritës dhe hijes së mëngjesit. Deni nuk besoi se mund të ndërronte menjëherë ajo ditë...

XII

Kishin hapur historinë e detit mbi tryezën në mes të palmetës. Ajo ishte në ata regjistrat e vjetër të bordit, që shkaktonin mall, kureshtje dhe dyshim. Pse po e vrisnin shpirtin Deni me Palin mbi ato vjetërsira? Motoristi ngjitej dhe zbriste përmes shkallës së ngushtë dhe u shkelte syrin të tjerëve.

— Pse po e vrasin shpirtin, o Ndoc? — pyeti Taushi.

Nuk mori përgjigje, madje edhe Karakolli që ishte gjithë dyshime për ata regjistra i ktheu shpinën.

— E pat kjo punë! Duhet të ndërrojmë barkë... — tha Taushi, që nuk mund të shkëmbente asnjë fjalë as me ata që shihnin, as me ata që shkruanin. Këta të fundit kishin një letër të ndarë me kolona përpara vetes ku shënohej viti, muaji dhe ditët e muajit.

— Anija eksperimentale! Letra në vend të pesh-

kut! — thirri nga shkallët motoristi. Nuk e kishte vetëm me Denin, po edhe me Karakollin që nuk kishte pasur sukses ato ditë. E kishte sunduar plakun duke i thënë që koha e tij kishte perënduar! Anija do të kthehej në një përbindësh mekanizmesh modernë që do ta thithnin peshkun si thith magneti hekurin! Po ai nuk ishte konsekuent as në atë shaka të keqe, pse trembej nga ndryshimet që po ndodhnin. Kishte shkuar te nëndrejtori dhe i kishte vënë një palë syze elegante mbi tryezë. «Për ditëlindjen...» — e kishte hedhur natyrshëm atë çast motoristi. «Ka një muaj që më ka kaluar!» — ishte përgjigjur tjetri duke rrotulluar syzet nëpër duar me kënaqësi. «Honkong! Portative...» — i kishte lëvdur motoristi. Ai ishte si i marrosur pas syzeve të diellit! Mund të dilte çjerrur e zbathur, po kishte pesë-gjashtë palë syze të blera shtrenjtë në shtëpi. «A nuk më heq nga «Pulëbardha?»» — kishte vazhduar si pa të keq ai. «Pse?» — e kishte parë me vëmendje nëndrejtori. «Aty nuk do të kapet më peshku! Do të kapet shkenca!» — kishte thënë motoristi. «Aha...» — ishte vrenjtur nëndrejtori. «Si ta mbushën mendjen, o Murat? Ti nuk je marrë me kalamallëqe? Na fike!» «E shoh! E shoh...» — kishte përsëritur nëndrejtori. «Kështu... Më hiq nga «Pulëbardha!» Nëndrejtori i kishte shtyrë syzet avash-avash gjer te dora e motoristit. «Pse? Janë të tuat...» — i ishte marrë goja motoristit. «Merri syzet!» — kishte thënë tjetri me qetësi. «Nuk do të më largosh nga «Pulëbardha?»» «Merri syzet!» — e kishte ngritur tonin nëndrejtori dhe pas kësaj motoristi kishte ikur.

— Po bëjmë një lloj kalendari... Karakolli e ka bërë aty nën shtirat për «Pulëbardhën», ne po e nxjerrim për gjithë flotën! — tha kapiteni.

— E sheh? Të vodhën! Të përllanë! — i tha Ndoc Marku Karakollit. Ai bënte shaka.

— Po shkuakemi me kalendar! Kur bie festa e grave? — tha me cinizëm motoristi.

— Do ta përdorim si një lloj orientimi krahasues. Me sa kemi kuptuar, kështu ka vepruar edhe Karakolli! — tha kapiteni që e kishte marrë me qejf atë punë. Ai ngriti sytë nga Karakolli, po plaku kishte një fytyrë pa asnjë shprehje.

— Do të na kruhet shpina kur t'i zhysin ato llambat në fund të detit! — u hodh kundër elektrolinjës vertikale motoristi.

Tri ditët e stuhisë që nuk kishim dalë në det, Pali, kapiteni dhe Deni kishin punuar për elektrolinjën në oficinë. Llambat që kishin nuk ishin për presione të mëdha. Deni kishte propozuar t'i rrethonin ato me një lloj feneri me xham më të trashë, që të duronte presionet. Xhamin e kishin gjetur, po nuk kishte qenë e mundur t'i hermetizonin. Kishin përdorur disa lloj izolantësh, megjithatë uji, kishte hyrë se kishte hyrë. Xhami kishte duruar mbi pesë atmosferë, po Deni kishte vërejtur që kjo nuk ishte e saktë gjersa feneri kishte marrë ujë përnjëherësh. Kështu ishte barazuar tryshia dhe nuk mund të dihej sa rezistent ishte xhami.

Pali e mbylli regjistrin. Ishte koha të shkonte te feneri.

— Kaq e pati shkenca... — u tall motoristi.

Ti mos na e prish atmosferën! — vërejt Deni.

— Këtu vjen era kulturë e fjalë të mëdha... — vazhdoi me të njëjtin ton motoristi.

Deni luajti nga karrigia.

— A mos don sherr, se unë... Ti e di...

— Kush e pat me ty? — u tërhoq motoristi.

— Ky është vendim Partie e drejtorie! Është edhe ma lart, po ti je hu gardhi! — iu shkreh kapiteni motoristit.

— Mos më fyej!

— Ik te motori dhe mos e nxirr as kokën, se mjaft të kemi duruar! Motoristi e ka vendin te motori! Po nuk të pëlqeu, bëjmë edhe ndryshe! — e ngriti zërin kapiteni.

— S'është nevoja për ndryshe... — u tërhoq motoristi. Ai i ngjiti shkallët dhe doli në kuvertë.

Deti ishte llom nga stuhitë e atyre ditëve dhe poshtë llambës që ishte në anë të anijes shihej vetëm turbullirë. Holloti jepte shpresa të dobëta, ose më mirë asgjë.

— Për sonte na rrofshin karremat! — u tall kapiteni, që ngriti njërin prej tyre. Ato ditë ishte dukur lojba, dhe të gjithë i kishin hedhur karremat.

— Nuk duhet mbështetur kurrë vetëm te një njeri... — tha kapiteni.

— E ke për Karakollin? — pyeti Deni.

— A mos e ka me të keq me ne dhe nuk çan kokën?

— Pse do ta ketë me të keq?

— Diçka po i rrëshqet nën këmbë dhe... Mos e ka për kalendarin?

— Edhe mund të rrëshqasë me këto të rejat, edhe jo! Po gjithsesi nuk na vë kurrë sapun nën këmbë neve! — tha Deni në mënyrë të figurshme.

— Nuk ka për të na vënë, por as ka për të na ndihmuar... — tha kapiteni duke zbritur poshtë.

— Po ikën? — e pyeti Deni.

— Po shkoj të shtrihem...

Deni qeshi nën buzë. Kishte parë dispenca në kabinën e kapitenit. Ai mësonte, po askush nuk e dinte këtë.

— Pse mëson fshehtas?

— Unë? Pse do të fshihem? — u zu në befasi kapiteni.

— Ashtu kot... — tha Deni duke kujtuar mësimet e tij. U kishte hyrë me zell të madh, pastaj i kishte harruar; përpara dy ditëve u ishte kthyer prapë. E dinte që kapiteni fshihej nga peshkatarët. Kush i duronte? Sundonte një ligj i cuditshëm: mund të pranoin më mirë një me fillore të kryer, sesa tjetrin që kishte mbetur në universitet! I pari mbase nuk kishte pasur

rast të tregonte veten, i dyti kishte pasur dhe nuk kishte arritur!

— Hall i fortë... — buzëqeshi kapiteni dhe zbriti poshtë.

Deni nuk e kishte pritur që ai të pranonte me aq zell provat e reja të peshkimit. Veç të tjerave ishte propozuar që «Pulëbardha» të gjuante tonin nga fundi i korrikut çift me anijen «Kastrioti». Ky bashkim sillte njëfarë prapësie për «Pulëbardhën», po atë e kishte kaluar natyrshëm kapiteni i saj në kolektiv. «Mund të dëmtohem, mund të mos dëmtohem! Si kur kemi marrë tepër, si kur kemi nxjerrë vetëm bazën, ata që kemi qenë jemi. Nuk kemi jetuar keq... Është fjala për të shtuar prodhimin! Paçim fat!» — kishte thënë ai. Pas kësaj të gjithë ishin kthyer vetvetiu nga motoristi. Pak t'i prekej xhepi, ai hidhej përpjetë. Motoristi i kishte lënë pa gojë. «Ç'ju gjeti? Mos jeni më kokëshkretë se unë? Dakord jam!» — ishte hedhur ai. «Flet nga inati, po do të na hajë shpirtin...» — kishte pëshpëritur Pali.

Deni u afrua te spiranca. Gjithnjë e shihte me nderim spirancën, ndiente sikur përmes saj i vinte zëri i tokës ku ajo ngulej... Atij që i kishte shkuar ndër mend ta hidhte atë peshë në det, mbase i ishte kujtuar që nuk lidhte vetëm anijen me tokën, po edhe njeriun!

Spiranca kallmonte dhe gati po dilte në fund të anijes. Deni mendoi për kapitenin dhe që i pakënaqur nga vetja. Nuk e kishte gjykuar drejt, nuk e kishte njohur! Po e zbulonte pak nga pak, siç po zbulonte të tjerët. Kapiteni kishte ngjitur në timoneri atë hartën e pengesave të nënujshme. Aty sundonin shkëmbinjtë nënujorë, ndërsa objektet e mbytura ishin më të rralla, po pjesën më të madhe e zinte fundi i detit me baltë që shënohej me katrorë të kryqëzuar. Brenda një harku të lakuar që përshkonte kuadrate të ndryshme ishte zona e ndaluar për gjueti. «Kry-

einxhinierit i ka pjellë radakja të na vërë hekurat, se askush nuk e respekton këtë hartë!» — kishte thënë Zeqiri. «Kush punon në këtë anije, do ta respektojë!» — ishte përgjigjur kapiteni. «Po të tjerët? Anijet e tjera? Po shqyhen gazit!» — kishte vazhduar motoristi. «Kush shqyhet gazit sot, qan nesër!» — ia kishte prerë shkurt kapiteni.

Ishtë një natë e errët, e heshtur gjer në mohim të natyrës, të lëvizjes dhe të gjithçkaje që dallon jetën, megjithatë Deni ishte plot shpirt dhe gjallëri. Heshtja e natyrës ishte diçka e përkohshme, ishte një nga pauzat e rralla të saj në udhën e pafund të lëvizjes dhe ripërtëritjes. Natyra heshtte dhe mbushej ristas me frymë për të rifilluar vrapin e madh të jetës... A nuk kishte kaluar pauza të tilla edhe Deni dhe tani po mbushej me frymë për të marrë vrap? Tani ndihej aq mirë në atë anije, sa i vinte zor nga shokët. Po e mbiçmonin pas asaj zhytjes së fashme dhe kishte frikë mos krijonte hendek me të tjerët, megjithatë i vinte mirë kur i thërriste Taushi: «Ej, Den! Ku je, mor peshkaqeni i Xhikes?» I vinte mirë kur pëshpëritnin për të në qytezë dhe kur i turrehin sa të hynte në klub. Nganjëherë zemërohej dhe u ikte. A mos duhej që njeriu të bënte diçka të veçantë që të trajtohej në mënyrë të veçantë? Nganjëherë pendohej që ishte hedhur për rrjetën. Zhytja në fund të detit e kishte nxjerrë në krye të qytezës! Sido që të ndodhte, kishte vërejtur që nuk ngjallte zili te të tjerët. As te motoristi nuk kishte arritur ta dallonte këtë. Ai mund të kishte tjetër gjë, mund të kishte frikë se i zinte vendin. Doktor Marku e kishte përkufizuar Denin si «shpirt shoqëror», prandaj nuk kishte si të ngjallte zilinë e të tjerëve... Ai kishte shtuar që kishte nga ata që e kërkonin vetë zilinë e të tjerëve...

Peshkatarët haheshin me njëri-tjetrin. Këto ishin castet përpara nisjes dhe ata dukeshin si fëmijë që mburrnin prindërit dhe farefisin. «Ne kemi Kara-

kollin, Denin, kapitenin! Kush hahet me ta nëpër lundricat tuaja?» — u thërriste Taushi të tjerëve.

Vetëm Pashk Luli kishte qenë ndryshe nga të tjerët për çudinë e madhe të Denit. Ai e kishte zakon të çmonte dhe të lavdëronte gjënë më të rëndomtë, ndërsa Denit i kishte thënë: «Djali! Higgjë, s'ke bërë! Unë kam nxjerrë korale me pesë atmosferë mbi shpinë!» Doktor Dëda e kishte vështruar i mahnitur. Kur kishte qenë Pashk Luli në detrat e jugut? Ç'ishte kjo? Amnezi retrospektive e ngatërrimit të personalitetit me personalitete të tjera? «Në vitin e tretë të universitetit kemi bërë një kroçierë në detrat e jugut...» — e kishte parë të nevojshme të shpjegonte Pashk Luli. ku kishte qeshur me fjalën «kroçierë» dhe i kishte ardhur mirë për atë sqarim. Nuk donte ta humbte Pashk Lulin...

«Kjo është bota ime...» — tha me vete Deni duke sjellë ndër mend të gjitha këto dhe zbriti poshtë. Karakolli kishte kryqëzuar duart dhe rrinte në këmbë duke vështruar regjistrat. Të tjerët flinin, ndërsa kapiteni kollitej në kabinën e vet. Që andej dilte tymi i duhanit e përhapej në gjithë palmetën.

— Si të duket kjo punë, Karakoll?

— Shkollë! — tha Karakolli. Shkencës ai i thoshte shkollë.

Denit i erdhi mirë që ai nuk mohonte. Nuk e kishte dëgjuar kurrë të mohonte të renë, siç ndodh me një kategori njerëzish të brezit të tij.

— Kjo është shkolla jote... — i tha Deni me të butë.

— Unë e kam pasur me një klasë, ju po e mbaroni! — tundi kokën tjetri.

— A na del gjë?

— Kryeinxhinieri nuk është pa tru, vetëm se ne ia kemi shtrënguar kokën me rubë të trashë... — tha Karakolli,

— A nuk është axhami? — qeshi Deni.

— E paske marrë vesh? Edhe unë jam prej atyre

që ia kanë shtrënguar kokën me rubë të trashë! Edhe murat Naubani! Lehe të tjerët...

— Ai e ka nisur prej teje këtë... — tha Deni duke u rënë regjistrave me dorë.

— Edhe unë e kam nisur prej një më të vjetri se unë...

— A nuk i hedhim një sy bashkë? — e nxiti Deni.

— Jo! — tundi kokën Karakolli.

Denit iu prish qejfi. As që e merrte me mend se do të kundërshtonte pas atyre fjalëve që kishte thënë.

— Pse? — pyeti Deni pothuaj me inat.

— Unë i kam shkruar aty ato që kam pasur... — tha Karakolli duke kthyer kokën nga shtrati i tij.

— Si të duket ajo elektrolinja vertikale? — pyeti Deni që iu duk se kështu mund të hakmerrej kundër tij.

— Si ta kesh mjaltin në krye të enës dhe ta zhytësh dorën kot në fund të saj!

— Peshku nuk rri gjithnjë në sipërfaqe... — vërejti Deni.

— E dike ti ku rri peshku? Ku rri peshku nuk e di unë, mor zot! — u zemërua Karakolli dhe shkoi u shtri në shtrat.

Denit iu prish qejfi. A mos e mbante veten ky Karakolli si Magu i Madh i detrave?

Mbi supin e tij u zgjat një dorë që mbante një pjeshkë të madhe.

— Oh, Ndoc... — pëshpëriti Deni duke marrë pjeshkën.

Ndoc Marku u ul përballë tij, vuri bërrylat mbi tryezë dhe mbështeti kokën në duar. Ai vëshronte me kënaqësi si e hante pjeshkën Deni.

— Nga të kopshtit? — pyeti Deni duke ngritur pjeshkën.

Tjetri pohoi me kokë.

— E shkëlqyeshme është! Sa rrënjë ke?

Ndoc Marku ngriti katër gishta.

— Pse i ke kaq të kursyera fjalët.

— Fjalët mbarohen...

Deni ia dha gazit. E kishte dashur që ditën e parë këtë djalosh të heshtur. Ai e kishte shtëpinë lart; pas malit, dhe bënte çdo ditë katër orë rrugë në këmbë për të ardhur në punë dhe për t'u kthyer.

Historia e Ndoc Markut zinte fill te historia e malësorëve pa tokë, ose me fare pak tokë. Kështu kishin ardhur në det ata, i kishin zbuar nga trojet e ata atëherë ishin kujtuar për detin... Ku mund të shkoje përtej tokës kur e kishe detin në kufi? Megjithatë Pashk Luli kishte thënë që këta malësorë dhe pasardhës malësorësh gjer në tre breza nuk mund të ishin detarë të vërtetë dhe e shihnin detin si arën e tyre! A nuk rrinin gati gjithnjë në bash ata dhe shihnin me përmallim si çante valët bashi i mprehtë i anies? A nuk u dukej se çanin tokën me plug? Diçka kishte të vërtetë në atë që kishte thënë Pashk Luli, megjithëse mund të mos shkante gjer në tre breza. Ndoc Marku kishte dy breza në det dhe bashin e anies e lëshonte vetëm kur shtyhej andej Karakolli, apo kishte punë me gatimin... E donte detin, po nuk ishte e mundur të harronte arën e mbjellë dhe fushën ku korrej bari...

Ndoc Marku luante me thikën. Ishte aio thika e mprehtë me të cilën kishte prerë koshilokun Deni. E vërtiste atë nëpër duar dhe herë pas here ngrinte sytë nga Deni. sytë e tij nganjëherë dukeshin si të mekur, aq mirësi tregonin. Ai dukej i qetë e i sigurtë në vetvete.

— Më kanë thënë që Mara e detit ka dalë nga kulla juaj...

— tha Deni pa u menduar fare, po u pre për njëherësh.

Tjetri e la ngadalë thikën mbi tryezë. Mirësia e tij u fik pak nga pak. U rrudh, u plak, u ashpërsua brenda pak sekondash. Rrëmbeu thikën dhe e nguli me një

forcë të përbindshme gjer në dorezë në tryezë. Pastaj iku pa thënë asnjë fjalë.

U zemërua me veten dhe e goditi sa mundi tryezën me pëllëmbë! Duket që zhurma e thikës nuk kishte qenë asgjë para pëllëmbës së tij se Taushi dhe Karakolli u zgjuan të trembur.

— Ç'qe? — pyeti Taushi.

— Një budallallëk! — u përgjigj Deni. Ai u mundua ta shkulte thikën, po qe e pamundur.

Gjon Kabashi pinte duhan dhe vështronte me një sy të mërzhitur rrëmujën përpara magazinës, megjithëse anijet kishin sjellë fare pak peshk. Zetori e kishte grumbulluar vetëm me një rrugë dhe nuk ishte mbushur si duhet me sardelen e zënë. Prodhimi ishte pa interes, po prapëseprapë kishte ardhur një përfaqësues nga çdo anije për të shoqëruar mallin. Të gjithë prisnin të rregullohej peshorja e madhe që ishte prishur papritur.

Deni shkarkoi dhjetë arkat e tij dhe u hodhi një sy vjedhurazi arkave të tjera. Të gjithë aty-aty ishin.

— Pse nuk e merr veresie, o Gjon Kabashi? Kjo e sotmja as na ngroh, as na ftoh... — tha njëri nga peshkatarët.

— Veresie, veresie! — u bashkuan të tjerët në kor për të ngacmuar Gjon Kabashin. Thuhej se një herë dikush kishte sjellë një ngjalë në magazinë dhe ai e kishte peshuar.

Gjon Kabashi e flaku bishtin e cigares dhe u fut brenda. E dëgjjuan si iu shkreh mekanikut që po rregullonte peshoren.

Deni u ul mbi një arkë boshe.

— Ej, Den! Pse nuk flet! — i thirrën.

— E kishit me Gjon Kabashin... — buzëqeshi Deni.

— Dhjetë arka, Den?

Deni ngriti të dy pëllëmbët dhe hapi gishtërinjtë.

— Aty afër edhe në! Ring dhe aqugë... Punë bo-
shel

Ai që fliste ishte nga ato të «Çlirimit». Ishte nga të paktat anije që mund të hahej për rezultat me «Pulëbardhën».

— A nuk të hahet ringu dhe aquga, o Bejto? — u hodh njëri nga peshkatarët.

— Nuk më hahet as mua, as Gjon Kabashit, as konservimit të Vlorës! — u përgjigj Bejtoja.

— Jo, more! Thonë që e konservojnë ringun...

— Të konservojnë kryeinxhinierin më mirë! — u tall Bejtoja.

— Ç'ke me kryeinxhinierin? — u kthye Dini nga ai.

— Ç'kam? Na e shtoi gati edhe një herë koshilo-
kun, po ç'doli? Erdhëm me shtatë arka! Na i shtoi edhe llambat e elektrolinjës, po ç'doli? Erdhëm me shtatë arka! — tha Bejtoja.

— A e përshkon drita rërën? — u zemërua Deni.

— Si ta përshkojë? Nuk ka sesi...

— Atëherë mbylle e mos fol se deti mbrëmë ishte më i trashë se rëra nga turbullira! — tha Deni.

— Turbull, o Bejto! Turbull! — thanë të tjerët.

— Do të shohim kur të sqarohet... — ndërhyri njëri nga të «Jezercës». Ai ishte një djalosh i dobët dhe rrinte vazhdimisht duke fryrë hundët.

— Kot dalin në det ata me rrufë! — ia këputi Bejtoja, megjithëse ai i kishte dalë zot.

— Të raftë mbi kokë! — i tha po ashtu ai i «Jezercës».

Bejtoja u kthye nga Deni.

— Shpejt ia bëre vendin vetes në peshkim... — i tha.

Deni e pa me vëmendje. Nuk qe në gjendje të merrte vesh nëse po e thumbonte, apo e lëvdonte.

Na vjen mirë që të kemi në mes nesh! Ku t'i kemi si ti! — tha Bejtoja.

Deni u çlirua nga halli. Nuk donte ta lëvdonin, po nuk donte as ta thumbonin.

— Nuk hahem, me ju! Ju jeni ujq! — u përgjigj Deni me të mirë.

— Ujq pa dhëmbë! — tha Bejtoja. Ai hapi gojën. Gjysmën e nofullës së sipërme e kishte bosh.

— Megjithatë ku ka për të kafshuar je i pari! — deshi të merrte hak ai që frynte hundët.

Bejtoja nuk ia vari. Zuri të fliste për rregullat e reja që po viheshin në peshkim. Pse duhet të dilnin në punë pasdrekeve në pesë? Për të bërë dy kalata? A nuk e shihnin që nuk kishte gjë as edhe në kalatën e parë? Pastaj ai kryeinxhinieri...

— Prapë me kryeinxhinierin ti? — vërejti Deni.

— Shkova te nëndrejtori të marr leje për atë dasmën e kushëririt. Më tha të shkoj te kryeinxhinieri. Unë e pashë me habi. Ku e ka zënë ndonjëherë në gojë kryeinxhinierin ai? «Po, sikur të mos më japë leje,» i thashë. «Puna e tij», m'u përgjigj nëndrejtori. «O shoku Murat! Unë kam dasmë!» i thashë. «Te kryeinxhinieri! Atje të shkosh», ma preu shkurt. A nuk ju duket se ka luajtur boshti i tokës?

— Ka luajtur, se Gjon Kabashi nuk i dha peshk dje shefit të kuadrit. I kërkoi letër nga nëndrejtori, ose nga kryeinxhinieri! Kur e kanë penguar ndonjëherë shefin e kuadrit? — tha ai që frynte hundët.

— Prit, se ka edhe më... Kapiteni ynë nuk donte ta merrte atë koshilokun e shtuar. E di si i tha ai çunaku? «Ose merre, ose dorëzo anijen!» Ku e mori gjithë këtë urrejtje? — pyeti Bejtoja duke rrotulluar sytë nga të gjithë.

— Nuk paske marrë vesh asgjë, he të rafshin trutë në qafë! Mbas tij është sekretari i Partisë! — tha ai i «Jezercës».

— Mbas tij është e drejta dhe e përparuara! — nuk iu durua Denit.

— Den! Ju diçka po përzieni atje në oficinë... — i tha njëri nga peshkatarët.

Deni i foli për elektrolinjën vertikale. Tjetri tundi kokën. Tha që në detin Jon kishin parë plot anije të

huaja që gjuanin pranë tyre, po asnjëra nuk kishte elektrolinjë vertikale. Të gjitha e kishin të shtrirë.

— Pse, duhet ta kenë ata që ta kemi edhe ne? Vetëm prej tyre do të marrim mend? — e ngriti Tonin Deni.

— Nuk thashë... Po, a na del gjë? — pyeti tjetri sinqerisht.

— Po doli, qar e kemi! Po nuk doli, nuk kemi ç'bëjmë! — tha Deni.

— Edhe me ata të «Kastriotit» thonë që do të bëhemi ortakë për gjuetinë e tonit...

— Mund të vendoset! — u përgjigj Deni me mërzi. Ai nuk kishte qejf që vëmendja e të gjithëve të kthehej nga ai.

— Me yrysh e kemi marrë!.. — vërejti Bejtoja.

— Kështu ka ardhur koha! — u përgjigj dikush nga peshkatarët.

Deni mbante vesh. Pse thoshin për peshkatarët që janë «nyja të vjetra me ndryshk»? Mbase ishte ai Bejtoja kështu, po të tjerët nuk dukej të kishin ndryshk. «Është ndër zanatet e para të njerëzimit, prandaj evoluon ngadalë peshkimi!» — kishte thënë Pashk Luli.

Deni buzëqeshi. Pashk Luli do t'i lidhte shumë gjëra me origjinën e njerëzimit dhe hapat e parë të njeriut.

U duk Gjon Kabashi. U tha të hynin brenda me radhë. Deni u ngrit dhe zuri të vërtitej nëpër oborr.

— Hë? — e ngacmoi Deni Bejton që sapo kishte dorëzuar peshkun.

— Mjaltë e sheqer! Ku të bën fjalë Gjon Kabashi kur ke 11 arka? T'i thuash që nuk është sardele, po levrek, për levrek ta merr!

— Nuk është kaq i keq... pëshpëriti Deni.

— Nuk është hiç i keq! Jemi ne të pangopur!

— u kthye përnjëherësh Bejtoja.

— Den! Den! — i thirrën nga magazina dhe ai shkoi andej.

Magazinieri i pa ftohtë arkat e Denit, po nuk i futi duart t'i trazonte si e kishte zakon.

— Gjashtë açugë, katër ring! — i ndau me kualitete ai dhe u bëri me shenjë punëtorëve t'i peshonin. E kishte marrë veten dhe e kishte harruar pezullimin, po Denit nuk ia hodhi një herë sytë.

Në magazinë erdhi shefi i kuadrit.

— Erdha për atë peshkun, Gjon! Nëndrejtorin nuk e kam dhe kryeinxhinieri më iku... — tha ai duke parë Denin me bisht të syrit.

— Të thashë edhe dje që ata e kanë në dorë!
— Gjon Kabashi foli pa e ngritur kokën nga fatura e Denit.

— A të duket punë e madhe ta bie nesër?

— As e vogël nuk më duket...

— Kryeinxhinieri u fut në ndërmarrje! — ndërhyri Deni. Atij as që i shkoi ndër mend që shefi i kuadrit nuk donte ta ulte veten të merrte letër nga ai.

— Kujt i flet ti kështu, o shoku Gjon? — pyeti tjetri duke i kthyer shpinën Denit.

— Bëj një vrap gjer te kryeinxhinieri më mirë!
— vazhdoi me të njëjtin ton Gjon Kabashi.

— Këtu unë kam të drejtë të marr dhe kam marrë...

— Ke marrë pa të drejtë dhe nuk ke për të marrë më! — e ngriti tonin magazinieri. Ai i zgjati faturrën Denit pa e vështruar në sy.

— Ashtu? Do të shohim! Do... Do... — u ngatërrua shefi i kuadrit. Ai nuk mund ta duronte këtë sjellje në prani të Denit.

— A thua po m'i djeg letrat si kryeinxhinierit? Nuk më bën kush drejtor mua...

— Do të shohim! — u zverdh krejt shefi i kuadrit.

— Në daç shih diellin, në daç shih hënë! — ia ktheu Gjon Kabashi pa u mërzhitur.

Shefi i kuadrit e kërcënoi nëpër dhëmbë dhe iku duke përplasur derën. Iku dhe Deni. Edhe ai mendoi që diçka kishte luajtur në ndërmarrje.

— Mirë je, profesor? — pyeti Deni.

— Mirë ka dashë natyra! — u ngatërrua Pashk Luli, që në atë çast po fliste me shitësen. Ai kishte tri trasta të mëdha nëpër duar sikur do të ngrinte të gjithë dyqanin.

— Specat, patate, qepë, domate, hudhra, pjeshkë, kumbulla! — tha me një frymë Pashk Luli.

Shitësja nuk e pyeti, po vuri 100 gramë mbi peshore. Nuk e ndërroi peshën gjersa i mbaroi të gjithë artikujt. Gjithnjë 100 gramë merrte nga çdo gjë Pashk Luli.

— Të faltë natyra! — e uroi duke paguar. Ai u kthye dhe pyeti për Karakollin.

— Nuk ka shumë që ka ikur! — tha Deni. Ai mendoi që Karakolli nuk do ta takonte atë ditë. Kapiteni nuk i kishte lënë as Taushin as motoristin të merrnin peshk. Ua kishte zbrazur trastat mbi arka e atëherë edhe Karakolli i kishte hedhur mbi arka 10 sardelet e Pashk Lulit.

— Mos është nga ndërmarrja... — iu ngjiti prapa Pashk Luli. Ai e harroi pas pak Karakollin dhe u fut bashkë me ta në oficinë. Kryeinxhinieri po i bërtiste njërit prej mekanikëve që nuk e kishte vrarë mendjen për fenerin.

— Mos bërtit, shoku Landi! Me se ta izoluj? Të heq lëkurën time? — u zemërua mekaniku. Ai e shtyu tutje fenerin mbi banak.

— Si është puna? — u përzie Pashk Luli. Ai la ato trastat qesharake në një anë dhe mori fenerin në dorë.

Kryeinxhinieri ia shpjegoi pa dëshirë si ishte puna. Harroi që Pashk Luli po përkthente për të një kronikë pararomake për peshkimin nga gryka e Bunës gjer në Karaburun. Kishte ndeshur gjëra me interes për emigrimin dhe kthimin e peshkut. A e dinte kryeinxhinieri si e konservonin ilirët sardelen? E kripnin shtresa-shtresa në amfora gjigante...

— Kam menduar për një guarnicion gome mes xhamit dhe metalit, po duhet skelet tjetër dhe fermo, — tha Deni.

— Shtërëgues! Bllokues! Jo fermo! — u zemërua Pashk Luli.

Deni kërkoi saldatriçen dhe mjete të tjera. Pas dy orësh feneri ishte gati. Gjatë gjithë kësaj kohe Pashk Luli nuk kishte luajtur nga vendi. Priste të mbaronte punë Deni.

— E provojmë në darkë, në det... — tha Pali.

— Duket si fener bashkie... — u entuziazmuu Pashk Luli.

— Në darkë the ti, Pāl? Tani do ta provojmë! — u kujtua Deni. Ai e mbështolli fenerin në një gazetë dhe kërkoi litar.

— E sheh si bëhen punët? — iu shkreh edhe një herë kryeinxhinieri mekanikut që buzëqeshte.

— Se mos e bërë ti, kryeinxhinier? — nuk ia la mangut mekaniku.

Ashtu ishte. Landi e pa gati me adhurim Denin. Sa mirë që kishte kaluar nëpër tërë ato zanate? Punë e madhe që nuk ishte ngulur në to. Ja, ishte ngulur në det!

— Duhet gjetur një sandall... — tha Deni.

A të duhem edhe unë në sandall, djali? — pyeti Pashk Luli. Ai pothuajse vraponte pas tyre me ato trastat e mëdha nëpër duar.

— Ik pusho, profesor! — tha Deni duke parë me

bisht të syrit shefin e kuadrit që rrinte si ndër gjem-
ba te dera e ndërmarrjes. «Kryeinxhinierin ja ku e
ka. Pret nëndrejtorin! Me sa duket do të kërcasë...»
tha me vete Deni. A nuk kishte thënë nëndrejtori që
atyre u ishin mbaruar llafet?

Nëndrejtori erdhi aty nga ora një. Shefi i kuadrit
nuk kishte luajtur nga dera e ndërmarrjes.

— Pse rri aty? — e pyeti Murat Nallbani.

— Unë edhe këtu e kam tepër! — tha me zemë-
rim shefi i kuadrit.

— Ç'ke? Fol shpejt, se nuk kam kohë! Do të nisem
për Durrës, për naftë.

— Lëre naftën në Durrës, se nafta po i bëhet
këtu ndërmarrjes! Kaq vjet unë në peshkim dhe nuk
paskam të drejtë të marr peshk për një rast dhe për
një mik? Kjo është skandaloze! — tha shefi i kua-
drit.

— Kam dhënë urdhër për të gjithë! Për të gjithë
me letër nga unë dhe nga kryeinxhinieri.

— Po ti? Nga kush do ta marrësh letrën ti? — u
ngrefos shefi i kuadrit.

— Unë kam letrën dhe vulën dhe sa të kem letrën...

— Do të shohim kur të vijne ata miqtë e tu, kur
të vijë triçikli!

Kur të vijë triçikli, do ta mbush më tepër se
përpara! — tha nga inati Murat Nallbani që ato ditë
kishte menduar ta largonte triçiklin.

— Kujdes, o Murat, se të keqen e të mirën ne e
kemi bërë bashkë... — tha si me kërcënim shefi i ku-
adrit.

— Aha! Këtu më rri! Kot nuk paske shkuar dy
herë rresht brenda javës tek ai miku në dikaster!

Unë nuk pyes as për atë as për mikun tënd, as për njeri, se xhepat e mi janë të shpuar! — tha Murat Nallbani me inat dhe rراسi duart në xhepa.

— Në dikaster kam shkuar për punët e mia! Nuk ke fjalë tjetër?

— Do të respektojme rregullat! Po deshe peshk, merru vesh me kryeinxhinierin! — tha me të mirë nëndrejtori.

— Ngordh dhe nuk ia shtrij dorën atij!

— Si të duash! Unë rruk kam kohë tani! — u përgjigj nëndrejtori dhe u fut brenda me të shpejtë.

Shefi i kuadrit u prish në fytyrë, kur pa rojën pas shpinës së tij. Ai i kishte dëgjuar të gjitha. Dhe dukej i kënaqur për ato që kishte dëgjuar... «Këtu nuk më duan, po do të më shohin, tha me vete shefi i kuadrit.

XIII

Plazhi kishte pak njerëz dhe në cep të tij përgatiteshin të xhironin. Deni e kishte ngacmuar Taushin gjithë kohës, po, kur ai hoqi dorë, tjetri gjeti diçka për ta bërë të hidhej përpjetë.

— Shpirti i Xhikes! Nuk po të vjen ajo dosa me kostum të bardhë?

— Mos guxo ta quash ashtu! — tha Deni me kërcënim. Ai u ngrit ndenjtur me sy të zgurdulluar.

Taushi u zbyth i trembur, ndërsa mjeku ia dha gazit me të madhe.

— Den! Më plase! Si tërbohesh kështu për një vajzë që të është ngjitur në tru vetëm se e ke parë dy herë në plazh? — pyeti ai.

— As derri nuk duhet quajtur «dosë»! Fjalë e pështirë... — vazhdoi Deni me buzët e varura.

— Shpirti i Xhikes! Më lër të të puth... — u lut

Taushi me një zë aq fëmijëror, saqë nuk mund t'i rezistonte askush.

— Lëre të të puthë! Është njëlloj sikur të të ngjisin venduza, — bëri shaka doktor Marku.

— Nuk di unë ç'janë venluzat... — u prek Taushi. Ai u ktheu shpinën dhe u mbështoll në botën e vet. Po nuk mund të rrinte shumë ashtu. U kthye dhe i hodhi një vështrim përgjërues Denit.

— Aman, Den, se plasi... — tha mjeku,

Deni qeshi. I shtrëngoi qafën Taushit, pastaj qeshi prapë duke u kujtuar se kishte thënë që «as derri nuk duhet quajtur «dosë»...»

Deni u shtri në shpinë dhe vështroi qiellin. Ishte lumturi që i kishte përbri tani ata të dy! Taushin e kishte afruar vonë, me mjekun kishte kaluar fëmijërinë. Ai mendoi në atë çast se nuk kishte gjë në botë të prishte miqësinë e tyre, megjithëse mjeku kishte parashikuar një stuhi. Ai kishte thënë që rrëziku i tyre mund të ishin vetëm gratë, martesat! «A nuk rrimë beqarë më mirë?» — ishte hedhur Deni.

Shiko! Ata e ndanë plazhin — tha mjeku duke treguar kambalecat që po vendosnin ata të filmit.

— Vemi të shohim... — tha Deni.

— Nuk është serioze! — vërejti doktor Marku.

— E çfarë është serioze kur shtrihesh në plazh?

— pyeti Deni. Ai u kthye dhe kërkoi rrobat.

— Nuk më the ç'bëhet andej nga ju? — e pyeti mjeku më shumë për ta mbajtur aty.

Deni vuri buzën në gaz. Gjithë moloja kishte bërë shaka me të kur ishte nisur të provonte fenerët. «Ej, Den! A po shkon të ndërrosh boat? A ke harruar që janë me elektrik?» — i kishin thirrur. Ai qe shtyrë me sandall në 40 metra ujë dhe kishte hedhur fenerin. As ishte thyer, as kishte futur ujë. Mrekulli!

— Po të ishte thyer, do ta bëje prapë! Tridhjetë herë do ta bëje, se të lëvrin krimbi dhe ie kokëderr! Shumë mirë që je kokëderr... — tha mjeku. Më tej ai pyeti se si ishte e mundur që nuk po zinin peshk. Mos e kishte humbur pusullën Karakolli?

— Ndoshta kështu është më mirë... Nuk jam egoist dhe më dhimbset Karakolli, po miti i tij duhet thyer! — tha Deni i menduar.

— Gabim! Nuk duhet thyer, po duhet bërë e qartë për të gjithë mbi ç'bazë qëndron ai mit! — mjeku u ngrit ndenjtur. Ai vazhdoi të fliste gjatë për Karakollin. Në fund tha se ishte si një obelisk i thjeshtë, që përjetësonte një kohë të caktuar. Ky obelisk mund të shtohet me një kapitoll barok, të plotësohet dhe të modernizohet dhe kjo do të ishte e reja, shkencën...

— Je pak i ngatërruar, megjithëse po mundohem të të marr vesh. Ti kërkon një shkencë të mbështetur mbi traditën, po mund të ketë shkencë edhe jashtë saj...

— A nuk ngrihem më mirë? Edhe ti i ke sytë andej nga shkoi Taushi! — tha mjeku.

Pas kambalecave prej druri rrinin kureshtarët, ndërsa ekipi i filmit ishte brenda tyre. Kishin një hapësirë të madhe plazhi përpara dhe i kishin larguar nga deti edhe ata që laheshin. Po shtyhej dielli drejt perëndimit dhe shumica e njerëzve kishin ikur nga plazhi. Ishte një kohë e mrekullueshme për të xhiruar.

— Paskan edhe prift me mjekër... — tha Taushi.

— Heshtni! — Regjisori dëgjoi edhe pëshpërimën e Taushit. Ai priti me megafon në dorë gjersa humbën tej aktorët. Herë pas here ai ngrinte gjer te goja megafonin dhe e ulte pastaj i pavendosur.

— Sa nervozë janë këta të artit... — nuk iu durua prapë Taushit.

— Gati? — u kthye regjisori nga ata të kamerës.

— Gati! — u përgjigj njëri prej tyre.

Regjisori tani ishte në kulmin e tendosjes.

U ndezën projektorët. Drita e tyre u shtri jo shumë larg bregut.

— Stop! Prapësohu! Drita është keq! Keq! Si do të filmojmë në det pa dritë? Rregulloni projektorët, ju marrtë djalli! — bërtiti ai.

I ndreqën projektorët, i provuan dy-tri herë. Drita e tyre shtyhej mjaft larg në det dhe regjisori mbeti i kënaqur.

— Gati! Fillo! — urdhëroi ai.

Kamera lëvizi paralel me bregun nga po vinte një malësore e re e veshur me xhubletë të rëndë. Ecte ngadalë, me shqetësim dhe me një hutim që i lexohej mjaft mirë në fytyrë.

— Bukur! Përpara! Përpara! — tha i kënaqur regjisori.

Malësorja vazhdoi të ecte duke e shtuar tensionin e lojës së saj. Ajo ishte e qeshur, e ngazëllyer nga bukuria e natyrës, e maleve dhe e detit në mënyrë të veçantë. U ul në breg dhe zgjati dorën drejt ujit!

— Stop! Jo! Jo! Malli yt është gati tragjik për detin që e ke pasur nën këmbë dhe nuk e ke prekur me dorë dhe nuk e ke shijuar kurrë! Ti duhet të zgjatësh dorën si drejt diçkaje të shenjtë dhe njëkohësisht ta tërheqësh sikur të kesh prekur zjarrin! Mos harro se lufton mes dy të kundërtave dhe je mes dy të kundërtave! — i foli me zjarr regjisori.

Aktorja e përsëriti skenën. Ajo e shtriu dorën drejt detit si drejt diçkaje të ndaluar. U kthye natyrshëm të vështronte mos e kishte parë njeri, pastaj mbushi pëllëmbën me ujë dhe ia hodhi fytyrës. Pikat e ujit sikur qëndruan në pushin e fytyrës së saj tërë gjallëri. Pastaj ajo sikur u kujtua për ndonjë mëkat, e tërhoqi dorën dhe e rrsi në gj.

— O Xhike, sa bukur! — pëshpëriti Taushi, po me sa dukej ai nuk ishte në gjendje të arrinte gjer tek e bukura që kërkonte regjisori që e ktheu rishtas aktoren.

— Mirë! Shumë mirë! Vazhdo! — u entuziazhua regjisori. Ai u kthye dhe kërkoi tani nga të gjithë një heshtje absolute.

Deti rrihte bregun.

— Si je kështu? — i tha detit aktorja sikur të zbulonte diçka të mahnitshme. Ajo e ktheu fytyrën ku dukej një trazim i madh bashkuar me të papriturën që i shkaktonte deti.

— As të di sa je i thellë, as të di sa je i rëndë...

— vazhdoi aktorja me një ton tragjik. Ajo bëri dy hapa ngadalë, pastaj qëndroi me dorën në mjekër.

— As të di kur je i gëzuar, as të di kur je i zemëruar... — vazhdoi aktorja me një ton tragjik. Ajo bëri dy hapa ngadalë, pastaj qëndroi me dorën në mjekër.

— As të di kur je i gëzuar, as të di kur je i zemëruar.. — pëshpëriti ajo. Tani ajo ishte e menduar dhe dişi e lëshuar, po nuk vonoi gjatë kështu se sytë e saj u gjallëruan gradualisht gjersa u dukën krejt të ndezur nga një dëshirë e beftë. Tek ajo sikur u ndez shpirti kryengritës, sikur u ndez diçka që e kundërshtonte gjithë qenien e saj të mëparshme dhe e shtynte të bënte diçka të pabërë. Ajo filloi të zhvishesh me ngadalë dhe me drojë.

— Këtu diçka ka... — pëshpëriti Taushi.

Aktorja e lëshoi përdhe xhubletën e rëndë dhe mbeti në këmishë. U afrua tek uji me ngadalë dhe zuri të shtyhej në det.

— Stop! Jo! Njëqind herë jo! Gjer tani ishe e mrekullueshme, tani hiç... Si futesh ashtu në det, sikur të ishe paradreke në plazh? E di kush je? Je një malësore e paraqlirimit që ta kanë mohuar detin, siç të kanë mohuar shumë gjëra të tjera! Deti ishte mallkim për femrën e maleve! Ti po prek mallkimin me këmbë! Sa është i rëndë mallkimi i kishës dhe sa është e madhe dëshira jote për të provuar atë që ta kanë mohuar me të padrejtë? Për kishën ishte turp të lahesh, po ti gjithnjë je çuditur si mund të ishte turp të lahej njeriu në det! Ti je e fejuar! Ç'do të ndodhte po të vinte ai këtu dhe të të gjente në këmishë? Mendoji dhe luaji të gjitha këto! — tha regjisori duke folur gjithnjë shumë shpejt. Ai u afrua dhe i rrahu shpatullat aktorese. Duke u kthyer, i ra në fytyrë drita e projektorëve e flokët e tij të thinjur shkëlqyen si argjend.

— Këtu diçka ka... — pëshpëriti Taushi me zë të ulët. Deni i bëri shenjë të heshtte dhe ai e mbylli gojën. Aktorja iu afrua detit. U kthye dhe vështroi malet.

U kthye prapë nga deti... Prapë nga mali. U fut gati praptas në det si të donte t'u largohej atyre maleve që i kishin mohuar shumë gjëra. U kujtua që ishte futur në ujë dhe doli nga deti sikur të kishte ndeshur në diçka të mallkuar. Pa xhubletën që kishte mbetur në këmbë si ndonjë kambanë që bëhej gati të jepte gjëmën. Vuri duart në gjoks me turp, ndërsa tutje erdhi një zhurmë dhe një rropamë e madhe. Malësorja u tremb dhe mbeti midis ujit dhe xhubletës. Gjithë qenia e saj ishte në mes ujit dhe xhubletës... Sa më pranë vinin të thirrurat dhe zhurma, aq më në breg shtyhej malësorja. Ajo kishte hyrë në ujë gjer në gju dhe nuk po kujtohej për ujin. Kishte hyrë në ujë gjer në brez dhe nuk po kujtohej për ujin... Kishte hyrë gjer në fyt dhe nuk po kujtohej për ujin... Ja bëhen malësorët. Të egër, të paarsyeshëm dhe të prirë nga një njeri që as dukej i egër, as i paarsyeshëm. Ky ishte prifti. Ai ishte i ftohtë, po ftohtësia e tij digjte! Ai ishte i lakueshëm dhe gati për çdo kompromis paqësor, po ky ishte një mesazh krejt tjetër për malësorët që thërrisnin dhe bënin me shenjë nga ajo që ikte në det. Ata sikur nuk e kishin me atë. Zemërimin dhe llahtarinë e vërtetë e kishin me xhubletën që kishte mbetur aty në mes të rërës si dëshmi e një ligji të përbuzur dhe të flakur. U dukën një plak dhe një malësor i ri. Ata duhet të ishin në mes të kamerës. Ata ishin aq të humbur pas lojës së tyre që e kishin marrë me shumë tension, sa nuk shihnin dorën e regjisorit që u thoshte të shtyeshin më tej, aty ku ndaheshin nga masa e malësorëve dhe mbeteshin para hallit dhe turpit të tyre. Ishin të dy të turpëruar. Ata e shkelën xhubletën, e përdhosën, e këthyen në një leckë të ndragur. Ajo nuk mbulonte më virgjërinë, mbulonte turpin! Po turpi kishte dalë sheshit dhe ikte nëpër det... Ata u kujtuan që turpi ikte nëpër det dhe shtinë të vrisnin turpin... Përmes drifës së projektorëve dukej e zhdukej koka e malësorës që shtyhej thellë në det. Tani të gjithë malësorët shtinin kundër saj, po përpara

se të arrinin gjer aty të gjithë kishin kaluar sipër asaj leckurines që dikur mbulonte virgjërinë.

— Nesër atë do ta mbledhin pastrueset e komunales... — pëshpëriti mjeku dhe shkaktoi trazim. — A mund të lidheshin dy kohë kështu siç kishte bërë ai?

— Xhubleta është e rekuizitës dhe nuk i takon komunales! — vërejtë Deni me njëfarë tensioni.

— Kjo është historia e Marës... — tha mjeku një gjë që dihej.

— Është historia e shtypjes së personalitetit! — tha Deni.

— Heshtni! — tha regjisori vetëm për forcë zakoni, se xhirimi kishte mbaruar. Aktoret i kishin hedhur një peshqir të madh dhe po e fërkonin me nxitim. Ishte errur, po cepi i plazhit ndriçohej mirë nga projektoret që kishin varur kokat. Poshtë rrinin aktorët dhe figurantët e mbledhur andej-këndej. Ata pinin duhan pa thënë asgjë.

Regjisori i futi krahun një gruaje të re dhe tepër të gjatë që gjithë kohën kishte ndenjtur mënjanë.

— Skenari të ka sukses! Më dëgjo mua! I sheh si heshtin të gjithë? I ke bërë të mendohen...

— Ajo është historia e Marës... — tha Deni padashur duke dëgjuar regjisorin.

— Historia e shumë Marave të asaj kohe, mor shok... — u kthye përgjysmë skenaristja pa vlerësuar atë që tha Deni.

— E shumë Marave po edhe e një Mare që e kemi këtu! — nguli këmbë Deni.

— Mundet... — tha skenaristja dhe u largua me regjisorin.

— Pritni! Ajo vjen vit për vit nga Kukësi dhe, me të arritur, hyn me gjithë rroba në det! Një herë kur vjen dhe një herë kur ikën! — tha Deni me dëshpërim. Ai i pa që nuk ia varën ata të dy dhe u skuq.

— Ç'ke kështu? — e pyeti mjeku i shqetësuar.

— Ç'ka? Ta kem unë një herë në dorë atë llaqipen e t'ia shtrydh hundët? Uthull i nxjerr, për

shpirt të Xhikes! Ajo të mos m'ia varë djalit? —
u revoltua Taushi.

— Nuk e di si mora zjarr... — tha Deni.

— Mara është në një fis me Gjon Kabashin. Kur
e mallkoi prifti, as fisi i tij nuk e pranoi. Thonë që
dikush e gjuajti edhe me gurë...

— A dini kush ishte ai plaku që shtinte me pushkë?
Kishte për të qenë gjyshi i Ndoc Markut! — tha mje-
ku.

— Ah! — bëri Deni duke kujtuar atë thikën e
ngulur në palmetë.

U fikën projektorët. Nga larg erdhi zëri i regji-
sorit që porosiste aktorët të mblidheshin tek auto-
busi. I hoqën edhe kangjellat dhe bashkë me to, si-
kur u largua edhe imazhi i rëndë i atij xhirimi.

— Kështu ikën edhe filmi, sikur nuk qe asgjë...
— qeshi mjeku.

— Nuk qe asgjë? Ju jeni të pashpirt! — tha Ta-
ushi. Ai sa vinte dhe e ndiente më shumë atë që kishte
parë.

— Ej, ej! Mos fillo të qash... — i tha Deni me të
mirë. Ai e kishte parë Taushin të qante në kinema e
në televizor.

Taushi vuante me gjithë mend.

Deni i dha një cigare, pastaj pyeti ku rrinte Mara
kur vinte këtu.

— Te kumbara e të shoqit! — tha mjeku.

Taushi u iku pa u thënë gjë. Iku me njëfarë revol-
te..

Ajo ishte një grua e pasjellshme... — tha Deni
për skenaristen. Nuk e hiqte dot nga mendja.

— Shkrimtarëve nuk u pëlqejnë rastësitë! U nxje-
rrin telashe! Prandaj iku ashtu.. E di ç'po mendoja?
Sikur të bashkohej Mara me Pashk Lulin dhe Kara-
kollin, do të ishte terceti më anakronik në botë...

— Ndoshta nuk ke të drejtë. Marës i njohim ve-
tëm një epokë, nuk dimë ç'ka bërë në kohën tonë,

ndërsa ata dy të tjerë.
kohe.

— hedhur pas kabinës, — tha

— Po, a nuk janë anakrud se ato ditë që ata ishin

— Do të thosha më shumë, sjellë peshk sa për gj-

— Po shkoj t'i jap daltës! — tha
rë në sy. Ai për pak se nuk i tha ture të madhe kur
Rashën si model. ntuar limbjotën!

— Ti daltës, unë provimeve! I kam të çast nuk e
shtator! — psherëtiu Deni. Ai mendoi që punën, po
të mbyllej në atë të ndarën e ambulancës që it të pu-
kthyer në një studio të vogël, do t'u vinte bata. sukses
xhamave për të mos e shqetësuar dhe do të punon
me qejf. Prej aty mund të tundej vetëm për ndonjë
urgjencë.

Në farmaci kishte dritë. Deni e kaloi atë, pastaj
ndërroi mendim dhe u fut brenda. Rasha numëronte
paratë. Ajo nuk e ngriti kokën kur hyri ai. I kishte
ndarë paratë veç e veç dhe i krahasonte me recetat
që kishte bërë.

— Kështu e ndan peshkun edhe Gjon Kabashi....
deshi të bënte shaka pa të keq Deni, po edhe kësaj
radhe ajo nuk tingëlloi mirë.

Rasha ngriti kokën dhe e pa me qetësi.

— Çudi.. Asgjë nuk të turbullon më! — tha De-
ni që ishte turbulluar për vete.

Rasha nuk i ktheu përgjigje.

— Taktika e heshtjes është e njohur... — u inatos
Deni.

Rasha vazhdoi të heshtte. Deni nuk mund ta merrte
me mend që ajo në atë çast kishte dëshirë të qeshte,
të qeshte me të madhe, po përnjëherësh kishte dë-
shirë edhe ta zbonte, ta nxirrte jashtë dhe t'ia mbyllte
derën në surrat.

«Nuk e di pse i bie në qafë! Nuk di ç'kërkoj...» —
tha me vete duke e mbyllur edhe atë takim me Rashën
si gjithë takimet e tjera.

XIV

U ngjit në anije me njëfarë boshllëku dhe mërzie. E kishin provuar tri net me radhë elektrolinjën vertikale dhe nuk kishin zënë gjë. Megjithatë askush nuk ishte ankuar, askush nuk ishte tallur. Deni e kishte pritur furtunën nga motoristi, po ai qëndroi tërë kohën pranë motorit dhe nuk i kishte dalë në sy kryeinxhinierit. Kishin ndenjur pothuaj zgjuar ato tri net, duke bërë sikur punonin me ata regjistrat e vjetër të lundrimit dhe duke e pasur mendjen në tridhjetë metra thellësi, gjer ku arrinte llamba e fundit e elektrolinjës. Natën e tretë Karakolli kishte kaluar si hije pranë tyre andej nga bashi i anijes dhe kishte lëshuar një fjalë: «Është ende ftohtë dhe sardelja është ngjitur lart.» Nuk e vlerësuan atë që tha ai dhe kjo iu kujtua Denit tani ndërsa ngjitej në anije. Kishte dikhë të shtruar në Tiranë dhe kishte ndenjur dy ditë andej.

«Fenerët e mi do t'i kenë hedhur pas kabinës, — tha me vete duke sjellë ndër mend se ato ditë që ata ishin kthyer bosh, anijet e tjera kishin sjellë peshk sa për gjithë muajin.

Ai u ndodh përpara një të papriture të madhe kur doli pas timonerisë. Pas saj kishin montuar limbjetën! Nuk u besoi syve. Ndjeu kënaqësi dhe atë çast nuk e pa aspak si një mjet që do t'u lehtësonte punën, po si një element të ri që i shtohet modernizimit të punës dhe që e shtynte të besonte se do të kishte sukses çdo gjë e re që do të hynte në anije.

— Kur e vunë? — pyeti Deni.

— Ndërsa ti bridhje në Tiranë, ne montonim limbjetën, o xhan! — tha Taushi. — E di si shkoi, o shpirti i Xhikes? Vjamë rosaku...

— Dhjamë rosaku, të marrtë djalli! — tha Deni që erdhi përnjëherësh në formë.

Deni kishte dalë pas timonerisë të shihte se ku e kishin degdisur elektrolinjën e tij. Ai kishte pasur frikë të pyeste për të, kishte pasur frikë të pyeste se me çfarë elektrolinje do të gjuanin atë natë. Kryeinxhinieri nuk kishte ardhur me ta dhe kjo nuk ishte shenjë e mirë. Me të kërcyer në anije, Deni i kishte vështruar të gjithë me radhë me vëmendje, po nuk kishte arritur të zbulonte gjendjen e tyre shpirtërore. E dinte që ishin të mërzitur dhe s'kishte si të ishte ndryshe kur nuk kishin zënë asgjë në kulmin e prodhimit. Nuk ia zuri syri Karakollin dhe mendoi se që ngjitur atje në majë të malit për të nuhatur peshkun.

Karakolli lexonte për të tretën herë letrën e të birit. Rrinte në bash dhe lexonte me zë të ulët duke i ndarë fjalët nga njëra-tjetra me pauza mjaft të gjata. Kishte pak erë dhe ajo e kishte fryrë si velë letrën që mbante me të dyja duart Karakolli. I biri merrej me mundje dhe do të vinte në Krujë nga gjysma e korrikut në kampionatin e reparteve të marinës. Ai e pyeste të atin nëse mund të takoheshin atje. Kishte

mbushur plot katër faqe me një shkrim të imët.
— Edhe dhjetë faqe duhet të të shkruajë pizeven-
gu! I ke bërë pallat me pesë dhoma! — tha Taushi.

Karakolli u kthye nga Deni.

— E di si duhet të jetë një fëmijë? Duhet të jetë
një vazhdues...

Deni buzëqeshi. «Vazhdues» ai i thoshte trashëgim-
tarit. Po a ishte kështu djali i Karakollit?

— Nuk e ka mendjen te deti! — tha Karakolli.

Ecnin normalisht dhe pothuaj i ishin afruar vendit
ku kishin për të bërë rrethim, kur u dëgjua një shpër-
thim nga bregu.

— Dinamit... — pëshpëriti Karakolli. I shpëtoi let-
ra nga dora dhe era e hodhi në det. Ai u shndërrua
përnjëherësh në një qenie të vuajtur dhe të llahtar-
shme, në një furi deti dhe njëkohësisht në njeri për t'u
dhimbsur. Sytë i kishin kërcyer jashtë, ndërsa nofullat
i kishin humbur në gojë.

— Dinamit... — përsëriti ai me atë zërin tragjik
me të cilin lajmëronin gërbulën në mesjetë.

U ngjiten të gjithë në kuvertë. Mos po luante mendsh
Karakolli?

— Stop! O shpirtin, o atë me dinamit! — tha Ka-
rakolli.

E mbajtën anijen. Karakolli zgjati dorën nga bregu.

— A e shihni skallinën? Ia dha detit kolerën... —
tha ai, duke treguar atë njeriun e zhveshur në breg.
Mund të ishte gjysmë milje larg dhe ai që e kishte
hedhur dinamitin dukej qartë.

E panë të hidhej në det dhe të nxirrte peshkun e
vrrarë. Kishte diçka groteske dhe primitive në veprimet
e tij, diçka që të kujtonte gjahun e njeriut të parë, zhy-
tej, nxirrte dorën dhe e hidhte peshkun në breg...

Kapitani hodhi një raketë andej. Ajo ra fare
pranë tij. Ai doli në breg dhe vështroi për një çast
anijen pa u trazuar, pastaj u përkul, seç bëri në breg
dhe e panë të ngrinte dorën dhe të flakte diçka në det.

— E hodhi prapë... — belbëzoi Karakolli. Ai kishte mbetur gati pa frymë.

Një krisme e mbytur buçiti nga bregu dhe u ngrit një shtatërvan uji.

— Ta kapim! Jepi motorit! — urdhëroi kapiteni. Motoristi nuk luajti nga vendi.

— A nuk dëgjove? — iu kthye kapiteni.

— Dëgjova, po për andej nuk e ndez motorin!

— Mor, je në vete, apo jo? — tha kapiteni duke vështruar të tjerët.

Atëherë motoristi shpërtheu gjithë vrerin që e kishte mbajtur tërë javën. Ç'nuk tha dhe ç'nuk talli dhe përbuzi! Ku donin të ktheheshin? Kishin gjithë atë kohë që nuk kishin parë një bisht sardeleje kur të tjerët po bënë namin! Ku do ta hidhnin firmën atë pesëmbëdhjetëditësh? Emrat e tyre ishin fshirë nga borderoja! Ishin harruar! Ishin bërë nul për hatër të shkencës dhe shpikjeve të kryeinxhinierit me shokë...

Ai bëri përshtypje të keqe te të gjithë.

— Ndiz motorin, përndryshe e ndez Deni dhe nesër ti nuk vjen më me ne! — tha kapiteni me qetësi.

— Urdhërove ti? E ndez! The ti? E ndez! Ti je zot këtu! — u hallakat motoristi dhe zbriti poshtë.

Kapiteni u ngjiti te timoni dhe e ktheu anijen me një manovër të shpejtë dhe të shkathët që i dha kënaqësi Karakollit. Atë e thyente vetëm mjeshtëria, zotësia e të tjerëve dhe asgjë tjetër!

Anija mori nga bregu me tetë milje në orë. Ai në breg nuk u kujtua përnjëherësh dhe vazhdoi të nxirrte peshqit nga uji. Kur u kujtua, i la peshqit, rëmbeu rrobat dhe ia dha me vrap poshtë bregut. Ishte i detyruar të ikte paralel me detin, në një rrip të ngushtë që kishte lënë mali. Në mal nuk mund të ngjitej, se ishte zonë ushtarake. Nisi kështu një duel mes njeriut që vraponte në breg dhe anijes që vraponte në det. Njeriu ia dilte herë-herë të largohej tridhjetë-dyzet metra, pastaj nuk ishte në gjendje më të vraponte me të njëjtin ritëm dhe anija e arrinte. Megjithatë ai asnjëherë

nuk mbeti prapa saj dhe kjo ishte e vetmja gjë për të cilën mund të lavdërohej ai maskara.

Tani anija nuk ishte më larg se 100 metra prej bregut. Më tej nuk mund të afrohej se ishte cektinë! Ai që ikte dallohej fare mirë në muzgun që po binte. E kishte mbuluar djersa dhe ankthi. Ikte si egërsira që e ndjekin langonjtë, ikte si një prè që vrapon vetëm për instinkt. Kthente kokën herë pas here nga anija me një ndjenjë tmerri dhe çudie. Kurrë nuk ia kishte marrë mendja që gjithë ajo anije do ta linte punën për t'u marrë me të.

— Kush e njuh maskaranë? — pyeti kapiteni.

Atë që ikte nuk e njihje askush.

— Tash e marr vesh... — pëshpëriti Karakolli.

U kthyen nga ai.

— Gjithë këtë javë dikush u ka shitur plazhistëve peshk të madh. E pashë peshkun dhe thashë me vete se edhe ne morëm fund! Kemi marrë peshk për vete dhe për ndonjë mik, po për ta shitur nuk e kemi shitur kurrë! Kush e shet peshkun, merr fund dhe mendova se na erdhi fundi edhe neve! Peshku ishte i prishur vende-vende! «Prej fuzhnjës!» — kishte gënjyer ai që e kishte shitur. «Nuk ishte prej fuzhnjës, po prej dinamitit!» — tha Karakolli. Ai shtoi që nuk ishte peshkatar ai që e bënte këtë punë, po ndonjë matrapaz...

— Të marrim sandallin! — tha kapiteni.

— Të fitojmë edhe pak udhë... Kërcejmë në det dhe kapemi pas sandallit për të qenë përpara tij! — tha Deni.

Pas dhjetë minutash kërcyen në det Pali, Deni dhe Taushi. Ky nuk vlente një dysh për të vrapuar, por, për t'u dhënë rremave, ishte si një makinë me avull. Sandalli i afrohej me të shpejtë bregut. Ai që vraponte qëndroi si i trullosur në vend. U kthye prapa, u kthye përpara, edhe një herë prapa dhe zuri të vraponte në drejtim të kundërt.

— Ç'frymë që paska qeni! — tha Deni. Ai i jepte

lopatës bashkë me Pashk Lulin dhe mezi balanconin të shtyrën e Taushit.

— Ka frymën e frikës... — tha Pali.

Kërceyen në breg. Ai që ikte tani mezi i hidhte hapat dhe ata të tre e ndienin frymëmarrjen e tij të rëndë. E zunë pas një vrapimi të shkurtër dhe ai u shemb përdhe.

— Nga je, mor derr! — i ra me shkelm Taushi.

— Lëre! — e largoi Deni.

Ai përdhe nuk ishte në gjendje të përgjigjej. Kishte marrë fund.

— Fol! Se për të vrapuar vrapoje si derr! — nuk iu nda Taushi.

— Ç'do të bëjmë me të? — pyeti Pali.

Deni mbeti. Vërtet, ç'do të bënin me të?

— Ky do një dru të mirë dhe...

Deni e largoi prapë Taushin që atë mbrëmje kishte vetëm shenja agresiviteti. E pyeti atë që kishte mbetur përdhe nëse kishte pasaportë.

— Nuk e kam marrë! Më thonë Pjetër Hasku dhe jam kooperativist prej Galanit... — u përgjigj ai.

— Nuk dukesh si kooperativist... — tha Deni.

— Nuk je prej Galanit! Ûnë i njoh burrat e moshtës sate në Galan! — tha Pali.

— Mos më merrni në qafë! Peshkun e desha për dasmën e tim vëllai...

— E deshe për dasmën e plazhit! — kërcëu Deni duke kujtuar Karakollin.

— Kushdo gabon një herë... — tha ai i dinamitit. Ai ishte rreth të tridhjetave, shtatflartë dhe me mësataqe. Dukej kapadai dhe përmbahej me zor.

— Ç'do të bëjmë? — pyeti Pali duke vështruar me sy të vrenjtur peshkun e ngordhur të shpërndarë në rërë. Ngjante sikur të kishte ndodhur një katastrofë ekologjike dhe të kishte hedhur natyra jashtë gjirit të saj qeniet e gjalla.

— Do ta marrim me vete! — tha Deni.

— Nuk keni të drejtë! Nuk jeni as polici, as kufi!

— kundërshtoi tjetri.. Ai deshi të ikte, po Taushi e mbërtheu në vend.

— Më lëshoni! Humbas turnin e punës...

— Ta kishe menduar kur hodhe dinamitin! — iu përgjigj Deni.

— Mora dy llokume kur hapëm transhetë! Unë...

— Bjere në sandall! — i tha Pali Taushit.

Taushi mbeti. Ishte përkulur të mernte një nga ata peshqit ë ngordhur. E hodhi peshkun përdhe nën vështrimin e Denit. Fshiu duart pas pantallonave dhe i dha një të shtyrë atij të dinamitit.

— Do të ma paguani! — tha ai.

— Njëherë do të paguash ti, pastaj shohim e bëjmë! — u zemërua Deni.

Erdhën dhe e ngjitën në anije. Deni e pa Karakollin që i hodhi një sy, pastaj u kthye sikur ta kishte kafshuar diçka.

Motoristi me Taushin e tërhoqën te direku dhe deshën ta lidhnin, po ai kundërshtonte dhe shante. Ndërhyri kapiteni.

— Lidheni! — u dëgjua zëri i vendosur i Karakollit, që rrinte gjithnjë me shpinë.

Ai i dinamitit u këput me të dëgjuar Karakollin. Uli kokën dhe nuk kundërshtoi më.

— Qen i poshtër! — iu turr motoristi.

— Askush të mos e shajë, se bëhet nami! — tha Karakolli.

Motoristi e pa me inat.

— Sikur po na vërtitet garbini...¹⁾ — tha ai për të dalë nga ajo gjendje.

— Taush! Lëreni atë! — urdhëroi kapiteni.

— Jo, për të gjallë! — ndërhyri Karakolli.

— Karakoll! Unë të nderoj, po për anijen përgjigjem unë! Merreni dhe futeni në kabinën time!

— Sa mirë! Sa mirë... — zuri të thoshtë Taushi

1) erë e rrezikshme në det

me dhembje. Ai kishte ndryshuar përnjëherësh dhe i vinte keq për atë të dinamitit.

— Hajde, pelte! — iu shkreh motoristi Taushit.

— Kështu është më mirë... — u qetësua kapiteni kur e zbritën poshtë atë të dinamitit. Pastaj ai u kthye nga Deni dhe pyeti nëse bënte ta linin për atë natë elektrolinjen vertikale. Gati gjithë pesëmbëdhjetëditëshin e kishin bosh,

— Jo! — tha me energji Pali.

— A e keni të gjithë këtë mendim? — u hodhi një vështrim Deni.

— E shohim veten keq kur dalim në mol... Na duket se dalim lakuriq! — ndërhyri Karakolli. Ai i mban-te sytë poshtë. E kishte inatosur kapiteni.

Denit se si i hipi inati. Nuk kishin zënë gjë as përpara se të merreshin me elektrolinjen.

— Pse nuk hip në shkëmb atëherë? — iu kthye Karakollit.

— E merr vesh kur të bëhesh sa unë... — ia ktheu tjetri me të butë.

— E fyeve... — i pëshpëriti kapiteni Denit.

«E fyeva? Mor, pse nuk thua që e qelba krejt!» — tha Deni me vete. Më tej ai mendoj që nuk bënte të niseshin për gjueti dhe të ktheheshin kaq ditë pa gjë. Nuk shkonte. I tha Palit të shtrinte elektrolinjen e zakonshme.

— A do ti? Ka marrë fund! — tha Pali për çudinë e të gjithëve. Megjithatë dukej që nuk i pëlqente.

Deni zbriti në palmetë. Karakolli ishte ulur në tryezë ku ishin grumbull regjistrat e lundrimit, që po pësonin një martirizim pa fund. Hanin bukë dhe i hidhnin mbi shtretër. Rrinin në të djathtë të tryezës dhe i shtynin në të mëngjër. Uleshin dhe i largonin tutje për të mbështetur bërrylat kur shihnin televizorin, i ngatërronin dhe i rrëzonin përdhe gjersa të vinin kapiteni me Palin dhe Denin që turfullonin gjersa t'i rreshtonin sipas viteve.

Karakolli ishte me shpinë nga ai. Deni pa shpinën e tij dhe thikën e Ndoc Markut që rrinte ende ngulur

në tryezë gjer në dorezë. Deni ishte tronditur kur e kishte parë. Mos e kishte lënë si një kërcënim dhe paralajmërim për të dhe të tjerët ai njeri i heshtur? «Atë ditë e ka harruar, pastaj nuk ka dalë më në punë. Është sëmure», — i kishte thënë Denit kapiteni. «Mund ta ketë harruar, po edhe mund të mos e ketë harruar...» — kishte vërejtur Taushi që, qysh se ishte ngulur ajo thika aty, e hante bukën në prehër mbi shtrat.

— Ej, Den... — e njohu Karakolli.

Deni mbeti. Rasha e njihte nga të ecurit, Karakolli e njihte nga të ecurit... «Kush të njeh pa të parë ose të do fort, ose të urren fort», — kishte thënë njëherë Pashk Luli.

Deni u ul përballë tij. Në mes tyre ishte thika dhe të dy e ndienin që ajo nuk shkonte aspak.

— Deshi ta hiqte ai elefanti, po nuk e la kapiteni. Ai që e ka ngulur, ai do ta heqë, i tha kapiteni... — foli Karakolli.

— Unë e qelba me të si e qelba me ty, Karakoll...

— Ti ia kalon tim biri... — tha rëndë Karakolli.

— Pse? — u gjend ngushtë Deni.

— Je si unë... — tha Karakolli.

Deni u mallëngjye. Karakolli e kishte ngushtuar aq shumë rrethin, sa e kishte afruar gjer te gjaku i vet... I sëmboi diçka në shpirt. A nuk ishte hedhur kundër Karakollit kohët e fundit? «Kundër peshkatarit Karakoll...» — e ngushëlloi veten. Po a mund të ndahej njeriu nga puna?

— Ju po e vrisni shpirtin me këto e nuk di si t'ju jap dorë... — tha Karakolli për regjistrat.

Deni uli sytë. Ai sikur po e dërrmonnte me qëllim, sikur po e godiste ku i dhimbte më fort.

— Karakoll! Të paçim! — i tha me gjithë shpirt.

Tjetri vuri buzën në gaz.

— Mos të të dukem engjëll. Se nuk më shkon mbas shpirtit gjithçka bëni ju, se unë jam mësuar ndryshe... Mendja dhe shkolla janë tuajat, po ec e

thuaja plakut! Jam shtatëdhjetë e tre jveç dhe këtë po ta them vetëm ty. Jetën e kam pasur tallaz-tallaz... Ju e keni ndryshe! Megjithatë nganjëherë më vjen t'ju puth, nganjëherë t'ju mbërthej për fyti. Kryeinxhinieri ka shkuar të marrë ato rasatet e peshkut e për këtë gëzohem, po, kur të vijë puna për ta hedhur në det, kam frikë se më del ndryshe...

— Jam i ri këtu, po më duket se ndërmarrja po merr për mbarë...

— Për mbrapsht mund të mbytet vetëm në det!

— Gjithnjë ke qenë me këtë anije druri?

— Qyshse erdhi!

— Pse?

— Druri nuk ka ndryshk dhe më ka shpëtuar edhe mua prej ndryshkut, — tha Karakolli duke vënë dorën në zemër. I pati hije ai gjest.

Deni u mendua. Vendi kishte rëndësinë e vet, po puna ishte kryesorja, puna nuk të linte të zije ndryshk! Ai u gëzua. E ndiente që gjer tani e donte punën... Ia tha këtë Karakollit.

— Kur e do tani, ke për ta dashur gjithmonë! — tha tjetri dhe u ngrit kur Deni shpresonte për një bisedë të zjarrtë.

Zbriti kapiteni duke fërkuar duart. «Ai i fërkon duart si priftërinjtë e filmave!» — hakmerrej motoristi kur nuk i plotësohej ndonjë kërkesë.

— Do të kemi peshk! — tha kapiteni.

— Shpejt qenka mbledhur... — pati njëfarë dyshimi Karakolli.

— Atëherë t'i grumbullojmë të gjitha anijet si nëndrejtori! — u entuziazhua Deni.

— E provova, po nuk që e mundur të lidhem me anije tjetër përveç «Jezercës! Mos na ka gjë radioja... Desha ta bëj edhe unë tym si Murat Nallbani!

— «Jezercën» nuk e kemi as një milje larg... — vërejti Karakolli.

Kapiteni e ftoi të hanin. Deni me Karakollin nxorën bukën e tyre. Të tre bënë sikur nuk e shihnin thikën e ngulur në tryezë.

— T'i japim diçka atij dinamitit, — tha Deni.
— Jo! — tha Karakolli.
— Sikur nuk e kemi mirë... — tha gjithnjë me dyshim kapiteni.
— Për të përgjigjem unë! — e pa në sy Karakolli.
— Për matrapazllëk e hodhi dinamitin? — pyeti Deni.

— Për budallallëk!
— Nga e di? — nuk iu nda Deni.
Karakolli nuk i ktheu përgjigje dhe Deni u ngjiti lart. Doli andej nga bashi dhe mbeti si i hutuar. Dy duar ishin kapur pas anës së anijes! Deni e mbajti frymën dhe iu bë të thërriste... I ishte dukur se po kapej pas «Pulëbardhës» një qenie amfibe...
— Pse dole nga deti? — e pyeti motoristin.
— Pashë elektrolinjën. Kishte një masë në motor...
— A e lidhe mirë sandallin?
— Ehu! Kujt ia kallëzon arat! — iku duke fishkëllyer motoristi.

Deni vështroi detin. Ishte i errët, i zi! Kishte dëgjuar të thoshin që, kur ishte kështu, nuk vononte të fillonte garbini. «Jezerca» ishte tutje dhe, për çudi, elektrolinja e saj kishte mbetur me një llambë. Deni u kthye andej nga ishte motoristi dhe u fut në palmetë.
— Elektrolinja e «Jezercës» ka vetëm një llambë! — tha.

— E pastaj? Edhe ciklopi një llambë ka... — deshi të bënte shaka kapiteni.

Deni mbeti keq. Vështroi motoristin. Ai rrinte me shpinë dhe përtypte ato farët e lulediellit. Deni mezi e duroi vështrimin e kapitenit.

— Asgjë! — tha ai dhe u ngjiti rishtas në kuvertë. U var jashtë anijes dhe zgjidhi sandallin. Te petromaksi ishte Pali.

— A ishte këndeje Zeqiri, Pal?

— Më foli për masë në motor...

— A t'u duk për masë?

— Nuk e di! Llambat nuk më kanë luajtur!

— Nga shkoi pastaj?

— U kthye... Ku ta dish? Është terr me të shti gishtat në sy! Po ku e ka hallin?

— Shihe «Jezercën»! Vetëm një dritë ka të ndezur...

Pali u ngrit në këmbë.

— A thua? — pyeti në mënyrë kuptimplote ai.

— Dyshoj... Merret vesh nesër! Dëmtimi mekanik dallohet...

— Njeri ziliqar është... — tha Pali. Ai e humbi drejtpeshimin dhe për pak sa nuk u përmbys.

Deni e mbajti.

— Gjithnjë kam menduar se do t'ia shohim sherrin një ditë... — tha Pali.

— Ika t'i them kapitenit.

Kapiteni u hutua. Pse i kishin borxh «Jezercës»? Ç'fliste ai Deni?

— Unë di vetëm që Zeqirin e kapin ëthet e forta kur na afrohen anijet e tjera në zonën tonë. Sa nuk u çmend atë natë që i grumbulloi nëndrejtori! Kjo punë mund të na përlyejë të gjithëve... Nesër e marrim vesh!

— Po qe e vërtetë, i kemi borxh «Jezercën»...

— Askujt nuk i kam mbetur borxh! — e ngriti kokën kapiteni me mërzi. Ai mori përsipër të gjithë anijen, për të mirë e për të keq, dhe kjo qe e bukur.

Deni u zgjua nga gërhimat e Taushit. Ishin shtrirë tek ktheheshin dhe kishin fjetur menjëherë nga lodhja. Edhe motoristi flinte. Edhe ai bënte gjumë të turbulluar, po nuk e kishte me të gërhitura. Fliste në gjumë dhe ndonjëherë imitonte zhurmën e motorit. «Mbase mund të jetë i keq, po nuk duhet lënë në të keqen e tij!» — mendoi Deni për të. Iu bë se diçka iu shemb në det, sikur u hodh dikush në det. Mbajti vesh dhe nuk dëgjoi tjetër zhurmë. Pastaj zuri të mendonte prapë për motoristin. Mendoi që nuk ishte marrë askush me të dhe e kishin lënë në të keqen e vet... U ngrit. U çudit ngaqë kabina e kapitenit ishte e hapur. Ai i dinamitit nuk ishte aty. U ngjit në kuvertë dhe vështroi detin. Ai i dinamitit notonte drejt bregut... Deni

kafshoi buzët dhe lajmëroi të tjerët. Si kishte mundur ta hapte derën?

— Hajde vigjilencë, hajde! — u skërmit motoristi.

— Ai nuk mund ta hapte vetë derën pa qenë mjeshtër! — tha kapiteni.

— Mund të ketë qenë mjeshtër... — pati shpresë të kotë për të mos përlyer ekuipazhin Deni. Ai nuk dinte ç'të thoshte, ç'të mendonte. Po ç'të thoshte? Ajo që ishte bërë, ishte bërë!

— Ti e dije kush ishte ai, Karakoll! — tha Deni me vendosmëri.

Tjetri deshi të largohej pa folur!

— Nuk ikën pa më thënë kush ishte! — e zuri për krahu Deni.

— Im nip! — tha Karakolli.

Deni e humbi. Ta kishte liruuar Karakolli? Ai deshi ta mbante lidhur! Megjithatë... Nuk guxoi ta pyeste. Pastaj Deni mbeti edhe më keq duke kujtuar ç'kishte thënë ai. «Të mos të dukem engjëll!»

«Pulëbardha» po vononte të shkarkonte. Kërkonin kapitenin, po ai qe fshehur dhe këtë e dinte vetëm Deni. Shefi i flotës dhe dispeçeri shanin e bërtisnin, po ata të «Pulëbardhës» ngrinin krahët. Nuk e dinin ku ishte kapiteni dhe nuk mund të shkarkonin pa të! Deni ishte hedhur te «Jezerca». «Shko dhe merre vesh punën pa i lënë të dyshojnë! Po u patëm borxh, e ndajmë prodhimin me ta!» — i kishte thënë kapiteni. «Po kështu del sheshit kjo punë», — kishte vërejtur Deni. «Do të ngulim këmbë pa dhënë shpjegime!» — kishte folur kapiteni. «Më duket si në filmat me kalorës...» — kishte buzëqeshur Deni. Po as ai nuk dinte rrugë më të mirë. «Pse ia këput kot? Ku hyjnë kalorësit në det?» — ishte ngutur tjetri pa e marrë vesh.

— Ç'ju gjeti? — i pyeti Deni ata të «Jezercës». Në bord ishin vetëm kapiteni i dytë dhe një peshkatar.

— Dogjëm katër llamba dhe bëmë pallë...
— Si i dogjët?
— Ta di, ia them vetes! — u përgjigj kapiteni.
— Mos bë të ndonjë masë?
— Më mirë na gjej ndonjë llambë gjersa të marrim tonat! — u hodh kapiteni.
— E di që kemi pasur, por...
— Por i kemi për vete! — ironizoi peshkatari.
— Ec pas meje! — mori përsipër diçka për të cilën ishte i pasigurt Deni. Po sikur të mos ia jepte kapiteni i tij?

Ai i dha dy llamba. Peshkatari iku i kënaqur.
— Si është puna? — pyeti kapiteni i «Pulëbardhës».
— Dysho sa të duash kur nuk vërtetohet!
— Prapë dyshon?
— Të them të vërtetën, dyshoj! — tha Deni.
— Edhe unë, megjithëse i them vetes të mos dyshoj!
— tha tjetri. Ai doli në kuvertë dhe iu desh të përballonte dispeçerin dhe shefin e flotës.
— Ngadalë... E filluam punën të shtunën dhe po e mbarojmë të dielën! — deshi ta kalonte me humor kapiteni...

U përmend e diela dhe Denit sikur i iku lodhja dhe mërzia. Nuk i kishte takuar të dilte në punë të shtunën dhe të punonte dhe të dielën.

— Ty të kërkojnë andej nga zyrat... — i tha Denit shefi i flotës.

— Kush më kërkon? — pyeti Deni me mërzë. Atij iu prish menjëherë ai mendimi për të dielën.

— Nëndrejtori, kush tjetër!

Megjithatë kudo ishte e diela, tek ata që lidhnin ngathët atë cimën, te zëtoristi që shtriquej, te çezma e molos që e kishin lënë gjysmë të hapur dhe rridhte me përtim...

— Urdhëro, shoku Murat... — tha Deni duke u hedhur një vështrim të tjerëve që ishin në zyrë.

— Ç'të urdhëroj? — pyeti ftohtë nëndrejtori.

Deni u skuq lehtë. Kishte tjetër njeri përpara dhe

jo Murat Nallbanin e asaj ditës te kallamishtet! Mendoj se ata duhet të kishin pasur ndonjë debat të fortë, që ishin të gjithë si të mpirë.

— Të kam thirrur unë! — tha kryeinxhinieri.

— Të kam thirrur edhe unë! — foli me ton shefi i kuadrit.

Deni u kthye nga njëri, pastaj nga tjetri pa marrë vesh gjë, pastaj ia nguli sytë sekretarit të Partisë që nuk dukej të dinte gjë.

— Të kam thirrur në zyrën time! — tha shefi i kuadrit.

— Shkojmë atëherë! — u inatos Deni.

— Pse nuk flisni këtu? — pyeti Samiu duke kërkuar me sy aprovimin e nëndrejtorit, po ai nuk e kishte mendjen aty.

— Na ka ardhur një shkresë nga SMT-ja që ju ngarkon me 1000 lekë të rinj për një dëmtim që është shkaktuar nga ju. Në shkresë thuhet që keni ikur ushtar pa bërë likuidimet dhe se keni mbajtur një qëndrim arrogant lidhur me problemin e mësipërm, — tha shefi i kuadrit.

— Ka një ngatërrim faktesh dhe kohe! Dëmtimi ka ndodhur dy javë pasi jam larguar unë. Ai që më zëvendësoi harroi të hiqte ujin nga karburatori dhe motori plasi nga ngrica. Jam sqaruar për këtë, po tani janë bërë disa ndryshime në administratë atje, prandaj nxjerr krye prapë kjo çështje, — tha Deni.

— Neve na duhet të mbajmë paratë dhe, veç parave...

— Nuk do të më mbani asnjë lek! — u zemërua Deni.

— Ne ekzekutojmë vendimin dhe ti, po deshe...

— A nuk duhet t'i vinte shefit të llogarisë kjo shkresë? — e ndërpreu sekretari i Partisë.

— Atij i erdhi, po këtu kishte edhe disa të dhëna morale dhe...

— Ç'të dhëna morale? — u ngrys Samiu. Ai nuk po përmbahej, megjithëse e dinte që nuk duhej të ndërhynte kështu.

— Ja, arroganca etj...

Po zemërohej. E kishte sinjalin lart mbi ballë, tek ato vetullat e kërleshura, po nuk kthehej dot prapa. A nuk po tregonte një zell të tepruar ai tjetrit për të demaskuar Denin?

— Mos do të buzëqeshnim ne po të na thoshin të pa-guajmë kot së koti 1000 lekë të rinj?

Deni ishte spostuar dhe i dukej se ajo shkresa kishte ardhur për Samiun.

— Megjithatë vendimi duhet ekzekutuar dhe pas-taj...

— Asgjë nuk duhet ekzekutuar, pa u sqaruar kjo punë! — e ngriti tonin Samiu që inatin më të madh e kishte me nëndrejtorin, që nuk po merrte pjesë në atë ngatërresë. Kishin shkëmbyer disa batuta mjaft të forta pak përpara. Ishte fjala për disa të dhëna që i ishin dërguar dikasterit nga kryeinxhinieri pa dijeninë e tij. Murat Nallbani kishte rrahur tryezën! E kishin mënjanuar dhe donin ta shtynin edhe më tej! Samiu e kishte kundërshtuar. A nuk i kishte lënë dorë të lirë nëndrejtori kryeinxhinierit? «Po e dini ç'vjen pas kë-tyre të dhënave? Vjen shtimi i planit!» — kishte shfry-rë Murat Nallbani. Ai e kishte pasur zakon të mbante rezerva, ndërsa kryeinxhinieri i kishte rënë drejt. «Më këni mënjanuar me qëllim!» — kishte vazhduar nën-drejtori. «Ke mënjanuar veten! — ishte përgjigjur Sa-miu. — Të veprosh kështu, është gabim. Shtetit i du-het treguar gjithë potenciali i ndërmarrjes!»

Shefi i kuadrit vështroi nëndrejtorin. Nuk pati asnjë përkrahje. E palosi shkresën dhe e futi në xhep.

Deni vështroi kryeinxhinierin.

— Flasim një herë tjetër! — tha ai.

— Ma thoni tani, se një përrallë e dëgjova dhe kjo tjetra...

— Përrallë! Fjalë e rëndë! — vërejti Samiu.

Deni iu duk se pas asaj fjale të rëndë u gjallërua nëndrejtori dhe mbase e pa me interes.

— Pse e latë pa provuar elektrolinjen? — pyeti

kryeinxhinieri që nuk kishte të mbaruar me ato shkresat që trazonte në tryezë.

— Këtu duhet të ishte kapiteni, po... Gjithsesi unë e kam fajin! Megjithatë...

Deni tha shkurt arsyet e veta.

— Nuk më duken bindëse! — tha kryeinxhinieri.

— Janë bindëse që ç'ke me të! — u hodh nëndrejtori.

Samiu tundi kokën. Nuk kishte ku të shkonte më keq! Kështu ndodhte kur punët bëheshin kuturu dhe pa marrëveshje në mes të administratës.

— Çështja është që të mos kthehemi prapa! E nisëm një punë e ta çojmë gjer në fund! Po ta kemi këtë mendim, nuk ka gjë se nuk e provuam një natë e dy net! — tha Samiu.

— Nuk kthehemi prapa! Rrini të qetë! — buzëqeshi Deni.

— Sqaroje atë ngatërresën me SMT-në se je djallë deti ti e jo lapardha! — u fry nëndrejtori sikur të lavdëronte një njeri të afërt.

«Erdhi në formë si atë ditën te kallamishtat...» — mendoi Deni. U mat të dilte, po në zyrë hyri Karakolli.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti nëndrejtori duke parë fytyrën e prishur të peshkatarit.

— Nuk e di! Më duket se e qelba... — tha Karakolli. Ai tregoi shpejt e shpejt ngjarjen me atë të dinamitit.

— Kështu vetë e zutë dhe vetë e lëshuat?

— Nëndrejtor, e kam shtrirë qafën! Bëj çfarë të duash e thuaj çfarë të duash! — tha Karakolli.

— Me atë të dinamitit e kemi kollaj, me ty e kemi të vështirë! — u gjet ngushtë nëndrejtori. Ai vështroi sekretarin, po Samiu e përshëndeti dhe doli. Ishte i lodhur dhe nuk duronte më. Pastaj iu duk se ai tjetri kërkonte mendimin e tij, si për të larë duart.

— Karakoll! Ti erdhe vetë, po nuk di si të them.

Herë më duket një gjë e madhe, herë një gjë e vogël!
Ik tani... — i tha me të butë nëndrejtori.

Kishte ikur edhe Deni. Në zyrë ishin vetëm shefi
i kuadrit dhe nëndrejtori.

— E sheh si janë punët, o Murat? Mua më ke pa-
sur për krah, po tani ma ke vënë gardhin...

Nëndrejtori nuk i dha përgjigje.

— Një herë të mënjanojnë, pastaj ikin pa të mbë-
shtetur... Njëri me shkencë, tjetri si sekretar partie...

— I kujt kujton se jam unë, mor shef? Jam i Par-
tisë! Dhe e di ç'ke ti? A më hiqesh sysh? Nuk e kam
të keqen prej tyre unë, po prej kokës dhe të fryrave
në vesh që dëgjoj këtu!

— Mirë! Si të duash! — tha nëpër dhëmbë shefi
i kuadrit dhe doli. Ai pa Denin me sekretarin e Par-
tisë që bisedonin poshtë shkallëve, po kaloi pa u folur.

— Sikur nuk e ka mirë me mua... — tha Deni du-
ke ndjekur me sy shefin e kuadrit.

— Ka një ton administrativ, asgjë tjetër! — de-
shi ta qetësonte Samiu.

— Ehu! Kush ia vë re... — tha Deni dhe ndjeu se
dikush e tërhiqte.

— Plasa duke të kërkuar! — luajti të zemëruarin
Riqoja.

— Pse?

— Oj! A nuk kam ditëlindjen? — thartoi turinjtë
djali.

— U bëfsh 1000 vjeç dhe do ta djegim sot! Eja
dhe ti, sekretar! — Deni e ngriti mbi supe djalin.

— Për ditëlindjet e kemi djegur vetëm unë e ti!
— u spitullua Riqoja.

— Shkoni! Unë do ta djeg diku tjetër! — u tha
Samiu miqësisht. Fliste me ta, po mendja i rrinte te
Murat Nallbani! Nuk njihete njeri tjetër si ai! E pa-
mundur... Nëndrejtori gjithë ato ditë ishte bërë copë
për të siguruar karburantin, pjesët e këmbimit për
anijet, llambat e elektrolinjave që nuk gjendeshin dhe
i kishte zbuluar nëpër skutat e magazinave të impor-

tit, ku nuk i dinin as vetë magazinierët. Ishte bërë copë për të ngritur në këmbë atë frigoriferin e shkatërruar. Mendoj që nëndrejtori hynte në binarë më mirë se kushdo dhe dilte prej tyre kur nuk ta priste mendja. Natyrë e çuditshme, e rrëmbyer dhe me të papritura... Po gjithsesi një natyrë e ndershme! Për shefin e kuadrit nuk dinte ç'të thoshte. Veç kishte bindjen që ata dy njerëz mund ta çonin së mbari apo së prapi ndërmarrjen. Të tjerët nuk ishin problem.

Mjeku ishte i lodhur. Bleu cigaret dhe nuk dëshoi të ulej aty ku rrinin Deni me Riqon. I rëndonin mbi supë nata dhe mëngjesi me ata pacientët pleq. Urgjencat pas urgjencash! «Këto nuk janë urgjencat! Këta janë pleq...» — ishte shprehur gati me dëshpërim ai. Ishte ngutur, se dihej që çdo çast të një plak përbente një urgjencë... Ai mëngjesi ishte dukur si «katastrofa e pleqve». Kishte nisur me Pashk Lulin, që duhej duruar me heroizëm për hundët e zëna. Plaku ishte tepër i tronditur që nuk nuhaste mirë dhe nuk ndiente aromë. «Jeta është gjumi, buka, mendja, nuhatja dhe miqësia... Ç'mbetet kur humbet njëra prej tyre?» — e kishte çmendur Pashk Luli. Plaku nuk kishte qenë kurrrë i sëmurë. Po të mos ishte shpuar e gërvishtur aty këtu, nuk do të dinte as si ishte dhimbja. E kishte përcjellë me disa pika Diabenyli Rineks, për të cilat Pashk Luli kishte ngulur këmbë t'ia shtinte ai në hundë. «Katastrofa e pleqve» të mëngjesit nuk kishte qenë asgjë para asaj urgjencës së vërtetë të natës. E kishin ngritur në orën dy. «Eja, se ajo po vdes! — i kishin thënë për Marën. «E kishte gjetur gati pa puls dhe me tensionin gjashtë. Ishte marrë gjer në katër me Marën, gjerësa i ishte normalizuar tensioni. «A jam prapë nën këtë diell?» — kishte pyetur Mara duke vënë pak buzën

në gaz. «Nën këtë diell je! — i ishte përgjigjur mjeku, megjithëse përtej dritares ndriçonte hëna. «Ani mirë! Po i kujt je, mor voc?» Mjeku i kishte treguar emrin e të atit dhe plaka i kishte mbyllur sytë përnjëherësh. «Kot me e pa diellin, se edhe shtëpia jote ma pat zënë diellin kur kisha hall të madh...» — kishte thënë plaka dhe mjeku kishte mbetur keq. Nuk e kishte ditur. «Të gjithë e kemi pasur diellin të zënë në atë kohë, nënë. Marë!» — i kishte thënë. Plaka nuk i kishte folur më me gjithë përpjekjet e tij. Vetëm kur qe ngritur të ikte andej nga ora katër, i kishte thënë: «Të kishe qenë ti, nuk ma kishe zënë diellin!»

Rasha po e priste në ambulancë.

— Nuk u vonova, apo jo? — buzëqeshi mjeku.

— Jo! — tha Rasha.

— Vetëm për ndonjë urgjencë më ke këtu! — i tha mjeku infermieres.

Ai u fut në të ndarën ku kishte vendin e punës. Rasha e ndoqi pas. Ai ishte munduar shumë t'i mbushte mendjen për të pozuar. «Më duhet një profil antik si yti!» — i kishte thënë vazhdimisht ai. «Askush nuk më ka thënë që kam profil antik!» — ishte përgjigjur ajo. «Nuk ke kaluar nëpër sy artisti! Sikur të mos ishte harbut, këtë gjë do ta kishte parë edhe Deni!» — kishte bërë shaka ai. «Nuk kam dëgjuar të bëhen buste kot... Cila jam unë? Këto punë i bëjnë për heronjtë, për njerëzit e dëgjuar...» — kishte vazhduar të kundërshtonte ajo. «Meqë thua kështu, ti do të jesh një anonimati!» — nuk i ishte ndarë ai. Në fund ajo i kishte thënë se duhet të pyeste të atin. «Po qe kështu, lamtumirë, profil antik...» — ishte mërzitur ai.

Rasha u ul në stol dhe i hodhi një sy portretit të saj. Pothuaj ishte mbaruar.

— Si të duket? — pyeti mjeku.

— I ashpër... — pëshpëriti Rasha.

— Pse, a mos të duket vetja e butë? — bëri shaka mjeku. Ai shtoi më tej që ashpërsinë e nxirrte në pah më shumë graniti. Nuk kishte gjetur gur të mirë.

Zuri të gdhendte me daltë. Qafën dhe fllokët nuk i kishte mirë. Nuk u kishte dhënë rëndësi që në fillim dhe po i nxirrnin punë. Ai ishte i kënaqur nga shprehja e përgjithshme e portretit të Rashës. Vetëm një tunikë ilire i mungonte për t'i dhënë përfundimisht tiparet antike.

— Deni ishte në klub... — pëshpëriti ai duke punuar. Rasha nuk i dha përgjigje. — Nganjëherë më vjen ta rrah... — vazhdoi mjeku. Rasha luajti aty në stol.

— Nuk e rrah, jo! Veç mos ma prish pozicionin... Rasha e gjeti pozicionin e parë.

— Pse nuk e do Gjon Kabashi Denin? — pyeti Marku.

Rasha ngriti supet.

— Është e çuditshme! Deni ka nam të keq pa pasur asnjë të keqe! — tha mjeku duke tundur kokën. Ai tani herë i dilte para, herë prapa skulpturës së tij. E vështronte gjatë, pastaj kthehej dhe ia ngulte sytë Rashës.

— Tashti ka nam tjetër... Është bërë gjysmë hero... — qeshi Rasha.

— Ti je e dobët! Të isha unë...

— Hesht! — tha Rasha.

— Nuk e di ç'kërkon ai gomar!

— Lëre, Mark! — tha Rasha.

— E lashë, e lashë, po ngreje një çikë kokën!

Dikush fliste me zë të lartë në ambulancë dhe ata të dy mbajtën vesh.

— Ky është im atë... — u ngrit në këmbë Rasha.

— Dhe pastaj? — pyeti mjeku krejt i qetë.

Dera u hap me forcë dhe brenda hyri Gjon Kabashi. Ai mbeti i hutuar. Nuk priste të shihte kavalete, allçi, dalta dhe çekiçë, mbi gurët në anë të dhomës. Ngriti sytë ngadalë gjër te portreti i Rashës, po nuk e njohu menjëherë. Shihte vetëm pjesën e pasme.

— Urdhëro, Gjon... — tha mjeku. Ai shkundi duart dhe iu afrua.

Gjon Kabashi i hodhi sytë nga e bija, pastaj nga

busti i saj. E bëri disa herë këtë punë dhe, sa më shumë e shikonte, aq më shumë nxihej në fytyrë.

— Ekspozitë me time bijë... — pëshpëriti ai.

— S'është për ekspozitë! E kam bërë për qejf...

— Qejf me time bijë... — belbëzoi Gjon Kabashi duke u afruar nga Rasha.

— Rashën e kam motër! — u zemërua mjeku.

— O Mark, njëfarë kohe nuk shkonin kështu këto punë! — tha Gjon Kabashi duke e kapur për dore të bijën.

— Tatë... — pëshpëriti Rasha.

— Bushtër! — pëshpëriti Gjon Kabashi.

— Shiko, Gjon... — e kishte humbur krejt mjeku.

— Më liro rrugën më mirë! — tha Gjon Kabashi dhe e tërhoqi të bijën pas vetes. Ai i ra me bërryl padashur stolit të lartë dhe e rrëzoi përdhe bustin e Rashës.

— Mos... — nxori një psherëtimë të thellë mjeku. Ai e ngriti bustin. Ishte thyer një pjesë e flokëve që ai ia kishte lënë Rashës sikur ia merrte era.

Gjon Kabashi doli jashtë. E panë ata që po mjekoheshin në ambulancë, e panë ata që prisnin te dera. Kur u kujtua ai t'i lëshonte dorën, që vonë. Atëherë u bë esëll dhe mallkoi Salkën... E kishte pyetur se mos e kishte parë të bijën. «Rashën do? Mbyllur me doktor Markun e ke!» Ai ishte turrur gjer në ambulancë duke përsëritur si i marrë: «Mbyllur! Mbyllur! Mbyllur!»

Mallkoi Salkën dhe veten! Si kishte mundur ta yshite ajo Salka që dredhonte përmes shtëpive me atë koken e zezë prapa? Rrëshqiste me kokën ulur duke kthyer sytë shpejt nga kalimtarët dhe duke u ikur vështrimeve të tyre. Edhe vështrimit të tij i kishte ikur sa ia kishte lëshuar atë fjalë. Helmin... Të gjithë e njihnin e megjithatë ajo kishte një pushtet të beftë mbi të gjithë, një pushtet të çastit, që vinte e shndërrohej pastaj te të gjithë në inat..

«E njoh time bijë...» — tha ai me vete dhe pati për-

Ai i motorit doli jashtë. U dëgjua që e ndezi triçiklin, e nisi dhe pas pak e mbajti në vend.

— E pat... — tha djali i kënaqur.

Në klub hynin e dilnin njerëz. Denit iu duk se të gjithë vështronin atë. Edhe ata që ishin nëpër tavolina ishin kthyer nga ai. Iu duk se biseda nëpër tavolina ishte gjallëruar, megjithëse tani kishte intimitet më të madh.

— Mblidhi pastat! — i tha papritur Riqos.

— Kaq e pat? — u ankua djali.

— Kaq! — foli disi i shqetësuar Deni. Ai i bëri me shenjë kamerierit të vinte. Doli jashtë i ndjekur nga Riqoja, që kishte vënë pastat një mbi një në duar.

Ai i triçiklit kishte mbetur në rrugë. «Mirë të të bëhet! Na ke ngrënë gjysmën e detit!» — tha Deni me vete. Pa grumbuj njerëzish përpara ambulancës. Ata flisnin me gjallëri dhe ai dëgjoji emrin e Rashës dhe të Gjon Kabashit. Pyeti ç'kishte ndodhur.

— Nuk e dike? Gjon Kabashi e nxori të bijën për krahësh nga ambulanca! Thonë për doktor Markun, — ia priti njëri.

— Për doktor Markun? Unë të shkul gjuhën! — u tërbua Deni.

— Ngadalë, mor jahu! Kështu më thanë, kështu të thashë! — tha tjetri dhe iku me të shpejtë.

— Riqo, tani e kemi pisk! — tha Deni pa qenë i zoti të merrte një vendim.

— Hiç pisk nuk e kemi! — u përgjigj djali i qetë.

— A nuk mbushesh më mirë? Mbushu! — tha Deni duke vështruar rreth e rrotull si i humbur.

— Ah, kështu? Mbushem! — tha djali me vajin në buzë. Ai i hodhi pastat përdhe dhe iku duke qarë.

Deni as që e pa se ç'bëri. U fut në ambulancë. Pyeti infermierën për Markun.

— Atje e ke... — iu përgjigj ajo si e shushatur.

Mjeku rrinte në stolin ku kishte ndenjtur Rasha. E pa Denin me qetësi.

— Ç'ka ndodhur? — mezi pyeti Deni.

— Zgjim instinktesh të lashta... — u përgjigj tjetri në një mënyrë të ftohtë. Ai kishte në dorë copën e thyer të bustit të Rashës.

Deni u bë gati ta shante, që po e sillte ashtu rrotull, po i shkuan sytë te busti i Rashës dhe mbeti. Nuk i erdhi mirë që tjetri s'i kishte treguar që Rasha pozonte për të.

— U turr Gjon Kabashi dhe mori të bijën! Më rrëzoi dhe atë... — tha mjeku duke bërë me kokë nga busti.

— Pse nuk më ke treguar për këtë? — pyeti me të keq Deni.

— Nuk të kam dado! — iu përgjigj po ashtu mjeku. Denit i hipi gjaku në kokë. E ndjeu t'i vërshonte si një shatërvan që nuk kishte nga të shpërthente. Në të tilla raste shpërthimi vjen nga fjala e rëndë. Deni i iku fjalës së rëndë. A nuk kishte thënë mjeku se «prishja e shokëve ndodhte nga gratë». Edhe ai vetë u habit që u kujtua për këtë. Ai nuk e kishte grua Rashën...

— Jashtë vlon kazani... — foli më butë Deni.

— Le të derdhet! — e ngriti tonin tjetri.

— Nuk qe e mirë kjo për Rashën...

— Ç'të hyn në xhep ty? Ti pret nimfën me kostum të bardhë! — tha hidhur tjetri. Ai e hodhi tutje fragmentin e flokëve të Rashës.

Denit iu duk se flaku diçka të gjallë të Rashës. E ndjeu veten pa fuqi, pa zemërim, pa asgjë. Ai mendoi përnjëherësh se dikush tjetër do të ishte bërë për turp e faqe të zezë me atë historinë e asaj me kostum të bardhë... A mos kishte qenë ajo një ndjenjë e vërtetë? Hiç fare! Ishte njëfarë romantike. Ai kishte ndier nevojën të kapej pas diçkaje dhe ishte kapur si sonambul pas asaj me kostum të bardhë. «Po ta shoh, imbase dhe nuk e njoh më», — tha me vete Deni. Ai mendoi me turp që e vetmja hallkë që e lidhte me atë vajzë ishte kostumi i bardhë.

U ul ngjitur me Markun dhe i zgjati një cigare.

— Disa herë na bën mirë nga një shuplakë... Përfshihet në terapi, — vuri buzën në gaz mjeku.

Deni i kishte sytë andej nga busti i Rashës.

— E përkryer! Kot hallkatesh në mjekësi...

— Ta fal! Jo, jo! Nuk të duhet gjë kopja kur nuk çan kokën për origjinalin... — u kthye sërish në tonin e parë mjeku.

— A ngjitet ajo? — i iku përgjigjes Deni.

— Ngjitet, po unë do ta lë ashtu. si bustet e sakuara të muzeve...

— E di ç'do të bëja tani? Do t'i hyja në shtëpi Gjon Kabashit dhe do ta kapja për mjekre! — tha Deni papritur.

— Ti vetëm një herë do t'i hysh në shtëpi Gjon Kabashit, kur t'i kërkosh të bijën! — u përgjigj me të butë mjeku.

Deni e pa me vëmendje.

— Dhe ngutu! Po troket porta e saj... — s'e la të fliste mjeku.

— A nuk ngrihem i më mirë? Më mërзите!

Jashtë ishin po ata njerëz që kishte lënë Deni kur hyri në ambulancë. Ata u kthyen nga ata të dy me njëfarë hutimi, kur i panë të qetë dhe krah për krah. Deni u drodh. «Kanë pritur të përleshem me Markun! Të gjithë e quajnë Rashën timen dhe unë vetë e kam ushqyer këtë!» — tha me vete i pakënaqur.

— Mark! Unë do të pija një gotë! — tha Deni me zë të lartë që ta dëgjonin të gjithë. Ai e tërhoqi nga vetja mjekun.

— E pimë! — ia ktheu mjeku pa e kuptuar ku e kishte hallin.

XV

Yjet dukeshin pranë dhe kishin një shkëlqim më të madh se të netëve të tjera. Dukej sikur ata i takonin vetëm detit dhe askujt tjetër... Dukej sikur çdo yll bënte një pëllg drite të veçantë në detin e errët... Çdo yll kishte domenin e vet në detin e hapur dhe nuk i ndahej atij! Ndryshe, si mund të shpjegohej që yjet gjendeshin gjithmonë në të njëjtin pozicion?

Mund të bridhte me mendje në të katër anët, mund të krijonte teoritë më qesharake dhe hamendjet më të pabesuara, mund të argëtohej dhe të zemërohej me to... Ishte vetëm mbi kuvertë, të tjerët flinin në palmetë. Ishte mbështetur pas kapitanerisë dhe priste të shkonte ora tre, që të ngriheshin të tjerët për të mbledhur koshilokun. Herën e fundit koshiloku kishte sjellë një grusht sardelesh të vogla, karkalec të egër, kalimare dhe atë buciën, që ishte turpi i peshkatarëve. Të gjitha i kishin flakur në det. Pas kësaj heshtja dhe sytë e pe-

shkatarëve nga ai... Mos po diskreditohej përfundimisht elektrolinja vertikale? Atë mbrëmje e kishte tërhequr kapitenin mënjane dhe i kishte thënë të hidhnin të dy elektrolinjat përnjëherësh. «Kështu nuk do të provojmë asgjë edhe sikur të zëmë një mal me peshk! Cilës do t'ia japim meritën?» — ishte përgjigjur kapiteni. «Ka diçka që nuk shkon me atë vertikalen, po, gjersa ta marrim vesh, duhet të zëmë peshk, se mbetëm në bisht!» — kishte thënë Deni. Ai mendoi që ishte me interes të dihej ç'mund të dilte nga kombinimi i dy elektrolinjave.

Shkaktoi ilaritet nga të katër anët. Ku ishte parë kjo? Mos kishin dalë në det për të luajtur? Palin e kishin gjithnjë me vete, po kësaj here ai u rruhd. «Kapiten! Ne po tallemi me planin dhe me bukën e fëmijëve!» — kishte kërcyer motoristi. «Mos na e përmend bukën e fëmijëve! Të kishe aq hall, nuk blije gjashtë palë syze «Hon-Kong»», — kërcëu Pali. Krejt papritur kapiteni kishte dhënë urdhër të hidheshin të dy elektrolinjat. «Plaç, po nuk patëm masë...» — kishte turfulluar motoristi. «Masë si ajo e «Jezercës»?» — nuk i ishte duruar Denit. «Ç'do të thuash?» — ishte çakërdisur motoristi. «Atë që thashë...» — ishte përgjigjur Deni dhe tani ishte i penduar. Pse e mbante gjithnjë përpara motoristin si pasqyrën e së keqes? «Më vjen si era ponentë¹)... — kishte thënë Karakolli ndërsa lëshonin elektrolinjat. Ai e mbante hundën lart, sikur të nuhaste retë. «Mua më vjen si erë dasme! Horizontalja e tërheq sardelen lart, vertikaleja e shtyn poshtë! Dasmë pa mish!» — ishte hedhur përnjëherësh motoristi. «A nuk mund të jesh më optimist?» — kishte dashur ta afronte Deni. Tjetri i kishte kthyer shpinën dhe qe larguar.

Ndezi një cigare. E vetmja kënaqësi e gjithë asaj jave kishte qenë takimi me Ndoc Markun. Ai ishte ulur përballë Denit me sytë poshtë. Thika ishte ende e ngulur aty pas kaq ditëve, po ajo prej kohësh kishte humbur çdo kërcënim. Rrinte simbolikisht aty, si një gur i vjetër

1) erë e rrezikshme e veriperëndimit.

i kanunit që kishin harruar ta rrokullisnin. . . Ndoc Marku mezi e kishte shkukur thikën. E kishte zënë nga tehu dhe i kishte zgjatur dorezën Denit. «Nuk e kam pasur me ty! E kam pasur me turpin e konakut!» — kishte pëshpëritur. «Unë gabova. . .» — ishte prekur Deni. «Nuk po na ndahet turpi i konakut, se ajo vjen vit për vit. . .» — e kishte ulur zërin edhe më shumë Ndoc Marku. «A nuk ka derman? Ikni dhe merreni! Pleqtë e rreptë kanë vdekur të gjithë! Edhe ajo kohë ka vdekur!» — i kishte thënë Deni me të butë. «I çova një lajmës, po ai më solli namën e saj», — qe ngashëryer Ndoc Marku. «Ajo do të bjerë! Do të vijë vetë!» — e kishte mbyllur atë bisodë Deni jo shumë i bindur në atë që kishte thënë.

E flaku cigaren në det. Sikur ndiente një të mërdhirë të lehtë dhe hodhi xhaketën krahëve. Gjer atëherë kishte ndenjur në kanotiere. Karakolli kishte përmendur ponentën. Deti kishte një valëzim të lehtë, po plaku e kishte kujtuar atë erë të rrezikshme për analogji të punës që kishte ndër marrë.

Dikush ecte në majë të gishtërinjve në kuvertë. Karakolli! Ai u afrua dhe e tërhoqi diçka më lart se një pash elektrolinjën. E lidhi fillin në atë lartësi dhe u kthye si kishte ardhur. Deni mezi e mbyti një britmë zemërimi. Pse ruhej ai dhe kthente kokën sa andej-këndej? Pas asaj ngjarjes me atë të dinamitit Karakolli ishte mbështjellë në një heshtje të plotë. As fliste as jep-te përgjigje. Kur kërkonin diçka prej tij, i binin supit. Ndryshe nuk mund të merreshe vesh me të.

Karakolli erdhi sërish pas gjysmë ore dhe përsëriti të njëjtin veprim. E ngriti kabllon më lart duke e lënë Denin si të shushatur. Erdhi disa herë gjer në agim dhe bëri të njëjtën gjë. Kur zbardhi, Deni e pa në dritë të vërtetë Karakollin dhe e përmbysi ngashërimi. . . I erdhi turp që ishte zemëruar me të, po kjo rridhte ngaqë i ishin kujtuar fjalët që i kishte thënë në klub.» «Kot e ke me atë të thellësisë.» «Ai po e tërheq peshkun lart pak

nga pak! Po e josh dhe po e tërheq», — kishte pëshpëritur Deni në mes të ngashërimit dhe entuziazmit.

Aty nga ora tre Karakolli erdhi për të fundit herë dhe e barazoi fenerin e elektrolinjës vertikale me llambën në anë të anijes. Ai vështroi nga të katër anët dhe iku si hajdut.

Në tre u ngjitën të gjithë mbi kuvertë.

— Aha! Të qenka mbushur mendja më në fund t'i heqësh qafe ata fenerët e bashkisë? — tha me kënaqësi motoristi.

— Ç'ti bësh... — u përgjigj Deni. Ai i shkeli syrin kapitenit që nuk mori vesh gjë. Vështroi Karakollin, po ai ishte i qetë, i ftohtë.

— Ose më kanë fluturuar trutë. ose hatanë e peshkut kemi! — thirri Pali duke lënë petromaksin mbi kuvertë.

— Lidheni koshilokun në limbjotë! Shpejt! — urdhëroi kapiteni.

— Elektrolinjën e ngriti pak nga pak Karakolli! Gjithë natën e joshi sardelen... — i pëshpëriti Deni.

— Bah, ku i shkoi mendja! Po të shohim! Të shohim... — Kapiteni ishte i papërqendruar dhe në hall për atë që do të nxirrte koshiloku.

Filloi të punonte limbjota. Ende e vështronin me çudi dhe e ndienin veten disi të shmangur nga ajo. Më keq ndihej Taushi, vlera e të cilit matej në «kuaj-fuqi» sipas motoristit. Për 20 minuta limbjota e mblodhi pothuaj tërë koshilokun dhe e hodhi mbi kuvertë si një gjarpër të mbështjellë kular. Në ujë kishte mbetur vetëm fundi i rrjetës.

— Shpejt, se nuk mban rrjeta! — thirri Pali.

U turrën të merrnin peshkun me atë ritmikën kronometrike që i afrohej robotizimit. Arkat u mbushën shpejt dhe u desh të ndahej më dysh kuverta, siç kishte bërë nëndrejtori.

— E kaluam natën e Murat Nallbanit! — u entuziazmuam Pali.

— Sa mirë që i hoqëm qafe ata fenerët...

Deni për pak sa nuk iu shkreh.

Taushi ankohej. Seleksionimi i peshkut ishte tortura e tij e madhe. Nuk e linte barku të përkulej. Merrej vetëm me arkat që ishin sipër, të tjerat i linte.

— Karakoll! Të mora vesh vonë... — pëshpëriti Deni.

Plaku vështroi sardelet që kishte në dorë. I kishte rreshtuar, ishin alamet sardelesh.

— Kështu nuk hyn në gjynah me natyrën! — tha i menduar Karakolli. Dukej i kënaqur.

— Vetëm nuk e mora vesh pse vidheshe në majë të gishtërinjve, — tha Deni.

— Jeni me huqe... Nuk ju duhet prishur gjumi... — dredhoi Karakolli.

— Bjeri drejt, Karakoll!

— E si t'ia bëja ndryshe kur unë kam mendjen time dhe ti tënden? Kishte rrezik të më hidhje në det, po të më shihje duke ngritur elektrolinjën! Kështu mendova...

— Të pashë dhe nuk të hodha në det!

— Nuk më ke parë, ke dremitur... — pëshpëriti plaku dhe i bëri me kokë nga motoristi, që më shumë interesohej të ndante veç skumrat e mëdhenj që do të përpiqej të merrte me vete, sesa peshkun që duhej dorëzuar.

— Edhe sot deshi t'i lagte arkat me zorrë përpara se të mbusheshin, po nuk e la Pali, — tha Karakolli.

— Është si i tërbuar pas peshkut... — tha Deni duke vështuar si i shpërndante andej-këndej skumrat e tij motoristi. Pashk Luli e kishte shpjeguar në një mënyrë të vetën etjen e njerëzve të detit pas peshkut. Nuk kishte ngulur këmbë, e kishte shpjeguar në mënyrë hipotetike: «Mbase fosfori bëhet shkak... Është mësuar organizmi me fosforin e peshkut dhe e do vazhdimisht.»

— Ej! Parangallat! — thirri Tanushi.

Ishin harruar pas peshkut dhe as që ishin kujtuar për parangallat. Ai i Denit ishte tendosur fort.

— Lojbë! — e mbajti frymën Taushi. Ai kishte ditë që ëndërronte një kokë lojbe për ta bërë supë.

Deni e tërhoqi parangallin, sipas teknikës më të rëndomtë, që është një dhëlpëri e njohur dhe e lashtë. Ajo i ngjet një lodre zbavitëse për njeriun dhe një torturë për kafshën e detit. Ajo është tërhiq dhe lësho! Tërheqja është kërcënimi, lëshimi është shpresa! Me siguri ajo lojba e Denit nën ujë përpëlitej në mes të kërcënimit dhe shpresës... Deni nuk ishte i dhënë pas kësaj lloj gjuetie, megjithatë ajo peshja që i rëndonte në parangall e kishte hutuar dhe entuziazmuar ndoshta aq sa edhe sasia e madhe e sardeles që kishin zënë. Ai nuk pa ç'po ngrinte lart, se ishte larguar gjer afër mesit të anijes duke tërhequr parangallin. Ata që e panë ia dhanë gazit. Deni nxori mbi kuvertë një pulëbardhë të madhe që i çakërdisi të gjithë me klithmat e saj të dëshpëruara. Ai u pre, e mori për ters atë pulëbardhë që kishte zënë në morinë e shpendëve që silleshin gjithnjë kur tërhiqej koshiloku dhe nuk u kushtonte vëmendje asnjëri. Lart u turrën një mori pulëbardhash dhe zunë të vinin rrotull anijes jo shumë më tej se direku i saj. Ky ishte një solidaritet tronditës dhe Denit iu prenë krahët përpara tij.

Iu afrua Ndoc Marku.

— Kur zë pulëbardhë, thonë rron sa pulëbardha...

— pëshpëriti ai me një admirim të veçantë për Denin.

— Sa rron pulëbardha? — pyeti kot së koti.

Tjetri ngriti supet.

Deni qeshi. Ai tjetri kishte dashur ta uronte, po pulëbardha mund të jetonte edhe dy vjet...

Motoristi ndante peshkun dhe e hidhte në det bubi-cën.

— Ti je edhe qeroz, edhe fodull! — i tha Deni që nuk dinte si të shpëtonte nga pulëbardha. Ai ishte ulur dhe po përpiqej t'ia hiqte grepin që i ishte ngulur në fyt.

— Prit... — e largoi motoristi. Ai nuk pati hall se mos e lëndonte pulëbardhën si Deni, megjithatë ia hoqi grepin menjëherë. E vuri ndenjgur shpendin mbi grumbullin e rrjetave. Pulëbardha hapte dhe mbyllte sqepin pa pushim. Merrte frymë thellë. Motoristi hoqi

cigaren e ndezur nga goja dhe ia vuri në sqep pulëbardhës. Ajo e thithi cigaren ngadalë gjatë përpjekjes për të marrë frymë dhe e lëshoi po ashtu, si një terjaqi që shijon edhe fjollën e fundit të tymit. Ishte për të qeshur, ishte dhe makabre. Taushi anoi nga e para, po u tërbua ai që nuk e priste askush, Ndoc Marku.

— Maskara! Të marr shpirtin! — iu turr ai motoristit, që u fsheh me vrap pas kapitanerisë.

Ndoc Marku e mori në duar pulëbardhën dhe e mbështeti në gjoks, sikur të kishte pritur lindjen e fëmijës së parë të njerëzimit... Denit iu duk si orakujt gjithë dritë të mitologjisë, që zgjatnin krahët dhe parafllisnin të ardhmen e bukur të botës. Iu duk se ai kishte kaluar përtej të gjithëve, ishte ngjitur tepër lart dhe i kishte lënë të tërë poshtë në mes të atij banaliteti pa kuptim, që kishte sajuar motoristi. Ai kishte marrë nën mbrojtje një qenie të natyrës, kur dikush kishte dashur ta përdhoste! Natyra kishte egërsinë e saj, kishte luftën për ekzistencë, seleksionimin dhe vdekjen, po përdhosjen nuk e kishte!

Çakërdisja e pulëbardhave sipër anijes kishte arritur kulmin. Mesazhi i tyre i shqetësuar kishte afruar aty shpendët e tjerë që po grumbulloheshin pak nga pak. Qielli mbi anije ishte kthyer në gri të bardhë, siç ishte ngjyra e barkut dhe e krahëve të shpendëve. Ato vërtiteshin në një sipërfaqe të ngushtë që kishte në qendër direkun e anijes, lëshoheshin në një pikiatë të dëshpëruar gjer aty ku nuk kishte rrezik, përplaseshin me njëra-tjetrën, shkapeteshin pas krahëve të vinqit dhe rrëzonin pupla poshtë. Poshtë po ngrinin. Asnjë dimër nuk kishte krijuar në anije një gjendje kaq të zymtë...

— Hidhe në det, o shpirt, se mbaruam! — u lut Taushi.

Ndoc Marku e mbështeti pulëbardhën mbi grumbullin e rretave. Ai i mbylli veshët me të dyja duart. Nuk e përballonte dot uturimën që vinte nga lart.

Pulëbardha e zgjati qafën, pastaj e lëshoi poshtë. Ndoc Marku e vështoi Denin me një sy të mjegulluar. I kishte thënë se do të rronte sa pulëbardha...

Shpendi u ngrit papritmas, u drejtua dhe së fundi u çua në këmbë. Pastaj u rrëzua, u ngrit dhe u rrëzua disa herë duke hedhur disa hapa të trullësuar mbi kuvertë. E gjithë anija ishte me të, madje dhe motoristi, që ishte zbehur atje pas kapitanerisë.

Pulëbardha kërceu mbi parmakun e anijes, pa detin dhe fluturoi andej. Qielli u hap mbi anije me kaltërsinë e mëparshme dhe zhurma pushoi. U bë heshtje si në ag të dritës... Ndoc Marku i hoqi duart nga veshët dhe të gjithëve iu duk bota më e bukur...

— Ai është shpirthollë... — bëri me kokë Karakolli nga Ndoc Marku.

— Edhe ti je shpirthollë... — i tha Deni duke parë dhjetë sardelet që kishte zgjedhur plaku për Pashk Lulin. Ato ishin dhjetë ekzemplarë madhështorë të llojit.

— Kështu nuk i hyjmë në hak detit! — qeshi plaku.

— Nuk e kam parë Pashk Lulin! — tha Deni.

— Shkoi dikah me ata që gërmojnë nën dhé... Si i thonë?

— Me arkeologët?

— Hë, de! Ua mbushi mendjen për disa vorreza dhe i çoi diku! — tha Karakolli.

— A do të nisesh për në Krujë? Të erdhi data...

— tha Deni duke pasur parasysh të birin.

— Nuk e kam gjë atë djalë... — e hutoi Denin Karakolli..

— Ti çmendesh mbas tij! — u zu ngushtë Deni.

— Nuk më shkon fort mbas qejfit! Nuk është si unë...

— Mos e ke përkëdhelur?

— Unë? Unë e kam pasur dorën të rëndë!

«Dorën të rëndë dhe shpirtin të lehtë!» — mendoi Deni. Ai iu afrua kapitenit. E pyeti nëse do t'ia dërgonin kryeinxhinierit grafikët dhe regjistrat me të cilët kishin mbaruar punë.

— Do të dorëzosh peshkun! Ke radhën!

— Prapë te Gjon Kabashi? — pyeti Deni me mërzi.

— Lërja gjithçka në dorë dhe mos i kundërshtoj!

Thonë që e ka rregulluar shpirtin! — qeshi kapiteni. Ai ishte si i luajtur mendsh nga sukses.

— Po kthehemi në një krah! Po mbytemi! — tha Deni. Kjo ishte mburrje.

Ishin vonuar. Anijet e tjera ishin shkarkuar me kohë.

— Ku do të akostojmë? — pyeti Deni.

— Hidhu cimën atyre të «Jezercës»...

Njëri nga ata të «Jezercës» e tërhoqi ngathët cimën.

— Tundu! — thirri Deni.

— Mos më mërzi fort, se ta lashë krejt! — u përgjigj tjetri..

— Ç'keni kështu? — pyeti Deni që pa edhe fytyra të tjera të mërzitura mbi kuvertën e «Jezercës».

— Ç'kemi? Erdhëm prapë bosh! Nuk bëjnë ato llambat! — iu përgjigjën.

Deni vështoi kapitenin e tij. I kishin mbetur në qafë motoristit dhe kjo nuk do t'u shlyhej lehtë nga mendja.

Kërkuan arka bosh nga «Jezerca».

— Merri të gjitha! Merreni edhe anijen, po deshët! — i thirrën me mërzi nga anija tjetër.

— Nuk lëshohen burrat kështu! — tha Deni me të qeshur. Ai ishte lakuriq gjer në brez dhe qe ndezur nga sukcesi. Arkat e rënda i dukeshin pendë.

Bënë një varg nga anija e tyre, përmes «Jezercës» dhe gjer në molo ku priste zetori për të ngarkuar peshkun. Kapiteni ishte në mes të vargut, në kuvertë të «Jezercës». Arkat me peshk kalonin dorë më dorë gjer në molo.

— Mjaft! — tha ai pasi kishin dërguar andej një sasi arkash. Të tjerat që po vinin si përmes një konvejeri ai u tha t'i shkarkonin në një cep të «Jezercës».

— Ej, ku jeni ju? — tha i pakënaqur njëri nga ata të «Jezercës».

— Nuk vonojmë! I heqim! I heqim! — buzëqeshi kapiteni që vazhdoi të transportonte arkat drejt molos.

Ata që ishin në kuvertën e «Pulëbardhës» kishin punë shumë. U duhej të mbushnin arkat nga peshku që ishte në mes të anijes. Taushi ishte larë në djersë, i ishte veshur gjithë fytyra me luspat e sardeles.

Deni iu afrua kapitenit dhe vështroi arkat e ndara mënjanë.

— Të shkoi mendja mirë, bukur, por...

— A do të na bëjnë fjalë? E kemi keq në të dy krahët, me tanët dhe me këta që mund të na fyhen...

— A të kanë ndihmuar ndonjëherë? — i ra shkurt Deni.

— Më kanë ndihmuar, por jo me peshk...

— S'ka gjë! E ke rrugën të hapur, atëherë! — tha Deni.

Shkarkimi i peshkut vazhdoi gjer nga ora dhjetë. Në molo kishte shumë kureshtarë, që nuk po merrnin vesh si e kishin zënë gjithë atë sardele. Ishte hapur fjala që elektrolinja vertikale ia kishte dalë më në fund. Pyesnin të gjithë, po ata të «Pulëbardhës» nuk kishin kohë të përgjigjeshin, se ishin të rraskapitur. Kalonin arkat dorë më dorë.

— Me sa duket Karakolli mori fund! Shkolla të vë përpara, o vëlla! — tha një ndër peshkatarët aty në molo.

Deni e kishte fare pranë dhe nuk iu durua pa i kthyer përgjigje.

— Karakolli nuk ka marrë fund! Këtu është dora e tij dhe «dora» e shkencës! — u thirri Deni dhe u ngjiti në molo.

— Ej! Harruat këtë peshkun këtu! — u tha kapiteni i «Jezercës».

— Neve na ka ecur, ju keni pasur defekt pas defekti! E lamë për ju! — u përgjigj kapiteni i «Pulëbardhës» duke parë ata të tijtë me një sy që nuk pranonte kundërshtime.

— Aha! U bëmë edhe për lëmoshë... — erdhi një zë nga «Jezerca».

— Merreni, se e hodhëm në det! — erdhi një zë tjetër më i rëndë.

Kapiteni i tyre ishte më dysh. Më në fund i qetësoi.

— Për të mirë e lanë, për të mirë le të mbetet! Ata janë shokët tanë dhe ne këtu jemi... Nuk rrimë pa ua kthyer! — Ai pati frikë se mos i fyente, pa do ta kishte kthyer peshkun.

— Ama kavalierë jemi... — pëshpëriti motoristi.

— The gjë? — u kthye Deni.

— Unë? Aspak! Kush guxon t'ju thotë gjë juve? — dredhoi motoristi.

Deni kërcëu mbi zetorin e ngarkuar.

— Mbahu përpara Gjon Kabashit! — i thirri Pali, po ai nuk e dëgjoi.

Gjon Kabashi kishte hequr dorë nga fjalët, por nuk kishte hequr dorë nga rregullat. I kishin ardhur revizorët ato ditë dhe nuk kishte dashur të firmoste për 27 kilogramë që kishte dalë mangut, megjithëse hynin në firon legale. E kishte peshuar tri herë peshkun që ndodhej në frigorifer dhe ua kishte sjellë në majë të hundës revizorëve. Po diferenca mbetej se mbetej. Qe ulur përpara derës së frigoriferit që ishte bosh, po qe ngritur përnjëherësh me gëzim. Pas derës ishin harruar tri arka me dental që nëndrejtori e kishte ndarë për banketin e ushtrisë. «Na lodhe për kot! Këto të hynin në firo», — i thanë revizorët. «Për kot? Për këtë fytyrë!» — u ishte përgjigjur Gjon Kabashi duke zënë faqet me dorë.

Magaziniери nuk po ngutej dhe vështronte peshkun pa reshtur. Deni po nervozohej. «Mirë që nuk po e trazon me dorë!» — mendoi.

— Gjithë ky prodhim... — pëshpëriti Gjon Kabashi.

— E pastaj? — nuk iu durua Denit.

— Pastaj Gjon Kabashi ta shkruan të gjithë të cilësisë së tretë! — u tall pas shpinës së tij nëndrejtori.

— E gjithë sardelja është e cilësisë së parë, shoku Murat, — tha prerë magaziniери.

— Po e di sa para do të marrin? — pyeti në mënyrë poetike nëndrejtori.

— Sa e ka caktuar shteti — i ktheu shpinën Gjon Kabashi.

— Paska marrë fund shteti. E paske braktisur! — vazhdoi të bënte shaka nëndrejtori.

— O Murat, më mirë të shkën ta pezullosh tjetrin, se ta tallësh tjetrin! As ti, as unë nuk dimë të tallemi... — tha me sytë poshtë magazinieri.

Kështu mendonte edhe Deni. Nëndrejtorit nuk i shkente shakaja. Gjithësesi mbetej zyrtar.

— E kam thyer diçka mendjen, po nuk e kam ndërruar! Ku jam unë, do të jetë halli i shtetit! — tha Gjon Kabashi prerë.

Do të qeshte për një tjetër! Halli i shtetit te një magazinier? Po Gjon Kabashi e kishte aq seriozisht, sa me të nuk mund të qeshte askush.

— Si po na shkojnë ata langonjtë, Gjon? — e ndërroi tonin nëndrejtori.

— Mirë... — tha nëpër dhëmbë magazinieri. — Nuk donte ta merrte vesh Deni që po rriste një zagar për nëndrejtorin. Kishte blerë dy këlyshë.

Deni vështroi nëndrejtorin. A mos ishte thyer Gjon Kabashi? Mos ishte zbutur dhe servilosur?

Nëndrejtori tundi kokën. Kabashi i kishte thënë se po i rriste një këlysh. «Ta vrava dhe po ta rris! Për nëndrejtor ta hangërt dreqi nderën se nuk të fryj në sy!» — i kishte thënë Gjon Kabashi.

— Sillu mirë me djemtë, o Gjon Kabashi, se këta janë heronj, — tha nëndrejtori.

— Heronj? Nuk ka krisur fe pushke... — tha nëpër dhëmbë magazinieri.

Deni mori faturën dhe deshi të largohej.

— Prit! Do të shkojmë bashkë! — e mbajti nëndrejtori dhe i futi krahun.

Gjon Kabashi i çapëleu sytë. Tepër po përkëdhelej me Denin nëndrejtori.

Deni mendoi që do të ndaheshin, kur erdhën para ndërmarjes, megjithëse nuk kishin shkëmbyer ende

asnjë fjalë, po Murat Nallbani as që e ktheu kokën nga zyrat dhe vazhdoi drejt. Deni nuk ndihej lirshëm në krah të tij. Nesër të gjithë do të thoshin që ai ishte bërë miku i nëndrejtorit, siç kishin thënë për shefin e kuadrit, motoristin dhe atë kapitenin që e mbante rrotull nëpër ndërmarrje gjersa t'i vinte anija e re... Po ç'të keqe do të kishte? Ai nuk ishte nga ata që u lëpiheshin të tjerëve! Le të flisnin ç'të donin!

— Do ta shkel orarin zyrtar për ty, se në zyrë nuk kam as kafe, as konjak dhe unë dua të të jap një kafe dhe një konjak! — i tha nëndrejtori Denit duke hyrë në klub.

— As shefi i kuadrit nuk paska kafe dhe konjak në zyrë... — qeshi Deni duke e treguar me kokë tek rrinte me motoristin e «Pulëbardhës».

Nëndrejtori u zemërua. Ai e respektonte orarin e punës dhe këtë e kishte bërë ligj dhe për të tjerët, ndërsa ai shefi i kuadrit... Tani nuk kishte ç'të bënte! Ishte vetë brenda!

— Më ka rastisur të pyes për ty nëpër ndërmarrjet ku ke punuar. Të lavdërojnë të gjithë! Gjithandej ke lënë diçka tënden, sadopak kohë që ke punuar, ama të gjithë më kanë thënë se nuk është për të të zënë besë se ti krisën e ikën kur të gjithë mendojnë se ke zënë rrënjë... Pastaj të gjithë thonë që duhet të ruhesh nga ti se të mbetesh në dorë. Cilin ke vrarë ti?

— Kurrë nuk kam prekur njeri me dorë! — tha Deni dhe kjo ishte e vërtetë.

— Unë i dua njerëzit e zotë dhe trimat! Se dhe unë jam trim... Jam trim, se kam bërë një thes me budallallëqe dhe nuk e kam vrarë mendjen... Këtij lloj trimi i thonë trim i marrë! — vazhdoi nëndrejtori.

Deni e pa me simpati nëndrejtorin, megjithëse nuk po e merrte vesh ç'nevojë kishte të rrëfehej tek ai.

— Tash mundohem t'i mbys marrëzitë në det! Ca i mbys, ca më dalin prapë mbi ujë si ata kacakët e fryrë! — tha nëndrejtori.

— Të marr vesh... — tha Deni.

— Më merr dhe nuk më merr... E di si e kam drejtuar unë ndërmarrjen? Me ditë, me javë, shumë-shumë me muaj! Kam qenë i ndershëm, po sa para bën? Besoj se kam qenë i drejtë, po sa para bën?

Deni zuri të shqetësohej. Ai nuk kishte asnjë intimitet me nëndrejtorin që t'ia thoshte këto.

— E di si e kam quajtur unë kryeinxhinierin? Si një çilimi që e zgjat dorën drejt çdo gjëje të re që sheh, drejt sahatit, krehrit, ventilatorit... Po a është më mirë të zgjatësh dorën si çilimi drejt tyre, apo t'i lidhësh duart pas shpine si një plak përçmues?

— Është më mirë të zgjatësh duart me arsye... — vërejtjti Deni, po përnjëherësh u pendua. Ai tjetri mund t'ia merrte sikur po thoshte fjalë të mëdha.

— Bukur! Me arsye dhe me fantazi! Mua më ka munguar fantazia!

— Fantazia? — gati sa nuk u hodh përpjetë Deni.

— Pikërisht! Kështu më tha dje ai miku yt i ngushtë dhe kështu është! Më la gjithë natën pa gjumë!

«Marku! Këto janë hallakatjet e Markut!» — tha me vete Deni.

— «Duhet fantazi që ta kërkosh dhe ta kapësh të renë», më tha ai.

— Drejtimi është një gjë e saktë, e përpiktë... Fantazia...

— Kështu e kundërshtova dhe unë sa munda atë mikun tënd, madje i thashë që ndoshta e ndiente veten ngushtë mes përpikmërisë së mjekësisë dhe është hedhur në fantazinë e sklupturës, po mbrëmë i thashë vetes ndryshe: «O Murat, ti nuk ke sy të keq, po nuk je munduar të shohësh larg dhe kjo është ajo fantazia për të cilën flet ai mjeku! Je vërtitur në një pëllëmbë vend dhe kaq të ka mjaftuar!

Deni u çlirua. Meqë nëndrejtori kishte biseduar me Markun, mund të bisedonte edhe me të.

— E thirra natën, se kisha një të shtrënguar në

gjoks, po ai e bëri për hiçgjë! Po a ia shkrep ndonjë çikë, apo...

— Ia shkrep! — tha Deni duke qeshur.

— Duket ai! Të pret si brisku me atë gojë... Po ku e kishim fjalën? Te fantazia... — nëndrejtori mbeti një çast dhe u mbush me inat duke parë që ende nuk po luanin vendit shefi i kuadrit me atë motoristin.

«I paska mbetur në mendje fantazia!» — tha me vete Deni.

— Pse fola kaq gjatë me ty? Sepse të ra ndër mend të shtrosh edhe elektrolinjën horizontale dhe atë vertikale! Kjo është fantazia! — nëndrejtori u qetësua duke parë që u ngritën ata të dy.

— Jo, unë... Si të duash... — u zu ngushtë Deni.

— Thuaj si të duash, po të ra ndër mend...

Deni i tregoi ç'kishte bërë Karakolli.

— Dhe ç'përfundim nxore nga kjo? — e pyeti nëndrejtori Denin.

— Them që elektrolinjën vertikale duhet ta përdorim ose siç e përdorëm mbrëmë, ose kur të jenë ngrohur mirë ujërat dhe të mos ketë nevojë sardelja të synojë shtresat e sipërme, po të gjendet edhe në atë thellësi që arrin elektrolinja vertikale. — Deni foli duke e parë në sy nëndrejtorin.

— Më duket e drejtë! Po a mund të jetë një rastësi suksesi juaj?

— Mundet...

Nëndrejtori u mendua një çast, pastaj tha se kishte qejf ta kishte në rrethin e tij.

— Dua të të kem mik! — tha shkurt nëndrejtori.

— E quaj për nder... — u përgjigj Deni, megjithëse nuk iu duk shumë e natyrshme kjo. Miqësia nuk kërkohet kështu. Pastaj ata kishin diferencë në moshë...

— Kam menduar të të çoj në atë kursin e kapitenëve të anijeve... Pse u rrudhe? A mos deshe të ta them në zyrë? Kështu jam unë dhe e di që nuk është mirë...

— Tani për tani nuk dua të largohem! Kemi ndër-marrë edhe atë eksperimentin e elektrolinjës dhe...

— Po sikur të të bëjnë thirrje të shkosh për tre vjet në zonat malore? Ç'bën ti?

— Po qeshë i domosdoshëm, shkoj menjëherë, por detin e lë me dhimbje! — u përgjigj me frikë sikur do ta largonin nga deti atë çast.

— Domethënë nuk do?

— Nuk dua! — u përgjigj Deni. Atij iu prish pak qejfi. Iu kujtuan provimet që kishte për të dhënë. Kishte punuar pak.

— Mos ke pasur ndonjë sherr të ri me motoristin? Po me shefin e kuadrit? — pyeti papritmas nëndrejtori. Ata të dy ia kishin sharë Denin.

— Me Zeqirin vetëm atë historinë e çizmeve, ndërsa me shefin e kuadrit asgjë, veç asaj bisedës për atë detyrimin që më kishin veshur kot.

— Si u bë?

— U sqarua! — tha Deni.

— Si të duken ata të dy? — ia nguli sytë nëndrejtori.

— Ata të dy janë miqtë e tu, shoku Murat... — tha Deni.

— Megjithatë! Megjithatë! — nguli këmbë nëndrejtori.

«Dreqi ta hajë...» — tha me vete Deni:

— Lëre... Ju jeni njëri më i mirë se tjetri te «Pulëbardha», ndërsa...

Deni e ndërpreu. Nuk donte të hynte në problemet e drejtorisë, nuk kishte dëshirë. I tha se, edhe nëse kishte ndonjë të metë ndonjëri prej tyre, nuk kishte nga të shkonte, kur të tjerët ishin top. Tha «top», dhe u skuq nga ajo fjalë që kishte përdorur.

Nëndrejtori buzëqeshi. Kishte menduar ta hiqte motoristin nga «Pulëbardha», po nuk e kishte lënë sekretari i Partisë. Ai kishte shprehur pak a shumë mendimin e Denit.

— Top jeni dhe e treguat sot në mëngjes! — tha nëndrejtori duke u ngritur.

Deni e kapi me vonesë. Nuk u kujtua fare për arkat e peshkut që i lanë «Jezercës».

— I gjeta të gjithë rrotull arkave të peshkut, posa kishit ikur ju. Ma thanë si ishte puna. Ishin të gëzuar, ishin të zemëruar... Nuk e dinin as vetë si ishin!

— Hidhini arkat në det dhe unë nuk do t'u them asgjë! Ju jeni malësorë me mustaqe një pash! Ju jeni sedërlinj! Ju e keni hundën në qiell dhe namin në Bosfor! Sesi m'u kujtua Bosfori, as unë nuk e di! Po duket se i theva me Bosforin... — qeshi nëndrejtori.

— Ne kujtuam se u morëm vesh... — u çudit Deni.

— Hiç fare! Ju ikët dhe ata u mblodhën në «kuvendin e fisit»! Vetëm kapiteni ju kishte kuptuar si duhet... Ka nja dy sedërlinj të prapë aty, ai feneristi me kapitenin e dytë që të mbeten në dorë për pesë para! «Kur të lë dikush diçka, do të thotë që nuk je i zoti ta marrësh vetë!», thoshin ata të dy. Nejsë! I zbuta, po kisha kaq inat përbrenda, sa nuk di të them!

Nëndrejtori qëndroi. E pa me vëmendje Denin, pastaj tha: «Ne mësojmë, ecim përpara, rritemi dhe drejtojmë, po neve malësorëve na lëvrin këtu përbrenda një sedër e egër edhe tre breza mbrapa!»

— Tre breza janë shumë... — e korrigjoi Deni.

— Mos do të të them katër breza? Sa për atë që bëtë te «Jezerca»... Jeni njerëz të mirë, po nuk ndihmohet tjetri kështu! Nuk di si mund ta quaj këtë lloj ndihme, sado që unë i binda ta mbanin sardelen. Më mirë do të kishit bërë sikur të vrisnit mendjen për të gjetur shkakun e defekteve të tyre... Dhe dil nga zyrat! Mos prit vetëm kur të kesh punë...

— Mirë! — tha Deni duke u ndarë, megjithëse e dinte që nuk do të shkonte pa punë.

Përtonte të futej në shtëpi edhe pse kishte gjumë. Po sikur të shtrihej në plazh dhe të flinte si Taushi? Kjo ishte kura e tij për të rënë në peshë. Pas kësaj hipte duke turfulluar në peshoren e dyqanit të zarzavateve dhe dilte që kishte shtuar!

I thirri doktor Marku. Ai ishte mbështetur pas murit të ambulancës dhe rrinte në diell.

— Kam gjumë... — ia preu Deni.

— Ik dhe marr një psikoton te Rasha... — bëri shaka mjeku.

— Nuk di emër tjetër veç saj? — u vrenjt Deni.

— Posi! Murat Nallbanin! — tha mjeku dhe tjetri e kuptoi se e kishte parë me të.

— E ke plagosur me atë punën e fantazisë! — u zbut ai.

— A nuk kam të drejtë? Sa për plagët le të vijë të kurohet! — mezi çpriti ta zgjidhte bisedën mjeku.

Nëndrejtori donte të zbrazej diku dhe më gjeti mua!

— Ai të ka kërkuar se nuk është nga ata që i hapin barkun të parit që ndeshin në udhë! — u bë serioz mjeku.

— Gjithsesi ai njeri po më ngjit! — tha Deni. Tek largohej pa me bisht të syrit nga farmacia. Kishte njerëz dhe ata e kishin mbuluar Rashën. Ajo ishte diku pas tyre, pas banakut të farmacisë. Ishte me bluzë të bardhë. Ishte krejt e bardhë...

KAPITULL I VEÇANTË

Kukullat e zotit dukeshin dhe zhdukeshin aty-këtu. Gjithnjë ishin një ilaritet dhe befasi e brigjeve të detit. Bashkë me to ndonjëherë arrinte ndonjë ungjill apo katekizëm i përmbysur, i ndragur me leshterikë dhe lëmashk deti. I gjenin kokëposhtë, si shpendë të zinj, të ngordhur nga një shtegtim pa shpresë. Të dukej se kështu duhet të kishin përfunduar të tërë dhe se nuk do të arrinin të gjallë në këtë breg apo të hynin në thellësi të këtij bregu. Megjithatë ndonjë edhe kish-te mundur të ikte dhe të ngjitej me mundim të madh gjer te rrënojat e kishës së Lançit. Kjo kishë kishte qenë një kohë çudibërëse, të kthente dritën e syve, të çlironte gjymtyrët e paralizuar dhe i bënte të lindnin gratë shterpa... Thuhej që shpendët i shmangeshin në fluturim për të mos gabuar me ndonjë glasë, thuhej që nata mbi kulmin e saj kishte qenë gjithnjë një muzg i lehtë dhe nuk kishte qenë kurrë natë...

Dikush e kishte ndihmuar një shpend të zi të mëkëmbej! E kishte zhveshur nga leshterikët, nga lëvnashku, e kishte ushqyer dhe i kishte dhënë krah gjer në kishën e Lançit, për të treguar që zoti po kthehej prapë në trëvën e tij të vjetër dhe nuk kishte rëndësi që ajo kishte mbetur rrënojë...

Nganjëherë të gjitha këto të dukeshin si mbeturina që i nxirrte deti në breg, apo sikur vinin nga një muze i harruar i lashtësisë që e kishin përlarë inondataat në viset e humbura të Paqësorit dhe Atlantikut. Të hipte një inat t'i ktheje nga kishin ardhur, t'i mbyllje në harresën e tyre, po nuk ishte kështu. Nuk ishte kështu po të sillje ndër mend mallkimet e papës dhe vajtimet e shtypit perëndimor. Ata sa nuk shkullnin qimet e kokës për fëmijët tanë që ligjëronin për Marks, Ajnshtajnin dhe Shekspirin e nuk dinin kush kishte qenë Krishti!

Rropullitë që sillte deti po binin më rrallë nën fshesat e ashpra të pastruesve të komunales. Dikush u dilte përpara atyre. Dikush i mblidhte dhe nuk po merrej vesh ku shkonin, se në rrënojat e kishës së Lançit kishte arritur vetëm një ungjill...

XVI

Nëndrejtori ishte gjithë jetë, gjithë vrull. Ai u ul përballë kryeinxhinierit pa i kushtuar vëmendje Pashk Lulit dhe Samiut.

— Fol! Zbraze thesin e shkencës! — i tha ai duke u kthyer me buzën në gaz nga dy të tjerët.

Pashk Luli bëri të ngrihej.

— Profesor! Ulu aty! — i tha nëndrejtori sikur ta kishte vartës.

Plaku u ul. Ai ishte munduar gjer atëherë t'u mbushte mendjen dy të tjerëve për vartësinë e faunës detare nga flora dhe planktoni në bazë të myshqeve dhe bimëve të tjera që kishte mbledhur. Nuk kishte asgjë për të kundërshtuar, nëse ai nuk i jepte një përparësi absolute kësaj pa marrë parasysh problemet e tjera. Ishte një kërkues gati pedant. I kishte klasifikuar ato që kishte mbledhur, kishte shënuar zonat e gjetjes dhe

sipas kësaj ishte i bindur për shumëzimin dhe lëvizjet e peshkut në ato zona. Kishte gjëra interesante dhe me to që ndeshur edhe kryeinxhinieri, po Pashk Luli absolutizonte si gjithnjë. Samiu e çmonte, po edhe ia dinte dobësitë. «Nëndeti nuk është vegjetarian dhe as unë e ti nuk jemi vegjetarianë!» — i kishte thënë në një mënyrë të tillë që të mos e vriste. Pas kësaj plaku i kishte munduar për një kohë të gjatë me shembujt që kishte sjellë për florën që ndikonte në «demografinë» e detit, gjersa në fund kishte shprehur keqardhjen që peshqit dhe njerëzit nuk ishin vegjetarianë...

— Kam ardhur të dëgjoj shkencën! — përsëriti edhe një herë nëndrejtori, që nuk ia ndante sytë asaj hartës së madhe të zonave të gjuetisë. Një ditë përpara kryeinxhinieri i kishte grumbulluar kapitenët e anijeve dhe u kishte kërkuar të gjuanin në bazë të saj. Ishin edhe Deni me Karakollin aty. Kishin folur, kishin diskutuar gjatë, po Karakolli nuk kishte nxjerrë zë. Dikush kishte thënë se duhet të fliste edhe Karakolli... U desh ta ngrinin pothuaj me zor. «Kur ngrurojmë mes së vjetrës dhe së resë, nuk na shkon mendja aspak të martesë! Edhe mua kot m'u kujtua...» — u kishte hedhur një vështrim Karakolli. «E qelbi! Me sa duket do t'i turret kanunit...» — kishte menduar Deni. «Edhe përpara, kur na martonin si me zor, mundoheshin të na jepnin grua të re dhe jo të vjetër! Po pse? Pse të re? Se vetëm ajo lind fëmijë!» — kishte thënë Karakolli duke sunduar mbi të gjithë me atë vështrimin e tij të mprehtë. Pas kësaj kryeinxhinieri ndihej njeriu më i lumtur në botë, ndërsa kapiteni i «Kastriotit» kishte marrë përpara të tjerët duke thënë: «Të shohim a do të lindim fëmijë.» Në mëngjes anijet kishin sjellë 47 kuin-talë sardele më shumë.

Kryeinxhinieri foli shkurtimisht për të gjitha këto duke treguar hartën. Ishte i sigurt në vetvete dhe dukej sikur po fliste në një sesion shkencor. Në fund tha që kishte menduar t'i mblidhte te «Pulëbardha» të gj-

thë kapitenët e sardeles, për të parë kombinimin e dy elektrolinjave.

— Më pëlqen! — tha nëndrejtori.

— Më merrni edhe mua, djali! — bashkoi duart Pashk Luli.

— Të marrim! Do të vijmë edhe unë me Samiun... Apo jo, sekretar? — e pyeti Murat Nallbani.

Tjetri pohoi lehtë me kokë. Nëndrejtori ishte i entuziazmuar dhe nuk e vuri re ftohtësinë e tij. U ngrit, i futi krahun dhe e tërhoqi sekretarin gjer në zyrën e tij.

— Punë me fantazi, apo jo? — pyeti.

Tjetri ishte në luftë me veten. Kishte mjaft për t'i thënë, po do t'i prishte entuziazmin. Pastaj punët në ndërmarrje po shkonin më mirë, tremujori ishte realizuar dhe vetë Murat Nallbani në shumë drejtime nuk ishte ai që kishte qenë. Hidhte ndonjë fjalë andej-këndej për mënyrën si kishte drejtuar dhe ajo tingëllonte si njëfarë autokritike. Pardje kishte thënë që «perspektivën e kërkonte edhe qorri». Ai përdorë bastunin për të çarë ç'ka përpara! Ose «idealet e mëdha nuk realizohen pa realizuar të thjeshtat, të përditshmet!» I lëshonte këto si proverba dhe me një ton të tillë sikur të kishte pretendime mbi autorësinë e tyre.

— Të shoh të ftohtë... — tha nëndrejtori që e ndjeu se tjetri diç bluante në kokë.

Samiu nuk reagoi përsëri.

— Aha... E mora vesh! Ty nuk të kalon gjë! E ke për peshkun e gjuajtur në kundravajtje! E kam paguar prapë me atë çmimin ordiner me të cilin nuk ke qenë dakord! Duhet ta konfiskoja! Po ja që nuk është provuar plotësisht kundravajtja! Mund ta kenë gjuajtur brenda ligjit! E di se ke me vete prokurorin e madh të akuzës, barishten që mbetet në rrjetë dhe tregon zonën e gjuetisë, po a nuk mund të gabohemi? Megjithatë ti më zë mat! Kot nuk bën prova me atë Taushin! Më zë mat se më thua kur nuk ka prova për kundravajtje, pse e paguaj me çmim ordiner, apo jo? Pse

buzëqesh? Po me çmend! — tha nëndrejtori që e fiku me forcë cigaren duke e shypur për një kohë të gjatë.

Tjetri e vështronte dhe heshte. Nëndrejtorit i erdhi të bërtiste, të thyente diçka, të ikte... Ndiante që nuk i shmangej dot atij njeriu as kur fliste, as kur heshte.

— Nganjëherë më duket se të kam në ballë, nganjëherë më duket se të kam në qafë! Në ballë ku të të marr, në qafë... Në qafë nuk mbaj as tim atë! — shpërtheu nëndrejtori.

Samiu u mërzi. Në mëngjes kishte qenë në Komitetin e Partisë. Sekretari e kishte pyetur me hollësi për ndërmarrjen. «Me të dhënat që kam po ecën disi më mirë!» — i kishte thënë ai. «Më mirë!» — kishte thënë plot gojën edhe Samiu. Ai ishte përpjekur të bënte një kuadër të plotë të gjendjes. «Na duhet të sjellim një drejtor! Ai që ka qenë nuk bëhet më për punë, lëre që nuk ka qenë kushedi çfarë...» — kishte thënë sekretari. «Drejtor? Po ne drejtorin e kemi!» — ishte hedhur me vendosmëri Samiu. «Murat Nallbanin?» — e kishte parë me vëmendje sekretari. Samiu kishte pohuar prerë. «Me gjithë dobësitë që ka pasur dhe mund të ketë ai?» — kishte vazhduar sekretari. «Me gjithë dobësitë që ka pasur dhe mund të ketë!» — e kishte ndjekur Samiu. «Kaq të vendosur e ke këtë mendim, shoku Sami?» «Po, sepse ai ka zjarrin e punës dhe tani i ka ndezur mirë!» — ishte përgjigjur Samiu. «Do t'i dobësohet!» — kishte buzëqeshur sekretari. «Mund t'i dobësohet për një çast, po pastaj i ndizet edhe më shumë, shoku sekretar...» Sekretari i kishte zgjatur një letër anonime. Samiu e kishte lexuar duke rrudhur ballin dhe duke ndier atë morsën e çuditshme mbi vetulla. «Ç'ka të vërtetë?» — e kishte pyetur sekretari i Partisë. «Me përjashtim të kapitenit që është lënë rrotull ndërmarrjes pa punë gjersa të vijë anija e re dhe shahut që luaj unë në plazh nuk ka asgjë të vërtetë!» — ishte përgjigjur Samiu. Ai kishte shtuar që nuk do të ishte keq të dër-

gonin një ekip në ndërmarrje. «Ekipin e keni aty, organizatën e Partisë! Analizojeni aty po e patë të arsyeshme!» — kishte thënë sekretari, pastaj ishte interesuar për Denin. «Djalë i ndershëm dhe i zoti! Po i ecën puna. Po pse të mos jetë kështu? Ai e ka zgjedhur vetë punën!» — kishte thënë Samiu.

Nëndrejtori doli nga zyra dhe u kthye pas pak me shefin e llogarisë.

— E ke aty atë shkresën që kam firmosur për ato pagesat në kundravajtje? — pyeti.

Tjetri e mori dhe e grisi copa-copa pa e lexuar.

— Tani ik dhe më thirr atë admiralin që bën sikur mbërthen arka duke pritur t'i vijë anija! — tha nëndrejtori.

Samiu ishte në tension të madh. Ndaj kujt drejtohej cinizmi i nëndrejtorit? Ishte i bindur që godiste veten dhe kjo qe krejt origjinale. Po si u kujtua për atë kapitenin?

Erdhi kapiteni. Ishte një burrë i gjatë, me mustaqe të përdredhura siç i mbajnë qejflinjtë.

— Te «Kastrioti» kemi njërin të sëmurë! Do të zësh vendin e tij! — tha nëndrejtori me ton të vendosur.

— A kështu i kemi pasur fjalët, nëndrejtor? — u zemërua tjetri.

— I kam harruar të gjitha fjalët! Nisu në det!

— A i ke harruar, a të kanë bërë t'i harrosh? — pyeti kapiteni duke kthyer një fytyrë të dyshimtë nga Samiu.

— A do ta prishësh muhabetin me mua? — u ngrit përgjysmë nga karrigia nëndrejtori.

— Pse ta prish kur është i prishur? — u përgjigj kapiteni dhe doli jashtë.

— I kisha premtuar ta mbaja këtu gjersa t'i vinte anija! Ia hëngra fjalën! Po a nuk ke ndër mend të thuash diçka ti? — pyeti nëndrejtori.

— Unë po shoh si po grin djathtas e majtas me shpatë. Kjo është autokritika jote e mundimshme! Ve-

tëm ti mund ta bësh këtë! Nuk e ke kundrejt meje, e ke kundrejt vetes! — tha me të butë Samiu.

— Ashtu? Pse nuk u thua atyre lart që jam një trung i palatuar dhe që nuk bëj për këtu? — u lëshua moralisht nëndrejtori.

— Do t'u them që ke disa vende të palatuara dhe megjithatë bën fare mirë për këtu! — buzëqeshi sekretari i Partisë duke menduar çfarë kishte biseduar në Komitet.

Nëndrejtori ngriti kokën. Mos shpresoj se mund të përshkohem si një fije peri nëpër vrimën e gjilpërës! — tha ai me zë të ulët.

— Asnjëri nuk mund ta bëjë këtë! Duhet zmadhuar tepër ajo vrimë që të nxërë të metat e njeriut! — buzëqeshi Samiu.

Hyri shefi i kuadrit. Ai e hapi pak derën në fillim dhe futi vetëm kokën. As nuk e ftuan, as nuk e ndaluan të hynte.

— Ju kërkova gjithandej, shoku Sami. Mendoj që asnjëri prej atyre të dyve që duam të dërgojmë në kursin vjetor të kapitenëve nuk i përmbush kërkesat! — tha ai.

— Pse? — u vrenjt Samiu, që i njihte mirë ata të dy.

— Nuk kanë garancinë e nevojshme! Martinit iu gjet vjet ikona në shtëpi dhe e shoqja iu hoq nga magazina e ushqimores për dëmtim malli, ndërsa Bujar Luca nuk ka qëndrim të mirë moral, ka ndarë dy të fejuara, njërin me kurorë civile bile. Këto duhet t'i dijë edhe shoku Murat, — deshi të bënte aleat nëndrejtorin shefi i kuadrit.

— I di, po nuk më ka shkuar ndonjëherë në mendje që nuk bëjnë për kapitenë! — tha Murat Nallbani.

Sekretari i Partisë e pa si nëpër mjegull shefin e kuadrit. Ajo erdhi dhe u dendësua dhe shefi i kuadrit u zbeh dhe u largua si një nënshtresë e atyre ikonave në mbishkresa pikturash që dalin vetëm kur restaurohen. Ai u mundua «të restauronte» shefin e kuadrit dhe

gjithë ç'kishte sjellë me vete ai. Atë ikonën e kishte fshehur gjyshi i Martinit, ndërsa çështja e së shoqes ishte e papërfunduar. Kishte rrjedhur një fuçi vaji, që mund të ishte shpuar gjatë shkarkimit, dhe kishte dëmtuar një pjesë të sheqerit. Ndërsa Baftjari nuk i kishte lënë të fejuarat, po e kishin lënë ato! Nuk ishte i bukur! Nuk ishte i qejfit dhe i shëtitjeve! Nuk ishte...

— A do t'i kishte ti garancitë për kapiten anijeje? — pyeti ftohtë Samiu. Ai u mundua të mos e kishte parasysh letrën anonime, që ishte një përpjekje për të gjetur sa më shumë të këqija. Po a e kishte shkruar atë letër ai njeri?

— Unë... Mua... Më kanë besuar detyrë tjetër... — mezi doli nga ankthi i asaj pyetjeje shefi i kuadrit.

— Po, veç askush nuk ta ka porositur gjithë këtë zell për të mbledhur të këqija të paqena! — tha nëpër dhëmbë sekretari i Partisë.

— Kam qenë gjithnjë në krye të detyrës! E shtrojmë në organizatë, po të duash! — u mbrojt shefi i kuadrit. Ai u zbeh kur pa nëndrejtorin të ngrihej dhe t'i afrohej xhamit. A nuk ishte kjo një shenjë që do të thoshte se duhet të dilte jashtë?

Nëndrejtori i largoi perdet. Ishte këputur diçka mes tij dhe shefit të kuadrit dhe ai po përpiqej të sillte ndër mend kur kishte ndodhur kjo. Sa herë mendonte për të, i dilte parasysh motoristi i «Pulëbardhës» dhe syzet Hong-Kong që i kishte lënë mbi tryezë. Shefi i kuadrit nuk i kishte lënë ndonjëherë syze Hong-Kong, po diçka tjetër që ai nuk ishte në gjendje ta përcaktonte.

— Arkivën e ruan mirë, po e plotëson keq! Kam kaluar disa dosje nëpër duar... Të metat, vërejtjet, masat i kishte shënuar me hollësitë më të mëdha, po mungonin meritat!

— Kjo është e padrejtë! Unë nuk mund t'u ngjitem prapa njerëzve për t'i pyetur çfarë dekoratash ka-

në marrë dhe çfarë meritash kanë. Duhet të vijnë ti plotësojnë vetë! — u hodh shefi i kuadrit.

— As masat dhe vërejtjet nuk vijnë t'i plotësojnë ata, po ti i shënon si duhet! Partia nuk e kupton shefin e kuadrit si një arkivist pedant, po si një hallkë kyçe në ndërmarrje që mobilizon kuadrin, të shpërblehet moralisht dhe materialisht, që i krijon besim në ndërmarrje të guximshme dhe të dobishme për shoqërinë! Të të bëj një pyetje të thjeshtë... Mjaft punonjës të ndërmarrjes vazhdojnë shkollat pa shkëputje nga puna. Si e ke ndjekur ti përparimin e tyre?

— Ja, kam pyetur... — u përpëlit tjetri.

— Asgjë nuk ke pyetur! Je marrë me gërmime arkeologjike të metash ose me fryrjen e tyre!

— Unë ruaj dhe kam ruajtur vijën e Partisë! — tha shefi i kuadrit krejt i nxirë në fytyrë.

— Vija e Partisë nuk ruhet, po përkundrazi prishet kur tregohemi sektarë dhe konservatorë! Duhet ta futësh mirë në kokë këtë. Dhe... Dhe plotësoji si duhet dokumentet e atyre të dyve...

— A duhet të veprojmë kundër bindjeve të mia? — u fry tjetri.

Nëndrejtori u kthye nga ai. Iu duk se e gjeti ku kishte gabuar së bashku me të dhe ku po ndahej nga ai, apo dhe ishte ndarë... Bindjet e shefit të kuadrit kishin qenë një rrëmujë tarafilëqesh, paragjykimesh farefisnore dhe krahinore! Ndonjë prej tyre e kishte pasur edhe ai vetë, po me një njeri tjetër në kuadër ato nuk do të kishin arritur gjer aty ku kishin arritur! Ia kishte lënë atij në dorë politikën e kuadrit, siç ishte e drejta, po ai nuk e kishte zbatuar mirë.

— Po të duash, kërkojmë një mendim më të gjerë! Kërkojmë mendimin e organizatës, nëse nuk je i bindur! — tha me qetësi Samiu.

— Kam qenë kundër liberalizmit! E kam pasur këtë të metë! — tha me ironi shefi i kuadrit dhe deshi të ikte.

— Pa prit këtu! — iu turr nëndrejtori.

— Ç'do? — e pa me të keq tjetri.

— Liberalizmat e qyfyre të tjera thuaja tjetërkuj! Unë të njoh tani si veten, se bashkë jemi futur në ca budallallëqe këtu, që për ty kanë qenë krejt të natyrshme! Do një prej tyre? Qëndrimin e turpshëm ndaj kryeinxhinierit që është një djalë i pasionuar dhe...

«I pasionuar dhe...» — përsëriti me vete shefi i kuadrit si ndonjë sonambul. Ai e kishte humbur krejt dhe nuk merrte vesh më asgjë. As në ëndërr nuk mund ta merrte me mend t'i sulleshin kështu ata të dy. Ai nuk gjeti asgjë për t'u mbrojtur, po gjeti diçka për t'u ankuar.

— M'u turrët keq! Sikur të mos jem komunist, po... Edhe mund ta kem gabim! Edhe gabojmë... — u tërhoq pastaj.

— Ik më mirë dhe mbushi dokumentet e atyre të dyve! — tha nëndrejtori.

Shefi i kuadrit doli.

— Ia kam parë sherrin...

— Mundet... — u përgjigj Samiu me mendjen gjithnjë te letra anonime.

— Ama e kam kërkuar edhe vetë atë sherr...

Tjetri u gëzua. Tani nuk ishte aspak i penduar që kishte thënë në Komitetin e Partisë se drejtorin e kishte aty...

Ai i futi krahun dhe dolën të dy.

XVII

Taushi erdhi dhe u shtri me rrëmujë pranë tyre. Ngriti aq rërë, sa mund të ngrinte një dem i hazdisur.

— Ej! Toro... — u ankua mjeku duke hequr rërën nga sytë.

— Vonë! — i tha Deni duke parë kutinë e shahut. Gladiatorët e mëdhenj kishin ikur dhe as Samiu nuk po dukej.

Taushi ishte i zemëruar. Nuk kishte partner dhe i kishte humbur një torre, që hëpërhë e kishte zëvendësuar me një tapë.

— Unë vdes dhe nuk luaj me tapa shishesh! — e ngacmoi doktor Marku.

Taushi mbylli sytë. Nuk deshi as të shihte, as të dëgjonte. Deni i futi një fije bari në vesh. Taushi e hapi njërin sy. Mendoi që e ngacmoi Pali. E vështroi turbull dhe e mbylli prapë syrin. Deni i futi fijen e

barit në hundë dhe atëherë Taushi u ngrit si i tërbuar dhe e kapi për fyti Palin.

— Ngadalë... — tha me mospërfillje mjeku duke u kthyer nga ata të dy.

Taushi e kishte mbërthyer fort Palin. Kishte një pamje të keqe në fytyrë.

— Ç'është ky viking i tmerrshëm? — u tall doktor Marku që nuk e kishte qafën e vet nën putrat e Taushit.

— Viking navigator! — tha Pashk Luli që as e kishte idenë ç'bëhej pas tij. Ai po rrinte tutje me Karakollin.

— Xhind... — qeshi Deni.

— Dhë Bagdad thif¹⁾, — tha mjeku për të nxitur Pashk Lulin që e ndihmonte në anglisht.

— Hajuej men²⁾, — e ndoqi Pashk Luli duke menduar që mjeku ushtronte gjuhën.

Mjeku qeshi me të madhe. Aq shumë qeshi, sa Taushi e lëshoi Palin nga habia.

— Ç'tha? — pyeti me zemërim. Tani gjithë inatin e kishte me plakun. Nuk duronte ta tallnin me atë gjuhë që nuk e merrte vesh.

— Ç'tha? Hajdut rrugësh, lapër... — u përgjigj mjeku.

Taushi erdhi në vete. U kujtua që e kishte martirizuar Palin dhe nisi t'ia fërkonte qafën me të butë. Tjetri e la për një kohë, po, kur Taushi u shtri në rërë, u ngrit dhe i kërcëu me të dy këmbët mbi shpinë. U hodh disa herë mbi të dhe u largua vetëm kur i ra inati.

— Tani kthehu edhe ti dhe fërkoja shpinën, sig bëri Taushi me qafën tënde! — i tha mjeku.

Deni qeshte me të madhe. Pashk Luli kthehej nga ata dhe qeshte edhe ai. Sillej nga Karakolli dhe bëhej serioz. Karakolli nuk e kishte parë të udhës të merrej me Taushin. Vështronte detin dhe mendonte për atë

1) hajduti i Bagdadit

2) hajdut rrugësh

algën e Paqësorit, që mund të bëhej një burim i pash-tershëm energjie, siç kishte thënë Pashk Luli.

U ngrit Pali. Ishte ende i zemëruar që nuk e kishin ndihmuar të shqitej nga putrat e Taushit.

— Hej, dreq... — tha Pali me një ton krejt tjetër.

— Ç'ke? — nuk e prishi qetësinë mjeku.

— Si paska dalë? Ajo nuk është mirë... — pëshpë-riti Pali.

Deni dhe mjeku u çuan ndenjmur pothuaj përnjëhe-rësh. Plaka e detit ishte ulur pranë ujit dhe kishte mbërthyer gjunjët me të dy krahët. Ata shihnin ve-tëm shpinën e saj dhe kokën e përkulur.

— Mos po hyn në ujë... — u shqetësua Pali.

— Nuk hyn kur nuk ka hyrë gjer tani! — tha mje-ku. Tha kështu për zakonin që kishte pasur Mara të hynte me gjithë rroba në det. Hynte një herë në fi-llim kur dukej në plazh, hynte dhe një herë kur ikte për në Veri gjersa të kthehej verën tjetër.

Andej nga ajo ishin kthyer dhe Karakolli me Pashk Lulin.

— Ajo po e merr veten! — ndërhyri mjeku. Ai nuk e kishte fjalën vetëm për gjendjen shëndetësore të pla-kës.

— Ajo edhe dje ishte po aty... — tha Karakolli me një mënyrë të veçantë.

— Si ka qenë ajo, Karakoll? — pyeti Deni krejt i bindur që plaku duhej ta kishte njohur.

Karakolli u kthye gati me rrëmbim.

— Mos e prek plagën! — Ai deshi të ngrihej, po e mbajti Pashk Luli. E qetësoi me atë buzëqeshjen e tij të veçantë.

— Rri, djali, dhe na e thuaj plagën... — Për Pashk Lulin të gjithë ishin «djali»...

— Ka qenë plaga e këtyre maleve! — tha Karakolli dhe heshti.

— Pse? — Deni mezi e përmbajti zemërimin, Ka-rakollit duhej t'ia nxirrnin një nga një fjalët.

— Pse ka qenë perri! Ka qenë e bukur — vazhdoi Karakolli.

— A ka faj dielli që është i bukur! — u zemërua Deni.

U kthyen të gjithë nga dielli. Ai po ikte tutje pas malit me atë madhështinë e perëndimit. Njerëzit duhet të druheshin se po i linte në terr, po dhe të shpresonin se do të rilindte të nesërmen...

— Ajo nuk e ka fshehur bukurinë e saj... — vazhdoi Karakolli.

«Atëherë paska qenë më e mirë se dielli! Dielli fshihet dhe del! Fshihet dhe del!» — mendoi Deni.

— Ajo ka qenë e bukur me tepri... Edhe buka me tepri është keq! Edhe jeta me tepri është keq! — tha Karakolli i menduar.

Vetëm Pashk Luli mund të ishte plotësisht me mendimin e tij. Të tjerët mund të pranonin që vetëm buka e tepërt ishte keq.

— Nuk e ka fshehur bukurinë e ka krijuar sherr padashur. Janë ngrënë për të dhe nuk do t'ia kishin lënë gjallë as të fejuarin, sikur të mos hynte në det. Ajo hyri në det për t'i lënë një cen vetes që të pushonte sherri...

— Jo! Ajo hyri në det se ia kishin mohuar detin! — kërcëu me zemërim Deni.

— Ju keni mend më shumë! — tha Karakolli me njëfarë ironie.

— Po shkoj nga ajo! — u nxitua Pali.

Deni e mbajti. Andej po shkonte Ndoc Marku.

— Ajo e zboi dje... — tha Karakolli për Ndoc Markun.

Ndoc Marku përshkoi bregun me kokën ulur. Ai gjithsesi kishte një sjellje fisnike dhe Deni e kishte vënë re që në ditët e para. Pse kishte njëfarë dobësie, njëfarë delikatëse ndaj tij në anije, megjithëse nuk bënte ndonjë gjë të veçantë?

Ndoc Marku u ul afër plakës dhe mbështolli dhe ai duart rreth gjunjëve.

— Ai më dhimbset... — pëshpëriti Karakolli.

— A do ta zbojë? — pyeti Deni me njëfarë ankthi.

Karakolli u mendua.

— Dje rrinte në këmbë pas saj! Sot rri si ajo dhe është si ajo...

«Atëherë nuk do ta zbojë...» — tha me vete Deni.

— Ç'bisedojnë ata? — pyeti mjeku.

— Hiç... Gjithçka prishet kur flet... — Karakolli foli sikur të zgjidhte një magji.

— A merren vesh? — Deni kishte mbetur në këmbë dhe nuk dinte ç'të bënte.

— Hëpërhë vetëm e durojnë njëri-tjetrin... — tha Karakolli.

«Gjersa e durojnë, nuk është keq...» — shpresonte Deni.

— Ku i di të gjitha këto ti, Karakoll? — pyeti mjeku.

— Unë nuk di asgjë! Unë vetëm loz me mendje...

Deni mendoi që atje në breg të detit nuk luhej me mendje, luhej me shpirt... Ata të dy kishin gati gjysmë shekulli në mes dhe prapë diçka u thërriste përbrenda. Turpi i ndante, gjaku i bashkonte!

Po errej dhe ata të dy mezi shiheshin. Pritën gjersa nuk i panë më dhe u ndanë. Deni iku vetëm gjatë bregut. Anijes po i ripararin timonin dhe nuk do të dilnin në det. Nga deti dilnin tek-tuk notarët e vonuar që kishin qejf të laheshin në mbrëmje. Ata ia mbathnin me vrap gjer te rrobat e tyre dhe fshiheshin duke kërcitur dhëmbët nga të ftohtët. Kështu doli edhe Rasha dhe atij i erdhi ta rrihte. I erdhi ta rrëmbente nga ato flokët që i shkundi me forcë përpara tij (pikat e ujit i ranë në fytyrë dhe ai i fshiu me dorë) dhe ta tërhiqte rrëshqan deri te Gjon Kabashi që mbahej burrë kanuni!

Rasha nuk e kishte vënë re dhe vazhdoi të kërcer-te për t'u ngrohur dhe t'u jepte poshtë e lart flokëve të saj të gjatë. Cirkat e ujit i binin prapë në fytyrë dhe ai i linte ashtu, si një dush të ftohtë për të mbledhur veten. Ai mendoi që Rashës nuk ia kishin mohuar detin, po bustin në gur ia kishin mohuar.

XVIII

Për afro tri javë gjysma e anijeve të sardeles ndoqën një rrugë që shkonte nga kepi i Rodonit gjer në Sarandë. Peshkun e zënë e dorëzuan në Durrës, në Vlorë dhe në Sarandë. Ky ishte një itinerar i përcaktuar mirë dhe kishte të bënte me studimin e kohëve të fundit dhe me metodat e kohëve të fundit. Elektrolinja vertikale kishte pasur sukses, po me sa dukej kryesorja mbetej gjetja e zonave të begatshme të sardeles. Karakollin e njihte gjithë bregdeti dhe, meqë printe «Pulëbardha», atë e kthyen përnjëherësh në një admiral të sardeles me fuqi të pakufizuara. Disa besonin se kjo anije druri ishte pajisur me aparate të reja për të krijuar befasi në gjithë flotën e peshkimit, dhe, megjithëse kjo nuk ishte për t'u besuar shumë, mbasi përgjithësisht pajisjet më të mira i kishin Durrësi dhe Vlorë, një mëngjes iu turrën «Pulëbardhës» në molon e

Sarandës dhe mbetën të shtangur kur nuk gjetën gjë tjetër veç hollotit dhe busullës. Askush nuk u kushtoi vëmendje fenerëve të elektrolinjës vertikale, megjithëse ata të «Pulëbardhës» deshën t'ua përshkruanin me zemërgjerësi. Madje Denit iu duk se pati njëfarë përgmimi për të. Ndodhi njëlloj si me peshkatarët e ndërmarrjes së tij në fillimet e eksperimenteve. Kishte qenë një nga peshkimet më të organizuara në det të hapët. Anijet ishin pajisur mirë që me t'u nisur, po befasia e tyre ishte e madhe kur ankoroheshin në Durrës. dhe gjenin aty nëndrejtorin me kryeinxhinierin, qëndronin në Vlorë dhe ata ishin aty, arrinin në Sarandë dhe nëndrejtori me kryeinxhinierin i prisnin në molo. Gjithë këtë rrugë e kishin bërë me kamionin e ndërmarrjes që mbartte materialet që u duheshin. Peshkatarët ishin të lodhur, po nuk ishin të mërzitur. Kjo ishte një gjueti pa pushim, pa ndërprerje. I kishte munduar gjumi kryesisht po kishte pasur edhe net me det të fortë. Karakolli kishte qenë sëmure, po nuk kishte dëgjuar ta zbrisin në tokë. Ai vazhdoi kështu gjersa u kthyen. Në Vlorë i kishin sjellë mjekun në anije. «Është si një kockë deti... Po si e kanë mbajtur gjer në këtë moshë?» — ishte çuditur mjeku. Karakolli i kishte flakur në det ilaçet dhe kishte kërkuar supë merluci. Deni që munduar të kujdesej për të, po ishte tepër i ngathët përpara Ndoc Markut, që ishte si një amvisë e heshtur dhe komunikonte me sy. Binte tek-tuk ndonjë merluc në koshilok dhe ai duhej kërkuar në të gjitha anijet. U lodhën ditët e para, pastaj kushdo afrohej pranë «Pulëbardhës», hidhte merlucët që kishin zënë dhe jo vetëm anijet e sardeles, po dhe pellagjiket e bregdetit që e kishin marrë vesh që Karakolli donte merluc. Ky njeri kishte bërë emrin e vet në ato anë, emër që ndeshesh në të gjitha skelat. Deni ndiente njëfarë sigurie përpara tij, atë siguri që ndiejnë detarët kur e kanë farin përpara syve. Kur dilte në kuvertë dhe rrinte pak kohë i mbështetur pas direktut, ndërronte atmosfera e gjithë anijes. Sikur të mos e kishin bren-

da, do të ishte ndryshe. Ndryshe do të ishte sikur ta kishin lënë të sëmure në tokë, po ata e kishin me vete dhe u dukej se diçka mbartnin edhe ata nga sëmurdja e tij. Kur rrinte poshtë, ai merrej vesh me të gjithë përmes Ndoc Markut që i qëndronte te koka. Nuk e pyeste. Vetëm e dëgjonte Ndoc Markun që mbase nuk kishte folur kurrë aq në jetën e vet. Nuk e morën vesh ç'kishte dhe ndoshta këtë nuk e gjeti as mjeku. «Pleqëri», — u tha ai duke zbritur nga anija. «Pleqëri...» — u tha të gjithëve dhe Karakolli. E pyesnin ç'ndiente dhe Karakolli përgjigjej që ndiente pleqërinë... Deni e kishte gjetur përmbysh një pasdreke dhe kishte menduar që ai kishte mbaruar. Nuk kishte guxuar as ta prekte, as t'i thërriste. Atij i qe ftohur gjithçka përreth dhe kishte menduar me dhimbje se nuk do të mundte të punonte më në këtë anije që e kishte dashur aq shumë. Pastaj Karakolli i kishte thirrur në emër dhe e kishte bërë të hidhej përpjetë. E kishte porositur që, kur të lidheshin me radio me ndërmarrjen, të pyeste për Pashk Lulin... Një ditë tjetër ai i kishte thënë Denit që të mos kishin frikë. Ai nuk do të vdiste këtu. «Mbase nuk do të vdes edhe për shumë kohë. Nuk jam gati...» — i kishte thënë dhe e kishte trembur më shumë sesa t'i thoshte që ishte duke mbaruar në atë çast. Duke përjashtuar Karakollin, të tjerat kishin shkuar mbarë. «Pulëbardha» ishte pranë realizimit të planit vjetor dhe anijet e tjera nuk ishin keq. Peshkatarët kapardiseshin dhe binin në sy në skelat ku qëndronin. Në Sarandë e ndienin veten më ngrohtë, prandaj, me të zbritur në tokë, kërkonin me çdo kusht vëmendjen e të tjerëve. Nuk ishin ngatërrestarë, po nuk ia përtonin sherrit. Pika e dobët e tyre ishin restorantet dhe vëmendja e kamerierëve. Mjerë ata sikur të mos u kushtonin vëmendje! Motoristi i «Pulëbardhës» porosiste gjellë dhe pije për tre veta dhe mezi i çikte me dorë. Ai hante pak, po donte të tregonte që e prishte paranë pa dhimbje. Gjithnjë do të përplaste para të pathyera mbi tryezë dhe do të bënte patjetër

një vërejtje për pecetat, për kruarëset e dhëmbëve dhe letrat e holla të buzëve. Në këto raste Deni vinte buzën në gaz duke kujtuar tryezën e tyre në palmetë që nuk e kishte pastruar kurrë dhe çizmet që ia kishte hedhur në det. A i kishte harruar? Kështu ishte mbrujtur dhe Deni nuk kishte mundur ta ndryshonte. «Pulëbardhës» po i vinin përreth peshkatarët e vendit dhe të anijeve që pushonin aty. Pyesnin për Karakollin, pastaj hidheshin te gjuetia. Kaq të vyer ishin ata fenerët dhe hartat për të cilat kishin dëgjuar?

Një mbrëmje që pati furtunë në det, pak përpara se të ktheheshin, nëndrejtori i mblodhi në turizmin e Sarandës. E kërkoi Denin përkrah tij dhe në të djathtë nuk la të ulej askënd, megjithëse aty kishin vënë shishen e birrës dhe mezet. Menduan se mos priste njeri nga ata të Sarandës, po gjer në fund nuk erdhi kush dhe ajo karrige mbeti bosh. Qeshën e folën për gjithçka, vetëm për gjueti nuk folën. Nëndrejtori ishte në kulmin e gëzimit, megjithatë Denit nuk iu duk se kishte ndaj tij intimitetin e asaj mbrëmjeje kur i kishte thënë se donë ta kishte në rrethin e tij. Nga fundi e pa që ishte gabuar. Murat Nallbani i ishte afëruar te veshi dhe i kishte thënë: «Den! E kam ditur që e kam vendin mes jush...» Denit i ishte dukur se po shpërthente si pas një zbulimi të madh që nuk i takonte vetëm asaj nate, po gjithë asaj kohe që kur e kishte njohur. I ishte dukur sikur nëndrejtori nuk po merrej me gjë tjetër, veçse me zbulimin e vetvetes... Deni e kishte pyetur për shtëpinë dhe e kishte kuptuar sa ishte gabuar kur kishte menduar që nëndrejtori e kishte humbur intimitetin ndaj tij. Po edhe sikur të kishte ndodhur kështu, kjo nuk kishte rëndësi, rëndësi kishte si e gjykonte nëndrejtori Denin! «Riqoja është sëmurë! Ka thyer krahun!» — i kishte thënë nëndrejtori. Deni e kishte parë në fytyrë dhe kishte rrezatuar mbi të mallin për Riqon. Djali i ishte vjedhur që prej asaj dite që ai e kishte zbuar pa menduar gjatë. E kishte kërkuar gjithandej përpara se të niseshin, po nuk

e kishte gjetur. E dinte që ai ishte diku dhe e përgjonte ndërsa e kërkonte, po mbahej prapë pas zemërimit të tij. «Kanë demaskuar Salkën!» — i dha lajmin e dytë nëndrejtori. Megjithëse kjo nuk ishte asgjë përpara Riqos, ai e kishte pyetur pse e kishin demaskuar Salkën. «Për ungjijtë! Për llapën e gjatë», — ishte përgjigjur Murat Nallbani duke qeshur. Salka kishte thënë që «zoti i kishte zbritur nga qielli ungjijtë e parë dhe tani i kishte nxjerrë nga deti të fundit!» «Po i thyjnë derën Gjon Kabashit për të bijën...» — i kishte dhënë lajmin e tretë nëndrejtori dhe me kaq kishte marrë fund intimiteti në mes tyre për atë natë. Deni e kishte lënë gotën përmbi tryezë. Cili nga të tri lajmet kishte qenë më i keq? Ai nuk kishte pse të gëzohej as për Salkën. E kishin demaskuar? Mirë ia kishin bërë, se ajo diku gjente një vesh të humbur për thashethemet e saj... Nuk kishte folur gjersa ishin ngritur, po, me të dalë, ai e kishte pyetur nëndrejtorin mos ishte fejuar Rasha. «Në mos është fejuar, aty rrotull është...» — i qe përgjigjur ai pa i dhënë rëndësi pyetjes së Denit. Ishte bërë në qejf dhe kishte filluar të këndonte me zë të ulët. Kishin kënduar edhe të tjerët, ashtu lehtë edhe ata dhe, kur ndonjëri e ngrinte zërin, nëndrejtori ulte gishin poshtë si të ishte baketi dirigjenti. Ai kishte urdhëruar të merrnin nga një pjatë nga të gjitha mezet që ishin përpara karriges bosh. Kishte bërë fjalë me kamerierin që nuk donte të linte pjatat jashtë lokalit dhe i ishte turrur edhe motoristit që i kishte vënë një 100-lekëshe nën hundë kamerierit për garanci. «Mua, ose do të më besojnë pa para, ose nuk dua të më besojnë fare!» — i kishte thënë duke ia larguar dorën. Ku kishte ndër mend të shkonte ai me ato meze dhe atë birrë? Do të ngjitej në hotel dhe do të vazhdonte pijen? I kishte lënë të gjithë gojëhapur kur kishte dalë në rrugë dhe kishte marë drejtimin e skelës. Anijet ishin aty dhe ai ishte ndarë me ekuipazhin e secilës. Në fund të gjitha pjatat u kishin mbetur në duar atyre të «Pulëbardhës». Ishin ngjitur dhe ishin futur me-

njëherë në palmetë. Karakolli rrinte ndenjtur në shtrat dhe nuk dukej keq. Nëndrejtori u kishte thënë t'i linin mezet dhe birrën mbi tryezë, pastaj e kishte ndihmuar Karakollin të ngrihej. Karrigia bosh kishte qenë për të...

Deni kërkonte briskun e rrojës. I mërziti të gjithë duke i pyetur. Kush dreqin ia kishte marrë briskun? Taushi rrinte drejt si qiri. Ai qe rruar pak përpara, po nuk luante asnjë qepallë, sado që Deni ishte i bindur që ia kishte marrë. Ia bënte shpesh këtë punë dhe Deni nuk i thoshte gjë. Kishte ndodhur të zbriste me mjekër në tokë për shkak të tij.

— Po më preke më veglat e rojës, do të ta marr shpirtin! — i tha ai Taushit dhe hoqi dorë nga të rruarit. U ul në anën e anijes dhe priti të hynin në port. Kishte një shpirt të amullt, të trazuar dhe nuk ndiente asnjë kënaqësi që po kthehej. Megjithatë do të takonte nënën, Markun, Riçon... Kur rrinte shtrirë dhe priste të shkonte ora për në punë, e ëma shkonte e vinte nëpër sallon dhe e mërziste me ato ankime të saj për detin dhe për të zënë një grua. «O zër një grua, o ika te dajat e tu! Nuk do të rri të ruaj shtëpinë si kukudhe, ndërsa ti harbohesh në det!» «Mirë! Do të hedh lakun...» — bënte shaka ai. Përpara asaj darkës me nëndrejtorin kishte menduar të takonte edhe Rashën, po tani kjo nuk kishte rëndësi. Atij iu duk se tani nuk kishte rëndësi asgjë. Kishte blerë një vazo druri për Rashën nga ato të artistikes së Vlorës dhe e kishte aty mbi kuvertë. I kishte ngjitur përpara të gjithëve teshat e tij lart, po tani i dukej se i kishte ngjitur kot dhe se ai nuk do të zbriste në tokë. I vërtitej Rasha nëpër kokë dhe mendonte që ai nuk mund të duronte të sillej nëpër qytezë me të fejuarin për kra-

hu. Ai provoi të njëjtën ndjenjë që kishte provuar kur kishte menduar që kishte mbaruar Karakolli. I vinte keq ta linte atë qytezë...

Karakolli i kishte çuditur të gjithë atë mëngjes. Ishte ngritur herët, ishte rruar dhe kishte ndërruar këmbishën. Tani rrinte në kuvertë dhe, duke e parë atë në këmbë, Deni mendonte se ato tri javë kishin qenë një ëndërr.

— Den! Po hyjmë në vjeshtë! — tha Karakolli sikur t'i thoshte «po hyjmë në port».

Ishte fund gushti, po vjeshta në këto anë niste nga gjysma e tetorit e mbase dhe nga fundi i tij. Megjithatë Denit iu duk se Karakolli e gjeti atë që ndiente në shpirt. Ai vështroi vazon që kishte blerë, e mori në duar dhe deshi ta hidhte në det.

— Druri del prapë në breg... — u kthye nga ai me sy të qeshur Karakolli.

Deni u bë nervoz. Le të ishte kush të ishte! Le të ishte Zeusi i gjithësisë, po nuk i duhej gjë të fuste hundët me atë zgjuarsinë e tij tinëzare në punët e tij!

— Edhe ne po dalim në breg! Gjithçka del në breg... — tha Karakolli duke e mbështjellë prapë me atë buzëqeshjen e tij të mirë.

E theu pas kësaj, e dërrmoi. A do të pranonte plaku ta përqafonte? Karakolli nuk i donte këto gjëra dhe ai nuk luajti nga vendi. Karakolli tallej me burrat kur i shihte duke u puthur faqe në faqe... Ai kishte thënë njëherë që burrat duhet të afroreshin vetëm kokë në kokë dhe aq...

— Karakoll! A ke gabuar ndonjëherë në jetë? — pyeti befas Deni.

Tjetri e vështroi me vëmendje. Sytë e tij kishin nisur të merrnin prapë gjallërinë e parë.

— Më thuaj kur nuk kam gabuar... Po, të thashë, gjithmonë dilet në breg... — u përgjigj ai dhe sytë iu mbushën me një dritë të mirë.

«Ehu.. Nuk arrihet më Rasha...» — tha Deni me vete.

— E sheh? Ai po më pret! — tha Karakolli duke zgjatur dorën drejt molos ku kishte aq shumë njerëz sa nuk ishte e mundur të dallohej askush.

Deni e dinte për cilin e kishte.

— Pashk Luli... — tha plaku.

Denit iu duk se shqiptoi «Rasha»...

Nuk i iku dot nëndrejtorit.

— Ik dhe rruhu! Nuk ka as nga ata të filmit që të ngatërrohesh me ta... — i tha nëndrejtori.

— Mirë, mirë... — nuk i dha rëndësi Deni.

Ai çau përmes grumbullit të mjeteve dhe njerëzve që kishin zënë molon dhe doli në rrugë pa u takuar me njeri tjetër. Në rrugë sesi i hipi në kokë që mund të takonte Rashën. Rashën me atë tjetrin... Ç'do të bënte po t'i shihte për krahu? «Ç'do të bëj? Do të ha një bajgë të madhe!» — tha me vete ai.

U kishin thënë të prisnin në ndërmarrje, po ai vazhdoi rrugën. Mendoi që ishte mirë që nuk kishin më shumë se tri ditë pushim. Ato tri ditë do të mbyllej në shtëpi, pastaj prapë deti... Pastaj mendoi që në shtëpi ishte mirë vetëm natën... Shtëpia ishte e natës... Tri ditë kishte ndenjtur mbyllur, një herë nga gripi dhe do të kishte luajtur mendsh sikur të mos kishte dalë. «Vetëm ekstrahumanët i bëjnë ballë kështu kësaj temperature! Shih mos je nga ata...» — ishte tallur doktor Marku. «Ç'bënte ai? Kishte pyetur dispeçerin në radio për të dhe ai i kishte thënë që e kishin dekoruar. Përmes radios nganjëherë dispeçeri i kishte lejuar vetes shaka të tepruara, si ajo kur kishte thënë të lajmëronin Taushin se i kishte ikur e shoqja... Dekorimi i Markut nuk ishte shaka. Deni do të shkante ta uronte dhe e merrte me mend përgjigjen e tij. «Gjysma e dekoratës më takon mua, gjysma detit! Jemi dy mjekë

këtu e mbase i takon krejt detit...» — do t'i thoshte ai.

Në farmaci nuk kishte asnjëri. Rasha rrinte me kokën ulur dhe mbështillte tabletat në ato letrat e bardha. E kishte inat kur e shihte kështu, se i dukej si Gjon Kabashi duke trazuar me dorë sardelet.

E vështroi nga xhamat dhe iu duk po ajo Rasha që kishte njohur gjithnjë, po ajo Rashë që ai e tërhiqte nga flokët dhe e rrëzonte në rërë. Kohët ishin larguar, ishin larguar edhe ata, megjithatë ai e ndiente herë pas here atë shtëllungën e flokëve të saj përsëri në dorë... Ai u mundua të gjente një ndryshim në fytyrën e saj, po nuk gjeti gjë. Ajo gjithnjë rregullohej fare pak dhe ikte nga shtëpia me dy-tri të dhëna krehri, sikur të mos donte të nxirrte më në pah bukurinë e saj disi të ashpër, Si mund të fejohej, kur ishte po ajo Rashë? Ai mendoi që duhet të ishte ndryshe, pa ditur aspak se si duhet të ishte... E kishte parë nga larg duke mbështjellë ato tabletat, po tani nuk guxonte t'i ulte sytë te duart e saj. Ndryshe ajo mund të ishte me një unazë në gisht...

U zemërua me veten. Rrethi në gisht ishte një banalitet përpara fytyrës së qetë të Rashës. A mund të ecnin krah për krah hekuri dhe shpirti? As diamanti dhe shpirti nuk mund të ecnin krah për krah... Ai hyri brenda dhe e vuri mbi banak atë vazën e drunjte duke e zgjatur krahun mbi ata xhamat që i kishte aq inat. Në fëmijëri ata nuk kishin pasur një xham të tillë ndërmjet tyre, në fëmijëri gjithçka kishte qenë e thjeshtë dhe pa stërholime.

Ai kishte menduar t'ia linte vazën dhe të ikte, po e mbajti vështrimi i saj i zemëruar. Kështu shihte ajo klientët e huaj dhe kokëfortë që i ndërhyenin në punën e saj. Ishte gati një vështrim fyes, përbuzës. Atëherë ai besoi se ajo ishte fejuar me të vërtetë dhe ndenji më shumë për të ndëshkuar veten, sesa për të marrë vesh të vërtetën. Ç'kishte dashur ai gjithë këto vite nga kjo vajzë? Ç'kishte pritur? Ai ndihej i fyer duke e ditur mirë që Rasha nuk i kishte asnjë faj! Ndihej

i braktisur duke e ditur mirë që nuk kishte asnjë peng të lidhur me atë vajzë! Ndihej i mënjanuar përgjithnjë nga jeta e saj duke e ditur që nuk ishte përpjekur kurrë të futej tërësisht në jetën e saj! Nuk kishte asnjë arsye t'i ndiente këto dhe prapë i ndiente.

Rasha e rrotulloi vazon nëpër duar.

— Ti gjithnjë ke menduar se mund të më kthesh nga të duash si kjo vazo... — tha ajo qetësisht.

Mbase nuk kishte shumë të drejtë. Ai kishte menduar që me të asgjë nuk mund të ndryshonte dhe se çdo gjë do të mbetej brenda atij intimiteti të përjetshëm kur rrëzonin njëri-tjetrin në rërë.

Ai nuk gjeti një fjalë, një përgjigje dhe nisi t'i binte xhamit me nervozitet. E zemëroi më keq kështu.

— Edhe këtë vazo ke menduar se duhet ta pranoj vetëm e vetëm se e ke sjellë ti...

Tani ajo nuk kishte të drejtë. Atij i kishte tërhequr vëmendjen ajo gjë e bukur në vitrinë dhe e kishte blerë. Vetëm pasi i kishte dhënë paratë kishte menduar se kjo bënte për Rashën.

«Paska marë fund kjo punë...» — tha Deni me vete.

— Po unë nuk kam ç'ta bëj tani këtë vazo se më ka ardhur këtu! — tha vajza duke vënë dorën në hundë.

«Mbushe me aspirina», — deshi t'i thoshte ai pas natyrës së tij, po nuk tha kështu.

— Mbaje dhe më kujto për keq! — i tha ai jashtë natyrës së tij.

XIX

Kurrë nuk e kishte menduar që do të largohej aq nga ai njeri! Ishin nga i njëjti vend dhe kishin punuar për shumë vjet në peshkim. Bashkë e kishin ndarë të mirën dhe të keqen dhe kishte pasur mjaft raste që ai i kishte besuar verbërisht shefit të kuadrit. Iu kujtua që drejtori kishte qenë i prerë dhe i matur me të. Kur iu desh atij ta zëvendësonte, nuk kishte ditur ta ruante këtë distancë. Nuk kishte mbajtur distancë me asnjeri dhe kjo kishte qenë edhe e mira edhe e keqja e tij! Një dobësi ia kishte ditur gjithnjë, po e kishte lexuar në plan të dytë: në të mirë shefi i kuadrit ishte përkrah tij dhe të tjerëve; në të keqe e linte në ballë nëndrejtorin me gjithë të tjerët. Dilte ndonjë e papritur dhe ai tërhoqej duke thënë: «Ju kam paralajmëruar!» Dhe asnjeri nuk ishte në gjendje të thoshte nëse i kishte paralajmëruar vërtet, sepse ai bënte para-

prakisht paralajmërimi për të qenë brenda. Duke qenë kështu, si mund të dyshohej që ai nuk kishte folur për ndonjë të papritur që mund të ndodhte?

— Unë ngul këmbë që në gjendjen e krijuar ai duhet të largohet nga «Pulëbardha»! T'i gjejmë një anije tjetër, shoku Murat, — tha tani duke picërruar sytë.

— Unë nuk mendoj kështu! — u përgjigj ftohtë nëndrejtori.

— Nuk e këni drejt dhe as ata të «Pulëbardhës» nuk e kanë drejt me motoristin...

— Përse mendon kështu? — pyeti gati pa interes nëndrejtori. Kishte kohë që e duronte këtë njeri vetëm për qëllime administrative.

— Në këtë ekuipazh dominon elementi pa parti dhe si të thuash... Dua të them që kemi vetëm një komunist dhe...

— Thuaj më mirë që ai ekuipazh është në ballë të situatës dhe po na zbardh faqen! Thuaj më mirë që ai ekuipazh me të rinj dhe të vjetër i ka vënë gjoksin së resë dhe po çan përpara! Thuaj më mirë që ishte komunisti i «Pulëbardhës» ai që foli më ashpër kundër motoristit!

— Që kur morëm atë Denin në punë...

— Që kur morëm atë veç mirë kanë shkuar punët! — e ndërpreu nëndrejtori me të ashpër.

— Desha të them që ka një përçarje në kolektiv...

— Do të doja të thosha që asnjëherë nuk ka qenë ai kolektiv më i bashkuar dhe yçkla nxjerr vetëm Zegiri!

— Për mua...

— Prit! Ai ka qenë më afër nesh se kushdo nga peshkatarët e tjerë dhe ne të dy një kohë gdhinim e ngryseshim me të...

— Hë, pra! Nuk marr vesh si u rrokullisën kështu punët dhe nuk po merremi vesh... — tha me shpresë shefi i kuadrit.

— Punët janë rrokullisur si s'ka më mirë, pa ta-

raflëqe dhe oportunizëm, po kjo është tjetër gjë! Unë do të doja të të bëja një pyetje, megjithëse e ka për detyrë sekretari i Partisë. Ti ke mbështetur kërkesën e Zeqirit për të hyrë në Parti. A qëndron prapë në këtë mendim pas ballafaqimit që bëri organizata me kolektivin e «Pulëbardhës»? Në organizatë kishte mendime të ndryshme për të. Kundër pranimit të Zeqirit jam edhe unë...

Shefi i kuadrit u turbullua. Nuk e priste këtë pyetje Ballafaqimi me kolektivin e «Pulëbardhës» e kishte tronditur. Zeqirin specialist e kishte ndier në qiell, Zeqirin njeri përdhe... U ishte dashur kohë për t'i bërë të flisnin ata të «Pulëbardhës», se rrinin si të mpirë, si të tronditur. Kishin kërkuar mendimin e kapitenit në fillim. «Kam shumë shokë komunistë, po më duket se kanë hyrë në Parti me një shpirt tjetër... Po Zeqiri? Ai gjallërohet vetëm kur flitet për para! Karburanti i tij është paraja! As ne nuk kemi dalë të punojmë badjava, po nuk na shkon ndër mend sa do të fitojmë kur jemi duke nxjerrë koshilokun nga deti. Kur nisëm eksperimentimin, ai ka dashur të largohet nga ne pas atyre dështimeve që patëm dhe shoku Murat mund ta dijë më mirë këtë!» — kishte sqaruar nëndrejtori. «Si të mos kërkoja kur më kishin vënë këmbën në shpinë?» — ishte hedhur motoristi. «Në shpinë ke vënë trastën me sardele çdo ditë!» — nuk ishte përmbajtur Pali. Pas kësaj kishte ndërhyrë Samiu. Duhej diskutuar me rregull dhe pa pasion. «Në rregull! Për specialist? Lërja atij motorin dhe mos, e nga! Si njeri... Nuk është i formuar si njeri! Rend pas interesit dhe jo vetëm që nuk na është bërë mbështetje, po na ka dëmtuar dhe mërzhitur me atë ironinë e tij! Si mund të kërkojë të hyjë në Parti një njeri që nuk i vë gjoksin së resë? Unë mendoj që është ende i papërgatitur për këtë, po gjithashtu mendoj që Zeqiri mund të bëhet për të hyrë në Parti më vonë, kur ta shohë më mirë veten. Ai e do punën, e do dhe zanatin e tij dhe kjo është gjë e mirë!» — kishte përfunduar

Pali. Pak a shumë të gjithë kishin thënë të njëjtën gjë. Karakolli kishte thënë se komunisti duhet të jetë si qelibari dhe Zeqiri nuk ishte ashtu. «Nuk ka si të jetë ashtu, ai është gjithë naftë», — ia kishte këputur Taushi. Sekretari i Partisë e kishte vështruar ashpër dhe ai ishte ngritur në këmbë si i hutuar. «Ai e ka hallin tjetërkund, mor dajë...» — kishte thënë ai dhe gati sa nuk e kishte kthyer në gaz mbledhjen. «Nuk përdoren këtu këto shprehje rrugësh!» — mezi e kishte mbajtur veten Samiu. «Vjet, mor da... Vjet pra, — për pak sa nuk kishte gabuar prapë Taushi, — Zeqiri u përpoq të shkonte motorist me një anije nga ato të mëdhatë që dalin përjashta dhe nuk e morën. E dini si më tha? Të isha në Parti, unë isha përjashta tani!» E kishin dëgjuar me kokën ulur, megjithëse mund të ishte gjëja më thelbësore ajo që kishte thënë ai për Zeqirin. Deni nuk kishte thënë asgjë kundër tij drejtpërsëdrejti, po ajo që kishte thënë për vete binte mbi motoristin. «Unë jam 27 vjeç dhe e dua këtë punë që kam, e dua detin dhe njerëzit e tij. Më duket se në këtë punë ku jam kam gjetur jetën dhe gëzimin. Unë do të bëj kërkesë për të hyrë në Parti pas dy vjetësh vetëm po të kem këtë besim që kam sot në veten time!»

— Kërkesën e shokut Zeqir për të hyrë në Parti e kanë mbështetur edhe të tjerë përveç meje... — i bëri bisht përgjigjes shefi i kuadrit.

— Gjashtë muaj përpara do ta mbështetja edhe unë, po sot jam kundër! Partia nuk është një trampolin për të arritur qëllime personale, po një fushë sakrificash dhe idealesh të mëdha që nuk i shoh tani te shoku Zeqir!

— Mbase! Mbase... — u tërhoq shefi i kuadrit.

— Kjo punë nuk mbyllet me një «mbase», «mbase»...

— Organizata akoma nuk ka vendosur për këtë çështje...

— Do të vendosë dhe do të vendosë me pjekuri!

— Nuk ka asnjë dyshim... — foli si një automat shefi i kuadrit.

Nëndrejtori u ngrit dhe iu afrua.

— E di ç'kam ndër mend të bëj unë në mbledhjen e parë të organizatës? Do të them një për një kush kam qenë dhe ç'kam bërë, megjithëse askush nuk ma ka kërkuar një gjë të tillë dhe, po deshe të dish, kanë kërkuar diçka tjetër nga unë.

«E di! Duan të të bëjnë drejtor!» — tha me vete shefi i kuadrit që merrte vesh çdo gjë para të gjithëve.

— Do të them një për një, pra... Pse nuk bën edhe ti si unë? Po ta them shoqërisht këtë.

— Ç'hyj unë këtu? Kam menduar që Zeqiri e meriton genien në Parti? — u zbeh shefi i kuadrit.

Nëndrejtori qeshi nën buzë.

— Ti e di që unë nuk e kam për Zeqirin, po për qëndrimin tënd. Ke qëndruar i mënjanuar kohët e fundit, po kështu nuk rregullon asgjë nga e kaluara.

— Këtu është krijuar një klimë jo e mirë për mua. Do të ishte mirë që unë të largohesha nga kjo ndërmarrje! — tha ftohtë shefi i kuadrit.

— E di si e shoh unë këtë? Si një përpjekje për të mos u ndrequr dhe për të qëndruar në pozitë e para! Për mua edhe mbështetja që i ke bërë Zeqirit për të hyrë në Parti nuk është bërë nga pozita të tjera veç atyre të familjaritetit të sëmurë!

— Çdo gjë mund të kisha menduar, po se do të arrinte një ditë që ne të flisnim kështu... — tundi kokën si me dhimbje shefi i kuadrit. Ai e la si përgjysmë fjalën me qëllim.

— Ti nuk kupton! Asgjë nuk kupton! — Nëndrejtori zuri të vërtitej nëpër zyrë, pastaj iu afrua me vrull shefit të kuadrit. — Kam qenë edhe unë kështu si ti! Ti të gjitha i kupton dhe nuk do t'i kuptosh! Nuk kam ç'të të them tjetër! — Ai u ul përpara tryezës dhe zuri të merrej me shkresat që ishin aty. Tani nuk i bënte asnjë përshtypje tjetri që rrinte përpara tij.

— A mund të të kërkoj diçka miqësisht?

Shefi heshti. Kishte dashur t'i thoshte të mos e pengonte, po t'i mbushej mendja të largohej nga ndër-marrja, po se pse u zemërua dhe ngriti krye.

— Unë nuk jam mish i ngordhur, o Murat Nallbani! — tha.

— As unë nuk jam kasap! Unë mund të të gjykoj vetëm si njeri... Po pse ta zgjasim? Më duket se mbaruam punë! — u tregua i duruar tjetri.

— Disave u numërohet qimja, disave nuk u shihet trau... — murmuriti.

— A nuk të duket se mbaruam punë? — vazhdoi ta mbante veten nëndrejtori.

— Disa ngjiten në përgjegjësi dhe harrojnë miqtë...

— Mjaft! — i ra tryezës.

U hap dera. Sekretari i Partisë erdhi si me porosi. Pas tij hyri kryeinxhinieri me një gazetë në dorë. Ai ishte i skuqur dhe i emocionuar.

— Këtu kanë shkruar për ne! — tha duke tundur gazetën.

— E kanë tepruar me lëvdatat dhe i kanë rënë anash me kritikatat... — tha Murat Nallbani. Ai u shkar-kua përnjëherësh nga tensioni që kishte ndër pak përpara. Ndërmarrja lavdërohej për tejkalim plani në global dhe kritikohesh në njëfarë mënyre për mosrealizimin në të gjithë zërat. Shkrimi merrej me njerëzit e punës dhe metodat e reja të punës. Ishte shkruar me ndjenjë dhe me tonin e një reportazhi letrar. Autori kishte një kënd vështrimi origjinal ku gërshetoheshin mendimet me gjendjen e tij shpirtërore përpara këty-re njerëzve...

... Mendime të çuditshme më përshkojnë kokën. Unë jam një rastësi sonte në det, jam i përkohshëm, siç janë të tillë pjesa dërrmuese e njerëzimit, ndërsa këta që kam rrotull nëpër kuvertë nuk janë të përkohshëm... Më vjen të mendoj që ata kanë dy jetë, atë të tokës dhe atë të detit, më vjen të mendoj që jetojnë dyfish! Shtyhem më tej në ato arsyetimet e mia të trazuar nga lëkundja e detit dhe mendoj që këta njerëz megjithatë

nuk kanë një personalitet të dyfishtë, po të unjisuar mes harmonisë së përgjithshme të natyrës. Ndoc Marku i zgjat një vile rrushi Karakollit, këtij eshtaku të vjetër të detit. Ai e ngre lart, e sheh si një mrekulli të natyrës, pastaj e lë mbi një arkë. Atë e përlan Taushi. Karakolli! Kush është ky njeri? Mos është një apendiks i detit që ka arritur heroikisht gjer në epokën tonë? Unë arrita ta shoh Karakollin duke njohur Denin! Deni dhe të tjerët janë në ballë, po Karakolli as ka mbetur pas tyre, as është përpjekur t'u pengojë rrugën. Te «Pulëbardha» ecin krah për krah breza të ndryshëm dhe kjo është garanci për të shkuar përpara... — kishte shkruar ndër të tjera gazetari.

— Na xori nga balta sardelja, po me pellagjikët jemi prapa... Kështu e kupton tejkalimin e planit edhe gazetari, — tha nëndrejtori.

— Më duket se ai merret më shumë me «tejkalimin» e vetes sonë, me përpjekjet që jemi munduar të bëjmë për të arritur te mentaliteti bashkëkohor i marrëdhënieve në punë, në drejtim dhe në shkencë! — tha Samiu.

— Nga unë nuk ka marrë gjë... — tha si me turp nëndrejtori.

— Në mos i pastë nga ti, i ka nga unë dhe nga përfundimet që ka nxjerrë vetë! Ai kishte një sy depërtues dhe një dell poetik! — tha Samiu.

— Këtu ishte pak përpara Zeneli... — tha krejt pa lidhje nëndrejtori ngaqë nuk po e shihte në zyrë. Nuk e kishte marrë vesh kur kishte ikur.

— E pastaj? — pyeti Samiu.

— Jam bërë i urtë, i durueshëm! Jam bërë një drejtues model... — tha me mërzi nëndrejtori. Ai u kthye nga kryeinxhinieri dhe e pyeti nëse i kishte mbaruar të gjitha punët për të cilat kishte shkuar në Durrës. Tjetri i tha një për një punët që kishte kryer. Kishte gjetur edhe llamba me rezistencë të madhe, kështu që mund t'i zëvendësonin ata fenerët...

— Jo! Duhet të mbeten, se i keni bërë me dorën

tuaj! Llambat jepua të tjerëve! — tha nëndrejtori.
Kryeinxhinieri foli për materialet e tjera dhe gjendjen e tyre. Koshiloku i tonit do të përfundonte për dy-tri ditë. Ishin në kohë. Toni po dukej aty-këtu dhe pritëshin masat e mëdha të peshkut...

— Mos e zgjat shumë hundën nga ajo gazetë... — i tha me të mirë nëndrejtori duke sjellë ndër mend ç'ishte shkruar për kryeinxhinierin.

— Do ta mbaj hundën në nivelin e detit! — u përgjigj Landi dhe doli.

— Ç'djalë i mirë... — psherëtiu nëndrejtori.

Tjetri e mbajti veten. Deshi t'i thoshte që vetëm tani e merre vesh si duhet sa djalë i mirë ishte kryeinxhinieri!

— Sikur the që ishte shefi i kuadrit?

Tjetri ia tha me pak fjalë ç'kishte ndodhur.

— A mos duhet larguar motoristi nga «Pulëbardha»?

— A e ka me të drejtë ekuipazhi i saj?

— Jam i bindur për këtë!

— Atëherë nuk duhet larguar! Ka të bëjë me njerëz të ndershëm dhe me ta duhet të rrijë!

— Ç'vendim mund të marrë organizata?

— Për mua tani për tani ai nuk i plotëson konditat për të qenë në Parti! Organizata le të vendosë vetë...

— Më zemëroi! Më futi në të turbullt...

— Ç'mund të bëhet me Zenelin? A mund t'i nënshtrohet një kritike dhe autokritike të vërtetë?

— Nuk e di... Tani mendoj që çalon në të dy krahet, si mendim dhe si karakter... Mos më thuaj që këto janë e njëjta gjë, se më ngatërron... Si mendim ka një praktikë të vjetër të cilën e quan të pandryshuar dhe që nuk duhet prekur! Pra si mendim është konservator. Si karakter... E ke njohur vetë. Ja, të të them për vete... Kam bërë gabime këtu dhe mund të vazhdoj të bëj kryesisht për forcë zakoni... Ashtu jam nisur dhe ashtu kam vazhduar. Përgjithësisht nuk i kam pasur bindje gabimet e mia... Sa për Zene-

lin... Më duket se kërkon të ikë! Dhe e di pse? «Dua të iki! E kam më lehtë të filloj nga e para në një ndërmarrje të re, sesa të filloj nga e para në një ndërmarrje të vjetër», ka thënë këto ditë.

— Me një fjalë ai e kupton reflektimin e veprimeve të tij si një transferim nga një ndërmarrje në një tjetër... — u vrenjt Samiu.

— Sedra qenka gjë e madhe! Kushedi si do t'i dukej, po të fillonte të reflektonte këtu ku është...

— Megjithatë nuk i kemi shkuar gjer në fund as Zenelit siç nuk i kemi shkuar as vetes! Duhet shkundur miqësisht e me takt një herë ai... Po, ta lëmë atë. A ke nevojë të shqyresh gazit? Ec të shohësh atë kursin e kualifikimit që drejton kryeinxhinieri.

Zbritën. Poshtë shkallëve nëndrejtori e pyeti Samiun ç'do të bënte pasdreke.

— Kam dy javë pa dalë në plazh...

— Taushi? — buzëqeshi Murat Nallbani.

— Taushi!

— I thartove trutë me shah!

— Ç'të bëjmë! Kemi edhe të meta, shoku drejtor!

— Fillove? Nuk po pret as të më sjellin patentën!

— u ngrys nëndrejtori, po tjetri i rrahu krahët.

Dera ishte e hapur dhe ata hynë pa u ndier në sallën ku ishin grumbulluar peshkatarët.

— Jo! Njëqind herë jo! Ky është profanizëm! — thirri kryeinxhinieri që rrinte para dërrasës së zezë ku ishin vizatuar anije dhe shigjeta që shponin detin. Me sa duket e kishte me kapitenin e «Jezerçës» që rrinte në këmbë.

Samiu i ra me bërryl nëndrejtorit.

— Profanizëm... — i pëshpëriti ai gati t'ia plaste gazit.

— Refleksi ynë duhet të jetë më i shpejtë se refleksi i tonit dhe ai nuk duhet të na dalë nga rrethimi...

Samiu i ra prapë me bërryl nëndrejtorit.

— Refleksi... — i pëshpëriti ai.

Dolën pa u parë dhe e lanë kryeinxhinierin të derdhte në qetësi të gjithë arsenalin e tij teorik. Samiu kishte punë në oficinë, ndërsa tjetri u ngjiti në zyrën e tij. Kishte një tog shkresash për të parë. I rrotulloi nëpër duar dhe i la. Nuk i bëhej të hidhte firmën. Këtej e tutje nuk do të firmoste për drejtorin, po si drejtor...

U afrua te dritarja. Vitet e fundit ndërrimin e stinëve e kishte ndier nga deti. Ai bëhej si i bardhë në prag të vjeshtës. Kështu i dukej. I bardhë në prag të vjeshtës, pastaj terratisej në një të kaltër të egër dhe të ngrysur nëpër rrugët e dimrit. E kishte filluar me të ftohtë këtë verë dhe kishte ardhur duke u nxehur gjer në fund të saj. Tani ndiente një të dridhur të lehtë dhe ajo nuk i vinte nga moti. Ai mendoi që, veç optimizmit, gjithkush duhet të kishte një të dridhur të lehtë kur ngrihej në përgjegjësi, nëse e ndiente përgjegjësinë dhe e shihte veten realisht...

XX

Rrinin në kuvertë me veshin nga motori që punonte keq. Kështu kishin ardhur gjer aty çalë-çalë dhe kështu dukej se do të vazhdonin. Pas asaj mbledhjes motoristi i kishte prerë lidhjet me ta dhe rrinte në të ndarën e tij. Ai nuk e kishte nxjerrë kokën asnjëherë jashtë, madje e kishte tërhequr edhe atë dërrasën sipër, pa pyetur për të nxehtë e madh.

Deni ishte mbështetur pas anës së anijes dhe kishte shtrirë këmbët. Në të djathtë kishte Taushin, në të mëngjër Ndoc Markun. Gjithë kohën Taushi ishte ankuar se atë nuk e kishte nxjerrë dhe as do ta nxirrite njeri në gazetë edhe sikur të rimorkionte gjer në breg çdo ditë nga një balenë.

Deni e kishte mendjen te Rasha. Nuk kishte qenë gjë ajo puna e fejesës dhe ai e ndiente veten të turpëruar. «A e di se po sillesh si kalorës : vërtetë? Ke

nisur të sjellësh dhurata...» — e kishte ngacmuar doktor Marku. Më tej ai i kishte thënë se e shihte më të menduar, më të sjellshëm dhe më human... E kishte përsëritur edhe një herë fjalën «human» dhe të gjitha këto sipas tij tregonin që Deni kishte rënë në dashuri. «Ike dhe ti! Mbarove...» — ishte tallur mjeku. Mezi e kishte detyruar ta dëgjonte. I kishte thënë se nuk ndihej mirë. Bënte gjumë të rëndë dhe gjithë ëndrra të frikshme. «Natyrisht...» — kishte vënë buzën në gaz mjeku duke aluduar për ato që kishte thënë pak përpara. Pastaj i kishte kërkuar t'i tregonte një ëndërr. «Mos do të tallesh? Nuk ta fal këtë...» — ishte ngrysur Deni. Mjeku nuk tallej dhe ai i kishte thënë që prej disa netësh i mbushej deti me ato kryqet dhe shenjtorët prej plastmase! Gjithë deti me kryqe dhe shenjtorë dhe asnjë pëllëmbë det! Gjithë rrjetat me kryqe dhe shenjtorë dhe asnjë bisht peshku! «Nganjëherë më afrohen ungjijtë e përmbysur me ato kopertinat e zeza dhe të rënda në breg të detit dhe rrahin fletët ashpër gjersa shndërrohen në lakuriqë nate të stërmëdhenj që më sulen të më mbysin...» — i kishte thënë Deni. «Mos u ke dhënë shumë rëndësi atyre?» — e kishte pyetur mjeku. «Si të them... As pa rëndësi nuk i kam marrë. Është një formë e agresionit ideologjik!» — ishte përgjigjur Deni. «Të ka bërë përshtypje rruga e veçantë dhe disi origjinale e këtij agresioni, prandaj të është ngulitur kështu në tru. Gjersa flasim për agresion, duhet ta quash si gjithë agresionet e tjera dhe do të shokthin e vërtetë e ke pasur nga diçka tjetër...» — kishte menduar Deni dhe nuk kishte dëgjuar të merrte as valium, as luminal.

— Ajo nuk është mirë... — i pëshpëriti Ndoc Marku dhe Denit iu duk sikur i tha që nuk ishte mirë Rasha. Tjetri e kishte për Marën. Kishte arritur ta merrte në shtëpi.

— Është sëmurë?

— Nuk e di! Ikën pas mesit të natës dhe merr bregun. Fillon mbas molos dhe shtyhet aq larg, sa mezi kthehet... — tha me zë të ulët Ndoc Marku.

— I je ngjitur pas? .

— Këu t'i ngjitem? Natën jam këtu! Më thonë ata të shtëpisë...

Motori punonte përherë e më keq. Kjo kishte shkaktuar një gjendje nervozizmi të të gjithë.

— A nuk zbret një herë nga ai? — i tha kapiteni Denit si me dyshim. As ai nuk ishte i bindur nëse duhet ta çonte Denin atje.

Deni vështroi Karakollin. Ai nuk i dha asnjë shprehje. Në det nuk ishte e lehtë t'i përziheshe tjetrit në profesion...

Deni tërhoqi kapakun dhe u fut në vendin e motorit. Zeqiri ishte mbështetur diku. Qe i larë në djersë, po me sa dukej nuk po e vriste mendjen për motorin.

Denit i erdhi ta përfshinte për gryke dhe ta ngjiste ashtu gjer në kuvertë, po pastaj ra pak nga pak dhe gjithë zemërimin e hodhi pa të drejtë nga ajo masë e nxehur hekuri që nuk punonte mirë.

— Më duket se duhen pastruar filtrat dhe...

Nuk i tha fjalët e fundit.

— Filtrat dhe?... — përsëriti motoristi me të keq. «Dhe shpirti...» — tha me vete Deni.

— Filtrat! — tha shkurt Deni.

— Urdhëro! Bëj ç'të duash! Ti ke gjithë ato zanate... — u skërmit tjetri.

— Erdha të të jap një dorë... — tha me të butë Deni.

— E di dorën tuaj! Dora juaj është grusht!

— Unë do ta mendoja si drejtësi dhe ndihmë... — tha me të butë Deni.

— Drejtësi? Ju më fikët... — u përgjigj disi i thyer motoristi.

— Kur janë shumë ata që kritikojnë, diçka është e vërtetë... Dhe nuk të kemi fikur! Me sa di unë organizata nuk t'i ka mbyllur të gjitha shtigjet! Të ka lënë kohë në dispozicion...

— Kohë? Po unë do të jem prapë me ju... — tha me naivitet motoristi.

— Ku ta gjesh të jesh me këta shokë që ke këtu! Po lëri këto dhe të shohim motorin! — foli me ton. Ai hoqi xhaketën dhe e hodhi jashtë. Ajo ra në këmbët e Taushit që ishte afruar të merrte vesh ç'bëhej atje poshtë.

— Me katër rrotë shkon puna! — dha informacion Taushi.

Motori heshti. Anija zuri të lëkundej keq, megjithëse nuk kishte dhe aq det. Hodhën spirancën. E gjithë kjo ishte kohë e humbur, po nuk kishin nga t'ia mbanin. Ishin afro dhjetë milje larg zonës së gjuetisë. Ishin ditët e fundit që do të merreshin vetëm me sardelen. Pas pak do ta kombinonin me rrethimin e tonit.

— Deti po ftohet... — tha papritmas Karakolli.

Të gjithë u kthyen nga deti. Të gjithë kishin të nxehtë.

— Këndeje e mbrapa ka për të qenë një det i ftohtë... — tha Karakolli sikur të parafliste erën e akullnajave.

— Kabinat janë mbushur si në pisk të gushtit! — vërejti Pali.

— Plazhistët gjithnjë hedhin zaret... — tha Karakolli.

U ndez motori dhe për disa çaste shkoi mirë, pastaj vazhdoi me atë galopin e tij të hallakatur, gjersa heshti krejt.

— O Xhike, mbaruam! — psherëtiu Taushi.

Pali ia dha gazit. Taushi kishte folur si atëherë kur e kishin hedhur në det dhe nuk e kishin lënë të kapej pas anijes.

Motori nisi me galop të rregullt dhe Deni u ngjiti lart. Ishte ndotur dhe kullonte nga djersët.

Ndoc Marku i hodhi krahëve xhaketën e tij.

— Mos hakmerrej motori? — pyeti kapiteni.

— Ku ta dish? Mbase dhe hakmerrej... — iu përgjigj po ashtu Deni.

Ngritën spirancën dhe u nisën.

— Nuk të thashë... Ajo tani i është ngjitur doktor Markut... — i pëshpëriti Ndoc Marku.

«Prapë me Marën ky... Ajo po u vjen hakut! I pagoi të pesëdhjetë vjetët...» — sesi mendoj Deni.

— Den! Lidhu me dispeçerin! Është koha e radios dhe mos e zgjat me atë defektin! — i tha kapiteni.

Deni e bëri dispeçerin ta përsëriste tri herë urdhrin për kthim.

— «Pulëbardha»? Mos ju ka ngrënë dreqi veshët? Të ktheheni menjëherë! Urdhër i drejtorisë! Karakollit i është mbytur djali në det! Si më dëgjon? I është mbytur i biri në det, thashë... Silljani rrotull me kujdes, se ju jeni matrahula! I është mbytur atje në Sazan dhe mund t'ia sjellin që sonte! Si më dëgjon?

— Si zërin e ferrit... — pëshpëriti Deni. Ai u ul pa pikë fuqie në stol dhe diçka ngeci brenda qenies së tij. Bota iu duk e shurdhët dhe e shmangur tej në një galaktikë të dyshimtë. Cili ishte ai bajloz deti që i dilte përpara Karakollit?

— Ej, Deni! — u dëgjua kapiteni.

Deni u lëkund, po nuk arriti të ngrihej. Ai u mundua të sillte ndër mend gjithë rolet e mëdha të njerëzimit ku zbutej e vërteta e egër dhe kudo pa Karakollin duke mohuar me kokë. Nuk do të arrinte ta gënjente...

Nuk arriti ta gënjente. Karakolli kërkoi një cigare dhe ktheu përnjëherësh shpinën. Qëndroi ashtu gjersa e mbaroi cigaren. Kur u kthye, të gjithë panë përpara sysh një njeri të plogët dhe me interes të humbur për ç'kishte rreth e rrotull.

— Pse? Pse?... — pëshpëriti Karakolli.

Deni u tremb dhe e njëjta frikë i përshkoi të gjithë. Goditja kishte qenë aq e fortë, sa pas kësaj ata mund të prisnin çdo gjë. Ishte njëjloj sikur secili prej tyre të gjente nga një të vdekur në shtëpi. Motoristi qante pa zë, pa një drithmë të fytyrës dhe të qerpi-

këve. Deni nuk kishte parë lot të tillë, që vërshonin e vërshonin pa ndërprerje. Kjo e shtangu. As që i kishte shkuar ndër mend se motoristi mund të derdhte një pikë loti. Ai mendoi që njeriu që prej dyzet mijë copash dhe gjithsesi do të ndeshje në diçka të mirë. I vështroi shokët një nga një. Kapiteni nuk ishte më kapiten, po një graduat i hedhur në rezervë, Taushi nuk ishte gjigant, po një fëmijë jetim, ndërsa ai vetë... Diçka i ishte larguar nga vetja, i kishte humbur...

Taushi mallkoi detin.

Karakolli u kthye nga ai dhe e fiksoi për një kohë të gjatë. Ai nuk foli. Kur kishte duruar ai t'ia mallkonin detin?

— Hesht... — tha më në fund Karakolli dhe pas kësaj të gjithëve u erdhi fryma.

— Stop! Të kthehemi! — urdhëroi kapiteni.

— Kush tha se do të kthehemi? — tha ftohtë Karakolli.

— Duhet të kthehemi... — foli me të butë kapiteni.

— Më lironi një sandall... — tha Karakolli.

— Nuk arrihet me sandall sonte në port! — tha kapiteni.

— E kush tha se do të arrij në port? — pyeti gjithnjë ftohtë Karakolli.

Denin e përshkoi një drithmë e fortë. Ku donte të shkonte ky njeri? Mos donte të merrte detin me sandall gjersa të humbte diku?

— Karakoll shpirt... — u lut Taushi.

— Shpirti më ka humbur! Më lironi një sandall! — tha Karakolli.

— Ku do të shkosh? Ke një detyrë për të përmbushur... — e ngriti zërin Deni.

— Karakoll! Shpirti i Xhikes... — u lut Taushi.

— A po ma lironi sandallin, a të hidhem në det?

Tani Karakolli iu duk të gjithëve i prapë dhe i keq, po dhimbja për të u mbeti njëlloj.

— Lironi një sandall dhe të shkojë dikush me të!

— nuk pati rrugë tjetër kapiteni.

Deni kërceu në sandall, e zgjidhi dhe mbeti në të. — Askush nuk do të vijë me mua! — tha Karakolli duke zënë vend në sandall. Ai e shtyu lehtë Denin të ngrihej, po ai nuk luajti. Karakolli murmuriti nëpër dhëmbë dhe ia hoqi rremat nga duart. Deni pati frikë se mos i hidhte në det, po Karakolli i përplasi në fund të sandallit, që ishte larguar nga anija dhe lëkundej sipas dëshirës së detit. U shtri vetë poshtë sandallit, si për inat të atij tjetrit që nuk kishte dashur ta linte vetëm.

Deni u shqetësua. Iu duk se Karakolli e kishte lënë veten në dorë të fatit. Dritat e qytezës ishin tepër larg dhe anija kishte mbetur afër gjysmë milje prapa. Llamba e madhe në majë të direktut dukej si një xi-xëllonjë.

— Diku duhet të arrijmë... — tha Deni.

Karakolli gjëmoi pa dhënë përgjigje.

— Burri gjithmonë arrin diku... — tha Deni.

Karakolli nuk dha përgjigje.

— Burri duhet të përpiqet! Burri ka nevojë të luftojë! — tha Deni. Ai ishte aq i tronditur, sa s'e vriste mendjen se mos ia merrte ai tjetri për fjalë të mëdha.

— Burri ka nevojë të dehet... — pëshpëriti Karakolli.

«Dehu gjer në breg! Në breg bëhu esëll», — i dha të drejtë Deni. Ai kishte dëgjuar nga peshkatarët e vjetër që, po të rrije shtrirë në sandall, të dehte dallga.

— A nuk mundesh të qëndrosh? Bota ka mbetur botë në të keq dhe në të mirë! — tha Deni pa menduar si duhet efektin e fjalëve të tij.

— Në këto raste thuhet që duhet ta ruash fytyrën! Po a do të kem fytyrë kur të mbërrijmë në breg? Po ma 'ha mishin hidhërimi...

— Nuk po dalim në breg! Po na merr deti...

— Pse, a ka det pa breg? — u skërmit Karakolli.

Deni për pak sa nuk i tha që nuk kishte as dhimbje pa shërim, po e la. Ai u drodh duke menduar që Kara-

kolli e kishte me të keq me të që nuk e kishte lënë vetëm. Ai sikur po e vinte në provë. po e torturonte për të harruar torturën e tij... Provoi t'i kapte rremat. Nuk bënte tani. I la. U shtri edhe ai përkrah tij.

— A mund t'i dehë dy burra ky det, o Karakoll? —
— i tha me zë të ulët. Kjo ishte një përgjigje ndaj sfidës së Karakollit dhe një shuplakë për ta zgjuar.

Tjetri nuk dha përgjigje. Deni ndjeu zhurmën e motorit të anijes së tyre që po i ndiqte. Nuk u ngrit të shihte. Si i shihte ajo, kur ata nuk e kishin parë gjithë atë anije?

— Nuk e kisha djalin kaq të fortë sa ti, po prapë e kisha djalë... — tha lehtë Karakoll.

Zhurma e motobarkës tani ndihej më qartë. Deni u shqetësua më shumë tani që po afrohej ajo. Druhej mos hidhërohej më Karakoll.

— Nuk ishte si ti! Në moshën tënde as unë nuk kam qenë si ti... Të kam njohur sa të kam parë...

Zhurma e motorit të anijes sikur u dobësua. Kishte ndërruar era dhe asaj ia la Deni. «Pulëbardha» duhet të ishte aty rrotull...

— A e di çfarë mendon plaku, kur nuk lë njeri mbrapa? — pyeti Karakoll.

Deni nuk dinte ç't'i thoshte. I vuri dorën mbi gjoks.
— Mendon se ka ndenjtur e ka ndenjtur me vite si ajo kësula e borës në majë të malit e është shkrirë një ditë papritmas e ka rrjedhur të humbë në det...

Deni për pak sa nuk ia dha vajit. Ai shtrëngoi dhëmbët. Ai ishte aty për të përballuar hidhërimin dhe zemërimin e këtij njeriu e jo për të qarë. Deni kishte qiellin përpara, po qiell nuk kishte. Qielli është yje dhe hënë! Qielli është kaltërsi... Deni kishte vetëm terr mbi sy dhe ai sikur dendësohej nga fjalët e Karakollit.

— Nuk hipa në sandall të humbas në det... Desha të merrem vesh me detin e të hahem me detin...

Deni pati frikë. Iu duk se kishin një jetë që vërtiteshin me atë sandall. Zhurma e anijes së tyre nuk

ndihej më. Ajo i kishte humbur. Ai nuk merrte në dorë as rremat nga frika se mos e trazonte Karakollin.

— Deti është bërë i shurdhët... — tha Karakolli dhe u ngrit ndenjtur.

U ngrit edhe Deni. Ku ishte toka? Ku ishte qielli? Ku ishin ata vetë? Kjo që kishin bërë që një marrëzi e madhe, që nuk do t'ia kishin besuar askujt! Nuk kishin ditur ta frenonin marrëzinë e Karakollit! Nuk ndiente frikë. Nuk ndiente frikë, se kishte Karakollin aty dhe, sido që të bëhej, ai do t'i nxirrte në breg...

Karakolli mori një rrem. Zuri të voziste në fund të sandallit vetëm me një rrem. Ku shkonte? Ku do të zinin dhë?

Karakolli e shtroi përnjëherësh sandallin, e zbuti, e bëri të bindur. Deni mendoi që dallgët nuk kishin arritur të dehnin asnjërin prej tyre dhe se kot kishte dalë ajo fjalë...

— Nuk e kemi larg tokën... — pëshpëriti Karakolli.

— Nuk e marr vesh...

— Afër tokës ajri thahet... — tha Karakolli.

Deni nuk që në gjëndje ta dallonte as këtë. Ishte po ai ajër që thithte ditë e natë.

Karakolli nuk foli për një kohë të gjatë. Voziste ritmikisht me rremën e vetëm dhe Deni e ndiente që sandalli shtypej njëlloj sikur vozitej me dy rrema. Në një çast iu duk se sandalli shtyhej me atë ritmikën e zemrës së tij... Ai ishte i lodhur dhe i përmalluar fort. I rrihte zemra si ai tamburi i lëkurës në anijet e skllervëve që rregullonte ritmin e lopatave. E kishte nisur më i fortë këtë udhë të çuditshme me Karakollin dhe, me ç'dukej, po e përfundonte më dobët se ai. Po pse e ndiqte Karakolli me atë rrem ritmin e zemrës së tij? Ai mendoi që ndienin njëlloj dhe vuanin njëlloj! Gjithçka që vihej sipër dhimbjes dhe vuajtjes në ato çaste ishte mashtrim. Ata mashtronin njëri-tjetrin dhe mbanin njëri-tjetrin!

— A kam pse shtyhem, Den? A kam pse shtyhem më? — pyeti Karakolli kur nuk e priste.

Denit i vërshuan qindra lekzione për optimizmin dhe qëllimet, po qenë shpërthime të shurdhëta përpara asaj që mendoj për atë njeri. Ai besoi se mund të lindte fëmijë, t'i rriste, të priste të bëheshin burra dhe të rriste fëmijët e tyre. Gjersa mendoj kështu, tha me vete që ai njeri nuk kishte nevojë për ngushëllim. Ai mund të ngushëllonte të tjerët!

Deni përplasi kokën pas sandallit. Fundi i tij kishte ngecur në rërë. I erdhi të thërriste dhe ta shkurdte natën nga ajo plogështi e zymtë. Doli në breg. Nata ishte njëllë, si në det, si në tokë. Më vonë mendoj që nuk ishte njëllë. Gjithnjë i ishte dukur që në det i ikej më shpejt natës, kurse në tokë të rrinte gjithë kohën pezull mbi kokë, sa të vinte mëngjesi...

Nuk e njihte atë breg dhe nuk e dinte ku ishin, po nuk deshë ta pyeste Karakollin. Ishte një rrëpirë plot shkarpa dhe dru që i kishte flakur deti. U pengua pas tyre dhe u rrezua disa herë duke vështuar Karakollin. Pse kishte ardhur ai atje? A e dinte pse kishte dalë në atë breg?

Dukej sikur nuk e dinte gjersa rrinte ashtu me krahët varur. Pastaj ai i ngriti krahët dhe rrahu kofshët me fuqi. Deni priti fluturimin e kondorit të madh, po Karakolli u përkul dhe zuri të mblidhte dru dhe shkarpa. Deni u bë akull. Ku do ta çonte atë të çmendur? Pastaj Karakolli zuri t'i grumbullonte shkarpat në një vend dhe Deni mendoj që po mërdhinte. Nata u bë e ftohtë edhe për të. Edhe ai zuri të mërdhinte...

Karakolli duhet të ishte bërë kallkan me gjithë atë përg që grumbulloi. Nuk po ngopej me dru dhe Denit iu duk si ankthi i plakut kur shihte borën... Atëherë nisi edhe Deni të mblidhte dru dhe t'i hidhte mbi përgvetëm e vetëm për të bërë si ai. Flakte drutë mbi përgun që po bëhej mal dhe vështonte Karakollin. Atij i ishin mbaruar fjalët. Ai kishte vetëm lëvizje dhe gulshim. Deni priste zjarrin. Kur do të vinte zjarri? Ky përg nuk mund të ishte parodia e zjarrit... Pati frikë. Iu

kujtua që Karakolli i kishte thënë se do t'ia hante fytyrën deti dhe do të mbetej pa mish...

Pirgu me dru e kaloi lartësinë e trupit të tyre, po Karakolli nuk kishte të ngopur. Ai shtyhej larg dhe kërkonte dru. E kishte pastruar vendin sikur të hapte tokë të re. Më në fund ai qëndroi, u ul në gjunjë dhe i dha flakën.

Deni ktheu kokën mënjanë, ngaqë besoi të shihte martirizimin e Karakollit. Pastaj ai ndjeu uturimën e shkarpave të thata, ndjeu edhe dritën si një befasi në mes të natës. Plaku po digjej! Po digjej bashkë me dhimbjen e tij dhe ajo nuk do të linte gjurmë...

— Ej, Karakoll!

Pse përgjigjej deti në vend të tij? Pse kishte atë shungullimë valësh dhe atë inat? Pse tkurrej dhe di-haste si një gjoks i munduar? Dukej sikur çdo kreshtë valësh jepte dhe merrte në kokë të vet. Ishte si një dihatje universale, që herë nxirrte frymën e një parzmi të shëndoshë, herë gulshin e një astmatiku. Ishte natyra brenda rregullsisë dhe çrregullsisë së saj, po kjo nuk zgjati më shumë sesa i duhet një orkestre të madhe për të hyrë në një akord të përbashkët. Një orkestre gjigante, ku kishin nisur të gjëmonin veglat e rënda në një kreshendo marramendëse dhe dirigjenti ishte trullësuar diku nën presionin e tyre. Orkestra i kishte rrëshqitur nga duart dhe ai tani tërhqej...

Karakolli tërhqej nga pirgu i zjarrit sa më i fuqishëm bëhej ai. Prapësohej me një hap të rëndë, të lëkundshëm, megjithatë Deni iu duk se ai kishte gjetur një përgjigje për pyetjen e tij. A nuk do të thoshte kjo që nuk kishte ndër mend të shuhej?

Deni u turbullua. Plaku u turr drejt zjarrit. Rrëmbëu një urë të ndezur dhe e flaku mes orkestrës së ngjirur të detit. Pushuan disa vegla, të tjerat u çorrën më shumë. Deni u ngjeth nga përcëllima e detit. Ishte e njëjlojtë me përzhitjen e mishit të gjallë në një zjarr të paktë... Karakolli po digjte detin! Ai po flakte në det pa pushim urët e ndezura dhe murmuronte fjalë që De-

ni nuk i kapte dot. Ai ishte i pakënaqur që deti i përpinte flakët, po megjithatë pak nga pak po e merite veten duke parë që po e vinte nën pushtetin e tij orkestrën e madhe të detit. Deni besoi se ajo luante dhimbjen e tij, dhe kryengritjen e tij! Trishtimin e tij dhe krenarinë e tij! Dashurinë e tij dhe hutimin e tij nga deti... Ishte si një simfoni e vërtetë e lindur aty për aty.

Veglat e fundit të orkestrës së madhe e ulën kokën andej nga tejet e horizontit. Po heshte përlëshja e ndjenjave, po heshte edhe Karakolli që gjithë kohën i kishte flakur urët me gëzimin e njeriut të parë që u tremb nga zjarri dhe e nderoi zjarrin. Kur nuk mbeti më asgjë, ai erdhi pranë detit. Zërat e rëndë kishin pushuar. Dëgjohej vetëm një oboe me një grishje të lehtë dhe paqësore. Nuk kishte arritur ta digjte detin! Flakët ishin shuar dhe ai mendoi se që më mirë kësh-tu. Bashkë me to kishte rënë edhe dhimbja e tij.

Ai u ul në gjunjë dhe nisi të përkëdhelte ujërat me dorë. Me shuplakën e dorës dhe kjo ishte finalja e orkestrës së madhe... Karakolli kishte ngritur krye kundër detit, po deti e kishte thyer me atë pafajësinë e ligjëruar të natyrës! Deni mendoi që nuk ishte krejt kështu. Ata kishin thyer njëri-tjetrin...

Karakolli u ngrit. U kujtua për Denin.

— Eja, bir! Po zbardh... — tha Karakolli.

«Eja, bir... U pajtuam...» — e kuptoi Deni dhe u lehtësua kur mendoi që Karakolli e kishte zbrazur një pjesë të pezmit të shpirtit dhe kjo i mjaftonte për të ndier agimin në të errët. Ai e ndoqi Karakollin nëpër djerrinën e lagur të bregut duke shkelur në gjurmën e tij. Vende-vende ajo ishte e thellë dhe dukej sikur mezi e mbante toka...

XXI

Skaliera ishte një botë gurësh të sheshtë ciklopikë, ishte dhe një fund bregu. Ishte heshtje, vetmi dhe mendim. Këto ishin ditët e buta të motit, kur valët mezi puqeshin pas saj dhe pulëbardhat nuk guxonin të prishnin qetësinë e natyrës. Qyteza ishte larg e mbështjellë në mjegullën e muzgut dhe rrinte si një botë më vete, që sikur nuk kishte të bënte me natyrën e vërtetë, të virgjër dhe të shkujdesur.

E kishin lënë qytezën dhe kishin ardhur aty, siç ndodhte kur e kishin zemrën të rënduar, apo donin të shpërthenin një gëzim të madh. Skaliera ishte një truall i mrekullueshëm për të dy rastet dhe ata e quanin si domenin e tyre, ku nuk kishte të drejtë t'u përzihej askush. Ishin ulur mbi ato dy gjysmështyllat e mermerta që kishin nxjerrë nga uji arkeologët. Ata ishin zhytur disa ditë, kishin thënë që ishte një pikë

që do të kishte të papritura me rëndësi dhe pastaj kishte
shin ikur të merrnin pajisje të tjera. Thuhej që ata
i kishte joshur aty Pashk Luli.

— E di si më dukej anija mbrëmë? Si një gërdë
llë e handakosur! Nuk ishte Karakolli dhe ajo kishte
mbetur pa direk! — tha Deni.

— Filluat me tonin? — Pali nuk kishte qenë në
det ato dy net.

Deni buzëqeshi dhe u bë gati të thoshte diçka,
po e ndërpreu Riqoja.

— Nul... — tha me të keq Riqoja që nuk kishte
hapur gojë gjer atëherë. Ai po pëlciste se nuk ia kishte
shin varur aspak.

— Na ikën! Mezi zumë pesë kuintalë në dy net!
— tha Deni duke vështruar djalin.

— Nul.. Dhe ju nuk jeni asgjë! As shokë nuk
jeni! — vazhdoi Riqoja po me atë inat.

— Ej! Ej! Atje te gurët... — u tërhoqi vëmendjen
Pali duke zgjatur dorën përpara.

Tutje, në krye të skalierës dukej silueta e një
gruaje, që ishte kapur pas gurëve dhe po dilte nga uji.
Ajo u ngrit në këmbë dhe ata panë një figurë të
zhdërvjellët që gati po njësohej me muzgun. Ajo
kishte flokë të gjatë të gjatë dhe ata i arrinin gjer
në fund të këmbëve...

— Nimfa... — belbëzoi Pali.

— Ku ta gjejmë Pashk Lulin? — pëshpëriti mje-
ku Ai kishte nevojë për këtë atmosferë fantastike,
që ishte si prehje pas ditëve të ngarkuara me punë.
— Nimfë e gjallë e detit... — vazhdoi po me atë ton
Pali.

— Nul! Ajo është Rasha! — tha Riqoja me një
përbuzje që i përfshinte të gjithë.

Deni e kishte njohur tek kërcente mbi gurët e shesh-
të dhe flokët i shkonin mënjanë. Vetëm atë mund ta
merrnin me vete flokët. Ai vuri dorën në faqe, po
nuk i ndjeu ato cirkat e ujit që i kishte hedhur ajo
në plazh.

— Ajo ka luajtur! Nga plazhi gjer këtu janë më shumë se tri milje! Pse futet në ujë në muzg? — tha Pali.

— Puna e saj! Ajo është vajzë trime! — ndërhyri mjeku.

— Thirreni! Është vonë për t'u kthyer nga erdhi! — tha Pali.

— E thërresim?... — pyeti mjeku duke vështruar nga Deni.

— Ik! Thuaji të vijë! — e urdhëroi Pali Riqon. Djali ktheu kokën në anën tjetër pa luajtur nga vendi

— Ik... — i tha me të lutur Deni.

Djali vrapoi nga Rasha. E panë të fliste me të një copë herë, e panë ta tërhiqte vajzën për krahu... Pastaj ajo u shkëput nga ai dhe u hodh në det. Të gjitha këto i panë si hije që zgjateshin dhe mbli-dheshin në teatrin e muzgut.

— Nul! Ajo iku! — tha Riqoja me një frymë. Ai i kishte varur buzët e gjithë inatin tani e kishte me Rashën.

— Si iku? — u interesua mjeku.

— Pyeti kush ishit dhe iku...

Në djall të vejë! — tha Pali. Ai u ngrit dhe u zhyt në ujë.

— Të dalë Pali dhe ikim! Nuk kemi ç'bëjmë më këtu! — tha mjeku.

Të tre mendonin tani për Rashën dhe secili kishte bindjen e tij të veçantë. Mjeku e admironte, Pali kishte frikë për të, ndërsa Deni luftonte mes frikës dhe inatit për këto banja në muzg.

Pali doli nga uji dhe u afrua me të shpejtë. Ish-te nxirë në fytyrë.

— Poshtë gurëve të skalierës ka një të vdekur... — belbëzoi ai.

— Një të vdekur? — sikur u gjallërua mjeku.

— Një të vdekur, të thonë! I preka dorën...

— Ej! Ka një kufi shakaja... — i tërhoqi vëmendjen Deni.

— Mua sa nuk më la fryma e ti më përmend kufijtë e shakasë! Shko e preki një herë ata gishtërinjtë e ngrirë! Të fortë si guri...

— Të shtangur, the?

— Të shtangur? Pse nuk thua hekur? — mezi e nxirrte fjalën Pali...

— Mos hyr në det më në muzg, se do të pësosh infarkt!

— Të gënjejnë koralet e buzëve të shkëmbinjve dhe formacionet gëlqerore... — tha Deni që i kishte krejt të freskëta këto nga provimi që do të jepte.

— Pse nuk bëni një provë ju trimat? — i nxitte me të keq Pali.

— Do të bëjmë një provë për të arritur gjer në klub! Të duhet një dopio konjak pas gjithë kësaj frike... — e vuri në lojë mjeku.

— Aty ishte një i vdekur! Edhe ju jeni të vdekur! Nul... — e imitoi Riçon Pali.

— Nul... — belbëzoi tepër i tronditur djali. Ai kishte frikë për vete, por nuk i kishte shkuar kurrë në mend që mund të trembej Deni.

— Në ikëm! Ti bëj edhe një provë, po deshe... — tha mjeku.

Ikëm, po Pali nuk iu nda me të vdekurin nën gurët e skalierës. Ai tha se do të lajmëronte në polici.

— Fort bukur! Do të argëtohem një ditë... Deni e vështroi mjekun. Edhe ai e kishte menduar si një lajthitje të Palit, po nuk e kishte kundërshtuar me aq ngulm sa tjetri! Pse ishte kaq i bindur në mirazhin e Palit? Ndoshta ai duhet ta dinde si rrinte trupi i të vdekurit në ujë... Papritur atij i hipi një frikë e madhe për Rashën. U kthye të shihte Riçon. Riçoja e kishte përbraktisur! Ishte kaq pur pas fundit të xhaketës së Palit!

— A do të kthehem tani dhe të zhytem atje? — e pyeti djalin me inat.

Riqoja u shkëput nga Pali. Ndryshoi përnjëherësh.

— Jo! Jo! — për pak sa nuk qau ai. Tani kishte frikë për Denin.

— Mirë... ik bregut dhe gjej Rashën! — u zbut Deni.

— Ç'ti them?

— Asgjë! Vetëm gjeje!

— Ku do të jeni ju?

Ata të tre vështruan njëri-tjetrin.

— Në ambulancë! — tha mjeku. Ai qe vendi i parë që iu kujtua, se e kishin krejt afër.

— Pse je kaq i bindur që aty nuk kishte një të vdekur? — e pyeti Deni mjekun duke hyrë në ambulancë.

Tjetri ngriti supet. Nuk tha gjë. Në ambulancë ishte vetëm infermierja. Ndhimësmjeku që zëvendësonte Markun ishte me një urgjencë.

— Futuni... — u bëri me dorë mjeku të hynin andej nga gdhendte.

Denit i hyri frika duke parë bustin e Rashës. Mendoi që këndeje e tutje do të kishte vetëm bustin e Rashës.

— Po kjo? — u gjet ngushtë Pali para bocetit të një plake.

As Deni nuk e njohu. Kushedi kush kishte pozuar për mjekun. Edhe plaka qe e ashpër. Mbase më tepër e idhët, e zemëruar...

— Mara! Nëna e detit! — pëshpëriti Pali.

Deni kujtoi Ndoc Markun. Me atë bust shpjgohej pse i ishte ngjitur plaka mjekut.

Erdhi Marku. Ai kishte një shishe në dorë. E tundi dhe ia zgjati Palit, po ai nuk e desh. E rrëmbu Deni.

— Ti ke një frikë tjetër... — i tha mjeku.

— Atë Rashën do ta rrihja... — tha Pali që ishte afruar shumë kohët e fundit me Denin. Ai i jep-te gjithnjë arsye Denit.

— Duhet rrahur Deni! E kam thënë kaq herë...

— A nuk më hiqeni qafe? — tha Deni nëpër dhëmbë. Ai herë vështronte bustin e Rashës herë bocetin e plakës. I ngatërroheshin të dy punët dhe tiparet e tyre merrnin përpjesëtime të shkapërderdhura. Rasha kthehej në një vajzë me rrudha dhe Mara në një plakë të freskët.

— Pse nuk e çon Markun ta kërkojë? — pyeti Pali sikur të ishte i bindur që kjo ishte rruga e vetme.

Deni e pa me frikë. Kurrë nuk i kishte shkuar ndër mend se do të duhej një shkues për nusen e tij! Sa për Rashën... Kushdo që do të marrorej pas saj e kishte për detyrë t'i thoshte një fjalë të atit! Pastaj, le ta rrëmbente, po të mos pranonte! Kështu mendoi ai.

Erdhi Riqoja. Tha që Rasha ishte në shtëpi. E kishte parë nga dritarja.

— Unë jam gati të bëhem shkues! — tha mjeku kur nuk e priste askush. Rasha ishte në shtëpi shëndoshë e mirë! A nuk mjaftonte për atë natë?

— Ç'përfitim ke që tallesh? — pyeti Deni si i dërrmuar.

— Nuk tallem! Këtu do ta kërkoj unë Rashën dhe ti rrudhi një çikë sytë si Gjon Kabashi... Kjo mund të jetë fejesa jote, po mund të jetë edhe gjyqi i Gjon Kabashit! — tha mjeku disi i shqetësuar.

— Si gjyq më pëlqen! — pranoi Deni. Ai ishte gati të bënte gjyqin e Gjon Kabashit me seriozitetin më të madh.

— Pra të kam rënë në derë, o Gjon Kabashi...
— filloi mjeku me tensionin e vërtetë të shkuesit. Derën e ke të hapur!

— Të kam rënë në derë për Rashën...

— Prapë paske ndonjë urgjencë të mbrapshtë?

— E kam një urgjencë! Dua ta nis Rashën në atë derë që ma do zemra! A më kupton?

— Të marr vesh dhe nuk të marr vesh!

— Kam ardhur të të kërkoj Rashën për Denin!
— Ah.. Prit! Mos përmend emra! Nuk duhet koritur askush pa e ditur a e ka kohën të shkojë nuse ime bijë!

— Vjetët i ka mbushur o Gjon Kabashi, po si e ke mendjen ti, nuk mund ta dijë askush...

— Ju të shkollës nuk e keni fort zakonin e shku-
esit...

— Po të qesh buza, o Gjon Kabashi, dhe nuk po ma bën mirë!

— Nuk të vrava o doktor, se të thashë një fjalë.

— Kam ardhur për Rashën!

— O doktor! Je lodhur...

— Si e njeh Denin?

— Mos u nxeh, o doktor! Nuk paske haber si shkues! As unë nuk kam pasur haber si shkues e nuk më ka ecur! Shkuesi duhet të jetë si llastiku!

— Si e njeh Denin?

— Pse nuk më pyet më mirë a dua ta njoh, o doktor?

— Është djalë trim...

— Trim qoftë!

— Është djalë i zoti...

— I zoti qoftë!

— Është me shkollë...

— Kush ka mbetur në Shqipëri pa shkollë, o doktor?

— Pse e ke kaq inat Denin?

— Ia ka bërë borxh vetes! Nuk ma ka lënë vajzën rehat pa e pasur mendjen kurrkund si duhet mbi të!

— I ka ardhur mendja në vend...

— Vonë! Kur të vijnë mendtë, të ikin dhentë!

— Pleqëroje më butë, o Gjon Kabashi!

— A do më butë? Pa vdekur Gjon Kabashi, ai nuk e merr Rashën!

— A nuk ka Rasha gojë? Fol, Rashë!

— Të lutem mos ma përmend, doktor! Ai ka kuj-

tuar që është Zeusi dhe mund të luajë si të dojë me «të shkretët» e kësaj toke...

Mjeku heshti. Ai ngriti kokën dhe i pa të dy shokët me radhë, Pali ishte i mpirë, Deni i hutuar. Ata kishin folur herë njëri, herë tjetri në vend të Gjon Kabashit. Përgjigjen e fundit e kishte dhënë Deni.

— Ç'tu desh që u nise shkues? Më turpërove! Më fike! — tha Deni. Ai u kthye dyllë i verdhë nga Pali dhe besoi me të vërtetë se nën ata gurët e skalierës ndodhej një i vdekur...

Riqoja e tërhoqi tutje Palin. Ai e mbante mend mirë ku ishte zhytur. Pali u zhvesh dhe i hodhi një sy skalierës. Ajo i ngjante një piste të ftohtë e të braktisur në fund të sezonit. Edhe pak do të perëndonte, po nuk kishte mundur të vinte më shpejt. Denin nuk e kishte gjetur, ndërsa mjeku e kishte përcjellë me shaka. Në vend të tyre kishte gjetur Riqon.

U zhyt në ujë dhe nuk u pa për një kohë të gjatë. E trembi djalin. Ai e hodhi përdhe litarin që mbante në dorë dhe u shtri jashtë skalierës. Pastaj Pali doli në sipërfaqe. Ai u afrua me dy-tri pashë dhe u ngjiti mbi skalierë.

— Nuk gjeta gjë... — tha. Ai fërkoj barkun nga të ftohtët. Kishte frikën e stomakut.

— Të ikim... — tha djali,

— Nuk kam kërkuar mirë! Diku nuk e kam arritur fundin...

— Të ikim... — iu lut djali.

Pali u hodh në ujë. Kësaj radhe vonoi më pak, po doli nga uji me fytyrë të prishur. U ngjiti në skalierë dhe u ul ndenjtur pa folur. Riqoja nuk guxoi ta pyeste.

— Ai është aty nën guvë... — pëshpëriti Pali.

— Të ikim! Janë ata të barkës së shpëtimit...

— Ma zgjat atë litarin!

Riqos iu drodhën buzët dhe nuk luajti nga vendi.

— Mos ki frikë! Nuk më gjen gjë! — tha Pali. Ai i shpupurishi flokët e djalit dhe u hodh në ujë me gjithë litarin.

Riqoja i pa të çrrotulloheshin rrathët e litarit dhe u kujtua të kapte fundin e tij kur gati ra ne det. Pali po vonohej të dilte. Riqoja e tërhoqi litarin. Nuk rëndonte dhe kjo e trembi djalin. Atij iu duk se Pali kishte një jetë aty nën ujë dhe nuk do të dilte më. E thirri Palin me emër. E gjithë skaliera u mbush me emrin e tij. Nga kreu i saj u çakërdisën shpendët e bregut që ishin strukur nëpër gurë dhe e mbushën vendin me një zhurmë të frikshme. Edhe për pak do të errej. Dielli ishte i tëri pas malit dhe godiste drejtpërsëdrejti vetëm një cep reje në qiell. Riqoja thirri prapë dhe mbi ujë u dha Pali.

— E lidha për krahu... — tha ai.

— Obubu...

-- Nuk m'u duk si njeri i mbytur, megjithëse kishte si krah... Nuk mund të ketë krah aq të fortë si hekuri... — tha Pali. Ai zuri të tërhiqte litarin gjersa u tendos.

— Duhet të jetë në pesë metra ujë... — tha Pali duke matur litarin e tërhequr. Ai zuri vend mirë dhe e tërhoqi me forcë litarin. Iu duk se e lëvizi peshën që ishte nën ujë, pastaj ajo nuk bëri më përpjetë. E lëshoi prapë dhe e tërhoqi pas pak.

— Diqë ka ngecur pas gurëve, — tha Pali. E lëshoi prapë litarin dhe e tërhoqi rishtas pas pak më me kujdes. Nuk ishte ndonjë peshë kushedi se çfarë. Vërejtji që litari nuk u pengua ku ishte penguar më parë, po ndonjë metër më lart. Ai vazhdoi të lëshonte dhe të tërhiqte. Ishte njëlloj si me gjahun e madh në det dhe ai për një çast besoi se kishte në grep një nga ato skallinat e mëdha të thellësive.

— Doli! Doli! — thirri Riqoja.

Tjetri nuk shihte gjë. Ishte larguar nga buzët e skaliërës, po tani litari ishte rënduar nga një peshë e jash-

tëzakonshme. Ai e ndiente që nuk e tërhiqte dot më shumë se tre-katër centimetra. Peshë ishte puthitur pas buzëve të skalierës.

— Doli një njeri pa kokë! — për pak sa nuk klithi Riqoja. Ai u spraps me frikë.

Pali nuk ia vari. Bëri më poshtë me gjithë litar, aty ku buzët e skalierës ishin pothuaj rrafsh me detin. E tërhoqi litarin me fuqi dhe pas një mundimi të fundit e hodhi peshën mbi skalierë.

Riqoja ndenji larg.

— Riqo! Kemi kapur një statujë! — tha Pali me triumf, Ai as po e vlerësonte ç'kishte gjetur, vetëm se ishte i gëzuar që nuk kishte të bënte me një të mbytur.

— Hidhe në det! E ç'duhet një statujë? — pyeti Riqoja. Edhe ai qe tepër i gëzuar që nuk kishin të bënin me një të mbytur.

Vetëm pas fjalëve të tij Pali u bë i ndërgjegjshëm për ç'kishte gjetur...

— Në det? Ku merr vesh ti? Ky mund të jetë një thesar... — tha ai dhe u ul ta pastronte nga barërat dhe llomishtet...

— Hidhe në det! Do të jetë nga ato me Krisht... — tha Riqoja që i kishte parë figurinat që kishte sjellë deti. Ai ende rrinte larg statujës.

— Nuk është me Krisht! Është një vajzë ilire... — pëshpëriti Pali jo shumë i sigurt për përcaktimin që bëri. Ai e ngriti në këmbë statujën dhe nisi ta vështronte me kureshtje. Bronzi kishte formuar ndryshkun e vet që i ngjante së përhimes së ngjyrës së blertë, po megjithatë nuk kishte arritur t'ia zhdukte elegancën dhe format e derdhura të trupit të zhdërvjellët. Duhet të kishte qenë statuja e një vajze teprë të re, mbase dhe të një fëmije me trup të zhvilluar. Ajo e futi në mendime Palin dhe ai për disa çaste shkoi larg në kohë.

— Ky është një zbulim i madh... — pëshpëriti Pali. Ai tani ishte krejt i hutuar dhe përshkonte me gisht

vijat e tunikës, apo të asaj si gunë që mbulonte trupin e vajzës mbi kofshët dhe lidhej në një cep të supit. Njëra kofshë ishte krejt e zbuluar.

— Qenka lakuriq... — vari buzët Riqoja.

— Duhet të ketë qenë një mrekulli... — belbëzoi tjetri.

— Një mrekulli pa kokë... — vazhdoi Riqoja që nuk dihej ç'kishte kundër statujës.

— Do t'ia gjej edhe kokën! — u rrëmbye Pali. Pastaj atij përnjëherësh iu kujtuan të gjitha ato koleksione që kishte parë, shumica nuk kishin kokë a një krah... Po të ishte e mundur të gjendeshin, nuk do të ishin pa kokë gjysma e statujave të muzeumeve të botës.

— Vetëm unë nuk po gjej asgjë... — zuri të qahej Riqoja.

— Nesër do të kërkoj kokën... — tha si i dalldisur Pali. Ai ishte tepër i kënaqur me vetveten dhe notonte në mes dallgëve të historisë, në mes dallgëve të kohrave. I shtynte ato 20 shekuj dhe 30 shekuj, i afronte 20 shekuj dhe 30 shekuj!

— A ka emër? — pyeti Riqoja.

E tronditi. Një emër ishte një jetë, një histori, një kohë! Koha e saj duhet të kishte qenë e përgjakur, gjersa kishte arritur pa kokë!

Pali zgjati dorën mbi supet e statujës, aty ku këpu-tej, si të ishte prerë me shpatë. E përkëdheli i humbur në mendime dhe nuk qe i zoti të kujtonte një emër ilir.

— Ka plot emra... — e zemëroi më shumë Riqoja.

— Gjeje ti që je më i zoti! — u inatos Pali. Ai harroi që kishte të bënte me një fëmijë.

— Ndofta e kanë quajtur Rashë... — tha djali.

Tjetri e pa një herë me çudi, pastaj e ngriti statujën. Ai e mbajti të mbështetur në gjoks gjer në fund të skalierës dhe aty e lëshoi. Qe një peshë që të dërrmonte.

— Thirr shokët... — u kujtua Riqoja.

Pali nuk u përgjigj. Nuk donte të thërriste njeri! Dontë ta çonte në befasi pa e parë askush rrugës...

Megjithatë Salka e pa. Në fillim ajo dalloi një peshe në shpinën e tij, pastaj pak nga pak pesha u kthye në një grua gjysmëlakuriq të lidhur pas shpine. Salka u nguros dhe sytë i shkëlqyen në terr. Nuk e kishte njohur Palin, po Riqon, e kishte dalluar mirë dhe nga ai kishte menduar që atë gruan lakuriq e mbante mbi shpinë Deni. Deni kishte rrëmbyer një grua lakuriq dhe po e çonte në shtëpi! Një nga ato të zezat... Kurrë nuk kishte për të shpërndarë ajo një lajm më të çuditshëm...

Mjeku e pastronte ndryshkun e statujës, e kruante, pastaj largohej dhe e kundronte nga larg duke belbëzuar: «Mrekulli! Mrekulli!» Ai ishte magjepsur pas saj dhe shihte me kujdes Denin që bënte të njëjtën punë.

E kishin lënë rastësisht statujën në një radhë me bocetin e pambaruar të Marës dhe kokën e Rashës. Aty kishte pasur vend të lirë dhe aty e kishin lënë, po pastaj kishin menduar që vetëm aty mund të rrinte. Ishin tri kohë që vinin njëra pas tjetrës! Nuk kishin rëndësi pauzat e tyre me diferencë tepër të madhe, kishte rëndësi që ishin tri kohë që vinin njëra pas tjetrës...

Pali i kishte bërë të hidheshin përpjetë. «Ja ku e ke ni të mbyturin pas skalierës!» — u kishte thënë ai. Mjeku kishte besuar që me të vërtetë ishte mbytur dikush. Ai e kishte lënë Pashk Lulin që kishte ankim për fshikën e urinës dhe që kthyer ngadalë nga Pali. «Poshtë skalierës...» — kishte përsëritur Pali. «Poshtë skalierës...» — e kishte ndjekur po me atë ton mjeku. Pastaj kishte qenë Pashk Luli që e kishte ngritur tensionin në qiell. «Ajo erdhi...» — kishte thënë Pashk Luli. Sa ishin aty kishin vështruar njëri-tjetrin. Pashk Luli dukej si i çakërdisur dhe e kishte harruar dhimbjen e fshikëzës. «Kush erdhi?» — e kishte pyetur Deni. Ai që

disi më i qetë se të tjerët. «Nimfa! E dija që do të vinte...» — kishte vazhduar krejt i sigurt në vetvete Pashk Luli. Pali ishte bërë nervoz. «Po të mos e nxirrja unë, ajo nuk do të vinte këtu as për 1000 vjet!» — kishte thënë ai. «Hesht, djali! Ajo e gjeti rrugën përmes teje!» — kishte thënë i ngashëryer Pashk Luli. Pali kullonte në djersë dhe nuk e duronte dot Pashk Lulin, se i qe dukur sikur i kishte mohuar sakrificën që kishte bërë. Mjeku e kishte ngritur statujën me Denin dhe e kishte futur në atë të ndarën ku kishte punët e tjera. Me sa dukej Deni ende nuk e kishte ndier peshën e vërtetë të asaj vepre. Ai e kishte marrë për një të papritur të çuditshme dhe aq! Për njëfarë kohe të gjithë e kishin kundruar në heshtje dhe askujt nuk i kishte shkuar ndër mend të pyeste Palin për peripecitë që kishte pasur. Pali kishte mbetur si i prerë. Nuk e kishte arritur triumfin që kishte pritur. Më pas e kishte harruar këtë, se qe harruar edhe ai pas statujës.

— Erdhi... — belbëzoi Pashk Luli si fëmijë. Ai zgjati dorën ta prekte dhe pastaj e tërhoqi menjëherë, sikur të kishte frikë se mos shkatërronte një ëndërr.

— Sa e vjetër është, profesor? — pyeti mjeku.

— Pse, a kanë moshë nimfat, djali? — pyeti Pashk Luli që sa vinte dhe hynte në një botë më të mistershme.

Mjeku i ra shpatullave. Pashk Luli po e mërziste me atë lirizmin e tij poetiko-mitologjik.

— Po, po... — erdhi në vete ai. Tha që ishte statujë ilire dhe kjo qe më e rëndësishmja për të gjithë. Ai dha hollësira të mjaftueshme për këtë.

— Jemi të vjetër në këtë truall! Jemi të parët në këtë truall! — vazhdoi ai. Vështroi bocetin e plakës dhe kokën e Rashës si për të gjetur një mbështetje për ato që tha dhe i shkëlqyen sytë. E rrëmbeu atë të fundit me hovin e një djali të ri dhe e vuri mbi statujë. Përmasat nuk ishin të njëjlojta dhe këndi i prerjes ndryshonte, po megjithatë koka e Rashës nuk rrinte keq aty. Më pas ata e zvogëluan diferencën e prerjes dhe men-

duan që koka e Rashës rrinte mirë aty. Nuk shkoi shumë dhe nuk panë asnjë ndryshim. Ishte pikërisht koka e Rashës që i mungonte statujës! Në të vërtetë kishte një harmoni të fortë mes tyre.

Pashk Luli u kthye me triumf.

— A nuk shihni që jemi të vjetër në këtë truall? — pyeti ai.

I mbërtheu të gjithë në përfundimin e tij dhe askush nuk guxoi të mendonte mos kishte diçka naive dhe fëmijërore tek ai. Po pse të mendonin kështu? Nuk mund të rridhte tjetër ajo harmoni e përkryer që përvionte njëzet shekuj? A nuk sundonte Rasha mbi të gjithë me të drejtën e mijëvjeçarëve?

— A nuk duhen njoftuar ata të arkeologjisë? — guxoi të fliste Pali.

— Ata ta kishin gjetur vetë! Aty rrotull u sorollatën! Të kënaqemi ne një herë me të! Ka kohë! — tha mjeku duke i përcjellë gjer në rrugë.

— Ç'ke? — e pyeti Denin.

Tjetri ngriti supet.

— Për vete jam si i trullësuar! A mund të përsëritet një rast i tillë në jetë?... Po ç'ke ti kështu sonte? — u shqetësua mjeku.

Deni i ngriti prapë supet, Nuk i tha që tani e mendonte Rashën si një nimfë të bardhë mes fisit të fortë të dardanëve...

KAPITULL I VEÇANTË

Ajo ishte e zemëruar dhe i ra me forcë portares së drunjtë të oborrit të Salkës.

— Ej, Salkë! — thirri ajo.

Mbrëmja ishte e qetë dhe dëgjoheshin hapat e kalimtarëve të rrallë në asfaltin e rrugës pas apartamenteve. Nga shtëpia e ulët e Salkës nuk pipëtinte asgjë. Ishte në terr dhe mbi xhamat e saj thyhej drita e projektorit të portit.

Ajo e la trastën që kishte mbi shpinë dhe u zgjat mbi portaren. E shkundi atë fort, sikur të shkundte Salkën, e përplasi me rropamë dhe deshi të bënte një zhurmë ferri. Deshi ta nxirrte Salkën nga shtëpia në rrëmujë, me flokët e shprishur dhe këmbët zbathur. Deshi ta nxirrte në këmishë, po të ishte e mundur...

— Ej, Salkë! Portaren e ke hapur! Ec dhe mbylle si atëherë kur më zbove...

U mendua. U duk e hutuar... Atëherë kishte qenë

një derë e madhe dhe e rëndë dhe nuk kishin qenë këto kangjella të bukura. Salka e kishte rrëzuar shtëpinë e vjetër dhe kishte bërë të re.

E mblodhi veten shpejt. Asgjë nuk duhet të kishte ndryshuar gjersa aty ishte Salka!

Ajo thirri me të madhe dhe i trembi pëllumbat e Salkës. Ata nisën një gugatje të trazuar në atë qypezin e madh prej llamarine që zinte pothuaj gjithë fundin e oborrit. Megjithatë nuk luajtën nga vendi. As Salka nuk po luante nga vendi.

Ajo rrëmbeu një gur dhe i ra me fuqi llamarinës së qypezit. Pëllumbat u frikësuan dhe u turrën të gjithë jashtë.

— Pëllumbat e Krishtit... — pëshpëriti ajo dhe nuk pati më asnjë shpresë se mund të ishte Salka brenda.

Nuk luajti nga vendi. Iu kujtua se dhe atëherë kur e kishte zbuar kështjën ishte vonuar Salka. Edhe më përpara kështu vonohej të dilte ajo. Ishte martuar me njërin nga ato anë dhe i kishte vënë këmbën atij qyqari. Ai punonte, Salka urdhëronte! Ai punonte, Salka dridhte llafin oborr më oborr... «Salkë! Ti nuk ke burrë, po rrogëtar!» — i kishte thënë një herë ajo. «Burri është si qeni e ke për ta marrë vesh kur të martoheh!» — i ishte përgjigjur Salka. «Salkë! Ti nuk ke shpirt gruaje!» — kishte vazhduar ajo. «Nuk kam!» — i ishte përgjigjur Salka.

«As shpirt gruaje, as shpirt njeriu...» — tha me vete plaka dhe e shkundi prapë portaren. I ishte shmangur asaj kaq kohë. Nuk mund ta shihte në fytyrë. Kur i kishte dalë përballë herën e parë pas aq vjetësh, i qe dukur bota e padrejtë. Salka kapardisej dhe ishte plot siguri në vetvete! Duhet të kishte kaluar një jetë pa halle dhe trazime! Salka nuk e meritonte një jetë pa halle dhe trazime! E njihte mirë cila ishte Salka! Shumëkush ia kishte mbyllur derën, po ndaj tyre mendonte ndryshe. Disa i kishte harruar, disa i kishte falur, disa ishte duke i falur... Salkën nuk e kishte

parë gati një jetë, gjer ditën kur po kalonte rastësisht nga rrënojat e kishës së Lançit. Ishte hutuar dhe kish-te menduar për një çast se ishte në vend të huaj. Salka rrinte në gjunjë dhe falej. Atëherë ajo ishte tërbuar dhe kishte menduar se Salkën mund ta falte qielli e toka, po ajo nuk kishte për ta falur!

Nga oborri i Salkës vinte aroma dehëse e luleve. Gjithë oborri që me lule dhe ato e zemëruan edhe më shumë. Ajo vetë për shumë kohë nuk kishte mundur të mbillte lule dhe as ishte kujtuar që mund të kishte më lule në botë!

— A u çmende, mor zotni? Dola! Dola! — u dëgjua zëri i Salkës.

«Ah! Dole? Më mirë të mos kishe dalë! Do të të dalin mendtë!» — tha ajo me vete. Tani që po dilte Salka nuk ndihej aq e sigurt si përpara. Salka do t'i dilte me atë kapardisjen e përhershme. Do ta tërbonte nga inati dhe kështu nuk do të ishte në gjendje t'i thoshte ato që duhej.

E shkundi edhe një herë me forcë portaren. Nuk arriti ta nxirrte në këmishë. Arriti vetëm ta nxirrte zbathur, po kjo nuk ishte asgjë. Salka ecte zbathur në çimenton e pastër dhe të freskuar me ujë, ndërsa ajo kishte udhëtuar zbathur në gjysmën e Veriut!

— A mos luajte mendsh, mor zotni? — përsëriti Salka duke u munduar të shquante kush kishte guximin të sillej ashtu. Edhe atë çast ajo i dha rëndësi vetes siç i jepte gjithnjë. I vuri duart në bel dhe u përkul poshtë, që të shpëtonte nga drita e projektorit të portit që nuk e linte të dallonte kush ishte në derë.

— Salkë! Kam ardhur si atëherë kur mora arratinë, pse u futa në det! Më shtro bukë dhe më jep rroba! A nuk më sheh se jam në këmishë?

Salka u tërhoq praptas.

— Salkë! Po dridhem! — tha ajo dhe zuri të dridhej me të vërtetë.

Salka u mbështet pas qyvezit të pëllumbave. Nuk

kishte ku të shtyhej më tej. Pati frikë të futej në shtëpi.

— Salkë! Jam akull! Më bjer një shkrepëse, se do të bëj një zjarr...

Salka mendoi që do t'i digjte shtëpinë. Thirri. Mendoi që thirri...

Plaka rrëmbeu trastën që kishte lënë përdhe dhe e zbrazi të tërë në oborin e Salkës.

— Qe Ku i ke kryqet, ungjijtë dhe shenjtorët me gjithë papën! Unë i mblodha për ty përpara atyre që duhet t'i mblidhnin! Ditë për ditë kam kërkuar për ty!

Salka deshi të kërkonte ndihmë dhe nuk diti se kujt mund t'i kërkonte ndihmë. Ajo mendoi që e kishte braktisur zoti. Pastaj ajo pa një shkëndijë që u ndez aty te portarja dhe mendoi që zoti po i niste ndihmë. Pastaj ajo pa flakë dhe ungjijtë e kryqet duke u djegur...

Nuk u shqetësua njeri për ato flakë. Nganjëherë mbrëmjeve dyndeshin mushkonjat dhe nëpër oborret i zbonin me tym.

XXII

Karakolli hoqi këmishën dhe u ul në rërë. Pantallonat i mbajti. Ato nuk i hiqte në plazh. Ai e pa me bisht të syrit Pashk Lulin që mbeti vetëm në të mbathura. Ai gjithnjë mezi e kalonte çastin kur zhvishej Pashk Luli. Pastaj e harronte dhe i dukej si gjithë të rinjtë që mbushnin plazhin.

— Duhet të hash karrota... — tha Pashk Luli duke parë trupin e dobët të mikut të tij. Ai fërkoj gjoksin e vet të bëshëm.

Karakolli e pa siç do të shihte një budalla. Ishte e para herë që e shihte kështu dhe për pak sa nuk u shemb përgjithnjë stima e madhe që kishte për të. E kishte tërhequr gjer në fund të plazhit për t'u larguar nga rrëmuja e asaj së diele, që me sa dukej duhet të ishte e fundit në atë sezon. Vera ishte zgjatur përtej kufijve të vet dhe nuk do të shkonte shumë dhe di-

kush do ta shtynte andej nga kishte ardhur... Kështu kishte thënë Pashk Luli dhe kjo ishte fjalë e zgjuar, jo ajo e karrotave...

Karakolli i harroi karrotat. Ai nuk kishte dëshirë as të rrinte në plazh, po nuk kishte ku e gjente tjetër Pashk Lulin. Ai e detyronte. Ai e kishte detyruar të hiqte këmishën vite përpara dhe të nxirrte në mes të njerëzve dhe në mes të diellit atë trupin e bardhë me kockë të madhe. Megjithatë kishte arritur gjer te këmisha, te pantallonat nuk kishte arritur. Po Pashk Luli vazhonte të luftonte edhe për ato. Karakolli mbrohej dobët dhe në ndonjë rast fatlum i vinte në ndihmë ndonjë moshatar i tij që ishte parodia e plazhit.

— Nuk i hoqe pantallonat? — pyeti Pashk Luli.

Nuk mund të zemërohej me të, sepse e donte kështu siç ishte. Ai po kalonte gjëmën më të madhe të jetës së tij pas mbytjes së të birit dhe Pashk Luli merrej me pantallonat e tij! Ai ndoshta këtë donte! Me siguri që nuk mund të rrinte me ata që tash e parë i përmendnin të birin. «Dhimbja për tënd bir as nuk duhet të jetë një gjë e kaluar, as një gjë prezente! Duhet të jetë vetëm dhimbje!» — i kishte thënë Pashk Luli. Ashtu e kishte pranuar edhe Karakolli.

— Jemi mirë... — tha papritur Karakolli.

— Ta merr mendja... — u përgjigj tjetri. Ai e kuptoi atë fjalë në përgjithësi, për gjithë shoqërinë.

— Po lëmë një tokë të bukur mbrapa... — tha Karakolli.

— Të bukur... — përsëriti Pashk Luli.

— Po lëmë njerëz të fortë...

— Të fortë... — përsëriti Pashk Luli. Ai u kujtua me vonesë. Ç'bënte kështu Karakolli? Testamentin?

Karakolli ishte gjithë dritë. Nuk kishte fytyrë testamenti. Dielli shkëlqente i madh dhe i pastër në mes të qiellit. Ishte i gjithëpushtetshëm. Karakolli priste Denin. E kishte kërkuar dy herë në shtëpi, po ai nuk kishte ardhur ende. I kishte lënë fjalë ta kërkonte në plazh.

— O burra të ikim! — tha papritur Pashk Luli. Ai u ngrit ndenjtur me fytyrën andej nga po vinte Taushi.

— Nuk na trazon...

— E ka atë arkën nën sjetull... — tha Pashk Luli që e kishte beterr shahun në dorën e Taushit.

Taushi e nguli shkopin e çadrës fare pranë shpinës së tyre. Vuri çadrën, pastaj numëroi pesë hapa me zë dhe aty u shtri. Ishte i ndërgjegjshëm për rrezikshmërinë e tij. Ata i nderoi me çadër, për vete ndenji në diell! Duroi sa duroi pa folur, pastaj pyeti sa ishte ora.

Karakolli nguli një shkop në rërë dhe vështroi hijen e tij.

— Dhjetë e njëzet! — tha.

Pashk Luli nxori sahatin e çhepit. Karakolli kishte gabuar dy minuta. Nuk i tha gjë Taushit.

Kaloi një plazhist dhe pyeti për Denin!

— Do të vijë këtu! — i tha Karakolli. Ai vuri buzën në gaz. Nga bregu shkonin Hata me të shoqin. Ajo përpara, ai prapa. Kur i afrohej, ajo i binte me bërryl dhe e linte pas. Karakolli vështroi Taushin. Ai fryu hundët dhe i ktheu shpinën. Po nuk ndenji gjatë ashtu. I lehën zagarët e Gjon Kabashit pothuaj te veshi dhe ai u ngrit duke turfulluar.

— Ai është sirvil! Sirvil i Murat Nallbanit! — shfryu Taushi.

— Servil... — e korrigjoi Pashk Luli.

— Sirvil të thonë! Po i rrit zagarin! — vazhdoi Taushi.

— Ej! Djali! Nuk futen qentë në det! — i thirri Pashk Luli.

— Pse, ç'kanë qentë? — u kthye nga ai Gjon Kabashi.

— Qentë janë qen... — iu mor goja Pashk Lulit.

— Ehu! — nuk ia vari tjetri dhe i nxiti qentë të hynin në det.

— Ai nuk është servil! Ai po i paguan borxhin Murat Nallbanit! — vërejti Karakolli.

— Për borxh janë një me një! Të dy zagarët mbaruan! — nuk iu mbush mendja Taushit.

Po vinte Deni me Palin.

— Jam i lodhur! — tha Deni dhe u shtri në rërë.

— Ku e këmi kapitenin?

— Iku për provimet! — u përgjigj Deni. Edhe atij i duhej të ikte ato ditë dhe nuk ishte aspak i sigurt.

— A nuk vjen tek unë? Po të pres... — i tha Karakolli Denit.

— Jam i vdekur për gjumë, po edhe mund të vij. Karakolli vërejti Pashk Lulin.

Zagarët e Gjon Kabashit dolën nga deti. U shkundën dhe e stërpikën Taushin duke i shkuar përbri. Taushi u ngrit në këmbë si i tërbuar.

— Më lagën me ujë qeni! — thirri ai krejt i zverdhur.

— Qetësohu! — i foli Deni.

— Mirë e ke... — u shtrua përnjëherësh Taushi dhe u ul në vend.

— Den! Të kërkon Riqoja! — i tha Pali.

Tjetri ktheu kokën me përtim. Riqoja rrinte tutje dhe priste.

— Ngrehu! Diçka ka...

Deni iu afrua djalit. Riqoja e pa me vëmendje, sikur ta kontrollonte mos kishte humbur ndonjë gjymtyrë.

— Ajo është aty... — i tha Denit.

— Kush është aty?

— Ajo me kostum të bardhë!

Deni mbeti një çast dhe nuk diti ç'të bënte.

— Nuk më hyn në punë! — tha Deni.

— Po ec një herë! Ec! — e tërhoqi për mënge djali me dëshpërim.

— Rri! Më shqeve...

Riqoja e tërhoqi ashtu disa hapa dhe ai e ndoqi padashur, sikur të kapërcente pengesa. Nuk i kundërshtonte më tej aty në mes të plazhit.

Djali i tregoi atë vajzën me kostum të bardhë që ishte shtrirë përmbysh në rërë.

— Të thashë që nuk më hyn në punë! — u zemërua Deni. Ai u shkëput nga Riqoja.

— Ti je qorr! Ajo është Rasha! — picërroi sytë djali.

Ai një herë mendoi që Riqoja kërkonte një shpullë, pastaj mendoi që Rasha kërkonte një shpullë... Ajo po tallej me të! Po e fëlliqte në sy të të gjithëve!

Ai iu afrua me hap të rëndë.

— Ngrehu! — i tha ai.

— Ku të shkoj? — pyeti vajza pa e luajtur fare kokën.

— Shko në djall! — hungëroi Deni.

— Në djall nuk shkohet me kostum të bardhë...

— u përgjigj Rasha.

Qeshi dhe ndjeu rrahjet e zemrës. Mendoi që as ai nuk mund të shkonte në djall... Nuk shkohej në djall me ato rrahje zemre!

— E kam ditur që nuk do të martohem si të tjerët...

— tha Deni me të butë.

— Si do të martohesh? — u kthye Rasha nga ai.

— Duke i vënë llozin derës dhe duke e shtrënguar fort... — tha ai.

— E dike frikën... — u bë lozonjare ajo.

— Ngrehu! Ne nuk kemi bërë gjë tjetër vetëm kemi humbur kohë! — i tha ai me zë të vendosur.

Ajo u turbullua. Vështroi rreth e rrotull me njëfarë hutimi.

— Të gjithë i kanë sytë kënde... — i tha ajo.

— Ngrehu! Kjo nuk ka rëndësi më... — i tha ai.

— Gjon Kabashi nuk do të më falë! — u zbeh Rasha.

— Nuk i dihet! — tha ai, megjithëse emri që kishte përmendur Rasha nuk ishte aspak premtues.

— Nuk kam menduar për rrobat! Nuk kam asgjë...

— Nuk mund të mendoje për të gjitha! Ke menduar për kostumin e bardhë,— i tha ai pa u kujtuar që mund ta fyente.

— Vetëm mos u mburr! Mos u mburr, se e ndiej veten keq! — tha Rasha.

— Unë mund të bëj çdo gjë! Unë të dua! — i tha ai.

Rasha qeshi. Ajo sikur nuk kishte ndër mend të luante nga vendi. Mbase e kishte ëndërruar një fund të tillë, po nuk e kishte menduar kështu. I pëlqeu ky fund, prandaj donte ta zgjaste sa më shumë. Ajo druhej se nuk do të flisnin më kështu asnjëherë në jetë.

— Të kam munduar si budalla! — i tha Deni.

— Edhe unë të kam munduar kohët e fundit! — i tha ajo.

Rasha u ngrit dhe veshi fustanin.

— Sa mirë që e mbulove atë kostumin e bardhë...

— E hedh! Ç'do tjetër? — deshi të bënte shaka ajo, po buzët zunë t'i dridheshin. I tha se kishte qarë natën. Ishte marrë vesh se ishte gjetur një minë dhe ajo kishte pritur ta sillnin Denin copa-copa, ose të mos e sillnin fare... — Nuk do t'u thuash gjë atyre? — pyeti pas pak dhe u kthye përgjysmë nga ishte Karakolli me shokë.

Ata ishin ngritur në këmbë dhe heshtnin. Prisnin një gjë të madhe. «Ç'bëjnë ata?» — kishin pyetur Riqon. «Përrallisin për ca filma...» — i kishte qetësuar Riqoja. Megjithatë nuk i kishte shmangur të prisnin një gjë të madhe...

Më në fund Karakolli u shkëput nga grumbulli. E pa Denin në sy dhe mendoi që kishte ardhur në çastin e duhur.

— Karakolli! Unë po e marr Rashën... — tha Deni.

— Ti po e merr Rashën dhe Gjon Kabashi nuk di gjë... — tha Karakolli sikur të përpiquej të zgjidhte një nyjë.

— Ashtu, ashtu... — tha Deni.

— A ke provuar ndryshe? — pyeti Karakolli. Qe pothuaj një pyetje formale. Karakolli sikur deshi të përshkonte Denin me qëllim nëpër të gjitha rrugët e

zakonshme e pastaj të arrinte gjer aty ku mendonte. Qe një justifikim për Denin.

— E kam provuar! Nuk është dakord!

— Atëherë paske mbetur vetëm me një rrugë...

— Me një rrugë! — përsëriti Deni.

— Ai ta zë rrugën! Ai duhet përmbajtur!

— Ashtu, ashtu... — sikur u zgjua Deni. E kishte kapërcyer shumë lehtë Gjon Kabashin.

— Ai duhet sqaruar dhe duhet përmbajtur...

— Kush mund ta përmbajë?

— Po e provoj një herë! Po nuk ia dola unë, ka kush ia del... Shteti... — vazhdoi Karakolli,

Gjon Kabashi nuk do t'i binte ndesh shtetit, kishte respekt të madh për shtetin. Do të lidhte duart dhe do të heshte, po ata do ta humbisnin përgjithnjë. Kështu mendoi Deni.

— Shteti të jetë në fund fare! — tha Deni.

— Në fund fare! — pranoi edhe Karakolli.

— Nuk dua që ata të bëjnë rrëmujë në plazh! Ata janë të marrë... — bëri buzën në gaz Deni duke treguar shokët e tij. E mori Rashën dhe u nisën.

— Riqo! Të ngriti potkonjtë! Të la në baltë! Nuk ka më nevojë as për ty, as për ne ai! — u dëgjua zëri i Taushit.

Deni buzëqeshi.

— Unë u kam shumë borxhe atyre... — tha ai me mall.

— Unë nuk dua që ti të ndahesh nga ata! — ndërhyri Rasha me të shpejtë.

Kishin dalë pas kabinave kur Rasha e tërhoqi fort për krahu. Gjon Kabashi ngjitej përpjetë me një rrjetë në dorë. Kishte marrë bukën. Shkonte rrugës qetësisht dhe si i dallësur në mendimet e tij.

— Nuk do ta hajë atë bukë... — pëshpëriti Rasha.

Deni u trondit. Për një çast iu duk sikur lumturia e tyre rrinte pezull mbi fatkeqësinë e Gjon Kabashit.

— Do të përpiqem që ai ta hajë atë bukë...

Kapërcyen rrugën. Deni buzëqeshi pasi hapi porta-

ren e oborrit. Për pak sa nuk e përplasi pas vetes ashtu siç e kishte zakon kur vinte vetëm. Iu kujtua e ëma. Sa herë e kishte sharë për atë të përplasur...

E ëma hante bukë. Ishte me fytyrë nga dera dhe i pa kur hynë të dy. I mbeti buka në dorë.

— Kjo është Rasha... — tha me njëfarë turbullimi Deni.

E ëma e la bukën. E uli atë dorë aq ngadalë, sa Rashës i erdhi të turrej jashtë dhe të ikte.

— Kjo është Rasha! — përsëriti Deni me njëfarë zemërimi.

E ëma u ngrit dhe vuri edhe një pjatë tjetër afër pjatës që kishte ndarë për Denin. Pastaj u çua, i vështroi një copë herë nga dera dhe u nis nga dhoma e saj.

— Edhe ajo pa bukë... — pëshpëriti Rasha.

— Megjithatë neve na e shtroi... — mezi e shfajësoi të ëmën Deni.

Rasha u ul në divan. Ishte krejt e këputur.

— Unë prita që ajo të më përqafonte! — tha Rasha. Ajo kishte mbështetur kokën pas divanit dhe kishte mbyllur sytë.

Deni zuri të vërtitej nëpër dhomë. Iu afrua derës së jashtme dhe i vuri llozin. U mendua dhe e hoqi. E hapi derën me inat. E hapi në të dy kanatet. Pastaj shkoi pranë Rashës.

— Mos i mbaj mëri... — i tha Rashës. — Ajo është grua e bardhë! Mos e shih nga kjo ditë...

— Të lutem mbylle derën! Nuk e di se si më duket me derë hapur...

«Të duket sikur po e ftoj Gjon Kabashin për sherr...» — tha ai me vete. Deni u ngrit dhe e mbylli derën, pastaj u ul në divan pranë Rashës. I mori dorën.

— Hëpërhë jemi si një ishull në mes dy rrymash të forta... — u mendua të buzëqeshte Rasha.

— Do të qetësohen! — tha Deni. Të paktën me të ëmën nuk e kishte të vështirë. Do të kthehej menjëherë, sa t'i ikte hutimi.

— Po më çahet koka... — tha Rasha. Ajo shtrëngoi tëmthat me duar.

Ai kërkoi gjithandej dhe nuk gjeti një aspirinë. I erdhi të rroposte gjithçka që kishte në dhomë. Rasha po e niste jetën me një dhimbje koke!

— Më fal për të gjitha këto... — i tha Rashës.

Ajo zgjati dorën dhe i shpupurishi flokët sikur të ishte ndonjë fëmijë.

— Hesht! Po më çahet koka! — i tha.

Ndenjën ashtu pa folur për një kohë. Me kokën mbështetur pas divanit dhe sytë mbyllur.

— Ai do të vijë... — tha papritmas Rasha.

«Ai do të vijë dhe unë nuk do të lëviz gjersa të shtrijë dorën për të marrë Rashën. Po e shtriu, janë fjalë të tjera...» — mendoi Deni.

— Ai po vjen... — tha Rasha.

Ajo ishte e qetë, e vendosur, po Deni nuk e duronte dot duke folur. E luti të heshte.

— Të hesht? Po ai është në udhë!

Kush ishte në udhë? Hija e Gjon Kabashit? Kishte lënë trevën e vjetër të gjyshërve të rreptë dhe vinte të merrte hak?

Deni për pak sa nuk thirri. Ajo po e mpinte, po e linte pa fuqi.

— A nuk i dëgjon hapat?

Nuk e mbajtën dot veten dhe kërcyen të dy në këmbë. Në prag të derës rrinte Karakolli.

— As luftë, as paqe! — tha ai.

XXIII

Kërceu nga anija të zgjidhte cimën. Gjeti shkak për t'i ikur Taushit që nuk po e linte të qetë, se mund t'i thërriste kujt do për cimën. Edhe tani vinte nga kuverta zëri i Taushit që këndonte me zë të trashë.

*Ägo Imeri u martu,
sall një natë ndejti me gru...*

Punëtorët e molos fishkëllenin dhe thërrisnin Denin. Deni ishte skuqur, po shpirtin e kishte të ngrohtë.

— Ej, Den! Mos fli, po zgjidhna cimën! — i thirrën nga kuverta.

«Pulëbardha» kishte ndezur motorin. Edhe anijet e tjera ishin gati. Pritej vetëm lëvizja. Ky ishte çasti i shkëputjes nga toka. Ai vinte në mënyrë të befasishme dhe linte pas vetes shkumën që krijonin helikat dhe mallin që përfytyronin njerëzit. Gjithmonë do të kish-te njëfarë malli kur lije tokën, gjithmonë do të kish-te njëfarë malli kur lije detin...

Ago Imeri u martu,
sall nji natë ndejti me gru... — erdhi zëri i

Taushit.

Deni e zgjidhi cimën dhe u bë gati t'i jepte krah në anije, kur dëgjoi pas shpine zërin e kryeinxhinierit. Ai vraponte dhe u thërriste të prisnin.

— Ç'ka ngjarë? — pyeti Deni. Ai u ftoh përnjëherësh duke parë Landin.

— Ku është kapiteni?

— Është me leje!

— Kush e zëvendëson?

— Unë! — tha Deni me bezdi.

— Mbajeni motorin! «Pulëbardha» nuk del në det!

— Pse? — pyeti me qetësi Deni. Ai u vrenjt pak nga pak duke parë kryeinxhinierin që po vonohej të përgjigjej.

— Posa erdhi një fonogram urgjent nga dikasteri. Të gjitha mjetet e lundrimit prej druri, të cilave u ka kaluar afati i skadimit dhe qarkullojnë ende, duhet të asgjësohen menjëherë!

— Të asgjësohen? Mos u tall, kryeinxhinier... — e mbajti veten Deni, megjithëse pati përshtypjen se ishte përpara një dënimi me vdekje.

— «Pulëbardha» ka dy vjet që e ka kaluar afatin dhe nuk jemi kujtuar. Posa kontrollova kartelën...

— Të asgjësohet? Po a je në vete? — u gjallërua Deni. Ai u kthye nga Karakolli dhe e pati inat. Si mund të rrinte aq i qetë? A nuk dëgjonte që po flitej për një dënim me vdekje? Nuk do të kishte më «Pulëbardhë»!

— U mbyt ajo peshkarexhja prej druri në Jon dhe pas kësaj kuptohet që shtrëngohen masat... — tha kryeinxhinieri. Ai përpigjej të ishte gjakftohtë, po nuk i shkonte. Ai ishte një njeri me ndjenjë dhe nuk i shkonte të luante zyrtarin e ftohtë.

— «Pulëbardha» është anije e fortë dhe asnjëherë nuk na ka shkuar nëpër mend që është prej druri... — vërejti Deni. Më, saktë, nuk u kishte shkuar ndër

mend të ishte më e dobët se të tjerat. E kishin provuar në kohë të mirë dhe në të keqe, në dallgë dhe në stuhi! Anijet metalike rrinin mbi ujë, mbi ujë rrinte edhe «Pulëbardha»! Mbase ishte një arsyetim i dobët, po nuk e kishin vrarë mendjen fort për këtë.

— Urdhri është urdhër...

— Kryeinxhinier! Ti po tërhiqesh, se e di edhe vetë se është urdhër në tym! Pse nuk merr Karakollin? I ka kaluar të shtatëdhjetat dhe është më i fortë se ne të dy. Brenda urdhrave duhet të ketë përjashtim për «Pulëbardhën» në lundrim, ashtu siç ka përjashtim për Karakollin në natyrë! — tha Deni, i kënaqur nga krahasimi që gjeti.

— Nuk e kam të lehtë ta zbatoj këtë urdhër... Me këtë anije më ka ecur dhe ajo na ka zbardhur faqen të gjithëve! Mos mendon se do ta djegim? Aty le të rrijë në molo, sa t'i vijë fundi dhe të kalbet nga deti dhe nga pleqëria! Askush nuk do të guxojë ta prekë me dorë! Të jap fjalën...

Deni u zbut. I erdhi keq për kryeinxhinierin. Ai do të mbetej një fëmijë i mirë gjer në pleqërinë e vonë. Si kishte thënë ai? Do ta linte anijen të paprekur në molo si një monument të mallit të tyre!

— Ashtu do ta kemi edhe më keq! Do ta kemi para sysh... — tha Deni. Ai tani po vuante të gjente një fjalë kundër Karakollit që heshte me dorën në mjekër.

— Pse mërziteni? Për dy javë vjen këtu anija e re dhe atë do ta merrni ju! E pushë në Durrës. Vetëm oxhakun e kishte të palyer...

Deni për pak sa nuk e shtyu. Nuk kuptonte ai, apo bënte sikur nuk kuptonte?

— Nuk mërzitem se mbetem pa anije dhe pa punë! Mërzitem për «Pulëbardhën»! Kaq gjë duhet ta kuptoje... — nuk e mëshiroi aspak Deni.

— Thuaju atyre të zbresin... — tha si i trullosur kryeinxhinieri. Ai e kuptoi që ia kishte veshur së prapthi.

— Ata do të të shqyejnë! — tha Deni që po e

zbrazte gjithë inatin mbi kryeinxhinierin. E ndiente që nuk kishte të drejtë, po nuk e përmbante veten. Kishte nevojë të shfrente diku.

— Nuk do të më shqyejnë! Do të merremi vesh...

— Ç'thotë drejtori? — pyeti Deni pa asnjë shpresë.

— Kujt ia mban të kundërshtojë në të tilla raste? Se... Se po ndodhi ndonjë hata, të pi e zeza!

— Ti, po të duash, e rregullon... Bëj një raport me shkrim që «Pulëbardha» i ka garancitë për të lundruar! Bëje, se nuk thua një gjë që nuk është... — u lut Deni:

— Oh, Deni! Si nuk e kupton që bëhet fjalë për jetën tuaj? Askush nuk mund të mbajë përgjegjësi për këtë...

Deni u kthye nga anija. I pa shokët të shkujdesur, të harruar pas përgatitjes së nisjes, dhe mbeti bosh. Iu vel puna, profesioni, deti... Ë pa detin të flashkët, të ndyrë dhe të ndragur nga mbeturinat e lëndës së shkatërruar të «Pulëbardhës», e pa anijen copa-copa! Me lëndën e saj shkrinin serën punëtorët e ndërmarrjes së ndërtimit, siç bënin me rrangallat e sandallave të kalbur që ua jepte peshkimi.

Tymi i serës i mbuloi gjithë portin...

— Inxhinier! Ky është tymi, flaka... — pëshpëriti Deni:

— Ç'ka kryeinxhinieri? — u përmend Karakolli. Nuk kishte dëgjuar asgjë. Kot ishte nxehur Deni.

Tjetri i tha që duhet të zbrisnin në tokë. Foli me hall të madh dhe duke vështruar përreth punonjësit e portit, që rrinin si në ndonjë funeral. Fytyrat e tyre ishin të mërzitura dhe gati armiqësore.

— Shpirti i Xhikes, mos u tall... — deshi ta merrte me të qeshur Taushi.

— Nuk tallem! Zbrisni! Nuk kemi ç'të bëjmë! Urdhër!

— Kush e dha këtë urdhër? — pyeti Pali.

— Dikasteri!

— Dikasteri nuk ka ardhur kurrë me «Pulëbardhën»! — tha Taushi.

— Pse lodheni? Nuk ka burrë ta thyejë këtë urdhër! Më vjen keq, por... — Kryeinxhinieri ndihej keq përpara të gjithëve. Ishte penduar që ishte turrur ashtu me të marrë fonogramin. Po ç'mund të bënte?

Karakolli fërkoj mjekrën me dorë dhe mori nga anija. U hodh brenda dhe u ul mbi një arkë. Pas tij u shkëput Ndoc Marku dhe bëri të njëjtën gjë. Pali sëç pëshpëriti dhe ndoqi të njëjtën rrugë.

— Ej! Ej! — ia bëri kryeinxhinieri, i mbytur në djersë. I vinte turp dhe e ndiente të lëkundur autoritetin e vet. Pas shpinës dëgjonte thumbat e punonjësve të molos, që shkonin në favor të «Pulëbardhës».

— Kryeinxhinier! Shpirti i Xhikes! Kur të mbytet «Pulëbardha», unë do të rri mbi ujë! — tha Taushi dhe kërcëu në anije.

Deni u kthye nga motoristi. Ai qeshi nën buzë dhe iku pas Taushit.

— Me sa po shoh, paskam mbetur vetëm... Nuk mund të ndahem prej shokësh, kryeinxhinier! Mbasi nuk mund të shkojmë me gjithë «Pulëbardhën» në dikaster, po dalim në det! — tha Deni. Ai e kishte marrë veten mirë dhe ishte gati të kapërcente çdo pengesë. Ai mendoi për një çast që gjëja më e bukur që kishte bërë në jetë ishte kthimi në det, ishte puna me ata njerëz që rrinin ulur atje mbi arkat e sardeles dhe ishin të lidhur pas anijes, si pas truallit të të parëve të tyre!

Anija u shkëput nga toka, u lëkund ngathët dhe mori udhë. Kryeinxhinieri u gëlltit me zor. Grykën e kishte të tharë sikur të ishte përvëluar në piskun e vapës. E gjitha kjo ishte kaq e beftë dhe e pabesuar, sa ai përpëlitej mes kënaqësisë dhe pakënaqësisë së atij fakti. I vinte t'u thërriste të qëndronin, i vinte t'u thërriste të merrnin detin...

«Pulëbardha» po humbiste në horizont. Mjeku me-



— Dikasteri nuk ka ardhur kurrë me «Pulëbardhën»! — tha Taushi.

— Pse lodheni? Nuk ka burrë ta thyejë këtë urdhër! Më vjen keq, por... — Kryeinxhinieri ndihej keq përpara të gjithëve. Ishte penduar që ishte turrur ashtu me të marrë fonogramin. Po ç'mund të bënte?

Karakolli fërkoj mjekrën me dorë dhe mori nga anija. U hodh brenda dhe u ul mbi një arkë. Pas tij u shkëput Ndoc Marku dhe bëri të njëjtën gjë. Pali seç pëshpëriti dhe ndoqi të njëjtën rrugë.

— Ej! Ej! — ia bëri kryeinxhinieri, i mbytur në djersë. I vinte turp dhe e ndiente të lëkundur autoritetin e vet. Pas shpinës dëgjonte thumbat e punonjësve të molos, që shkonin në favor të «Pulëbardhës».

— Kryeinxhinier! Shpirti i Xhikes! Kur të mbytet «Pulëbardha», unë do të rri mbi ujë! — tha Taushi dhe kërceu në anije.

Deni u kthye nga motoristi. Ai qeshi nën buzë dhe iku pas Taushit.

— Me sa po shoh, paskam mbetur vetëm... Nuk mund të ndahem prej shokësh, kryeinxhinier! Mbasi nuk mund të shkojmë me gjithë «Pulëbardhën» në dikaster, po dalim në det! — tha Deni. Ai e kishte marrë veten mirë dhe ishte gati të kapërcente çdo pengesë. Ai mendoi për një çast që gjëja më e bukur që kishte bërë në jetë ishte kthimi në det, ishte puna me ata njerëz që rrinin ulur atje mbi arkat e sardeles dhe ishin të lidhur pas anijes, si pas truallit të të parëve të tyre!

Anija u shkëput nga toka, u lëkund ngathët dhe mori udhë. Kryeinxhinieri u gëlltit me zor. Grykën e kishte të tharë sikur të ishte përvëlur në piskun e vapës. E gjitha kjo ishte kaq e beftë dhe e pabesuar, sa ai përpëlitej mes kënaqësisë dhe pakënaqësisë së atij fakti. I vinte t'u thërriste të qëndronin, i vinte t'u thërriste të merrnin detin...

«Pulëbardha» po humbiste në horizont. Mjeku me-

ndoi për horizontin e burrave, si për diçka pa fund...

Karakolli rrinte si orakull në anije. Fliste me Denin dhe nuk donte përgjigje. Donte vetëm ta dëgjonte.

— Kur e kisha djalin, isha burrë, isha plak, ndërsa tani më duket vetja fëmijë!

Deni vuri dorën e tij mbi dorën e Karakollit.

— E di pse ndodh kjo? Pse njeriu do që jeta të vazhdojë, të nisë gjithnjë nga e para... Unë nuk kam mundësi ta shtyj jetën gjatë si plak dhe prandaj e ndiej veten fëmijë! — buzëqeshi lehtë Karakolli.

Denit iu shtuan të rrahurat e zemrës dhe iu lidh diçka në gjoks. Nuk e merrte vesh mirë; Karakolli ishte disi i ngatërruar, po një gjë ishte e qartë dhe ajo e ngashëreu: Karakolli donte ta shtynte jetën dhe kjo rrinte mbi të gjitha.

ky libri është
mjaft i mirë
nga Çika
kot
love

Drini, S.
Njerëzit dhe deti. Roman. [Red. N.
Dujaku] T., «Naim Frashëri», 1987.
296 f.
891.983-31
D 76

Tirazhi 6000 kopje Formati 78x109/32 Stash 2204-82
KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re Tiranë, 1987